



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORTI VJETOR 2014

Nr. 14

Prishtinë 2015

Z. Kadri Veseli

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Prishtinë

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 135, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 27, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Ju paraqes Raportin e katërmbëdhjetë vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht, Ju lutem të pranoni edhe kërkesën për paraqitjen e këtij Raporti në seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe hapjen e diskutimit në lidhje me këtë Raport.

Me nderime,

Sami Kurteshi



Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 31 mars 2015

PËRMBAJTJA

Fjala e Avokatit të Popullit	11
Përmbledhje e përgjithshme	14
a. Vështtrim i përgjithshëm mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në vitin 2014	14
b. Struktura dhe përmbajtja e këtij Raporti	16
c. Në vend të përfundimit	27
Kapitulli I	29
Institucioni i Avokatit të Popullit	29
1.1. Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit	29
1.2. Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit	31
1.3. Zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare	32
Kapitulli II	35
Pjesa e parë - Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut	35
2.1. E drejta për jetën	35
2.1.1. Pasojat e mosveprimit respektivisht zvarritjes në gjykatë	35
2.1.2. Mungesa apo zvarritja e hetimeve	36
2.2. Dinjiteti i njeriut dhe integritetit personal	37
2.2.1. Shkelja mbi dinjitetin e njeriut	37
2.2.2. Integriteti personal	38
2.3. E drejta e lirisë dhe sigurisë	40
2.4. Ndalimi i torturës	41
2.4.1. Vizitat në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria	41
2.4.2. Ankesat e personave të privuar nga liria	42
2.4.3. Lirimi me kusht	42
2.4.4. Kujdesi shëndetësor	43
2.4.5. Mbipopullimi	45
2.4.6. Institucionet e shëndetit mendor	47
2.4.7. Grupi Punues për Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës	48
2.5. Liria e lëvizjes	49
2.5.1. Zbatimi i marrëveshjes për lirinë e lëvizjes	50
2.5.2. Liria e lëvizjes në pjesën veriore të Kosovës	50
2.5.3. Udhëtimi në BE	52
2.6. E drejta e privatësisë	53
2.6.1. E drejta për mjedis të shëndetshëm dhe e drejta e banimit	54
2.6.2. Kontrolli dhe përgjimi i mjeteve të komunikimit	54
2.7. E drejta e martesës dhe e familjes	55
2.7.1. Roli i Qendrave për Punë Sociale	56
2.7.2. Problemet me pagesën e alimentacionit	57
2.8. Liria e besimit, ndërgjegjes dhe e fesë	58
2.8.1. Mirëmbajtja e trashëgimisë kulturore dhe varrezave	59
2.8.2. Informimi i publikut dhe bashkëpunimi ndërfaqetare	59
2.8.3. Statusi i bashkësive fetare në Kosovë	60

2.9.	Liria e shprehjes.....	61
2.10.	Liria e mediave.....	62
2.11.	Liria e asociimit.....	64
2.12.	Liria e tubimit	65
2.12.1.	Protesta e studentëve para Rektoratit.....	65
2.12.2.	Protesta e ish-punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore	66
2.12.3.	Protesta e organizatave joqeveritare	66
2.12.4.	Protesta e Organizatës së Veteranëve të Luftës.....	67
2.13.	E drejta e votës.....	68
2.13.1.	Vëzhgimi i zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Kosovës.....	68
2.13.2.	Fushata e pashpallur zgjedhore e qetë.....	69
2.13.3.	Zhvillimi i zgjedhjeve	69
2.13.4.	Rastet konkrete të shkeljeve të regjistruara.....	69
2.14.	E drejta e pronës	71
2.14.1.	Ankesat ndaj komunave.....	72
2.14.2.	Ankesat ndaj Agjencisë Kosovare të Privatizimit.....	72
2.14.3.	Agjencia Kosovare e Pronës	75
2.14.4.	Ankesat ndaj kompanive publike dhe KEDS	77
2.15.	E drejta për arsimin	78
2.15.1.	Arsimi para-universitar	78
2.15.2.	Arsimi universitar	79
2.15.3.	E drejta për arsimim e fëmijëve me aftësi të kufizuara.....	80
2.15.4.	Ankesat për arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuara	81
2.15.5.	Rasti ex officio kundër MASHT-it.....	81
2.15.6.	Ankesa e përfaqësuesve të komunitetit ashkali.....	82
2.16.	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	83
2.16.1.	Ankesat e regjistruara në IAP	83
2.16.2.	Mbrojtja dhe siguria në punë	84
2.17.	E drejta e qasjes në dokumente publike	85
2.17.1.	Mangësitë e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.....	85
2.17.2.	Afatet për përgjigje dhe vonesat e institucioneve përgjegjëse.....	86
2.17.3.	Mbrojtja e privatësisë dhe e të dhënave personale	87
2.17.4.	Mohimi i paarsyetuar i qasjes në dokumente publike	87
2.17.5.	Gjetja e punëve përgatitore të hartimit të Kushtetutës.....	88
2.18.	Përgjegjësia për mjedisin jetësor	89
2.18.1.	Ndotja e ajrit.....	90
2.18.2.	Ndotja e ujit.....	91
2.18.3.	Dëmtimi dhe shkatërrimi i tokës bujqësore dhe pyjeve.....	91
2.18.4.	Planifikimi hapësinor	91
2.18.5.	Problemet me menaxhimin e mbeturinave.....	92
2.18.6.	Ndikimi i ndotjes së mjedisit në shëndetin e njeriut	92
	Pjesa e dytë - Diskriminimi.....	94
2.19.	Barazia para ligjit	94
2.19.1.	Zbatueshmëria e ligjeve	94

2.19.2.	E drejta e punës dhe diskriminimi në moshë.....	94
2.19.3.	Personat me aftësi të kufizuara (PAK).....	95
2.19.4.	Infrastruktura ligjore dhe zbatimi i saj në praktikë.....	95
2.19.5.	Kushtet për arsimim të PAK në shkollat publike.....	96
2.19.6.	Kufizimi dhe pengimi i lëvizjes së lirë për PAK.....	97
2.19.7.	E drejta për arsimin.....	97
2.19.8.	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK)	98
2.19.9.	Çështja e strehimit.....	99
2.20.	Barazia gjinore	100
2.20.1.	E drejta në punë dhe vendimmarrje	100
2.20.2.	E drejta e pronës dhe trashëgimisë	101
2.20.3.	Ankesat në lidhje me të drejtën në pronë dhe trashëgimi	101
2.20.4.	E drejta për mbrojtje shëndetësore.....	101
2.20.5.	Dhuna në familje	102
2.20.6.	Gratë dhe vajzat, viktima të dhunës seksuale gjatë luftës.....	102
2.21.	Të drejtat e fëmijëve	103
2.21.1.	Kontaktet e fëmijës me prindin që nuk ushtron kujdesin prindëror	103
2.21.2.	E drejta e fëmijëve për shkollim.....	104
2.21.3.	Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla	105
2.21.4.	Trafikimi me qenie njerëzore - fëmijët viktima.....	106
2.22.	E drejta shëndetësore dhe sociale.....	107
2.22.1.	Shërbimet e mangëta shëndetësore dhe dyshimet për keqpërdorime	108
2.22.2.	Vlerësim i përgjithshëm i fushës së shëndetësisë.....	108
2.22.3.	Ankesat e njerëzve në sistemin shëndetësor.....	108
2.22.4.	Mirëqenia sociale.....	109
2.22.5.	Rastet konkrete në IAP për çështjet e ndihmave sociale.....	110
2.22.6.	Kërkesat për strehim social	111
2.22.7.	Vendimet kundërligjore të ministrit të MPMS.....	112
2.23.	Të drejtat e komunitetit LGBT.....	113
2.24.	Përdorimi i gjuhëve.....	115
2.24.1	Ankesat e parashtruara në lidhje me përdorimin e gjuhës	116
2.24.2	Përdorimi i gjuhës në nivelin qendror dhe lokal.....	117
2.24.3	Problemet me përkthimet në gjuhët zyrtare.....	118
2.24.4	Problemet dhe shkaqet e mosrespektimit të gjuhëve zyrtare në administratën publike	118
2.24.5	Problemet e informimit elektronik në gjuhë të ndryshme nëpër komuna.....	119
2.24.6	Shembulli i mirë – përmirësimi në zbatimin e së drejtës së regjistrimit të emrit personal	120
2.24.7	Zyra e Komisionerit për Gjuhë.....	120
2.25	Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.....	121
2.25.1	Kthimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur në Kosovë	122
2.25.2	Situata e sigurisë dhe incidentet sporadike	123
2.25.3	Arsimimi i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë.....	125
2.25.4	Situata e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas	127

2.25.5	Përfaqësimi në punësim në organet qendrore dhe lokale të pushtetit	129
Pjesa e tretë		129
2.26	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	129
2.26.1	Vështrime të përgjithshme	129
2.26.2	Ankesat e qytetarëve ndaj gjykatave	130
2.26.3	Zvarritjet e procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve	131
2.26.4	Parashkrimi i lëndëve gjyqësore nga gjykatat	132
2.26.5	Mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të plotfuqishme.....	132
2.26.6	Rastet tjera të ndryshme të ankesave të qytetarëve	133
2.26.7	Ankesat ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës.....	134
2.26.8	Ankesa e Sindikatës së punëtorëve lidhur me taksat gjyqësore.....	134
2.26.9	Mungesa e gjykatësit në Gjykatën Themelore - dega në Graçanicë.....	134
2.26.10	Konstatimet e Avokatit të Popullit lidhur me mbrojtjen gjyqësore të të drejtave	135
2.27	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	137
2.28	Të drejtat e të akuzuarit.....	140
2.29	E drejta për mjete juridike	142
2.29.1	Raste individuale të paraqitura në IAP.....	143
2.30	Raportet e Avokatit të Popullit me Gjykatën Kushtetuese.....	144
2.30.1	Ndryshimi i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese – heqja e kufizimit.....	145
2.30.2	Referimi i Dekretit të Presidentes në Gjykatën Kushtetuese	145
2.30.3	Gjetja e punëve përgatitore për Kushtetutën e Republikës së Kosovës	147
2.30.4	Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.....	148
2.31	Hetimi kundërligjor i IAP nga Prokuroria -	149
2.31.1	Përshkrimi i fillimit të hetimeve - Dëshmitë dhe faktet e rastit	149
2.31.2	Baza ligjore	151
2.31.3	Hetimi i avancimeve në punë	152
2.31.4	Konstatimet e Institucionit të Avokatit të Popullit.....	153
Kapitulli III		155
Bashkëpunimi dhe aktivitetet e IAP-së.....		155
3.1.	Bashkëpunimi me institucionet vendore	155
3.1.1.	Komentet dhe rekomandimet në projektligje dhe akte nënligjore.....	156
3.1.2.	Bashkëpunimi me shoqërinë civile	158
3.2.	Bashkëpunimi ndërkombëtar	159
3.2.1.	Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare	159
3.2.2.	Bashkëpunimi evropian.....	162
3.2.3.	Bashkëpunimi rajonal	163
3.2.4.	Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë	163
3.2.5.	Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë	164
3.3.	Komunikimi me media.....	165
3.4.	Aktivitetet e Njësisë për të Drejtat e Fëmijëve.....	166
3.5.	Aktivitetet kundër diskriminimit.....	172
3.6.	Personeli i IAP-së.....	174
3.7.	Buxheti i IAP-së	175

3.7.1.	Financimi i IAP-së nga Buxheti i Kosovës.....	175
3.7.2.	Buxheti final i IAP-së dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2014.....	176
3.7.3.	Financimi i IAP-së nga donatorët.....	177
3.7.4.	Përfundim.....	177
Kapitulli IV	179
	Përmbledhja statistikore e rasteve të paraqitura në IAP	179
4.1.	Ankesat e shpallura të papranueshme nga IAP	179
4.1.1.	Ankesat e papranueshme kundër gjykatave.....	181
4.1.2.	Ankesat e papranueshme kundër ministrive	181
4.1.3.	Ankesat e papranueshme kundër komunave	181
4.1.4.	Ankesat kundër autoriteteve të huaja dhe personave privat	182
4.1.5.	Përfundim.....	182
4.2.	Paraqitja statistikore e rasteve për vitin 2014.....	183
4.3.	Paraqitja grafike e statistikave.....	192
Shkurtesat	197

Lista e tabelave

<i>Tabela 1: Lista e dokumenteve për të cilat LAP ka dërguar komente dhe rekomandime</i>	157
<i>Tabela 2: Lista e raporteve të dërguara në organizata të ndryshme ndërkombëtare</i>	164
<i>Tabela 3: Paraqitjet mediale të LAP-së, sipas medimeve gjatë vitit 2014</i>	166
<i>Tabela 4: Kërkesa buxhetore dhe buxheti i aprovuar për vitin 2014</i>	176
<i>Tabela 5: Buxheti i shpenzuar për vitin 2014</i>	177
<i>Tabela 6: Ankesat e paraqitura nga qytetarët në LAP gjatë vitit 2014</i>	184
<i>Tabela 7: Ankesat e shpallura të papranueshme gjatë vitit 2014</i>	184
<i>Tabela 8: Rastet e hapura për hetim në LAP gjatë vitit 2014</i>	185
<i>Tabela 9: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë</i>	186
<i>Tabela 10: Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura nga LAP gjatë vitit 2014</i>	186
<i>Tabela 11: Autoritetet përgjegjëse individuale të rasteve të hetuara nga LAP</i>	189
<i>Tabela 12: Dështimet e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e LAP-së</i>	190
<i>Tabela 13: Raportet me rekomandimet dhe kërkesat për masë të përkohshme nga LAP</i>	190
<i>Tabela 14: Implementimi i rekomandimeve në raportet për rastet e hetuara nga LAP</i>	191

Lista e figurave

<i>Figura 1: Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në LAP gjatë vitit 2014</i>	192
<i>Figura 2: Përkatësia etnike e qytetarëve të paraqitur në LAP gjatë vitit 2014</i>	192
<i>Figura 3: Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në LAP gjatë vitit 2014</i>	193
<i>Figura 4: Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në LAP gjatë vitit 2014</i>	193
<i>Figura 5: Përkatësia etnike e qytetarëve sipas rasteve të hapura për hetim gjatë vitit 2014</i>	194
<i>Figura 6: Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga LAP</i>	194
<i>Figura 7: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë</i>	195
<i>Figura 8: Rastet e mbyllura nga LAP gjatë vitit 2014</i>	195
<i>Figura 9: Implementimi i rekomandimeve në raportet për rastet e hetuara nga LAP</i>	196

Fjala e Avokatit të Popullit

Roli kushtetues i Avokatit të Popullit është të “mbikëqyrë dhe mbrojtë të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”¹ Meqenëse Avokati i Popullit heton ankesat e paraqitura nga individët dhe grupe individësh në të gjitha rastet që ka kompetencë për të shqyrtuar, ai përfaqëson shpresën e fundit të ankuesve për zgjidhjen e problemeve të tyre, kur ata të kenë shtjerrë të gjitha mjetet efektive ligjore në dispozicion.

Ky fakt e bën të domosdoshme që Avokati i Popullit të ushtrojë kompetencat e tij me integritetin dhe përgjegjshmërinë më të lartë të mundshme. Në njëërën anë, ai duhet të përçojë ankesat e qytetarëve drejt autoriteteve, duke kërkuar, madje duke këmbëngulur, për zgjidhje të këtyre ankesave dhe, në raste të veçanta, të njoftojë edhe opinionin publik për shkeljet e autoriteteve të caktuara. Mirëpo, Avokati i Popullit, si institucion i pavarur, po ashtu i mbron autoritetet publike, kur konstaton se ankesat dhe kritikata ndaj tyre janë të pa bazuara dhe pa meritë ligjore.



Megjithatë, sado i rëndësishëm që të jetë, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të kryejë punën e vet në shërbim të qytetarëve pa bashkëpunimin dhe përkushtimin e institucioneve të tjera shtetërore, për dy arsye.

Së pari, trajtimi dhe zgjidhja e rasteve individuale të shkeljeve të ndryshme, më shumë se punë e Avokatit të Popullit, është punë e vetë autoriteteve publike përgjegjëse, sepse vetë autoritetet janë ato që praktikisht zbatojnë ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që në thelb përbëjnë vullnetin e deklaruar të të gjithë qytetarëve dhe të secilit veç e veç, përmes votës së tyre.

Së dyti, me gjithë fushëveprimin e gjerë të tij, Avokatit të Popullit i mungon fuqia ekzekutive dhe sanksionuese. Së këndejmi, Avokati i Popullit nuk mund t’i detyrojë autoritetet për të respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, përderisa vetë autoritetet publike nuk janë të ndërgjegjshme për t’i respektuar ato. Si institucion ndërmjetës midis qytetarit dhe autoriteteve publike, Avokati i Popullit, me rekomandimet e tij konstruktive, mëton ndryshimet pozitive vetëm përmes autoritetit moral dhe bindjes. Këtë rol e ka theksuar Komisioni i Venecias duke pohuar se: “Çelësi i suksesit të institucioneve të ombudspersonit, qëndron në fuqinë e tij/saj për të bindur nëpërmjet arsyes, në bazë të ligjit dhe drejtësisë.”²

Për këto arsye, përkushtimi i autoriteteve shtetërore për të drejtat e njeriut – duke përfshirë në veçanti gatishmërinë e tyre për t’iu përgjigjur kërkesave për informata dhe dokumente dhe për të zbatuar rekomandimet e dala nga hetimet e Avokatit të Popullit – është i domosdoshëm për suksesin e Institucionit të Avokatit të Popullit, në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, par. 1.

²CDL-AD 2007 020 – *Mendim mbi reformë të mundshme të Institucionit të Ombudspersonit në Kazakistan.*

Pikërisht në këtë fushë, Avokati i Popullit vëren se performanca e autoriteteve shtetërore, posaçërisht ajo e instancave më të larta, lë për të dëshiruar. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton qartë se *“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”* Por, me gjithë këtë obligim kushtetues të qartë, Avokati i Popullit ka hasur gjatë këtij viti në dështimin ose refuzimin nga një varg institucionesh për të bashkëpunuar ose për të adresuar çështje legjitime të ngritura nga qytetarët e vendit. E ky nuk është ogur i mirë! Këtu bëhet fjalë për institucionet më të larta shtetërore.

I tërë procesi i vendimmarrjes në administratën shtetërore apo publike, sido që ta quajmë, në parim, vetvetiu është jashtëzakonisht i gjatë dhe i komplikuar. Kosova nuk përbën ndonjë përjashtim në këtë drejtim. Në shumë raste është një punë sizifi që në shumësinë e institucioneve, me apo pa ngjashmëri funksionale, të identifikohen qartë personat e autorizuar që mbajnë përgjegjësinë ligjore për të zbatuar ligjet, rekomandimet dhe për të marrë vendime. Përcaktimin e përgjegjësisë ligjore dhe morale në këtë situatë edhe më shumë e rëndon edhe shumësia e institucioneve eprore para të cilave vetë punonjësit e administratës duhet të japin përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet e tyre.

Pikërisht kjo e fundit, vështirësia e përcaktimit të përgjegjësisë ligjore, është një karakteristikë e vendeve në ngritje, të cilat ende nuk kanë krijuar një rutinë administrative dhe vuajnë nga një shumësi e pasistemuar dhe e pakoordinuar administrative, ku i humbur gjithnjë del qytetari. Mirëpo, kjo mangësi e vendeve të reja ku bën pjesë edhe Kosova, nuk mundet dhe nuk guxon ta përcjellë Kosovën përgjithmonë. Sidomos, kur këto mangësi identifikohen dhe janë lehtësisht të përmirësueshme. Ne kemi kaluar moshën fëmijërore si shtet. Përgjegjësinë duhet ta fusim si kategori ligjore personale dhe kolektive, për të gjitha veprimet: individuale e kolektive, private dhe institucionale.

Ndarja kushtetuese e pushteteve shtetërore në Republikën e Kosovës shpeshherë, për të mos thënë përherë, keqinterpretohet nga të gjitha palët. Ndarja dhe pavarësia e këtyre pushteteve, varësisht nga fuqia e individit, është interpretuar dhe vazhdon të interpretohet herë si ndarje absolute, herë si ndarje sa për sy e faqe. As njëra as tjetra nuk ka sjellë rezultate. Kjo ndarje nuk është as qëllim më vete, as kategori abstrakte. Kjo ndarje në thelb ka një qëllim të qartë dhe konkret: ndarja e pushteteve duhet të jetë në funksion të qytetarit, sovranit, në funksion të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Është e qartë se administrata publike, qoftë në nivelin qendror apo lokal, është diga që ballafaqohet me kërkesat, ankesat, shqetësimet dhe nevojat e shoqërisë. Administrata publike është fytyra e shtetit në raport me shoqërinë dhe individin. Prandaj, ekziston vetëm një kërkesë imediate ndaj saj: ajo duhet të jetë transparente, moderne, efikase, efektive, miqësore, jopartiake dhe e përgjegjshme për veprimet e saj në raport me qytetarin. Në këtë kuptim, qeveria dhe mekanizmat e saj, janë të obliguar të krijojnë kushte të volitshme dhe motivim për punë për administratën publike.

Puna e administratës publike duhet të mbështetet në etikën profesionale të një administrate të shëndoshë e moderne. Etika profesionale e administratës publike moderne dhe të përgjegjshme, mbështetet në arsyen praktike dhe urtësinë në raport me vendimmarrjen komplekse institucionale. Pikërisht në këtë kuptim, etika profesionale e administratës publike është e rëndësishë primare për të gjitha format e pushtetit shtetëror.

Mungesa e një etike profesionale dhe ikja nga përgjegjësia ligjore dhe morale, përcillet me pasoja negative të jashtëzakonshme, të shprehur në forma të ndryshme. Format më negative

të veprimtarisë së administratës publike si korrupsioni, mitmarrja, papërgjegjësia, neglizhenca apo anshmëria e çfarëdo forme, cenojnë thelbin politik të një organizimi shoqëror. Këto fenomene të shprehura në gjirin e një administrate publike përbëjnë sfidën më të madhe për një bashkësi shoqërore të shëndoshë dhe bëjnë që individit të mos i ofrohen shërbimet e duhura, apo i njëjti të mos vlerësohet bazuar në kriteret universale të transparencës, ligjshmërisë, mosdiskriminimit apo meritës, por bazuar në fuqinë dhe aftësinë e tij për të korrptuar sistemin politik.

Një administratë publike me kulturë demokratike në një shtet të së drejtës, nuk guxon të vuajë as nga aktivizmi juridik i politikës dhe as nga aktivizmi politik i gjyqësorit. Këto skajshmëri veprimi ofensiv të pushteteve të ndara domosdo duhet të shkrihen në një kulturë demokratike të ndërveprimit ligjor ndërinstitucional, ku kufiri i ndarjes është normë e legjitimuar në mënyrë demokratike që duhet respektuar pa përjashtim.

Në këtë kuptim bashkëkohor të një administrate shtetërore, ku veprimet administrative janë procese publike të iniciuara me kërkesa individuale apo kolektive, ajo duhet të ofrojë siguri për iniciuesit duke dhënë garanci për rregullsinë dhe ligjshmërinë e këtyre veprimeve, duke ia nënshtruar ato një shqyrtimi gjyqësor, në rast nevojë. Vetëm një shkrimje e tillë, ku shqyrtimi gjyqësor bëhet pjesë e veprimit administrativ si proces publik, garanton rolin plotësues apo komplementar të gjyqësorit dhe administratës në një shoqëri demokratike si drejtësi e normuar, shoqërisht të pranueshme dhe institucionalisht të zbatueshme. Dhe vetëm në shoqëritë e tilla ku shqyrtimi gjyqësor i veprimeve të administratës publike nuk kuptohet si përzierje në procedurën administrative, por si pjesë e pandashme e saj, mund të flasim për siguri ligjore, për respektim të të drejtave dhe lirive të njeriut në procesin administrativ. Për të arritur këtë, kërkohet jo vetëm ndërtimi i një kulture politike i mosndërhyrjes dhe e ndikimit të çfarëdo forme në gjyqësor dhe tek gjykatësit si individë, por edhe një politikë kulturore e të kuptuarit se ndarja gjyqësore e drejtësisë nuk është gjë tjetër veçse vazhdimësi e veprimit administrativ shtetëror. Ky është obligim që kërkohet nga ne sot, nesër dhe në të ardhmen edhe nga Evropa, pjesë e së cilës ne pretendojmë të jemi. Kjo është edhe kërkesë e KEDNJ, nëse duam të jemi pjesë e drejtësisë institucionale të Evropës.

Andaj, mesazhi kryesor i këtij Raporti është që Avokati i Popullit kërkon medoemos që të gjitha autoritetet publike, dhe organizatat që ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, t'u përgjigjen kërkesave dhe të marrin parasysh të gjeturat e Avokatit të Popullit dhe rekomandimet e tij, të bëra qoftë në këtë Raport, qoftë në raportet e tjera vjetore apo të veçanta.

Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të mbetet i përkushtuar ndaj parimeve të demokracisë dhe sundimit të ligjit, duke u përpjekur t'i qëndrojë besnik atij standardi të lartë ligjor sipas të cilit e vlerëson edhe performancën e institucioneve të tjera. Kjo është forma e bashkëpunimit ndërinstitucional e përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj midis Avokatit të Popullit dhe autoriteteve tjera publike.

Përndryshe, jo vetëm Avokati i Popullit, por i tërë sistemi është i pafuqishëm nëse dështon hallka e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe respektimi i ligjit.

Përmbledhje e përgjithshme

a. Vështrim i përgjithshëm mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në vitin 2014

Përmes këtij raporti, dhe në përputhje me një traditë vjetore të përcaktuar me Kushtetutë, Avokati i Popullit njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës, përfaqësuesit e drejtpërdrejtë të popullit, për gjendjen e respektimit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në vitin që shkoi, si dhe u paraqet institucioneve përkatëse rekomandime për përmirësimin e kësaj gjendjeje, gjatë këtij viti dhe në vitet e ardhshme.

Raportimi vjetor i Avokatit të Popullit ofron një mundësi të mirë, për të gjitha institucionet shtetërore, për t'u kujtuar se "Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet" dhe "ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj" (Kushtetuta, neni 1, paragrafi 2). Me fjalë të tjera, respektimi i të drejtave të njeriut nuk është thjesht një qëllim mes të tjerash, që mund të sakrifkohet ose të shpërfillet përballë interesave të rëndomta të politikës ditore. Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, sipas Kushtetutës, përbën vetë bazën - themelin e shtetit tonë.

Nëse një shtet nuk qëndron fortë mbi themelin mbi të cilin është ndërtuar, ky shtet është në gjendje të rëndë. Në fjalën e tij të fundvitit Avokati i Popullit ka konstatuar se shteti i Kosovës ka dështuar sa i përket respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, në të tri shtyllat e qeverisjes demokratike: legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Ky raport, i cili jep një pasqyrë të të gjithë punës së Institutit të Avokatit të Popullit (IAP) gjatë vitit 2014, ofron dëshmi të hollësishme për këtë konstatim.

Sigurisht, asnjë shtet nuk është i përsosur, prandaj, edhe shtetet më demokratike mund të gabojnë ndonjëherë në fushën e të drejtave të njeriut. Në këto shtete, nëse rastet e mospërbushjes së obligimeve ligjore dhe kushtetuese janë vërtet të rralla, këto pak pika të zeza nuk e turbullojnë dot përkushtimin dhe vullnetin e tyre të pastër dhe të singertë, për të mbrojtur, respektuar dhe promovuar të drejtat e njeriut, në mënyrë sa më efikase.

Gjendja e shtetit të Kosovës, fatkeqësisht, është krejt e kundërta. Siç dëshmohet qartë në këtë Raport, në Republikën e Kosovës rastet e rralla janë ato në të cilat institucionet shtetërore ndërmarrin veprime për përmbushjen e obligimeve të tyre lidhur me të drejtat e njeriut, kurse dështimet e njëpasnjëshme në këtë drejtim, janë si qindra pllakëza të vogla, të cilat bashkohen për të formuar një mozaik të pafund të mospërfilljes dhe papërgjegjshmërisë institucionale. Qëllimi kryesor i këtij Raporti është për të nxjerrë përpara publikut, pa asnjë rezervim a zbutje artificiale, gjendjen e rëndë të të drejtave të njeriut në Kosovë. Kjo gjendje që, ndonëse nuk mund të dallohet duke analizuar secilin dështim të izoluar prej të tjerave, bëhet i qartë dhe i pamohueshëm vetëm duke i shikuar të gjitha dështimet bashkë, dhe duke vërejtur modele të përsëritura të shkeljeve të ndryshme të kryera nga një varg institucioneve shtetërore, lidhur me një rang të gjerë të drejtash dhe lirish të njeriut.

Në fushën legjislative, ky Raport jep shembuj të dështimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës edhe për të shqyrtuar rekomandimet e Avokatit të Popullit për miratimin e ligjeve të reja, ose për ndryshimin e ligjeve aktuale, që ndikojnë në të drejtat dhe liritë e njeriut. Ky dështim i Kuvendit ndaj të drejtave të njeriut, bëhet edhe më shqetësuese nëse e vërejmë faktin se vitin e kaluar, Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit nuk është diskutuar në seancë plenare. Një dështim tjetër përbën edhe zvarritja e zgjedhjes së Avokatit të ri të Popullit, që

nga qershori i vitit 2014. Natyrisht, meriton të theksohet angazhimi i Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut në dy vitet e fundit për bashkëpunim me IAP.

Nuk mund të lihet i papërmendur fakti se gjithë këto dështime ndërlidhen ngushtë me një dështim tjetër edhe më elementar: dështimi i politikës pas zgjedhjeve të qershorit 2014 për të konstituuar legjislaturën e re të Kuvendit. Ky raport tregon se ndërçori politik gjashtëmujor nuk ka qenë vetëm një farsë qesharake që dëshmoi për dështimin e politikës dhe gjyqësorit. Ndërçori politik ka qenë një goditje e rëndë edhe për të drejtat dhe liritë e njeriut, duke lënë të pashqyrta, gjashtë muaj me radhë, një sërë reformash legjislative të propozuara dhe rekomandimesh të bëra nga Avokati i Popullit, në disa raste të përsëritura vite me radhë. Pas një viti të dështuar legjislativ, Avokati i Popullit pret që reformat e propozuara dhe rekomandimet e bëra, të cilat shtjellohen sipas temave të ndryshme në këtë Raport, të shqyrtohen dhe të zbatohen pa vonesë nga legjislatura e re e Kuvendit.

Edhe më i rëndë në vitin 2014-tën ka qenë dështimi i ekzekutivit, si në nivelin kombëtar, ashtu edhe në nivelin komunal. Të dhënat e këtij raporti dëshmojnë se, në vitin 2014, si në vitet e mëparshme, refuzimi ose dështimi i plotë për t'u përgjigjur në kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, vazhdon të jetë sëmundje kronike e përhapur midis autoriteteve më të larta të shtetit, duke përfshirë Presidenten, ish-Kryeministrin, Kryeministrin aktual, dhe ministrat të ndryshëm të qeverisë së vjetër dhe të re. Dështimi ose refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit përbën shkelje të drejtpërdrejtë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila përcakton qartë se: “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj” (neni 132, pika 3). Për më tepër, sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, dështimi ose refuzimi për t'u përgjigjur “konsiderohet pengim i punës” së tij. Në bazë të këtij standardi, numri i hetimeve të Avokatit të Popullit që janë penguar nga autoritetet më të larta ekzekutive në Republikën e Kosovës është i pashpjegueshëm për një shoqëri demokratike.

Fakti që Presidentja e Republikës, “kreu i shtetit [që] përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës” (Kushtetuta, neni 83), ka refuzuar dhe vazhdon të refuzojë të bashkëpunojë me Avokatin e Popullit, është jashtëzakonisht shqetësues.

Po aq zhgënjyes është dështimi i bashkëpunimit nga ana e Kryeministrit aktual dhe vartësve të tij. Por mbetet të shihet sa real ka qenë premtimi në fjalimin inaugurues që ka mbajtur si i nominuar për postin e kryeministrit, z. Mustafa vetë premtoi se “Qeveria do t'i vendosë të drejtat e njeriut lart në axhendën e saj politike” dhe “do të sigurojë që rekomandimet e Ombudspersonit të adresohen në mënyrë adekuate”. Duke marrë parasysh dështimin që në fillim të krijimit të Qeverisë së tij për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit, mbetet të shihet se sa të besueshme ishin premtimet e dhëna. Avokati i Popullit megjithatë shpreson për një bashkëpunim më të frytshëm në të ardhmen, si nga Presidentja, ashtu edhe nga Kryeministrit dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas detyrimit të tyre kushtetues dhe ligjor.

Gjendja e gjyqësorit sa i përket të drejtave të njeriut, po ashtu, vazhdon të jetë jashtëzakonisht shqetësuese dhe pa shpresa për përmirësim dhe është duke u shndërruar nga mbrojtës në shkelës të të drejtave dhe liritë të njeriut, duke rezultuar në humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë për sundimin e ligjit. Probleme të shumta në gjyqësorin e Republikës së Kosovës përfshijnë mosfunksionimin e pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit; zvarritjen në vendosjen e lëndëve civile dhe penale; numrin e lëndëve të pazgjidhura nga vitet paraprake; shkallën e ulët të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore; parashkrimin e lëndëve gjyqësore;

vendime dhe procese gjyqësore ndaj gjyqtarëve për korrupsion; moszbatimin në praktikë të normave të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) dhe mosinterpretimin e vendimeve gjyqësore sipas vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Pavarësisht nga këto dështime të gjyqësorit, të dëshmuara edhe në vitet e mëparshme, në vitin 2014 kemi parë edhe një dështim të jashtëzakonshëm nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (GJKK) në trajtimin e lëndës së referuar nga Avokati i Popullit kundër Dekretit të Presidentes Jahjaga për vazhdimin e mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë të GJKK-së. Aktvendimi i GJKK-së në këtë rast, pavarësisht se vlefshmëria e tij ligjore tashmë është kontestuar, për shkak të dyshimit për falsifikimin e dokumentit zyrtar - nuk përmbush as standardet minimale intelektuale, juridike dhe profesionale. Ky është një zhvillim i ri i vitit 2014, dhe shumë shqetësues për Gjykatën që “është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës” (neni 112, par. 1), duke përfshirë interpretimin e dispozitave të Kapitullit të dytë të Kushtetutës, për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Të gjitha këto mangësi objektive e subjektive, të gjyqësorit dhe të gjykatësve, kanë bërë që njerëzit të humbin plotësisht besimin në drejtësinë institucionale – gjyqësorin dhe të marrin drejtësinë në duart e veta duke i zgjidhur kontestet e tyre jashtë sistemit gjyqësor, shpeshherë me përdorim të dhunës. Në këtë mënyrë, shpeshherë ka ngjarë të kemi kalimin nga kontestet civile në ato penale. Për këto raste kemi paraqitur dëshmi konkrete në këtë raport. Pavarësimi i gjyqësorit nga dy pushtetet e tjera, ai ekzekutiv dhe legjislativ, në frymën e Kushtetutës, është një domosdoshmëri urgjente. Rrjedhimisht, ngritja e përgjegjësisë së gjykatësve në nivelin maksimal, pa pardon për lëshime objektive dhe papërgjegjësinë profesionale, është imperativ i pashmangshëm.

b. Struktura dhe përmbajtja e raportit

Ky Raport ndahet në katër kapituj. Kapitulli i parë paraqet një prezantim të kompetencave, përgjegjësisë dhe mandatit të IAP-së. Gjithashtu, Kapitulli i parë përsërit një rekomandim që Kushtetuta të amendamentohet për të përfshirë tri instrumente ndërkombëtare në listën e instrumenteve ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës: Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e OKB-së, Karta Sociale Evropiane dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Rekomandimi për dy instrumentet e para, i përsëritur disa vite me radhë nga Avokati i Popullit, deri tani është shpërfillur plotësisht nga autoritetet kompetente për amendamentimin e Kushtetutës, duke përfshirë Kuvendin.

Kapitulli II ofron një përmbledhje të hollësishme të punës së Avokatit të Popullit lidhur me të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara në Kushtetutë. Kapitulli ndahet në tri pjesë. Pjesa e parë përqendrohet në të drejtat dhe liritë themelore, kurse pjesa e dytë dhe e tretë trajtojnë të drejtat që kanë të bëjnë posaçërisht me mbrojtjen e këtyre të drejtave, përkatësisht e drejta për mbrojtjen e barabartë të të drejtave dhe të drejtat që kanë të bëjnë me mbrojtje gjyqësore.

Pjesa e parë e Kapitullit të dytë fillon me **të drejtën për jetën**, mosrespektimi i së cilës dëshmon qartë mangësitë e gjyqësorit të Kosovës dhe pasojat, ndonjëherë të rënda, të këtyre mangësive. Në vitin 2014, Avokati i Popullit ka marrë një sërë ankesash, duke përfshirë një rast në të cilin zvarritja 12-vjeçare e një procesi gjyqësor ka rezultuar në një ngatërresë midis palëve që ka marrë jetën e një personi dhe ka rezultuar në lëndime të rënda të personave të

tjerë. Gjithashtu, shqetësim të veçantë për Avokatin e Popullit paraqesin zvarritjet në hetimin e lëndëve penale dhe mungesa e hetimeve efektive dhe efikase dhe zvarritjet e ekspertizave për rastet e paraqitura, në lidhje me shkeljen e të drejtës për jetën.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë periudhës raportuese ka pranuar dhe trajtuar ankesa të ndryshme për shkeljet e pohuara të **dinjitetit të njeriut**. Avokati i Popullit gjatë vitit 2014 ka vërejtur se një formë tepër e përhapur e cenimit të dinjitetit të njeriut është trajtimi i të punësuarve në tregun privat të punës në Kosovë, që në rastet e skajshme marrin karakteristika të skllavërimit. Më shqetësues është fakti se disa ndër shkelësit më flagrantë në këtë mes janë kompani private të sigurimit dhe të mirëmbajtjes e higjienës, që operojnë nëpër institucione shtetërore.

Gjithashtu, Avokati i Popullit konsideron se varfëria (me mbi 10% të qytetarëve në varfëri të skajshme) në të cilën jetojnë një numër konsiderueshëm familjesh të Kosovës, përbën shkelje të dinjitetit të tyre. Është për t'u theksuar gjithashtu se, statistikave të IAP-së tregojnë se kategoritë më të cënueshme të popullatës, ato më të varfërat, zakonisht janë edhe viktimat më të shpeshta dhe më të mundshme të cenimit të dinjitetit dhe integritetit njerëzor, si: pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, individët dhe familjet me gjendje të rëndë ekonomike sociale dhe me varfëri, fëmijët, femrat dhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë si ashkalinjtë, romët dhe egjiptasit.

Sa i përket **së drejtës së lirisë dhe sigurisë**, shqetësimin më të madh përbëjnë vendimet gjyqësore për paraburgim që zgjasin nganjëherë vite me radhë, për shkak të zvarritjes së jashtëligjshme të procedurave deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë. Avokati i Popullit rithekson se administrimi efikas i drejtësisë është obligim dhe përgjegjësi e autoriteteve kompetente, gjë që do të siguronte që kohëzgjatja e paraburgimit të personit të akuzuar të mos tejkalojë afatet.

Në fushën e **ndalimit të torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues**, Avokati i Popullit në vitin 2014, si në çdo vit, realizoi vizita të rregullta mujore në të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit si dhe në vendet ku liria e lëvizjes është e kufizuar. Vizitat kanë përfshirë edhe institucionet e shëndetit mendor dhe të kujdesit social, si dhe Qendrën e Azilit. Kurse, shumica e ankesave të pranuar janë drejtuar kryesisht kundër vendime të gjykatave, Panelit për Lirim me Kusht (PLK), trajtimit shëndetësor, lirimeve gjatë fundjavave, transferimeve, ekstradimeve etj.

Avokati i Popullit vëren se mbipopullimi i burgjeve dhe mungesa e trajtimit adekuat shëndetësor mbeten probleme të rënda në vendet ku liria e lëvizjes është e kufizuar. Megjithatë hapja e burgjeve të reja ka ndikuar në shkarkimin e qendrave tjera korrektuese nga mbipopullimi, renovimet në shumë qendra korrektuese, si dhe mos përfundimi i punimeve kanë bërë që mbipopullimi të jetë shqetësim edhe për këtë vit raportues.

Gjithashtu, me gjithë angazhimin e Bashkimit Evropian (BE) dhe institucioneve vendore për përmirësimin e trajtimit shëndetësor të të burgosurve, IAP në vitin 2014 ka vazhduar të pranojë ankesa për trajtimin joadekuat shëndetësor në institucionet korrektuese, për mungesë barërash dhe çështje tjera të ndërlikura me shëndetësinë. Gjithashtu, është vërejtur se institucionet e shëndetit mendor, vazhdojnë të ballafaqohen me mungesën e stafit profesional si dhe mos trajnimin të tyre, edhe pse ka pasur përmirësime në rregullimin e infrastrukturës në përgjithësi. Një hap kyç në këtë drejtim është miratimi i Projektligjit për Shëndetin Mendor. Më në fund, në mars të këtij viti, Qeveria ka miratuar këtë projektligj, dhe Avokati i Popullit i bën thirrje Kuvendit që ta miratojë sa më shpejt.

Në përgjithësi, Qeveria ka respektuar **lirinë e lëvizjes** gjatë vitit 2014. Por, tensionet ndëretnike, incidentet sporadike, provokimet dhe frikësimet edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, e kanë kufizuar lirinë e lëvizjes së qytetarëve të Kosovës në disa pjesë të vendit, dhe Avokati i Popullit kërkon angazhim të vazhdueshëm të institucioneve kompetente për të zgjidhur këto probleme. Liria e lëvizjes në pjesën veriore të Kosovës vazhdon të mbetet e kufizuar edhe sot.

Sa i përket **të drejtës së privatësisë**, në periudhën raportuese, IAP ka pranuar një numër ankesash të qytetarëve dhe ka hapur raste *ex officio*, lidhur me shkeljen e kësaj të drejte. Këto ankesa kanë të bëjnë me sektorin publik dhe atë privat.

Dështimi i vazhdueshëm i Kuvendit për të miratuar një projektligj për rregullimin e çështjes së përgjimit të telekomunikimit dhe atij elektronik ka vazhduar në vitin 2014, si në vitet e mëparshme, kryesisht për shkak të mungesës së vullnetit të Kuvendit për të përfshirë në këtë projektligj mbrojtje të mjaftueshme për të drejtën e privatësisë. Kuvendi është aktualisht duke shqyrtuar projektligjin e fundit mbi këtë temë. Avokati i Popullit i bën thirrje Kuvendit që të veprojë sa më shpejt.

Lidhur me **të drejtën e martesës dhe familjes**, rastet e paraqitura në IAP edhe gjatë vitit 2014 dëshmojnë se jetësimi i kësaj të drejte, lë shumë për të dëshiruar. Avokati i Popullit, edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit, ka marrë një numër të ankesave, që dëshmojnë përsëritjen e problemeve pothuajse të njëjta sikur në periudhën paraprake. Këto probleme kanë të bëjnë kryesisht me zvarritjen e procedurave të shkurorëzimit, mosekzekutimin e vendimeve mbi pagesat e alimentacionit, mosrealizimin e kontakteve të rregullta me fëmijë nga prindërit e divorcuar, si dhe zvarritjen e procedurave për të vendosur, përkitazi me të drejtën e besimit të fëmijëve në ruajtje dhe edukim. Prandaj, mosrespektimi i së drejtës së martesës dhe familjes dëshmon edhe një herë pasojat e rënda të dështimi thuajse të plotë të gjyqësorit të Kosovës.

Çështja e **lirisë së besimit, ndërgjegjes dhe fesë** jep dëshmi të mëtejshme të neglizhimit të shtetit në vitin 2014. Këtë herë kemi të bëjmë me dështimin e Kuvendit për të miratuar një projektligj për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për liritë fetare. Avokati i Popullit konsideron se liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë nuk mund të mbrohet në mënyrë adekuate pa miratimin e një ligji të ri. Nevojën për zgjidhjen e kësaj çështjeje, Avokati i Popullit e ka theksuar edhe në raportet vjetore për vitet 2012 dhe 2013. Fakti se Kuvendi akoma nuk ka miratuar një projektligj të ri, tregon edhe një herë papërgjegjshmëri në çështjet e të drejtave të njeriut.

Gjatë vitit 2014, nuk është drejtuar ndonjë ankesë tek IAP, që ka të bëjë me **lirinë e shprehjes**, por kjo nuk e ka penguar Avokatin e Popullit të përcjell respektimin e lirisë së shprehjes. Me vëmendje të veçantë janë përcjellë rastet e raportuara publikisht për cenimin e lirisë së shprehjes si dhe gjuhës së përdorur. Meqenëse mediat janë në funksion të realizimit të lirisë së shprehjes, ato janë parë si burim thelbësor i informacionit, ashtu si edhe platformat elektronike mediale, përmes të cilave, tashmë, zhvillohet komunikim interaktiv, përfshirë këtu edhe rrjetet sociale.

Në fushën e **lirisë së mediave**, Avokati i Popullit konsideron jashtëzakonisht shqetësues faktin se, në vitin 2014, janë raportuar një sërë kërcënimesh dhe përpjekjesh për të bërë presion tek gazetarët në Kosovë. Në tetor, brenda mediumit ku punon dhe gjatë kryerjes së detyrës së tij, është sulmuar dhe rrezikuar për jetë, një gazetar. Në shtator, kërcënimet ndaj gazetarëve të portaleve elektronike, por edhe të mediave të shkruara, apo edhe kanosja e gazetarëve nga vetë pronarët e medimeve ku punojnë, gjithashtu janë konsideruar serioze dhe të papranueshme. Shkelje e rëndë e lirisë së medias në Kosovë konsiderohet edhe presioni

nga zyrtarë të misionit të EULEX-it në Kosovë, ndaj gazetarit të “Kohës Ditore”, me qëllim të ndalimit të raportimit mbi dyshimet për përfshirje në korrupsion të zyrtarëve të EULEX-it.

Gjithashtu, për Avokatin e Popullit mbetet shqetësues mosrespektimi i Ligjit të Punës, në mënyrë të veçantë sa i përket kontratave të punës së gazetarëve në media, dhe të lirisë së organizimit sindikal, sidomos në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), si institucion publik i financuar nga taksapaguesit. Kjo çështje konsiderohet presion i drejtpërdrejtë në punën e gazetarëve dhe kërkon vëmendjen e institucioneve kompetente, për të krijuar një ambient më të favorshëm për gazetari cilësore dhe në funksion të informimit të drejtë e të saktë.

Sa i përket **lirisë së asociimit**, Avokati i Popullit mirëpret miratimin nga Kuvendi, të deklaratës për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe shoqërisë civile, e cila ka për qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në procesin e hartimit të legjislacionit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tij, si dhe sigurimin e mbështetjes së Kuvendit të Kosovës në zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile në Kosovë. Po ashtu, miratimi i Udhëzimit Administrativ për funksionimin dhe organizimin e Organizatave Joqeveritare nga Qeveria e Kosovës në shtator të vitit 2014, është një hap pozitiv. Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat e regjistrimit, përditësimit të të dhënave në Regjistrin Publik, shuarjen dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare (OJQ) nga Regjistri i OJQ-ve.

Por, pavarësisht nga këto zhvillime pozitive, Avokati i Popullit gjatë vitit 2014 ka pranuar disa ankesa të cilat ndërlidhen me cenimin e ushtrimit të kësaj të drejtë. Një nga këto ankesa, gjatë shqyrtimit të së cilës Avokati i Popullit ka kërkuar prej Ministrisë së Administratës Publike (MAP) informata të domosdoshme për hetimin e ankesës, tregon edhe një herë mospërfilljen e zyrtarëve qeveritarë ndaj punës së IAP-së. Kërkesa për informata është dërguar tek Ministria në shtator të vitit 2014. Deri më sot, më shumë se gjashtë muaj, Avokati i Popullit nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Gjithashtu, IAP, gjatë vitit 2014, ka pranuar disa ankesa nga përfaqësuesit e organizatave sindikale të punëtorëve, të cilat kishin të bënin me cenimin e të drejtës së organizimit sindikal, si pjesë e lirisë së asociimit. Për këtë arsye, në shtator të vitit 2014, Avokati i Popullit lëshoi një deklaratë për media, përmes së cilës kishte apeluar që të ndalohen veprimet e tilla nga ana e institucioneve të caktuara

Sa i përket **lirisë së tubimit**, në vitin 2014, sikurse edhe viteve të kaluara, ka pasur organizim të një varg tubimesh publike dhe protestash të ndryshme nga ana e qytetarëve, studentëve, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të ndryshme të interesit. Këto tubime dhe protestat janë organizuar në qytete të ndryshme të Kosovës, në të shumtën e rasteve ato janë organizuar në vende publike dhe para institucioneve specifike. Në kuadër të mandatit të vet, IAP ka përcjellë me vëmendje shumë nga këto tubime dhe paraqet vlerësimin e tij në këtë Raport.

Gjithashtu, në këtë Raport, sikurse në Raportet Vjetore të 2012 dhe 2013, Avokati i Popullit ripërtëritë kërkesën për ndryshimin e një pjese të Ligjit për Tubime Publike për ta harmonizuar me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ky rekomandim për reformë legjislative, si shumë rekomandime të tjera, është shpërfillur plotësisht nga Kuvendi disa vite me radhë.

Sa i përket **të drejtës së votës**, zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 8 qershorit 2014 në përgjithësi kanë qenë të organizuara mirë, përkundër disa lëshimeve, kryesisht të natyrës teknike, por të cilat nuk kanë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit të votimit. Në përgjithësi, Dita e votimit ka kaluar qetë dhe pa incidente. Mund të thuhet se këto janë zgjedhjet më të mira të mbajtura deri më tani në Republikën e Kosovës.

E drejta e pronës ka qenë objekti i 90 ankesave tek IAP në vitin 2014, gjë që tregon se aparati institucional për zgjidhjen e çështjeve pronësore nuk po tregohet adekuat për t'u përballuar me një sërë problemesh të ndërlikuara dhe të ndjeshme. Ankesa janë paraqitur kundër gjykatave të të gjitha instancave, duke përfshirë këtu edhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), kundër komunave, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, kundër Agjencisë Kosovare të Pronës, kundër kompanive publike, kundër prokurorive publike dhe Policisë së Kosovës. Në mënyrë që të zgjidhen problemet në këtë fushë, Avokati i Popullit, në këtë Raport, paraqet një varg rekomandimesh drejtuar institucioneve kompetente.

Gjatë vitit 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur më shumë se dyfishim të ankesave lidhur me **të drejtën për arsim**. Këto ankesa janë drejtuar kundër një rangu të gjerë institucionesh shtetërore: Universitetit të Prishtinës (UP) "Hasan Prishtina", Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA), komunave, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Rektoratit të UP "Hasan Prishtina", Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), Qendrës së Studentëve në Prishtinë dhe Fakultetit të Edukimit në Gjakovë.

Nga ankesat e pranuar, Avokati i Popullit e konsideron më shqetësues faktin se në vitin 2014, ashtu si në vitet e mëparshme, pengesat serioze për personat me aftësi të kufizuara nuk janë pakësuar. Përkrahja dhe përmirësimi i kushteve për këta nxënës si dhe krijimi i kushteve për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt arsimor duhet të jetë prioritet i MASHT-it dhe komunave.

Ia vlen të përmendet gjithashtu rastin *ex officio* që është hapur nga Avokati i Popullit në fund të vitit 2014, lidhur me vendimin e ish-ministrit të MASHT-it, Ramë Buja, për regjistrimin e fëmijëve të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së në UP. Bazuar në dyshime të arsyeshme se ky vendim ishte i kundërligjshëm dhe kundërkushtetues, si dhe që ekzekutimi i vendimit do të mund të shkaktonte dëme të pariparueshme për studentët aktualë të UP-së, Avokati i Popullit kërkoi pezullimin e menjëhershëm të vendimit, duke u drejtuar këtë kërkesë fillimisht ish-kryeministrit Thaçi dhe ish-ministrit të MASHT-it Buja, dhe pastaj kryeministrit Mustafa dhe ministrit aktual të MASHT-it, Arsim Bajrami. Të gjithë këta katër zyrtarë kanë shpërfillur plotësisht rekomandimin e Avokatit të Popullit, duke konfirmuar edhe një herë papërgjegjshmërinë e skajshme të autoriteteve më të larta të ekzekutivit në çështjet e të drejtave të njeriut.

Në këtë vit raportues, Avokati i Popullit ka vërejtur një varg shkeljesh të shumëllojshme të **së drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit**. Gjatë kësaj periudhe, Avokati i Popullit konstaton se si në sektorin publik, e sidomos në sektorin privat ka shkelje të ndryshme të së drejtës nga marrëdhënia e punës, përfshirë edhe diskriminimin, si: shkelje të procedurave të punësimit, të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë jo ligjore, si dhe shkelje lidhur me kohëzgjatjen e orarit të punës, kompensimin për punë jashtë orarit, mohimin e së drejtës për pushim vjetor dhe pushim të lehonisë dhe mosrealizimin e së drejtës në pagë.

Së fundi, edhe pse mbrojtja dhe siguria në punë është e garantuar me ligje në fuqi, gjatë kësaj periudhe janë shënuar raste të vdekjes së punëtorëve dhe të lëndimit të tyre në vendin e punës. Për Avokatin e Popullit është një shqetësim tejet serioz veçanërisht mungesa e hetimit të rasteve nga Inspektorati i Punës dhe organeve hetuese, mosndëshkimi i punëdhënësve për shkak të mos sigurimit të punëtorëve dhe vendeve të punës, si dhe mossigurimi i kompensimit të viktimave apo familjeve të tyre pas fatkeqësisë.

Avokati i Popullit është i shqetësuar gjithashtu sepse edhe në këtë periudhë të raportimit, vërehen çdo ditë fëmijë të moshës jo madhore, duke kryer punë të ndryshme që dëmtojnë shëndetin dhe dinjitetin e tyre.

Bazuar në numrin e përgjithshëm të ankesave drejtuar IAP në vitin 2014, vërehet një rritje e lehtë krahasuar me numrin e ankesave të parashtruara në vitin paraprak, sa i përket **së drejtës për qasje në dokumente publike**. Avokati i Popullit e konsideron mangësi serioze faktin se Ligji për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), ndonëse i jep Avokatit të Popullit juridiksion mbi ankesa për shkelje të këtij ligji, nuk përcakton shprehimisht institucionet tjera publike me fuqi ekzekutive, që mund të obligojnë institucionet përgjegjëse për shkelje, për të respektuar dhe zbatuar të drejtën për qasje në dokumentet publike. Kjo i lë ankuesit pa zgjidhje të kënaqshme në raste kur institucionet publike i shpërfillin rekomandimet e Avokatit të Popullit që palët ankuese të pajisen me dokumentet e kërkuara. Për shembull, në dhjetor të vitit 2014 Avokati i Popullit hartoi një raport me rekomandime të cilin ia drejtoi Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) lidhur me mohimin e së drejtës për qasje në dokumentet publike duke konstatuar shkelje të ligjit. Deri tani, IAP nuk ka marrë asnjë përgjigje prej Ministrisë.

Pa dyshim që njëra ndër çështjet më të rëndësishme që duhet të theksohet e që lidhet me qasjen në dokumentet publike, është kërkesa e Avokatit të Popullit dhe gjetja e dokumenteve të punëve përgatitore (*travaux préparatoires*) të hartimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këto dokumente historike dhe të rëndësishme të lartë juridike kanë qenë të humbura për publikun dhe për komunitetin juridik të Kosovës që nga themelimi i Republikës. Gjetjen e punëve përgatitore Avokati i Popullit e cilëson si arritjen më të rëndësishme në fushën e qasjes në dokumentet publike.

Edhe pse Kushtetuta radhit **përgjegjësinë për mjedisin jetësor** në Kapitullin II për të drejtat e liritë themelore, mjedisi dhe mbrojtja e tij kanë vazhduar të mbeten jashtë prioriteteve të Qeverisë, siç tregohet nga ndarja e buxhetit të pakët. Në veçanti, mosinteresimi i Qeverisë së Kosovës është duke shkaktuar probleme në shëndetin publik dhe cilësinë e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Po ashtu, edhe taksa ekologjike e mbledhur gjatë regjistrimit të veturave, nuk ka filluar të ndahet për fushën e mjedisit. Edhe bashkëpunimi ndërinstitucional, i organeve në mbrojtje të mjedisit është duke ecur me hapa të ngadalësuar. Për shkak të kësaj neglizhence të pajustificueshme, ndotja e vazhdueshme e mjedisit, zgjerimi i pakontrolluar urban, ndërtimet pa kriter, mosrespektimi i planeve rregulluese dhe normave të ndërtimit, humbja e tokave bujqësore, ndotja e ajrit dhe ujërave, shkatërrimi i sipërfaqeve pyjore, mosmenaxhimi i duhur i mbeturinave, dëmtimi dhe zhdukja e biodiversitetit, mungesa e sistemeve të mjaftueshme monitoruese, zhurma, mungesa e respektimit të parimeve bazë mjedisore, sidomos të informimit dhe të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, janë problemet që vazhduan edhe në vitin 2014.

Siç u theksua më sipër, pjesa e dytë dhe e tretë e Kapitullit të dytë të këtij Raporti trajtojnë të drejtat që kanë të bëjnë posaçërisht me mbrojtjen e të drejtave bazike, përkatësisht me të drejtën për mbrojtjen e barabartë të të drejtave dhe të drejtat për mbrojtje gjyqësore.

Lidhur me **të drejtën për barazinë para ligjit**, Avokati i Popullit fillimisht vëren se Ligji Kundër Diskriminimit, edhe përkundër faktit që ka kaluar nëpër faza të plotësimit dhe ndryshimit, ende nuk ka arritur të miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit ka rekomanduar ndryshimet në këtë ligj edhe në raportet vjetore paraprake. Bazuar në përvojën e deritashme, pikërisht për shkak të mangësive të theksuara vazhdon të ketë një moszbatim të Ligjit kundër Diskriminimit. Deri më tani, IAP ka të njohur vetëm një rast të

diskriminimit të trajtuar nëpër gjykata. Prandaj, Avokati i Popullit ripërsërit thirrjen e tij që Kuvendit të adresojë këtë çështje me seriozitetin e duhur, gjë që deri tani ka dështuar ta bëjë.

Nga 1 janar deri më 11 dhjetor 2014, janë pranuar 61 ankesa të qytetarëve të Kosovës në Departamentin kundër Diskriminimit (DKD) në IAP, në të cilat pretendohet se është shkelur e drejta e barazisë para ligjit. Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me diskriminim në sferën sociale, shëndetësore, pronësore dhe të marrëdhënies së punës.

Sa i përket **diskriminimit në bazë të moshës**, Avokati i Popullit vëren se, siç është raportuar edhe në raportin e vitit të kaluar, Institucioni i Avokatit të Popullit ka të regjistruara raste që kanë të bëjnë me marrëveshjen që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ka lidhur me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), për punësim të 100 punëtorëve të cilët janë të përfshirë në skemën sociale. Pas fazës së testimit dhe pas lajmërimit të kandidatëve se janë pranuar në punë nga KEK-u, ata janë ri-lajmëruar se nuk mund të fillojnë punën sepse nuk e plotësojnë kriterin e moshës, sipas marrëveshjes mes tyre dhe MPMS.

Në raportin vjetor paraprak Avokati i Popullit, ka raportuar se MPMS, nuk i është përgjigjur letrave të Avokatit të Popullit, lidhur me këtë çështje. Prandaj më 27 shkurt 2014, Avokati i Popullit ka publikuar Raport me rekomandim për MPMS. Edhe përkundër obligimit të tij kushtetues dhe ligjor, MPMS asnjëherë nuk është përgjigjur në rekomandimet e dala nga Raporti i Avokatit të Popullit.

Sa i përket **personave me aftësi të kufizuara**, Avokati i Popullit në vitin 2014, si në vitet e mëparshme, ka vërejtur një varg problemesh ende të pazgjidhura. Ia vlen për të theksuar dy probleme në veçanti. Së pari, në fushën e arsimit, qasja fizike e personave me aftësi të kufizuara nuk është e kënaqshme nëpër shkolla publike. Në Prishtinë, për shembull, janë vetëm dy shkolla që i plotësojnë kushtet për qasje të lirë të fëmijëve me aftësi të kufizuara për shkollim, ndërsa një shkollë tjetër i plotëson ato vetëm pjesërisht. Avokati i Popullit e konsideron këtë dështim një shkelje të rëndë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Së dyti, problemi i lëvizjes së lirë të personave me aftësi të kufizuara vazhdon të mbetet problem edhe nëpër institucionet tjera publike duke përfshirë edhe Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Sipas informatave të cilat IAP i ka siguruar nga OJQ “Hendikos”, ka raste kur mjeku është detyruar të dalë në oborrin e spitalit për ta kontrolluar pacientin në pamundësi për hyrje në spital. Komuna e Prishtinës e ka kërkuar nga “Hendikos” listën e personave me aftësi të kufizuara të cilët jetojnë nëpër banesa kolektive për rregullimin e Infrastrukturës për qasje të lirë. Por gjendja e kësaj shtrese të shoqërisë ka mbetur si më parë, sepse edhe sot nuk është ndërmarrë asnjë hap.

Sa i përket **barazisë gjinore**, edhe pse në Republikën e Kosovës është bërë një progres në arritjen e barazisë, gratë si kategori më e cenueshme, vazhdojnë të përballen me shumë sfida dhe trajtim të pabarabartë dhe diskriminues në shumë aspekte. Përvoja shumëvjeçare në IAP tregon se gratë, në shumicën e rasteve, ankohen për problemet që lidhen me të drejtën në punë, statusin ekonomik, mbrojtjen shëndetësore, të drejtën në trashëgimi si dhe lidhur me dhunën në familje.

Avokati i Popullit vëren se, edhe pse në Kuvendin e Republikës së Kosovës përfaqësimi i grave është 30% sipas kuotës gjinore, një gjendje e pafavorshme për gratë ekziston në Qeverinë e Kosovës që ka hyrë në pushtet në fund të vitit 2014 dhe që në përbërjen e saj ka vetëm dy gra ministre nga 21 gjithsej. Ky fakt tregon se ekziston një dominim i madh i burrave në procesin politik dhe vendimmarrës. Për këtë shkak Avokati i Popullit konsideron se kuota gjinore duhet të ekzistojë edhe për një periudhë kohore si pjesë e legjislacionit të Kosovës, derisa të krijohet një kulturë e pjesëmarrjes së grave në pozitat udhëheqëse.

Gjithashtu, Avokati i Popullit konsideron se barazia gjinore nënkupton një shoqëri në të cilën gratë dhe burrat gëzojnë të njëjtat të drejta dhe kanë të njëjtat obligime në të gjitha sferat e jetës. Megjithatë, të drejtat e grave mbetën ende një nga sfidat kryesore për zhvillimin e shoqërisë së Kosovës, në veçanti në lidhje me të drejtën e tyre për ta trashëguar pronën.

Dhuna në familje vazhdon të jetë problem evident në shoqërinë tonë. Vetëm një numër i vogël i rasteve të dhunës në familje raportohet tek autoritetet kompetente për trajtimin e kësaj çështje, por ekziston perceptimi që në realitet ky numër është shumë më i madh. Posaçërisht në zonat rurale, pozita sociale e femrës është qartas e nënshtruar ndaj asaj të mashkullit dhe shoqëria është shumë pak e vetëdijshme për konceptin e barazisë gjinore. Gjithashtu, në shumicën e rasteve viktimat më të shpeshta të dhunës në familje janë fëmijët, gratë, dhe pleqtë.

Edhe pse ekziston një bazë solide ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje, është e nevojshme që në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të përfshihet edhe Konventa e Këshillit të Evropës për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e ashtuquajtura Konventa e Stambollit, e cila hyri në fuqi në gusht të vitit 2014. Një thirrje e tillë bëhet edhe në Strategjinë për Zgjerim të Komisionit Evropian.

Sa i përket viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, një hap i rrallë përpara është shënuar në vitin 2014. Në Raportet vjetore të Avokatit të Popullit të vitit 2012 dhe të vitit 2013, Avokati i Populli ka kërkuar rregullimin ligjor të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Ai gjithashtu ka kërkuar që grave dhe vajzave, viktimave të luftës në Kosovë, duhet t'u sigurohet përkrahja institucionale dhe ligjore, me fokus të veçantë për heqjen e paragjyqimeve ndaj tyre, me qëllim të rikthimit të dinjitetit njerëzor për këtë pjesë të shoqërisë tonë.

Kuvendi i Kosovës më 20 mars 2014 ka miratuar Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre, i cili krijon kushte ligjore për rehabilitimin dhe dëmshpërblimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Lidhur me **të drejtat e fëmijëve**, IAP gjatë këtij viti raportues ka pranuar 54 ankesa, të parashtruara kryesisht nga prindër të fëmijëve. Në këto ankesa, vërehen edhe njëherë mangësitë e konsiderueshme të gjyqësorit të Kosovës, dhe pasojat janë numri i madh i ankesave kundër gjykatave. Këto kanë të bëjnë me: zvarritje të procedurës gjyqësore për të vendosur për besimin e fëmijëve, alimentacion, kërkesa për njohjen e së drejtës për përkrahje materiale për familje që në përkujdesje kanë fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme. Po ashtu ka pasur ankesa për moszbatim të vendimeve të plotfuqishme, lidhur me mosrealizimin e kontakteve personale të fëmijëve me prindin, por edhe mospagesën e alimentacionit, në të shumtën e rasteve nga babai i fëmijës.

Dy sfida të tjera për fëmijët e Kosovës medoemos duhen theksuar. Së pari, dhuna mbetet dukuri shqetësuese në shkollat publike të Kosovës. Me gjithë përpjekjet e MASHT-it në këtë fushë, nuk është vërejtur ndonjë përparim i dukshëm. Në fillim të këtij viti raportues në ambientet e shkollave dhe afër shkollave kanë ndodhur incidente të dhunshme. Dy nga këto incidente kanë përfunduar me vdekje. Së dyti, përkundër përparimeve të bëra, parandalimi i trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtja përkatëse e të drejtave të fëmijëve, mbeten sfida për institucionet e Kosovës. Institucionet e Kosovës në të gjitha rastet në të cilat fëmijët janë viktimat do të duhej që me seriozitet dhe përgjegjësi më të madhe të angazhohen për mbrojtje dhe ndihmë adekuate. Ky Raport paraqet disa rekomandime në këtë drejtim.

Lidhur me **të drejtën sociale dhe shëndetësore**, ky vit raportues nuk paraqet ndonjë ndryshim të madh, krahasuar me vitet paraprake. Gjendja e përgjithshme socio-ekonomike në Kosovë po vazhdon të jetë e rëndë. IAP gjatë vitit 2014 ka hapur katër (4) raste për ankesa të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e kësaj të drejte institucionet shëndetësore, kurse pjesa tjetër e ankesave (60) i përket institucioneve që ofrojnë shërbimet nga fusha e mirëqenies sociale. Këto ankesa kryesisht kanë të bëjnë me ndihmat sociale, pensionet dhe strehimin.

Ofrimi i shërbimeve nga institucionet shëndetësore në Republikën e Kosovës edhe gjatë këtij viti ka vazhduar të mbetet i mangët në të gjitha nivelet (primare, sekondare dhe terciare). Furnizimi me barna nga lista esenciale, ka vazhduar të jetë i pamjaftueshëm dhe si pasojë pacientët janë detyruar t'i blejnë ato nëpër barnatoret private.

Sa i përket sigurimit shëndetësor, miratimi i Ligjit për Sigurimet Shëndetësore në prill të 2014, shihej si shpresë për zbutjen e kësaj gjendje të rëndë dhe ngjalli shpresat e qytetarëve për një shëndetësi moderne në Kosovë. Por sipas të gjitha gjasave ky ligj do të ketë vonesa në zbatimin e tij edhe për shumë kohë, për shkak të mossigurimit të mjeteve financiare dhe moskrijimit të fondit të sigurimeve shëndetësore.

Nga hetimet e rasteve tjera që ndërlidhen me të drejtën shëndetësore, IAP ka vërejtur se ka shumë raste kur të sëmurit janë të diagnostifikuar me sëmundje që nuk kanë perspektivë të shërimit dhe këta pacientë, ose qëndrojnë në institucione jo adekuate shëndetësore, ose lëshohen në shtëpi, sepse në Kosovë nuk është e themeluar disiplina shëndetësore e cila njihet me emrin “Mjekësi Paliative”. Nisur nga ky fakt, Ministria e Shëndetësisë (MSH) në bashkëpunim me institucionet tjera përgjegjëse duhet të iniciojë çështjen e themelimit të kësaj disipline mjekësore, shumë të nevojshme për qytetarët e Kosovës.

IAP ka pranuar disa ankesa që kanë të bëjnë me vendimin e ish-ministrit të MPMS-së z. Nenad Rashiq, përmes të cilit ka bërë pezullimin e kërkesave për realizimin e të drejtave që burojnë nga *Ligji për Statusin e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile*. IAP pas analizës ligjore të rasteve ka konstatuar se ministrit të MPMS-së nuk i delegohet ndonjë kompetencë për nxjerrjen e ndonjë vendimi, me të cilin do të pezullohej apo pengohej zbatimi i ligjit. Për këtë vlerësim Avokati i Popullit ka vënë në dijeni ish-ministrin Rashiq dhe ministrin aktual të MPMS-së, Arban Abrashi. Asnjëri nuk është përgjigjur, me gjithë letrat e dërguara dhe të ri-dërguara nga ana e Avokatit të Popullit. Në këtë rast, heshtja e Qeverisë tregon se sa të parëndësishme i konsideron ajo të drejtat e atyre që janë prekur nga lufta.

Të drejtat e komunitetit LGBT përbëjnë një rast të rrallë në të cilin mund të thuhet se ka një përparim të dukshëm në Kosovë, me mbështetje të Qeverisë dhe të bashkësisë ndërkombëtare, megjithëse vazhdojnë të ekzistojnë probleme të rënda me të cilat pjesëtarët e komunitetit LGBT (Lesbian, Gay, Bisexual and Transgender) ballafaqohen çdo ditë.

Siç kemi tërhequr vëmendjen edhe më parë në raportet e IAP-së, paraqitja e shkeljeve të të drejtave të komunitetit LGBT është një nga faktorët kryesorë në monitorimin e punës së organeve shtetërore në parandalimin e këtyre shkeljeve. Është e nevojshme që shkeljet e të drejtave të komunitetit LGBT të vihen në pah në mënyrë që të zhvillohen hetimet dhe dënohen kryesit e shkeljeve të këtyre të drejtave.

Me problemin e diskriminimit në bazë të përkatësisë seksuale ballafaqohen edhe të rinjtë adoleshentë. Pjesëtarët e organizatave LGBT tregojnë shembuj kur vetë arsimtarët në shkolla i ngacmojnë dhe diskriminojnë të tjerët në bazë të orientimit seksual.

Edhe këtë vit nuk mund të flitet për përparime të konsiderueshme sa i përket gjendjes së **të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre**. Si në raportet e mëparshme vjetore, në

vitin 2014 komunitetet jo shumicë në Kosovë, përkundër kornizës ligjore dhe kushtetuese jashtëzakonisht të favorshme, e cila garanton të drejta të veçanta kolektive dhe individuale duke përcaktuar edhe ndërmarrjen e veprimeve përkrahëse në nivelin qendror dhe lokal, nuk ka zhvillime të pritura kur është në pyetje zbatimi i kësaj kornize. Në fakt, të gjithë shembuj pozitivë reduktohen vetëm në disa raste individuale dhe jo në komunitete jo shumicë në tërësi, gjë që është e domosdoshme të ndryshohet në të ardhmen.

Kur është fjala për sigurinë, vazhdon të ketë incidente të drejtuara kundër komuniteteve jo shumicë, kryesisht anëtarëve të komunitetit serb. Përveç incidenteve të vogla ka pasur edhe incidente më të rënda si zjarrvënie, shkaktim dëmsh, shkrimi i porosive kërcënuese në shtëpitë dhe pronat e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, kryesisht serbë, është regjistruar edhe një numër i konsiderueshëm i vjedhjeve të makinave bujqësore dhe të bagëtisë, si dhe një sulm fizik i armatosur. Në disa komuna incidentet edhe përsëriten.

Në fushën e arsimit, gjithashtu nuk ka ndonjë përparim domethënës në raport me periudhën e mëparshme raportuese të IAP-së. Ende ekzistojnë dy sisteme paralele të arsimit, njëri sipas planit dhe programit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe tjetri, i cili është në përputhje me programin e Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë.

Gjatë periudhës raportuese, është për t'u lavdëruar fakti që për herë të parë u arrit një bashkëpunim i hapur ndërmjet qeverive lokale dhe institucioneve arsimore, të cilat punojnë sipas planit dhe programit të Serbisë, gjë që parqet një hap përpara drejt një bashkëpunimi të plotë në të ardhmen me institucionet legjitime të Kosovës.

Sa i përket pjesëtarëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas në veçanti, duhet theksuar se në këtë periudhë raportuese, si në të gjitha periudhat e mëparshme, ata po përballen me një situatë të vështirë në aspektin socio-ekonomik.

Kur është fjala për personat e riatdhesuar nga radhët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas, situata e tyre nuk ka ndryshuar në kuptimin pozitiv, në krahasim me situatën e përshkruar në raportin e IAP të vitit 2013. Mundësitë për punësim janë të vogla, nuk është përmirësuar, as nuk është përpunuar veçanërisht ndonjë program për trajnimin profesional të personave të riatdhesuar, ndërsa nuk ekziston as ndonjë program adekuat kalimtar edukativ për fëmijët e personave të riatdhesuar para vazhdimit të shkollimit të rregullt.

Pjesa e tretë e Kapitullit të dytë të këtij Raporti përqendrohet tek të drejtat e mbrojtjes gjyqësore. Edhe gjatë këtij viti raportues, gjyqësorin e Kosovës, gjykatat dhe prokuroritë së bashku, e kanë përcjellë vështirësi të natyrave të ndryshme, të cilat kanë pasur për pasojë humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë për sundimin e ligjit. Siç u vërejt më sipër, probleme të shumta në gjyqësorin e Republikës së Kosovës përfshijnë mosfunksionimin e pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit; zvarritjen në vendosjen e lëndëve civile dhe penale; numrin e lëndëve të pazgjdhura nga vitet paraprake; shkallën e ulët të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore; parashkrimin e lëndëve gjyqësore; vendime dhe procese gjyqësore ndaj gjyqtarëve për korrupsion; moszbatimin në praktikë të normave të KEDNJ dhe mosinterpretimin e vendimeve gjyqësore sipas vendimeve të GJEDNJ.

Avokati i Popullit gjatë këtij viti raportues ka pranuar edhe ankesa ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK). Pas hetimit të ankesave të qytetarëve, në disa raste ka konstatuar se ka pasur shkelje të drejtave të njeriut. Andaj me qëllim të eliminimit të këtyre shkeljeve dhe përmirësimit të legjislacionit në fushën e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit i ka dërguar KGJK-së rekomandimet përkatëse. Është shenjë e mirë për bashkëpunimin midis KGJK-së dhe Avokatit të Popullit që në të gjitha këto raste, ndryshe nga mospërfillja e treguar nga

autoritetet më të larta të ekzekutivit, rekomandimet e Avokatit të Popullit janë zbatuar brenda afateve të arsyeshme kohore.

Sa i përket **së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm**, gjatë periudhës së raportimit IAP ka pranuar 548 ankesa nga qytetarët dhe ka hapur 180 raste për hetime, të cilët përfshijnë pohimet për shkeljen e të drejtave të procesit të rregullt gjyqësor, veçanërisht të së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Në të gjitha rastet e hapura, IAP ka nisur hetimet dhe ka kërkuar informata nga gjykatat e instancave të ndryshme, në lidhje me veprimet të cilat janë ndërmarrë, për të mbrojtur të drejtat e njeriut. Nga përgjigjet të pranuar nga gjykatat, Avokati i Popullit ka vërejtur se gjyqësori i Kosovës ballafaqohet me një numër shumë të madh të rasteve të pazgjidhura. Numri i rasteve të pazgjidhura, sipas raportit vjetor të KGJK për punën e gjykatave të vitit 2014, është i lartë dhe ka tendencë të rritjes. Gjithashtu, një numër i ankesave të pranuar nga qytetarët ndërlidhet me të drejtat e procesit të rregullt gjyqësor, të cilat i referohen kohëzgjatjes së procedurës, për shkak të mosfunksionimit të gjykatave në pjesën veriore të Mitrovicës. Ky fakt mbetet një sfidë e madhe në sigurimin e sundimit të ligjit.

Sa i përket **të drejtave të të akuzuarit**, në raportet e mëhershme vjetore dhe raporte të veçanta, Avokati i Popullit vazhdimisht ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me cenimin e kësaj të drejte. Shkeljet e kësaj të drejte, të cilat madje edhe përsëriten, paraqesin jo vetëm shqetësim për Avokatin e Popullit, por para së gjithash cenim të rëndë të të drejtave të njeriut. Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka pranuar njëqind e dyzet e tetë (148) ankesa, për shkelje të tilla. Ankesat e pranuar dëshmojnë se paraburgimi i zgjatur dhe i pajustificuar vazhdon të jetë një sfidë për sistemin e drejtësisë penale. Në shqyrtimin e këtyre rasteve është vërejtur se vendimi për paraburgim shpeshherë nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm dhe pak ose hiq nuk përdoren masat e tjera alternative për të pandehurit.

Çështje që është ngritur edhe në raportet e kaluara dhe vazhdon të mbetet shqetësuese, është pranimi i ankesave të shumta sa i përket pakënaqësisë me mbrojtjen e ofruar, qoftë nga avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare apo edhe ata që i kanë zgjedhur vet. Avokati i Popullit konsideron se duhet siguruar mekanizëm efektiv pranë Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) në mënyrë që përfaqësuesit juridikë të papërgjegjshëm, seriozisht të hetohen dhe të nxirren para drejtësisë dhe të ballafaqohen me pasojat e shkeljes së ligjit.

Sa i përket **të drejtës për mjete juridike**, gjatë vitit 2014, IAP ka pranuar 255 ankesa. Më të shpeshta janë ankesat kundër sistemit gjyqësor, ministrive, komunave, Policisë së Kosovës dhe kompanive publike. Ankesat paraqiten për shkak të jo efikasitetit të mjetit juridik, përkatësisht të mos shqyrtimit të ankesave brenda afateve ligjore dhe mos zbatim të vendimeve gjyqësore e administrative.

Ankesa të shumta janë drejtuar kundër institucioneve gjyqësore, gjykatave të të gjitha niveleve, si dhe DHPGJSK-së. Ankesat e qytetarëve kanë të bëjnë me zvarritje, herë-herë disa vjeçare, të procedurave gjyqësore, pastaj për mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të plotfuqishme si dhe dyshime në objektivitetin e gjyqtarit në vendosjen e lëndës. Ky është një tregues i gjendjes së rëndë të sistemit gjyqësor, i cili ende nuk ka arritur të përmbushë detyrimet ligjore në raport me kërkesat dhe të drejtat e garantuara të qytetarëve, për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre.

Përveç këtyre ankesave, ankesa janë drejtuar edhe kundër ministrive, administratës dhe komunave dhe kryesisht kanë të bëjnë me mos përgjigje në kërkesat që u drejtohen atyre – heshtje administrative, të cilat përfshijnë çështje të fushave të ndryshme.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, siç u theksua më lart, “është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës” (neni 112, paragrafi

1), duke përfshirë interpretimin e dispozitave të Kapitullit të dytë të Kushtetutës, për të drejtat dhe liritë themelore. Marrë parasysh këtë rol të rëndësishëm, Avokati i Popullit, që nga raportimi i vitit të shkuar ka theksuar se do të duhej hapur diskutimi në lidhje me afatin 6 mujor, të përcaktuar nga Ligji për Gjykatën Kushtetuese, brenda të cilit Avokati i Popullit mund të kontestojë një akt juridik para GJKK-së. Avokati i Popullit propozon dhe kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ndryshimin e kësaj norme ligjore, përkatësisht të nenit 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, duke hequr tërësisht kufizimin për Avokatin e Popullit, sepse ky kufizim i afatit nuk mund të mbështetet nga përvoja e deritanishme në Republikën e Kosovës dhe në përvojat e vendeve të rajonit me ngjashmëri politiko-juridike, por as në përvojën e vendeve të tjera evropiane, që shquhen për stabilitet politik-juridik.

Avokati i Popullit, gjatë këtij viti raportues, ka pasur edhe dy shqetësime të tjera lidhur me Gjykatën Kushtetuese. Së pari, siç është diskutuar më sipër, Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese në lëndën e referuar nga Avokati i Popullit kundër Dekretit të Presidentes Jahjaga nuk përmbush as standardet minimale intelektuale, juridike dhe profesionale. Së dyti, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e tij për dështimin e vazhdueshëm të Qeverisë dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKPv) që të zbatojnë vendimin e GJKK-së për kompensimin e ish-punonjësve të Fabrikës së Çelikut - IMK Ferizaj, vendim që mbetet ende i pazbatuar që nga dhjetori i vitit 2010. Në vitin 2013 Avokati i Popullit u ka rekomanduar Qeverisë dhe AKPv-së të zbatojë vendimin e GJKK-së, por të dy institucionet në fjalë, kanë qëndruar dhe vazhdojnë të qëndrojnë të heshtura në lidhje me këtë, duke konfirmuar edhe një herë papërgjegjshmërinë dhe mospërfilljen e shtetit të Kosovës ndaj të drejtave dhe lirive të njeriut.

Pas raportimit të hollësishëm të secilës të drejtë, Kapitulli i katërt i këtij Raporti jep disa informacione lidhur me veprimtaritë e zhvilluara nga sektorët e ndryshëm të IAP-së, duke përfshirë bashkëpunimin e tij me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Kapitulli pestë e përfundon raportin me një përmbledhje statistikore të ankesave të pranuar në IAP gjatë vitit 2014.

c. Në vend të përfundimit

Njësoj si në vitin e kaluar, IAP ka vazhduar t'u ofrojë shërbimet e tij qytetarëve të cilët kanë nevojë për ndihmë, përfshirë ofrimin e të gjitha mundësive për paraqitjen e ankesave me të gjitha format e komunikimit, në çdo kohë dhe në çdo rrethanë: drejtpërdrejt në zyrat e Avokatit të Popullit për çdo ditë pune apo edhe në Ditët e Hapura, në seli apo zyra regjionale të IAP si dhe jashtë tyre, në të gjitha komunat e Kosovës, përmes postës fizike dhe elektronike, përmes familjarëve apo avokatit mbrojtës, me telefon apo edhe forma të tjera.

Nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2014, janë parashtruar 2224 ankesa dhe kërkesa për këshillë apo ndihmë juridike, nga qytetarët e Kosovës, duke shënuar një rritje rreth 10 për qind nga viti 2013. Me Avokatin e Popullit apo zëvendësit e Avokatit të Popullit janë takuar personalisht, 207 ankues, gjatë "*Ditëve të Hapura*" të mbajtura dy herë në muaj në Prishtinë dhe së paku njëherë në muaj nëpër komuna të tjera. Këto statistika janë një shenjë pozitive për rritjen e njohurisë mes qytetarëve për shërbimet e ofruara nga Avokati i Popullit, por njëkohësisht një dëshmi tjetër për rrugën e gjatë që mbetet para nesh në respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Bazuar në të gjitha këto raste të paraqitura në IAP, në kërkesat dhe ankesat e rreth 3'000 njerëzve të paraqitur në IAP për çështjet e tyre, në këtë raport IAP ka nxjerrë 141 rekomandime për institucione të ndryshme në Republikën e Kosovës.

Megjithëse rreth 75% apo 1637 ankesa të paraqitura tek Institucioni janë shpallur si të papranueshme, Avokati i Popullit dhe stafi i tij janë të ndërgjegjshëm se individët që vijnë nëpër dyert e Institucionit, qofshin edhe me ankesa që nuk janë të pranueshme, shpeshherë e shohin Avokatin e Popullit si mundësinë e fundit për të zgjidhur problemet e tyre, por edhe si instancën e fundit për të paraqitur pakënaqësitë e tyre për mospunën e institucioneve shtetërore. Prandaj, edhe në rastet në të cilat Institucionit i mungon kompetenca për të vepruar, madje sidomos në këto raste, Avokati i Popullit i dëgjon të gjithë ata që ndjejnë nevojën për t'u shprehur dhe për t'u dëgjuar për problemet e tyre, pa asnjë dallim. Çdokush pritët, dëgjohe me kujdes dhe ndihmohet aty ku është e mundur, apo këshillohet aty ku është e nevojshme. Në këtë aspekt, Institucioni i Avokatit të Popullit synon të jetë institucioni më demokratik i Republikës së Kosovës. Secili qytetar i Republikës së Kosovës është prioritet i Avokatit të Popullit.

Në fund të përmbledhjes ekzekutive të Raportit Vjetor të vitit 2013, Avokati i Popullit ka theksuar se:

Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qeverisja e mirë janë obligim i autoriteteve publike. Prandaj, Avokati i Popullit fton të gjithë personat përgjegjës në institucionet publike që të mos injorojnë ankesat e qytetarëve. Po ashtu, fton autoritetet publike që t'i marrin ato seriozisht dhe t'i trajtojnë si kontribut konstruktiv rekomandimet e Avokatit të Popullit, sepse paraqesin një mundësi të mirë për të mësuar nga gabimet dhe lëshimet dhe rrjedhimisht për përmirësimin e administratës shtetërore në përgjithësi.

Fatkeqësisht, siç tregohet në këtë Raport, një pjesë e madhe e institucioneve publike, sidomos autoritetet më të larta të shtetit, nuk e kanë pranuar këtë ftesë. Megjithatë, Avokati i Popullit përzemërsisht i falënderon ata zyrtarë, që në vitin 2014 janë treguar të përgjegjshëm dhe të gatshëm për të bashkëpunuar me IAP-në, në përputhje me obligimet e tyre ligjore dhe kushtetuese, për të mirën e vendit. Në këtë vit dhe në vitet e ardhshme, Avokati i Popullit mirëpret bashkëpunim të vazhdueshëm me këta zyrtarë, si dhe fton të gjithë zyrtarët e tjerë, sidomos ata në krye të shtetit, që të ndjekin shembullin e tyre të mirë, në mënyrë që të hapim rrugë për një avancim sa më të shpejtë, dhe të qëndrueshëm, të të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës.

Kapitulli I

Institucioni i Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (nenet 132-135) e përcakton Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) si kategori kushtetuese.³ Avokati i Popullit mbikëqyr, promovon dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike,⁴ por edhe të organeve të tjera dhe të organizatave që ushtrojnë autorizime publike për llogari të tyre.⁵ Sipas Kushtetutës, Avokati i Popullit ka një ose më shumë zëvendës.⁶ Për zgjedhjen e zëvendësve dhe punonjësve të IAP-së rëndësi e veçantë i kushtohet përbërjes shumetnike dhe barazisë gjinore.

1.1. Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Avokatin e Popullit kanë përcaktuar mandatin e Avokatit të Popullit për të pranuar dhe për të hetuar ankesa nga çdo person, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë nga autoritetet publike në Kosovë.

Në punën e vet IAP udhëhiqet nga parimet e paanshmërisë, konfidencialitetit dhe profesionalizmit, është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga organet, institucionet ose nga autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtet në Republikën e Kosovës. Të gjitha organet, institucionet dhe autoritetet tjera që ushtrojnë pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, janë të detyruara t'iu përgjigjen kërkesave të IAP-së dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

Në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese⁷ dhe ligjore,⁸ Avokati i Popullit zhvillon hetime për ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe aktet të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, posaçërisht me KEDNJ.

Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime edhe me iniciativën e vet (*ex officio*) nëse dëshmitë, faktet, konstatimet ose njohuritë e fituara ofrojnë bazë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Avokati i Popullit përdorë ndërmjetësimin dhe pajtimin, si dhe mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që ndodhen jashtë shtetit.

Avokati i Popullit nuk ndërhyr në rastet që zhvillohen në gjykata, përveç kur ka zvarritje të paarsyeshme apo keqpërdorim të dukshëm të pushtetit. Ai, po ashtu, nuk merret me hetimin e çështjeve që kanë të bëjnë me kontestet që zhvillohen ndërmjet personave privatë. Mirëpo,

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 132-135.

⁴ Po aty, neni 132.

⁵ Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 1.

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 133, paragrafi 2.

⁷ Po aty, neni 132.

⁸ Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 15.

Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në GJKK në pajtim me kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.⁹

Avokati i Popullit ka edhe përgjegjësitë e theksuara ligjore: jo vetëm t'i hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut, por edhe të angazhohet për zgjidhjen e tyre; t'i bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe të njoftojë Kuvendin, Qeverinë dhe institucionet e tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut; t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve, si dhe nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; të përpilojë raporte vjetore, periodike dhe të tjera për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës; të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv; të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha organizatat dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.¹⁰

Krijimi dhe zhvillimi i kulturës së qeverisjes dhe administrimit të mirë, që kërkon administratë profesionale, efikase dhe efektive, transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të administratës publike karshi qytetarëve që ndikon në forcimin dhe zhvillimin e sundimit të ligjit, janë objektivat kryesore të Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit angazhohet për rritjen e besimit të qytetarëve në administratën publike, sistemin gjyqësor dhe autoritetet e tjera publike.

Ankesat kundër administratës publike, qytetarët mund t'i parashtrojnë sipas një procedure të thjeshtë dhe pa pagesë. Ankesat e drejtuara në IAP mund t'u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të administratës publike, që nga ankuesit mund të konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e juristëve të IAP-së kanë të bëjnë me ofrimin e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave nga administrata publike, nga gjykatat dhe nga institucionet tjera të rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara administrative dhe gjyqësore.

Avokati i Popullit, gjithashtu është edhe një mbrojtës i autoriteteve publike nga kritikrat e pabazuara dhe të papërligjura, nga dezinformimi dhe veprimet e paligjshme, të qëllimshme apo të paqëllimshme.

Në rastet që kërkojnë veprime të menjëhershme, Avokati i Popullit paraqet kërkesa për masa të përkohshme, duke kërkuar ligjërisht që organi administrativ kompetent të ndërmarrë ose të suspendojë një veprim të veçantë, për të parandaluar dëmtimin e papërmirësueshëm të ankuesve apo pasurisë së tyre.

Në qoftë se kërkesat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me rekomandime për institucionin publik, për të evituar shkeljet. Raportet janë mjeti i fundit i institucionit për avokim, kurse kopjet e raportit i dorëzohen autoritetit që e ka bërë shkeljen, Kuvendit të Kosovës dhe organizatave të tjera relevante. Sipas ligjit, këto raporte mund të lëshohen edhe për media.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 113, paragrafi 2 dhe 135, paragrafi 4; Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 15, paragrafi 7; Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 29.

¹⁰ Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 16.

Për të mbrojtur të drejtat e disa grupeve të njerëzve që konsiderohen më të cenueshme në Kosovë, në IAP tash sa vjet funksionojnë: Njësia për të drejtat e fëmijëve, Njësia për barazi gjinore dhe Grupi për mosdiskriminim.

Pas zgjedhjes së zëvendësve të Avokatit të Popullit, në kuadër të IAP-së janë krijuar departamente, të cilat udhëhiqen nga zëvendësit e Avokatit të Popullit, si dhe njësi të tjera të veçanta, sipas fushave të caktuara.

Në kuadër të *Departamentit kundër diskriminimit* funksionojnë këto njësi: për të drejtat e fëmijëve; për barazi gjinore; kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe kundër dhunës; për personat me aftësi të kufizuara; për të drejtat e komuniteteve; për çështjet sociale dhe për të drejtat e personave LGBT.

Departamenti i Legjislacionit merret me koordinimin e punës lidhur me Kuvendin e Republikës së Kosovës; koordinimin e ngritjes së çështjeve në GJKK; vlerësimin e përputhshmërisë së ligjeve dhe akteve nënligjore; hetimin e ankesave për qasjen në dokumente publike dhe raportimin vjetor e periodik.

Në Departamentin e Ekzekutivit merren me hetimin e ankesave kundër presidencës dhe qeverisë; hetimin e ankesave kundër agjencive të pavarura; hetimin e ankesave kundër ndërmarrjeve publike; mbrojtjen e mjedisit; Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPI) si dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Departamenti i Gjyqësorit merret me hetimin e ankesave kundër gjyqësorit; kundër prokurorisë; kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK); Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe hetimin e ankesave kundër Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) dhe Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK).

Ndërsa, *Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun* merret me bashkëpunimin me shoqërinë civile; bashkëpunimin me organizatat e huaja në Kosovë; bashkëpunimin me donatorë; me publikimet si dhe me konferencat e trajnimet.

1.2. Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit

IAP çdo ditë pune pret qytetarët, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Ata priten nga këshilltarët ligjorë të IAP-së, të cilët i trajtojnë rastet me kujdes, konfidencialitet dhe profesionalizëm, duke mbledhur me kujdes të gjitha dëshmitë, informatat, dokumentet dhe duke evidentuar të gjitha pohimet e tyre për shkelje të të drejtave të njeriut.

Për të lehtësuar qasjen e qytetarëve të Kosovës në IAP, përveç Zyrës Qendrore në Prishtinë, IAP ka edhe zyra rajonale në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Graçanicë. Po ashtu, në kuadër të Zyrës Rajonale të IAP-së në Mitrovicë funksionon edhe nën-zyra e saj në veri të qytetit. Zyrat e IAP-së përbëhen nga stafi profesional që u shërben qytetarëve dhe trajton kërkesat dhe ankesat e tyre, bazuar në mandatin ligjor. Ankesat e qytetarëve në zyrat e IAP-it pranohen çdo ditë pune (nga e hëna deri të premten) nga ora 8:30 - 16.00. Por, për raste urgjente, qytetarët mund të paraqiten edhe jashtë orarit të punës.

Për qasje më të lehtë të qytetarëve organizohen 'Ditët e Hapura' nga Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij. Ato organizohen në Prishtinë (dy herë në muaj) dhe në komunat e tjera të Kosovës (nga një herë në muaj). Zyrat rajonale i njoftojnë qytetarët e komunave përkatëse për

ditët e hapura përmes publikimit të datave nëpër këto komuna, nëpërmjet mediave lokale dhe nëpërmjet faqes zyrtare të IAP-së në internet.

Format e tjera të qasjes janë edhe nëpërmjet postës, telefonit, telefaksit dhe me postë elektronike, që po përdoret gjithnjë e më shumë dhe e cila, në të shumtën e rasteve momentalisht po përdoret për parashtrimin e ankesave nga qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës. Në Zyrën Qendrore të IAP-së në Prishtinë ekziston edhe linja telefonike falas për të gjithë ankuesit.

Zyrtarët e IAP-së bëjnë vizita të rregullta në të gjitha burgjet dhe në vendet ku mbahen personat me liri të kufizuar në Kosovë. Për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me të burgosurit, në bashkëpunim me autoritetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) dhe me autoritetet përgjegjëse të burgjeve në Kosovë, IAP që nga viti 2004, në të gjitha burgjet dhe në qendrat e paraburgimit në Republikën e Kosovës, në vende të dukshme, ka vendosur kutitë postare, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e IAP-së. Kjo praktikë ka dëshmuar se kutitë e vendosura nëpër burgje, përkatësisht në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, kanë ndihmuar shumë të privuar nga liria ta vënë kontaktin e parë me Avokatit e Popullit. Kutitë e tilla janë vendosur edhe në Entet dhe Qendrat e Shëndetit Mendor, gjë që lehtëson qasjen e pacientëve në IAP. Këto ente dhe qendra vizitohen rregullisht për çdo muaj nga përfaqësuesit e IAP-së.

1.3. Zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut është obligim i çdo shteti. Ato duhet t'i përmbahen marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe t'i ratifikojnë dhe t'i zbatojnë ato.

Republika e Kosovës i ka përfshirë në Kushtetutën e saj shumicën e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare më të rëndësishme për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat njëkohësisht janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë. Në rast konflikti ato kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike të Kosovës.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës shprehimisht garantohet zbatimi i drejtpërdrejtë i instrumenteve ndërkombëtare, si në vijim: *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*, *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore si dhe Protokollet e saj*, *Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj*, *Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*, *Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor*, *Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas*, *Konventa për të Drejtat e Fëmijës*, si dhe *Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mëzore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese*.¹¹

Këto instrumenteve ndërkombëtare kanë rëndësi të posaçme në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për shkak se ato zbatohen drejtpërdrejt edhe në raste kur ka mangësi apo zbrazëti të shprehura në legjislacionin e brendshëm të Kosovës.

IAP ka vërejtur shkelje serioze të këtyre instrumenteve në disa raste të caktuara. Ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2014, dëshmojnë se ato kryesisht kanë të bëjnë me të drejtën për

¹¹ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 22.

proces të rregullt gjyqësor.¹² Mbingarkesa e gjykatave me lëndë të vjetra të pazgjidhura dhe vonesa në trajtimin e lëndëve të reja, si dhe mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë, tash sa vjet po e rëndojnë punën e gjyqësorit në Kosovë dhe në këtë mënyrë qytetarëve të Kosovës po u cenohet e drejta për proces të drejtë, të rregullt, të paanshëm dhe brenda afatit të arsyeshëm.

Edhe pse Republika e Kosovës nuk është nënshkruese e Protokollit, ajo ka obligim kushtetues të zbatojë drejtpërdrejt Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Avokati i Popullit rithekson se zbatimi i dispozitave të Protokollit Opcional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese do të mundësojë realizimin e monitorimit edhe më të plotë, më efektiv dhe efikas të institucioneve ku mbahen personat e ndaluar dhe të dënuar. Në këtë drejtim janë ndërmarre aktivitete nga *Grupi Punues*, i cili vepron si pararendës i MKPT-së,¹³ krijimi i të cilit parashihet me këtë protokoll.¹⁴

Edhe një herë, Avokati i Popullit, ri-përsërit shqetësimin e tij për mospërfshirjen e Konventës për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të OKB-së dhe të Kartës Sociale Evropiane në Kushtetutën e Kosovës. E drejta për strehim adekuat, e drejta në punë dhe ato që burojnë nga marrëdhënia e punës, e drejta për sigurim shëndetësor dhe një sërë të drejtash të tjera sociale dhe ekonomike, janë vetëm disa nga të drejtat që përmban kjo konventë, e të cilat ende vazhdojnë të mos kenë mbrojtjen e duhur ligjore në Kosovë. Prandaj, përfshirja e kësaj konvente në Kushtetutën e Republikës së Kosovës është e domosdoshme edhe si garanci shtesë për qytetarët e Kosovës, përkatësisht për mbrojtjen e të drejtave të tyre ekonomike dhe sociale.

Po ashtu, Avokati i Popullit rithekson se në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës, duhet të përfshihet edhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Edhe pse normat e kësaj konvente në masë të konsiderueshme janë të përfshira në instrumentet tjera ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, përfshirja e saj është e domosdoshme, për shkak se kjo Konventë është instrumenti më gjithëpërfshirës ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, i dedikuar posaçërisht për personat me aftësi të kufizuara, kategori kjo që përbën rreth 10 % të popullsisë së përgjithshme të vendit, e që synon integrimin e plotë në të gjitha fushat shoqërore, politike dhe ekonomike në Kosovë.

¹² *KEDNJ*, neni 6, paragrafi 1. “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

¹³ Si rezultat i bashkëpunimit të IAP-së me disa OJQ vendore (Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive të Njeriut - KMDLNJ dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - QKRMT), në maj të vitit 2011 është formuar Grupi Punues i përbashkët, me të cilat është nënshkruar edhe marrëveshja e bashkëpunimit.

¹⁴ *Protokollit Opcional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese*, neni 3 „Çdo Shtet Palë krijon, projekton ose mban në nivel kombëtar një ose disa organe vizitore për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit të egër, jonjerëzor ose poshtëruar.”

Rekomandime:

- *Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të përfshihet Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e OKB-së, si dhe Karta Sociale Evropiane.*
- *Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të përfshihet Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.*
- *Të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të angazhohen për respektimin dhe zbatimin e plotë të instrumenteve ndërkombëtare, siç kërkohet shprehimisht me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*

Kapitulli II

Pjesa e parë - Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut

2.1. E drejta për jetën

E drejta për jetën, si një e drejtë themelore dhe kusht i parë për ekzistimin e të drejtave të tjera, garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹⁵ dhe me KEDNJ-në.¹⁶

Gjatë vitit 2014, IAP ka pranuar 7 ankesa, lidhur me shkeljen e të drejtës për jetën.¹⁷ Nga ky numër 5 ankesa janë ende në procesin e hetimeve, ndërsa për 2 raste ka përfunduar shqyrtimi. Për dy raste tjera janë hapur hetime sipas detyrës zyrtare *ex officio*. Në njërin nga rastet bëhet fjalë për vetëvrasje të një të dënuari në burg.¹⁸ Në këtë rast çështje për hetim janë veprimet e obligueshme të autoriteteve, me mjete që kanë në dispozicion, për të parandaluar vetëvrasjen e të burgosurit.¹⁹

2.1.1. Pasojat e mosveprimit respektivisht zvarritjes në gjykatë

Një dukuri shqetësuese për Avokatin e Popullit është edhe zvarritja gjyqësore e zgjidhjes së kontesteve pronësore, që në disa raste kanë për pasojë shkeljen e të drejtës për jetën.²⁰ Ankuesi kishte parashtruar padi për vërtetimin e pronësisë dhe kthimin e saj në Gjykatën Komonale në Prizren (tani Gjykata Themelore) më 22 prill 2002.²¹ Më 24 korrik 2014, pala parashtron ankesë në IAP, për zvarritje të procedurës për shqyrtimin e lëndës së tij që nga prillit 2002 e deri në ditën e paraqitjes së ankesës në IAP (përfundimin e këtij raporti),²² duke theksuar se, për shkak të moszgjidhjes 12-vjeçare të këtij kontesti nga gjykata, palët në kontest

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 25.

¹⁶ KEDNJ, neni 2, paragrafi 1.

¹⁷ LAP, rastet: A. nr. 18/2014, A. nr. 68/2014, A. nr. 154/2014, A. nr. 177/2014, A. nr. 337/2014, A. nr. 420/2014, A. nr. 422/2014.

¹⁸ LAP, rasti *ex officio* A. nr. 422/2014.

¹⁹ *Udbëzimi Administrativ për Trajtimin e të Burgosurve në Institucionet Korrektuese*, neni 38.1 “Personat që konstatohet që janë me çrregullime mendore nuk do të mbahen në burg, por sa më shpejt që të jetë e mundur në marrëveshje me institucionet përkatëse shëndetësore do të zhvendosen në vende të përshtatshme për sëmundje mendore”; dhe shih Manualin e të Drejtave të Njeriut, nr. 8. Një udhëzues për zbatimin e nenit 2 të KEDNJ, Douwe Korf, E drejta për jetën, f. 19. *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në të cilën shteti akuzohej se nuk kishte mbrojtur mjaftueshëm një person të sëmurë mendërisht nga vetëvrasja.

²⁰ LAP, rasti A. nr. 337/2014.

²¹ Padia e protokolluar në Gjykatën Komonale në Prizren më 22 prill 2002.

²² KEDNJ, neni 6, paragrafi 1, i cili garanton që: “Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile çdokush ka të drejtë për proces të hapur dhe të drejtë brenda një afati të arsyeshëm [...]”. I njëjti parim është edhe në nenin 10.1 të *Ligjit të Procedurës Kontestimore*, i cili thotë që: “Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas ligjit”.

për pronën kontestuese, më 29 qershor 2014 ngatërrohen mes vete dhe për pasojë një person vritet dhe disa të tjerë lëndohen rëndë dhe lehtë.²³

Lidhur me rastin, më 11 gusht 2014 Avokati i Popullit i dërgoi letër Gjykatës Themelore në Prizren, për të kuptuar shkaqet e zvarritjes së lëndës. Nga përgjigja e kryetarit të gjykatës, të datës 21 gusht 2014, Avokati i Popullit informohet se më 6 mars 2013, gjyqtari i çështjes ka caktuar seancën përgatitore, por nga ajo kohë e deri më tani gjyqtari i çështjes nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër për këtë lëndë.²⁴

2.1.2. Mungesa apo zvarritja e hetimeve

Shqetësim të veçantë për Avokatin e Popullit paraqesin zvarritjet në hetimin e lëndëve penale dhe mungesa e hetimeve efektive për rastet e paraqitura, në lidhje me shkeljen e të drejtës për jetën.

Edhe në këtë periudhë raportuese IAP, ka pranuar disa ankesa që kanë të bëjnë me cenimin e kësaj të drejte dhe mungesën e hetimeve efikase nga organet përgjegjëse, lidhur me zvarritjen e procedurave hetimore, gjetjen, zbulimin dhe identifikimin e kryerësve të vrasjes dhe nxjerrjen e tyre para drejtësisë. Cenimi i së drejtës për jetën dhe rastet e vdekjeve për shkaqe të ndryshme si në fatkeqësitë në komunikacionin rrugor,²⁵ vrasjet dhe lëndimet trupore, janë vepra penale, kryerësit e të cilave, në shumë raste arrijnë t'i ikin përgjegjësisë dhe të mos zbulohen nga autoritetet përgjegjëse.

Një nga sfidat me të cilat ndeshet shoqëria jonë është edhe fenomeni i gjakmarrjes, zakon i trashëguar nga e kaluara dhe veprim ky në kundërshtim me parimet e shoqërisë moderne dhe të shtetit të së drejtës. Në këtë drejtim rol të rëndësishëm ka zbatimi i ligjit, sidomos nga ana e policisë kriminale, prokurorisë dhe gjykatës, të specializuara me kualifikime përkatëse, e të cilat janë kompetente për ruajtjen e rendit dhe zbatimin e ligjit pa marrë parasysh pengesat.

Pa marrë parasysh rrethanat, mënyrën dhe situatën e cenimit të së drejtës për jetën, autoritetet nuk kanë të drejtë të shmangin detyrimin ligjor, sipas kuptimit të nenit 2 të KEDNJ për të siguruar zhvillimin e një hetimi të pavarur dhe efektiv për rastet e cenimit të së drejtës për jetën. Avokati i Popullit konstaton se, mungesa e hetimit efektiv për rastet e vrasjeve dhe vendimit gjyqësor, pengon të afërmit e viktimës t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar shpërblimin e dëmit, për shkak të shkeljes të së drejtës. Prandaj, është obligim i autoriteteve që qytetarëve t'u sigurohen mjete të përshtatshme ligjore për realizimin e kompensimit për dëmet e shkaktuara në rastet e dështimit të institucioneve publike kompetente për hetimin, zbulimin e kryerësve të veprave penale dhe nxjerrjen e tyre para drejtësisë. Deri në krijimin e mekanizmave të tillë, sistemi juridik në Kosovë, do të vazhdojë të mos jetë efikas.

²³ Shih Aktvendimin për caktimin e paraburgimit palëve për kontest pronësie nga Gjykata Themelore në Prizren Ppr. nr. 133/2014, datë 18 korrik 2014.

²⁴ *Ligji i Procedurës Kontestimore*, neni 420.2, i cili thotë: “Seanca kryesore do të mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditor nga dita në të cilën është mbyllur seanca përgatitore”.

²⁵ Informata të pranuar nga drejtorja e Divizionit të Komunikacionit Rrugor në Policinë e Kosovës, më 4 dhjetor 2014. Vetëm nga aksidentet e trafikut në Kosovë, në periudhën 1 janar - 30 nëntor 2014, në Kosovë kanë ndodhur 116 vdekje.

Rekomandime:

Shërbimi Korrektues i Kosovës

- *Të mos i mbajë personat me çrregullime mendore në burg, por në marrëveshje me institucionet përkatëse, t'i dërgojë në institucione të përshtatshme për personat të tillë.*

Këshillin Prokurorial të Kosovës

- *Organet e prokurorisë, në bashkëpunim të ngushtë me policinë, të zhvillojnë hetime të shpejta, të plota e objektive, brenda afateve ligjore, duke dërguar çështjet në gjykata, me prova dhe fakte të plota e të dëshmuara.*

2.2. Dinjiteti i njeriut dhe integritetit personal

Dinjiteti i njeriut dhe e drejta e integritetit personal garantohen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës²⁶ dhe si të tilla janë të ndërlidhura me njëra tjetrën, sepse dinjiteti i njeriut është pjesë e pandashme e qenies njerëzore dhe personalitetit të tij.

2.2.1. Shkelja mbi dinjitetin e njeriut

IAP gjatë periudhës raportuese ka pranuar dhe trajtuar ankesa të ndryshme për shkeljet e pohuara të dinjitetit të njeriut.

Një ndër ankesat për të cilën IAP ka hapur hetime është edhe rasti i një nëne në qytetin e Mitrovicës. Njëra nga degët e partive politike në Mitrovicë, për qëllime politike, pa lejen e nënës, në rrjetin social facebook, kishte publikuar fotot e birit-fëmijës të saj, duke cenuar kështu dinjitetin dhe privatësinë e fëmijës në këtë rast. Përfaqësuesi IAP-së, me anë të kontakteve të vazhdueshme dhe komunikimit përmes letrave, ka kërkuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP), që në përputhje me ligjin të sanksionohet partia për të cilën bëhet fjalë, në mënyrë që në të ardhmen mos të përsëritën raste të tilla. Përfaqësuesi IAP-së, po ashtu përmes kontakteve me përfaqësuesit e partisë politike, ka kërkuar që këto fotografi, të hiqen nga rrjeti social facebook. Prej përgjigjes nga partia politike, ka rezultuar se pas kërkesës dhe ndërmjetësimit të Avokatit të Popullit, fotot e publikuara janë hequr nga rrjeti social.²⁷

Një formë tjetër e cenimit të dinjitetit të njeriut është edhe trajtimi i të punësuarve në tregun privat të punës në Kosovë, që në rastet e skajshme marrin karakteristika të skllavërimit. Nga hetimet e IAP në një rast të tillë, janë konstatuar shkelje të një sërë të drejtave të njeriut nga një kompani private e sigurimit në Kosovë. Punëtori i punësuar në këtë kompani që nga viti 2010, kishte punuar nga 7 ditë në javë me ndërrime, natën dhe ditën, pa asnjë ditë pushimi, duke mos iu respektuar e drejta e punës, e drejta për pushim vjetor dhe pagesë për ndërrimin

²⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 23 dhe 26.

²⁷ LAP, rasti A. nr. 152/2014.

e natës. Pas 4 viteve përvojë pune në këtë kompani, ishte larguar nga puna pa asnjë arsyetim dhe pa njoftim paraprak.²⁸

Bazuar në këto të dhëna dhe duke u ndërlidhur me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), e cila thekson se “*Gjithkush që punon ka të drejtën për shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t’i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor*”,²⁹ Avokati i Popullit konsideron se në rastin konkret, përveç shkeljes së ligjit të punës ku parashihen përcaktimi i orarit të punës, e drejta në pushim ditor, javor dhe vjetor, dhe e drejta në kompensim për punën e bërë gjatë orarit dhe pas orarit të punës,³⁰ këtu kemi të bëjmë edhe me cenimin e dinjitetit njerëzor të të punësuarit dhe shumë të punësuarve të tjerë që punojnë nëpër kompani private dhe nuk gëzojnë as të drejtat elementare të parapara me ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Kjo dukuri fatkeqësisht është e shprehur te shumica e operatorëve ekonomik privatë në Kosovë, duke shfrytëzuar kështu në mënyrën më të vrazhdë krizën ekonomike dhe papunësinë e madhe, në njërën anë dhe mungesën deri në padukshmëri të institucioneve përgjegjëse të shtetit, respektivisht të Inspektoratit të Punës, për një kontroll të respektimit dhe të zbatimit të legjislacionit për punën në Kosovë, në anën tjetër. Përfaqësuesi IAP-së, me anë të takimeve me përfaqësuesit e Inspektoratit të Punës, ka kërkuar të ndërmerren masa ndaj përfaqësuesve të kompanive private në mënyrë që në të ardhmen mos të përsëriten këto raste.

Avokati i Popullit, me qëllim të parandalimit të shkeljes së dinjitetit dhe të të drejtave të njeriut, është i përkushtuar të ketë një qasje sa më praktike dhe aktive. Prandaj, si pjesë e pandashme e punës së tij janë vizitat e rregullta, në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria anëmbanë Kosovës, si dhe vizitat periodike në Shtëpinë për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (*Shtëpia e Pleqve*) në Prishtinë. Këto vizita shërbejnë për t’u siguruar nëse në ato vende mbrohet dhe respektohet dinjiteti i njeriut, sipas standardeve ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.

Një shqetësim të veçantë paraqet mbrojtja e dinjitetit të njeriut, te familjet që jetojnë në varfëri. Sipas statistikave në Kosovë, në varfëri të përgjithshme jetojnë afërsisht 29.7 %, ndërsa në varfëri ekstreme jetojnë afërsisht 10.2%.³¹ Bazuar në këtë, jeta në kushte të rënda ekonomike, lë shumë për të dëshiruar për një jetë të dinjitetshme për këtë kategori të shoqërisë kosovare.

2.2.2. Integriteti personal

Sa i përket të drejtës së Integritetit Personal, IAP po ashtu ka pranuar disa ankesa. Karakteristik është rasti i një ankueseje, e cila gjatë vizitës mjekësore në një prej spitaleve

²⁸ LAP, rasti A. nr. 453/2014.

²⁹ DUDNJ, neni 23, paragrafi 3.

³⁰ Ligji i Punës, Nr. 03/L-2012, nenet 20, 28, 30 dhe 32.

³¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2014*, botuar në maj 2014, në: <http://esk.rks-gov.net> (12.12.2014).

private në Kosovë, në rrethana të dyshimta është operuar pa dëshirën e saj,³² duke cenuar të drejtën e saj për të mos iu nënshtruar trajtimit mjekësor kundër vullnetit të saj.³³

Avokati i Popullit rithekson se bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, çdokush ka të drejtën për të marrë vendime për riprodhim, të drejtën për të pasur kontroll mbi trupin, të drejtën për të mos iu nënshtruar trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij dhe të drejtën për të mos qenë pjesë e eksperimenteve mjekësore ose shkencore pa pëlqimin e tij. Edhe GJEDNJ ka theksuar se, vendimi për të detyruar një person t'i nënshtrohet trajtimit mjekësor pa pëlqimin e tij, shkel integritetin e tij.³⁴

Kategoritë më të cenueshme të popullatës zakonisht janë edhe viktimat më të shpeshta dhe më të mundshme të cenimit të dinjitetit dhe integritetit njerëzor, si: pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, individët dhe familjet me gjendje të rëndë ekonomike sociale dhe me varfëri, fëmijët, femrat, pjesëtarët e komuniteteve pakicë etj.

Sikurse edhe në raportet e mëhershme, Avokati i Popullit rikujton se edhe gjatë kësaj periudhe raportuese një shqetësim të veçantë paraqet gjendja e pensionistëve të Kosovës. Çështje kjo që sipas ankesave të parashtruara në IAP, është e rëndë. Pensionet të cilat pensionistët e Kosovës i marrin nga shteti, edhe më tej ngjasojnë si një ndihmë sociale dhe jo e drejtë e realizuar nga puna dhe e rregulluar me ligj. Kompensimi material dhe financiar për kontributin e tyre shoqëror për dekada të tëra që marrin pensionistët në Kosovë, por edhe mjetet që marrin përfituesit e ndihmave sociale, familjet që jetojnë në varfëri, nuk sigurojnë një jetë të dinjitetshme për këto kategori të shoqërisë kosovare.³⁵

Po ashtu, sfidë me të cilën ballafaqohen qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës edhe më tutje është mbrojtja e dinjitetit të njeriut për personat me aftësi të kufizuara. Sikurse edhe në raportet e mëhershme, Avokati i Popullit rikujton dhe rithekson se, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, situata e kësaj kategorie në Republikën e Kosovës ka vazhduar të jetë tejet e rëndë, pa përmirësime. Shqetësim të veçantë për Avokatin e Popullit, paraqet sidomos moszbatimi i infrastrukturës ligjore, që për qëllim primar ka zbutjen e diskriminimit të personave të kësaj kategorie.³⁶

Shkelja e të drejtave të njeriut, cenimi i dinjitetit dhe i integritetit personal ndodh më tepër në situata të pafavorshme për individin, veçanërisht kur ai është i pafuqishëm që t'i mbrojë, t'i kërkojë dhe të luftojë për të drejtat e veta.

Avokati i Popullit konsideron se, obligim i shtetit nuk është vetëm garantimi kushtetues i pacenueshmërisë së dinjitetit të njeriut dhe integritetit të tij personal. Kjo është vetëm nismë e mirë, por e pamjaftueshme në një shoqëri demokratike. Prandaj, obligim i shtetit duhet të jetë respektimi dhe mbrojtja e dinjitetit të njeriut me të gjitha mjetet dhe në të gjitha rrethanat.

³² LAP, rasti A. nr. 310/2014.

³³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 26, paragrafi 3.

³⁴ GJEDNJ, *Glass v. United Kingdom*, Application no. 61827/00, Judgment, 09.03.2004, në: <http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-61663> (9.12.2014).

³⁵ LAP, Raporti vjetor 2013, f. 27 dhe 110.

³⁶ *Po aty*, f. 27.

2.3. E drejta e lirisë dhe sigurisë

Kjo e drejtë garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës³⁷ dhe me aktet tjera ndërkombëtare siç janë: Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike³⁸ dhe KEDNJ.³⁹

GJEDNJ ka theksuar rëndësinë dhe qëllimin e nenit 5 të KEDNJ-së.⁴⁰ GJEDNJ këtë nen e vendos në radhën e parë të të drejtave themelore që mbron sigurinë fizike të individit të caktuar. Sipas kësaj gjykate, qëllimi kyç i këtij neni është parandalimi i privimit nga liria në mënyrë arbitrare dhe të pajustificuar.⁴¹

Gjatë kësaj periudhe, Avokati i Popullit nuk ka pranuar ankesa për privim nga liria në mënyrë të kundërligjshme dhe arbitrare. Përfaqësuesit e IAP kanë realizuar një numër të konsiderueshëm të vizitave në burgje, qendrat e paraburgimit dhe qendra të ndalimit në stacionet policore. Nga intervistat e realizuara me personat e ndaluar, në disa raste ka pasur pohime për shkelje të së drejtës së lirisë dhe sigurisë, duke iu referuar vendimeve për paraburgim dhe zvarritjes jashtëligjore të procedurave gjyqësore deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë.

Në rastet të cilat i ka analizuar dhe monitoruar IAP i referohen kohëzgjatjes së paraburgimit. Në këto raste paraburgimi është duke zgjatur katër (4) vite dhe po të njëjtat raste deri në momentin e raportimit ende janë duke u trajtuar nga gjykata kompetente.⁴²

Avokati i Popullit rithekson se administrimi efektiv i drejtësisë është obligim dhe përgjegjësi e autoriteteve kompetente, gjë që do të siguronte që në rastin e caktuar kohëzgjatja e paraburgimit të personit të akuzuar të mos tejkalojë afatet ligjore. Kohëzgjatja e paraburgimit duhet të jetë në harmoni të plotë me aktet vendore dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit po ashtu rithekson se masa e paraburgimit duhet të caktohet vetëm në rastet kur një gjë e tillë është e domosdoshme, ndërsa vendimi për caktimin e paraburgimit duhet të arsyetohet mirë ligjërisht, pasi që arsyetimi i tillë është i nevojshëm dhe i rëndësishëm për të pandehurin për ushtrimin e të drejtës së tij për të kundërshtuar atë vendim. Kjo kërkesë është edhe në përputhje me vendimet e GJEDNJ, e cila ka theksuar se në secilin rast, baza juridike për shqiptimin e masës së paraburgimit duhet të jetë e qartë dhe gjykatat duhet të theksojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë.⁴³

Po ashtu, është përgjegjësi e autoriteteve kompetente që të garantojnë sigurinë e personave të cilët janë nën përkujdesjen e tyre dhe të cilët mbahen në qendrat e ndalimit, paraburgimit dhe në burgje.

³⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29.

³⁸ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 9.

³⁹ KEDNJ, neni 5.

⁴⁰ GJEDNJ, *McKAY v. The United Kingdom*, Application no. 543/03, Judgment, 3 October 2006, në: <http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-126353#%7B%22itemid%22:%5B%22001-77177%22%5D%7D> (8.12.2014).

⁴¹ *Po aty*.

⁴² LAP, rastet A. nr. 442/2014 dhe A. nr. 197/2013.

⁴³ GJEDNJ, *Danalchi v. The Republic of Moldova*, Application no. 25664/09, Judgment, 17.12.2013, në: <http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-126353#%7B%22itemid%22:%5B%22001-126353%22%5D%7D> (8.12. 2014).

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, në Qendrën Korrektuese (QK) të Dubravës, një person i dënuar u dhunua në qelinë në të cilën mbahej.⁴⁴ Avokati i Popullit rithekson obligimin e autoriteteve kompetente që të garantojnë sigurinë e personave të cilët janë në përkujdesjen e tyre. Ndërsa, në këto rast janë të obliguara të zhvillojnë hetim efektiv dhe të pavarur në mënyrë që të zbardhen rastet.

Rekomandime:

- *Këshilli Gjyqësor i Kosovës të ndërmarrë masat e nevojshme për të garantuar administrimin efektiv të gjyqësisë, në mënyrë që të evitohet çdo zvarritje e panevojshme e paraburgimit dhe rastet e paraburgimit të trajtohen brenda afatit të arsyeshëm kohor.*
- *Ministria e Drejtësisë, respektivisht Shërbimi Korrektues i Kosovës, të ndërmarrë të gjitha masat për sigurinë e personave të cilët ndodhen nën përkujdesjen e tyre në qendrat e ndalimit, paraburgimit dhe në burgje, bazuar në obligimin e tyre ligjor.*

2.4. Ndalimi i torturës

2.4.1. Vizitat në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria

Në vitin 2014, Avokati i Popullit, në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor për parandalimin e torturës,⁴⁵ ka realizuar vizita të rregullta mujore në të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit si dhe në vendet ku liria e lëvizjes është e kufizuar.

IAP ka vizituar edhe Institucionet e shëndetit mendor dhe të kujdesit social, si dhe Qendrën e Azilit.⁴⁶ Këto vende nuk paraqesin vende klasike për privim nga liria, mirëpo IAP këto vende i viziton në përputhje me kompetencat që dalin nga neni 4 dhe 20 i Protokollit Opcional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese ose Ndëshkuese.⁴⁷

Vizitat në këto institucione realizohen në bashkëpunim me drejtoritë dhe të punësuarit, ndërsa zyrtarët e IAP kishin qasje të papengueshme në të gjitha hapësirat ku mbahen personat e privuar nga liria, si dhe kishte liri të plotë në zgjedhjen e personave me të cilët zhvilloi biseda.

⁴⁴ IAP, rasti *ex officio* A. nr. 422/2014.

⁴⁵ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 27 "Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjërzor ose poshtëruës".

⁴⁶ Avokati i Popullit ka vizituar Azilin e Refugjatëve më 20 qershor 2014, në Ditën Ndërkombëtare të Refugjatëve. Në qendër ishin të vendosur 9 persona. Kjo qendër i plotëson standardet më të larta evropiane për azilkërkuesit.

⁴⁷ OPCAT është adoptuar më 18 dhjetor 2002 në seancën e 57 të Asamblesë së Përgjithshme të UN, me Rezolutën A/RES/57/199 dhe ka hyrë në fuqi më 22 qershor 2006.

2.4.2. Ankesat e personave të privuar nga liria

Gjatë vitit 2014 IAP ka realizuar 161 vizita monitoruese në burgje, qendra të paraburgimit, qendra të ndalimit dhe institucionet tjera, ku liria e lëvizjes është e kufizuar.

Ankesat janë pranuar nëpërmjet kutive të vendosura në këto qendra, nëpërmjet postës, thirrjeve telefonike, familjarëve, avokatëve apo edhe nëpërmjet punëtorëve social të atyre institucioneve. Ankesat e natyrës urgjente, kryesisht procedohen menjëherë, përmes postes elektronike apo telefonit si dhe drejtpërdrejt nëpërmjet menaxhmentit të institucionit korrektues. Hapja e kutive të ankesave bëhet gjatë vizitave të rregullta në këto institucione.

Shumica e ankesave të pranuara janë drejtuar kryesisht kundër vendimeve të gjykatave, Panelit për Lirim me Kusht (PLK), trajtimin shëndetësor, mos lejimin e pushimit të fundjavave, transferimeve, ekstradimeve.

2.4.3. Lirimi me kusht

PLK ka vazhduar punën në trajtimin e rasteve që kanë aplikuar për të fituar të drejtën për lirim me kusht. Shqetësimi i vazhdueshëm i IAP për përbërjen e Panelit me tre anëtarë të rregullt dhe një të katërt zëvendësues,⁴⁸ është dëshmuar i drejtë, pasi që janë evidentuar raste kur anëtarë të caktuar të këtij Paneli janë ballafaquar me situatën, që edhe gjyqtari edhe prokurori është dashur të përjashtohen, për shkak të konfliktit të interesit. Andaj, është vendosur që të emërohen dy anëtar të tjerë, të ashtuquajtur, pasiv dhe të cilët do të angazhohen në rastet e konfliktit të interesit.⁴⁹

PLK e ka mbajtur 34 seanca, gjatë të cilave ka shqyrtuar 234 raste, të përcaktuara sipas listës që u ka arritur nga qendrat korrektuese. Gjatë kësaj periudhe nga PLK janë liruar me kusht 56 persona, ndërsa nën mbikëqyrjen e Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK), kanë qenë 88 persona të liruar me kusht nga burgju, prej të cilave 32 raste kanë qenë të bartura nga vitet e kaluara. Dy raste kanë qenë femra, prej të cilave, njëra e ka përfunduar me sukses përkujdesjen ndërsa tjetra vazhdon të jetë në programin e përkujdesjes.

Nga numri i përgjithshëm, gjatë vitit 2014, mbikëqyrjen e kanë mbaruar me sukses 36 persona, ndërsa 50 raste vazhdojnë të jenë ende nën mbikëqyrje të SHSK-së. Gjatë vitit raportues 2 raste nuk iu kanë përmbajtur me sukses obligimeve të mbikëqyrjes, për çka PLK e ka revokuar vendimin për lirim me kusht. Në Programin e Përkujdesjes pas Lirimit, kanë marrë pjesë 38 të mitur, prej të cilëve 11 janë bartur nga vitet e kaluara. Nga ky numër 17 kanë përfunduar me sukses programin, ndërsa përkujdesja vazhdon për 21 të tjerë.⁵⁰

⁴⁸ IAP, *Raporti vjetor 2013*.

⁴⁹ KGJK me Vendimin nr. 01/196, më 14 maj 2014, ka emëruar kryesuesin rezervë vetëm në rastet kur kryesuesja përjashtohet nga shqyrtimi, sipas nenit 22 të Rregullores nr. 01/39, mbi organizimin dhe funksionimin e Panelit për Lirim me Kusht. Gjithashtu, KGJK me Vendimin nr. 129 më 16 shtator 2014, ka emëruar kryesuesin rezervë, në rastet kur të dy kryesuesit përjashtohen nga shqyrtimi, konform nenit 22 të Rregullores nr. 01/39 për PLK.

⁵⁰ IAP i ka siguruar informatat nga z. Armend Mustafa, udhëheqës i Divizionit për Masa dhe Dënime Alternative në SHSK.

Gjatë këtij viti raportues, IAP ka pranuar një numër të madh të ankesave kundër vendimeve të PLK, për shkak të numrit të vogël të lirimeve, mos informimit me kohë për vendimin e marrë, përpilimit të vendimeve, që të shumtën e rasteve nuk kanë arsyetim të mjaftueshëm për shkaqet e refuzimit. Kjo siç duket ka shkakuar pakënaqësi në mesin e të dënuarve, dhe për këtë arsye IAP ka hapur për hetim ankesën e parashtruar përmes peticionit të nënshkruar nga 93 të dënuar. Lidhur me ankesën i është drejtuar me shkresë KGJK-së, nën mbikëqyrjen e së cilës punon PLK.⁵¹

IAP, po ashtu, ka hapur hetim edhe për ankesën e parashtruar me peticion, të nënshkruar nga ana e 63 të dënuarve të tjerë, kundër PLK.⁵² Të dënuarit ankohen se atyre po u shkilen të drejtat e parapara në nenin 3 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (KPRK),⁵³ për moszbatim të dispozitave të cilat janë më të favorshme. Ankuesit pohojnë se janë të dënuar me ligjin që ka qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të KPRK të vitit 2013,⁵⁴ për çka atyre u mohohet e drejta e radhitjes në Panelin për lirim me kusht, pasi ta kenë vuajtur gjysmën e kohës së dënimit, ashtu si ka qenë e paraparë në kohën kur janë dënuar.⁵⁵

2.4.4. Kujdesi shëndetësor

Me përkrahjen e BE, është bërë hapja e Institutit të Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK)⁵⁶ ku do të trajtohen personat, të cilët kanë kryer vepra të ndryshme penale dhe të cilët kanë nevojë që krahas ekspertizës psikiatriko - forenzike njëkohësisht t'i nënshtrohen edhe trajtimit të detyrueshëm në këtë institucion.

Ky Institut ka kapacitet prej 36 shtretërve, 12 prej të cilëve janë për ekspertizë psikiatriko forenzike, ndërsa 24 të tjerë për trajtim të detyrueshëm, janë vendosur gjithsej 12 persona, 6 në repartin e vlerësimeve dhe 6 në repartin e trajtimit të detyrueshëm.⁵⁷ Personat që vendosen në Institut, vijnë me urdhër të gjykatës dhe meqenëse mund të jenë të rrezikshëm qoftë për vetveten, qoftë për stafin, për siguri janë angazhuar gardianët. IPFK për momentin vepron në kuadër të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar, por është duke u punuar që Instituti të kalojë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

⁵¹ LAP, rasti A. nr. 443/2014.

⁵² LAP, rasti A. nr. 553/2014.

⁵³ Kodi Penal i Kosovës, nr. 04/L-082, ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, neni 3, paragrafi 2, “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.”

⁵⁴ Po aty, neni 94, paragrafi 2 “Personi i dënuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me të paktën pesë (5) vjet burgim, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dy të tretat (2/3) e dënimit të shqiptuar [...]”.

⁵⁵ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, nr. 2003/25, neni 80, paragrafi 2, “Personi i dënuar i cili e ka mbajtur gjysmën e dënimit me burgim mund të lirohet me kusht dhe të lirohet nga burgu me kusht se ai nuk do të kryejë vepër tjetër penale para skadimit të dënimit”.

⁵⁶ Më 13 maj 2014, është bërë hapja e IPFK, ndërsa kompletimi me stafin profesional ka filluar nga 4 gusht 2014 dhe të cilët kanë përfunduar të gjitha trajnimet e nevojshme dhe janë të gatshëm për punë.

⁵⁷ Më 27 tetor 2014, Avokati i Popullit ka vizituar IPFK-në dhe është takuar me drejtorin e tij, z. Gani Halilaj. Objekti i IPFK-së i plotëson standardet më të larta evropiane për punë dhe trajtim të pacientëve.

Gjatë periudhës raportuese, ka filluar zbatimi i marrëveshjes për bartjen e kompetencave nga Ministria e Drejtësisë (MD) në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH).⁵⁸ Është nxjerrë Udhëzimi Administrativ për Funkcionimin e Shërbimit Shëndetësor në Burgje,⁵⁹ si dhe është duke u punuar në përpilimin e protokollove, që është pika kyçe për suksesin e transferimit nga MD në MSH. Integrimin e Protokollit të Stambollit, si dokument për parandalimin dhe dokumentimin e torturës dhe keqtrajtimin në vendet e ndalimit, nga shërbimi shëndetësor i burgjeve, është duke e zhvilluar Institucioni i MKPT-së nga Danimarka (Dignity Institute), në bashkëpunim me QKRMT.⁶⁰

Gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet, janë finalizuar kontratat për të gjitha furnizimet (barëra, zyre, mjete higjienike etj.) e planifikuara. Ka përfunduar trajnimi i stafit për përdorimin e Sistemit Informativ Shëndetësor, si dhe është rregulluar çështja e këshilltarëve, të cilët do të paguhen sipas normës së realizuar.⁶¹ Gjithashtu, është funksionalizuar Stacionari i Burgut të Sigurisë së Lartë (BSL) në Gërdovc, me 11 punëtorë shëndetësorë (2 mjekë, 6 infermierë, 1 psikolog, 1 stomatolog dhe 1 psikiatër me gjysmë orari). Menaxhimi i pacientëve të burgosur në hallkën e të gjitha institucioneve shëndetësore është rregulluar me Qarkoren Informative.⁶² Ndërsa, shqetësuese vazhdon të mbetet mos funksionimi i dhomave të sigurta në QKUK.

Megjithatë, IAP ka pranuar një numër të ankesave kundër trajtimit shëndetësor në institucionet korrektuese, për mungesë barërash, trajtim joadekuat dhe çështje të tjera të ndërlydhura me shëndetësinë. Në të gjitha rastet e ankesave, IAP ka hapur hetime për rastet dhe ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse që të sigurohen medikamentet të cilat janë të domosdoshme sipas ligjit.⁶³

⁵⁸ Më 13 qershor 2013, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të MD dhe MSH, për bartjen e kompetencave për ofrimin e shërbimit të kujdesit shëndetësor në institucionet korrektuese, nga MD në MSH.

⁵⁹ Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2014, i miratuar në mbledhjen e 201 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendimin nr. 02/201, të datës 22 tetor 2014.

⁶⁰ Intervistë e realizuar me Drejtoreshën Ekzekutive të QKRMT-së, znj. Feride Rushiti, gjatë punëtorisë “Integrimi i Protokollit të Stambollit për stafin mjekësor të burgjeve”, në bashkëpunim me Jens Modvig, nga Danish NPM/Dignity Institute, datë 11 dhjetor 2014.

⁶¹ Intervista e realizuar me z. Milazim Gjocaj, drejtor i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, datë 11 dhjetor 2014.

⁶² Qarkore Informative 03/2013 për trajtimin e pacientëve të burgosur në institucionet shëndetësore publike, datë 27 nëntor 2013.

⁶³ IAP, rasti A. nr. 420/2014, ankesë kundër Burgut të Dubravës, datë 16 shtator 2014, e parashtruar nga bashkëshortja e të burgosurit, e cila pretendonte se bashkëshorti i saj, i cili është duke vuajtur dënimin në Burgun e Dubravës, nuk po trajtohet me barnat e duhura dhe se jeta e tij është në rrezik. I dënuari vuante nga sëmundja e zemrës, pasi që kishte operuar valvulet e zemrës. Më 17 shtator 2014, drejtorja e burgut, përmes postës elektronike dhe telefonit, është njoftuar për rastin dhe shqetësimet e paraqitura nga bashkëshortja e të dënuarit. Po atë ditë, i dënuari është dërguar në Spitalin Rajonal në Pejë për trajtim, pasi që gjendja e tij është keqësuar. Më 19 shtator 2014, përfaqësuesit e IAP-së e kanë vizituar të dënuarin në Spitalin e Pejës, ku mjeku kujdestar i ka njoftuar se gjendja e tij është shumë e rëndë dhe kërkon trajtim adekuat. Për tërë këtë është njoftuar drejtorja e burgut, të cilët premtuan se i dënuari do të vendoset në spital për trajtim të mëtejshëm. Më 25 shtator 2014, IAP është njoftuar se i dënuari, është vendosur në spitalin e burgut dhe se janë duke u përfillur rekomandimet e mjekëve të Spitalit të Pejës. Më 1 dhe 24 tetor 2014, përfaqësuesit e IAP-së e kanë vizituar të dënuarin në burg, i cili i ka njoftuar se tani është i kënaqur me trajtimin që po i bëhet nga stafi mjekësor i burgut.

2.4.5. Mbipopullimi

Edhe në raportet paraprake vjetore, Avokati i Popullit në vazhdimësi ka vënë në pah problemin me mbipopullimin e qendrave ku mbahen personat e privuar nga liria dhe ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse evitimin e tij. Hapja e BSL-së⁶⁴ dhe hapja e IPFK-së kanë ndikuar në uljen e mbipopullimit. Megjithatë, renovimet në shumë qendra korrektuese, si dhe mospërfundimi i punimeve për ndërtimin e Qendrës së Paraburgimit (QP) në Prishtinë dhe në Gjilan, kanë bërë që mbipopullimi të jetë shqetësim edhe për këtë vit raportues.

Në periudhën raportuese, gjendja e popullimit të qendrave korrektuese ka qenë si në vijim:

- QK në Dubravë, si një ndër qendrat me kapacitetin më të madh të vendosjes, edhe këtë vit është ballafaquar me problemin e mbipopullimit, kjo për arsye të renovimeve që janë bërë si dhe për shkak të faktit se në disa pavijone, si p.sh. pavijoni 8, ku janë të vendosur të dënuar me rrezikshmëri më të lartë, nuk kanë pasur mundësi të vendosen të dënuar të tjerë.

- QK në Lipjan është duke rinovuar pavijonin O, ku janë të vendosen femrat të cilat momentalisht janë të vendosura në pavijonin e kundërvajtësve. Aty janë të vendosura 43 femra, prej tyre dy të mitura.⁶⁵ Në pavijonet tjera janë të vendosur 45 të mitur. Nëntë të dënuar për kundërvajtje janë mbajtur për të punuar ndërsa të tjerët janë transferuar në qendrat e tjera.⁶⁶

- QK në Smrekonicë, e cila është e tipit gjysmë të hapur, ka kapacitet prej 200 vendesh në pavijone dhe 16 vende në dhoma pranimit apo të ashtuquajtura kaluese. Këtu janë të vendosur 201 persona.⁶⁷

- BSL në Gërdovc, i cili ka kapacitet prej 390 vendesh, pranimin e parë të të dënuarve e ka bërë më 31 maj 2014, ndërsa momentalisht numëron 82 persona të dënuar.⁶⁸

- QP në Lipjan, e cila ka kapacitet prej 170 vendeve, ka më tepër se dy muaj që ka në renovim krahun B dhe C të objektit, dhe kjo ka bërë që të ballafaqohet me mbipopullimin, prej 96 personave të vendosur.⁶⁹

- QP në Mitrovicë, me kapacitet prej 55 vendesh, ka të vendosur 39 persona.

- QP në Prizren, me kapacitet prej 92 vendesh, mban 97 persona, ndërsa disa renovime dhe gëlqerosje që kanë pasur, i kanë përfunduar para pak kohësh.⁷⁰

- QP në Pejë ka kapacitet prej 80 vendesh, plus 6 në vetmi, ka të vendosur 71 persona plus 1 aktualisht i dërguar në IPFK. Kjo qendër është duke kryer disa punime në banjo, që nuk paraqesin ndonjë pengesë për funksionim, por qendra nuk i plotëson kushtet, pasi ka shumë pak dritë natyrore, për personat e vendosur dhe për stafin.⁷¹

⁶⁴ Më 18 dhjetor 2013 u bë hapja zyrtare e Burgut të Sigurisë së Lartë (BSL) në Gërdovc të Podujevës.

⁶⁵ Të miturat janë të vendosura me të rriturat që përben shkelje të drejtave të njeriut dhe Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, ku në nenin 33, paragrafi 6, theksohet: "Personat madhor nuk vendosen në institucionin korrektues, ose në një pjesë të institucionit korrektues me të mitur."

⁶⁶ IAP i ka siguruar statistikën nga drejtori i QK në Lipjan, z. Hestet Loku, më 15 dhjetor 2014.

⁶⁷ IAP i ka siguruar statistikën nga drejtori i QK në Smrekonicë, z. Xhevdet Maçastena, më 15 dhjetor 2014.

⁶⁸ IAP i ka siguruar statistikën nga drejtori i BSL-së, z. Rasim Selmanaj, më 15 dhjetor 2014.

⁶⁹ IAP i ka siguruar statistikën nga drejtori i QP në Lipjan, z. Arif Beqa, më 15 dhjetor 2014.

⁷⁰ IAP i ka siguruar statistikën nga Drejtori i QP në Prizren, z. Ilir Gutaj, më 15 dhjetor 2014.

⁷¹ IAP i ka siguruar statistikën nga drejtori i QP në Pejë, z. Isuf Ibërdemaj, më 15 dhjetor 2014.

- QP në Gjilan ka kapacitet prej 94 vendesh, ndërsa ka të vendosur 84 persona. IAP në vazhdimësi ka rekomanduar ndërtimin e një qendre të re për QP në Gjilan. Gjatë vitit raportues jemi njoftuar se punimet e vrazhda për ndërtimin e kësaj qendre janë në përfundim.⁷²

- QP në Prishtinë ka kapacitet prej 65 vendesh, ndërsa në të janë vendosur 67 persona. Ndërtimi i një qendre të re të paraburgimit ka filluar dhe deri në fund të vitit raportues, pritet të kryhen ndërtimet e vrazhda.⁷³

Mbipopullimi dhe sistematizimi i të dënuarve, ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm për IAP-në. Bazuar në nenin 15, paragrafi 3 të Ligjit për Avokatin e Popullit,⁷⁴ IAP ka hapur hetime bazuar në raportimet e fundit në media, se në Burgun e Dubravës ka ndodhur një vetëvrasje dhe një dhunim.⁷⁵ Lidhur me rastin e vetëvrasjes IAP më 24 shtator 2014, ka realizuar një vizitë në Burgun e Dubravës, ku ka biseduar me menaxhmentin e burgut si dhe ka realizuar intervista me personat që kanë qenë në dhomë me të ndjerin, i cili ishte vetëvrasës arë në banjon e dhomës së tij, më 19 shtator 2014. IAP po ashtu ka vizituar edhe të dëmtuarin, respektivisht viktimën e dhunimit, i cili ishte sulmuar nga të dënuarit e tjerë, me të cilët ishte vendosur në dhomë. Po gjatë kësaj vizite, IAP është takuar edhe me mjekun e spitalit të Dubravës.

IAP është njoftuar se lidhur me rastin është duke zhvilluar hetime Prokuroria Themelore në Pejë, dhe ka kërkuar ekzaminim mjeko-ligjor për rastin. Po ashtu SHKK ka formuar dy komisione *ad hoc*, të cilat janë duke zhvilluar hetime lidhur me rastin dhe se për rezultatet e hetimeve do të njoftohet IAP.⁷⁶

Shqetësim për Avokatin e Popullit paraqet mos sistematizimi në momentin e vendosjes të të dënuarve në institucionin korrektues, jo vetëm që mund të përcillet me pasoja, por përbën edhe shkelje të drejtave të njeriut të garantuara me ligjet vendore dhe ndërkombëtare si dhe ka qenë një ndër rekomandimet që në vazhdimësi është përsëritur nga IAP. Në rastin në fjalë, i dënuari – viktimë e dhunimit ka qenë i dënuar me vetëm 20 ditë burgim, ndërkaq është vendosur në një dhomë me të dënuar, me dënime afatgjata (nga 3, 6 dhe 17 vjet). IAP vlerëson se mos respektimi i kriterëve për sistematizimin dhe vendosjen e të dënuarve, përbën shkelje të të drejtave të njeriut, të parapara edhe me Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale.⁷⁷

⁷² IAP i ka siguruar statistikën nga drejtori i QP në Gjilan, z. Shefik Sylejmani, më 15 dhjetor 2014.

⁷³ IAP i ka siguruar statistikën nga u. d. e drejtorit të QP në Prishtinë, znj. Besa Sahiti, më 15 dhjetor 2014.

⁷⁴ *Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit*, neni 15, paragrafi 3, “Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (*ex officio*), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut.”

⁷⁵ IAP, rasti *ex officio* A. nr. 422/2014.

⁷⁶ IAP ka biseduar me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, z. Emrush Thaçi, më 16 dhjetor 2014.

⁷⁷ *Ligji Nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale*, neni 33, paragrafi 3, “Gjatë vendosjes së personit të dënuar në institucionin e veçantë korrektues, ose në njësi të veçantë të institucionit korrektues, duhet të merret parasysh mosha e tij, llojet dhe pesha e dënimit, fakti se a ka qenë më parë i dënuar, shëndeti i tij fizik dhe mendor, kërkesat për trajtim të veçantë, lokacioni i vendbanimit, ose i vendqëndrimit të familjes së tij, siguria e tij, si dhe arsyet lidhur me arsimimin, ose punët që mund të jenë të rëndësishme për ri-integrimin e tij shoqëror dhe të kriterëve tjerë të përcaktuara me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri”. Neni 182, paragrafi 1, “Personat e dënuar me dënim për kundërvajtje, e mbajnë dënimin në institucionin korrektues, të ndarë nga personat e paraburgosur.”

2.4.6. Institucionet e shëndetit mendor

Aktualisht në Kosovë janë 16 institucione të cilat janë të dedikuara për vendosjen e personave me aftësi të kufizuara mendore. Këto institucione menaxhohen nga MSH, ku janë vendosur personat me sëmundje kronike psikiatrike,⁷⁸ si dhe institucionet e menaxhuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), të parapara për vendosjen e personave me prapambetje mendore apo ngecje në zhvillim.⁷⁹ Për vendosjen e personave në këto institucione, deri më tani nuk ka ligje përkatëse që rregullojnë kushtet dhe kriteret për kufizimin e lirisë së këtyre personave, ndërsa Ligji për Shëndetin Mendor i cili e trajton këtë kategori, nuk është miratuar ende nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Institucionet e shëndetit mendor, vazhdojnë të ballafaqohen me mungesën e stafit profesional si dhe mos trajnimin të tyre, edhe pse ka pasur përmirësime në rregullimin e infrastrukturës në përgjithësi.

Nisur nga informacionet dhe të gjeturat gjatë vizitave të shumta në të gjitha këto institucione, Avokati i Popullit, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme, e konsideron të nevojshme që për MD, SHKK, MSH, MPMS, të japë rekomandime, disa prej të cilave mbeten të njëjta që nga viti i kaluar.

Rekomandime:

Ministria e Shëndetësisë

- *Të ndërtohen Dhomat e Sigurta në QKUK, në të cilat do të vendosen personat e dënuar e që kanë nevojë për trajtim mjekësor.*

Ministria e Drejtësisë

- *Femrat e mitura të vendosen ndaras nga të rriturat në QK në Lipjan.*
- *Të bëhet kategorizimi dhe vendosja e personave të dënuar dhe të ndaluar, sipas natyrës së veprës, trezikshmërisë dhe moshës.*
- *Të ofrohen trajnime për stafin e institucioneve ku mbahen personat e ndaluar (për punëtorët socialë edhe stafin tjetër), me qëllim të zgjerimit të njohurive të tyre për të drejtat e njeriut.*

Kuvendi i Republikës së Kosovës

- *Të miratohet sa më shpejt Ligji për Shëndetin Mendor.*

PLK, SHKK dhe SHSK

- *Të forcohet bashkëpunimi i PLK me stafin e SHKK dhe SHSK, për të ofruar shërbime më të mira, përmes organizimit të takimeve punuese të përbashkëta.*

⁷⁸ Institucionet e menaxhuara nga MSH janë: Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime; Shtëpitë Integruese në Bashkësi (SHIB) në Bresje (komuna e Fushë Kosovës), në Ferizaj, në Gjilan, në Mitrovicë, në Gjakovë, në Pejë dhe në Prizren.

⁷⁹ Institucionet e menaxhuara nga MPMS janë: Instituti Special në Shtime, Shtëpia e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime, Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore në Shtime; Shtëpitë me bazë në komunitet (SHBK) në Ferizaj, në Kamenicë, në Vushtrri, në Deçan dhe në Graçanicë; si dhe Shtëpia për Persona të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (*Shtëpia e Pleqve*) në Prishtinë.

- *Të njoftohen të ndaluarit për të drejtat dhe obligimet e tyre, si dhe për mënyrën e parashtrimit të ankesave.*
- *Të rritet numri i stafit profesional për Institutet e shëndetit mendor dhe t'u ofrohen trajnime të nevojshme.*

2.4.7. Grupi Punues për Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës

*Grupi Punues*⁸⁰ ka vazhduar bashkëpunimin edhe në këtë vit raportues, duke realizuar vizita të përbashkëta të rregullta në vendet ku janë të vendosur personat e privuar nga liria. Në pajtim me metodologjinë e punës, gjatë vizitave të rregullta, *Grupi Punues* fillimisht, për planin e vet e informon personin udhëheqës të organit ku bëhet privimi nga liria, kurse pastaj realizon hetim në vendet ku mbahen personat, bën kontrollin e evidencës, si dhe zhvillon biseda të drejtpërdrejta dhe individuale me personat e privuar nga liria, pa prezencën e zyrtarëve.

Grupi Punues ka realizuar takime të përbashkëta me qëllim të përcaktimit të punëve, gjetjes së fondeve, zhvillimit të aktiviteteve, mbajtjes së trajnimeve, seminareve e konferencave, lobimit, avokimit etj.

Grupi Punues vazhdon bashkëpunimin me OSBE si dhe Komitetin e Helsinkit të Holandës, me të cilët janë duke zhvilluar projektin “Përmirësimi i kushteve të burgut dhe ri-integrimi i të miturve të dënuar”. Projekti ka filluar në fund të vitit 2013, po zhvillohet në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni dhe do të përfundojë në fillim të vitit 2016.

Më 28 mars 2014 *Grupi Punues* ka realizuar vizitë në ISSH, pas publikimit të informatave në media,⁸¹ në lidhje me keqtrajtimin e një personi rezident. Drejtori i Institutit njoftoi se pas akuzave të bëra në media, ai ka kërkuar të bëhet ekspertiza mjeko ligjore si dhe të zhvillohen hetimet nga ana e prokurorisë kompetente,⁸² dhe kërkoj që të ndihmohet që të zbardhet ky rast.⁸³

IAP në lidhje me rastin ka kontaktuar Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe është njoftuar se janë hapur hetimet dhe se rasti është në procedurë të rregullt të hetimit.⁸⁴

Më 23 dhe 24 qershor 2014, *Grupi Punues* ka realizuar vizitën e dytë ri-kontrolluese në QK në Dubravë dhe në Lipjan si dhe në QP në Lipjan, me qëllim të përcjelljes së rekomandimeve nga viti i kaluar, si dhe të analizimit të veprimeve ndaj personave të privuar nga liria. Raporti përmban rekomandime të cilat drejtohen tek institucioni përgjegjës i vizituar dhe tek ministria respektive.

⁸⁰ IAP, QKRMT dhe KMDLNJ, më 10 maj 2011, kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit, me të cilën parashihet krijimi i *Grupit Punues*, i cili do të kryejë obligimet që dalin nga Protokollin opcional i Konventës kundër Torturës dhe do të llojë për krijimin e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës në Kosovë.

⁸¹ Gazeta “Koha Ditore”, datë 27 mars 2014, publikoi artikullin “Pacientet në Institutin Special në Shtime dysobohet se abuzohen seksualisht nga personeli, rriben dhe keqtrajtohen”.

⁸² Intervistë me Drejtorin e ISSH, z. Xhemajl Dugolli, më 28 mars 2014.

⁸³ Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 15, paragrafi 8, “Avokati i Popullit i ushtron kompetencat e veta edhe me ndërmjetësim dhe pajtim”.

⁸⁴ Më 21 nëntor 2014, përfaqësuesit e IAP-së janë takuar me u. d. të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, z. Rasim Maloku.

Më 26 qershor 2014, *Grupi Punues* mbajti një konferencë për media, ku u prezantuan të gjeturat e monitorimit, të cilat do të publikohen në raport.

Më 29 tetor 2014, *Grupit Punues* mbajti trajnimin, me temën: “Parimet themelore të dokumentimit të torturës dhe veprimeve çnjerëzore,” organizuar nga QKRMT në bashkëpunim me MKPT nga Danimarka Dignity Institute, i cili u shërben monitoruesve, për identifikimin e shkeljeve nga ana e stafit mjekësor.

Më 16 dhjetor 2014, *Grupi Punues* ka mbajtur takimin e fundit për vitin 2014 me qëllim të koordinimit të aktiviteteve dhe planit të punës për vitin vijues.⁸⁵

2.5. Liria e lëvizjes

Liria e lëvizjes është e drejtë themelore e njeriut dhe nënkupton lëvizje të lirë dhe të papenguar brenda shtetit dhe jashtë kufijve të tij, në mënyrë të barabartë për të gjithë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton këtë të drejtë, për të gjithë banorët e shtetit, në tërë territorin, pa kufizime dhe ndërhyrje të kundërligjshme.⁸⁶

Liria e lëvizjes gjatë kësaj periudhe raportuese në përgjithësi është respektuar, me gjithë tensionet ndëretnike, incidentet sporadike, provokimet dhe frikësimet që edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, në disa pjesë të vendit (në veri të Kosovës) kanë ndikuar në shkeljen e lirisë së lëvizjes.

Edhe më tej ekzistojnë vende, ku serbët nuk mund të lëvizin lirshëm, nuk mund ta vizitojnë pronën e tyre dhe as të vizitojnë vendet e objektet e shenjta, siç ishte rasti në fshatin Mushtisht dhe në Gjakovë.⁸⁷

Gjatë këtij viti, ka ndodhur një numër i incidenteve dhe sulmeve ndaj të kthyerve, djegie dhe vjedhje e pronës së tyre, sidomos në komunën e Klinës dhe të Istogut.⁸⁸ Po ashtu, gjatë këtij viti ka pasur sulme dhe incidente edhe në Viti, në të cilat disa pjesëtarëve të bashkësisë serbe u janë shkaktuar lëndime trupore, si dhe provokime verbale me prapavijë etnike u janë drejtuar priftërinjve të Kishës Ortodokse Serbe (KOS).⁸⁹

Po ashtu, shqetësim përbëjnë edhe provokimet e drejtuara ndaj pjesëtarëve të bashkësisë serbe me shkrimin e grafitëve në muret e shtëpive serbe në Rahovec dhe Fushë Kosovë,⁹⁰ si dhe

⁸⁵ Takimi u mbajt me mbështetjen e OSBE-së, në Prishtinë më 16 dhjetor 2014.

⁸⁶ *Kushtetua e Republikës së Kosovës*, neni 35.1. “Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt të cilët janë banorë të ligjshëm të Kosovës, gëzojnë lirinë e lëvizjes dhe zgjedhje të vendbanimit në Republikën e Kosovës.”

Ligji për shtetësinë Nr. 03/L-034, Ligji për vendbanimin dhe vendqëndrimin Nr. 02/L-121, Ligji për të huajt Nr. 03/L-126, Ligji për dokumentet e udhëtimit nr. 03/L-037, i miratuar më 19.6.2008 në versionin e ndryshuar me *Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit Nr. 03/L-217*, i miratuar më 11.12.2010.

⁸⁷ Informata e marrë nga ueb faqja e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK), rubrika lajmet, <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,748> (15.12.2014).

⁸⁸ *Po aty*, <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,802>; <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12&offset=70> (15.12.2014).

⁸⁹ *Po aty*, <http://www.mkk-ks.org/?page=3> ; <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12&offset> (15.12.2014).

⁹⁰ *Po aty*, <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,798>; <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12&offset> (15.12.2014).

incidentet në të cilat cak ishin manastiri serb në Deçan dhe Patrikana e Pejës.⁹¹ Në këto raste ka intervenuar Policia e Kosovës, por IAP nuk ka informata se ndonjë nga këto raste është zgjidhur dhe se kryesit e tyre janë sjellë para drejtësisë.⁹²

Pavarësisht faktit se Këshillat komunale për siguri në bashkësi (KKSBB) kanë mbajtur takime të rregullta (përveç Mitrovicës Veriore, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit), me qëllim që të inkurajohen zyrtarët komunal, Polica e Kosovës dhe shoqëria civile, që të punojnë së bashku në çështjet e sigurisë lokale, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese nuk janë arritur rezultate të kënaqshme në këtë drejtim.⁹³

Avokati i Popullit, vëren se organet kompetente për çështje të sigurisë nuk kanë reaguar në masë të duhur dhe tërheq vërejtjen, siç ka bërë edhe disa herë deri më tani, se incidente të tilla dhe të ngjashme ndikojnë negativisht në lirinë e lëvizjes. Prandaj, organet kompetente duhet të bëjnë më shumë përpjekje në parandalimin dhe ndalimin e incidenteve dhe sulmeve të tilla dhe të reagojnë shpejtë, me përgjegjësi dhe vendosmëri në ndriçimin e tyre dhe të ndëshkojnë kryesit e veprave të tilla në mënyrë adekuate me qëllim të sigurimit të lirisë së lëvizjes në tërë territorin e Kosovës. Është domosdoshmëri të punohet më shumë në sigurinë e qytetarëve në Kosovë dhe në ndërtimin e besimit aq shumë të nevojshëm në organet e pushtetit.

2.5.1. Zbatimi i marrëveshjes për lirinë e lëvizjes

Në përputhje me Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes (Marrëveshja) nga dialogu i Kosovës me Serbinë,⁹⁴ qytetarët e Kosovës gjatë periudhës për të cilën po raportohet, kanë mundur të lëvizin dhe udhëtojnë lirshëm brenda ose përmes territoreve të dy vendeve, duke shfrytëzuar vetëm letërnjoftimet, kurse për fëmijët e moshës nën 16-vjeçare vetëm me certifikatë të lindjes. Mirëpo, qytetarët e Kosovës edhe më tej nuk mund të udhëtojnë me pasaportë të Republikës së Kosovës.

Mirëpo, dhe pse kanë kaluar tri vite e gjysmë nga arritja e Marrëveshjes, deri në mbarim të periudhës raportuese qytetarët edhe më tej kanë paguar taksa të larta dhe të ndryshme për automjetet e tyre me rastin e hyrjes nga Kosova në Serbi dhe anasjelltas. Avokati i Popullit përsërit se është e domosdoshme që pagesa për personat që drejtojnë mjetet motorike, sa më shpejtë të hiqet me përmbylljen e marrëveshjes midis Kosovës dhe Serbisë.

2.5.2. Liria e lëvizjes në pjesën veriore të Kosovës

Sikurse në vitet e mëhershme edhe në vitin 2014, liria e lëvizjes në pjesën veriore të Kosovës, kryesisht për banorët shqiptarë, por edhe për një pjesë të banorëve nga komunitetet e tjera joserbe, vazhdon të jetë e rëndë dhe e paqëndrueshme.

⁹¹ Po aty, <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,775> (15.12.2014).

⁹² Po aty, <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,748> (15.12.2014).

⁹³ Organet konsultative të parapara me udhëzimet administrative të cilat i kanë miratuar Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

⁹⁴ Marrëveshja për lirinë e lëvizjes e arritur në korrik të vitit 2011 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Kufizimi i lirisë së lëvizjes dhe situata e rëndë e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës, vazhdon tash e 15 vite, duke sjellë pasoja të rënda për stabilitetin e përgjithshëm të sigurisë në këtë pjesë të territorit në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2014, lirinë e lëvizjes në veriun e Kosovës e kanë penguar edhe disa incidente të herëpashershme. Gjatë këtij viti kanë ndodhur 8 shpërthime (7 shpërthime me mjete eksplozive për qëllime ushtarake në pjesën veriore të Mitrovicës dhe 1 shpërthim në Zveçan). Këto shpërthime shkaktuan dëme materiale në prona private, vetura dhe biznese. Po ashtu gjatë këtij viti kanë ndodhur gjithsej 5 incidente ndëretnike, 4 sosh në pjesën veriore të Mitrovicës dhe 1 në Zveçan.⁹⁵

Përveç incidenteve të lartcekura, më 19 maj 2014, nga persona të panjohur është thyer dhe demoluar shkolla fillore “Aziz Sulejmani” në lagjen Kodra e Minatorëve në veri të Mitrovicës, duke shkruar nëpër tabela të klasave, simbole nacionaliste serbe dhe si pasojë e kësaj, prindërit dhe fëmijët kanë hezitur të vazhdojnë mësimin, sepse janë ndier të pasigurt në këtë lagje.⁹⁶ Shkolla në fjalë, që nga viti 1999, funksionon si paralele e ndarë e shkollës fillore “Aziz Sulejmani” në Mitrovicë dhe përbëhet prej dy kontejnerëve, ku vijojnë mësimin gjithsej 21 nxënës shqiptarë, nga klasa parë deri në të nëntën.

Po ashtu, gjatë këtij viti kanë vazhduar provokimet dhe pengimi i punëve nga ana e individëve dhe grupeve të organizuara të personave, kundër rindërtimit të objekteve të banimit të shqiptarëve në pronat e tyre private në lagjet e veriut të Mitrovicës. Një nga këto raste ka ndodhur më 2 korrik 2014, kur dhjetëra persona serbë kanë penguar dhe ndërprerë punimet në ndërtimin e shtëpive të shqiptarëve në lagjen “Kroi i Vitakut” në veri të Mitrovicës, duke ua pamundësuar kështu banorëve shqiptarë të këtyre lagjeve ndërtimin dhe kthimin në pronat e tyre private.

Në këtë pjesë të Kosovës ende gjenden të vendosura tri barrikada, të cilat pengojnë edhe fizikisht lirinë e lëvizjes. Dy nga to gjenden në Mitrovicë, në të dy rrugët që lidhin pjesën jugore me atë veriore të qytetit të Mitrovicës, përkatësisht njëra në urën kryesore të lumit Ibër dhe tjetra në rrugën “Knjaz Millosh”, në afërsi të shkollës teknike në veri të Mitrovicës. Këto barrikada pamundësojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve nga Lagjja e Boshnjakëve për në pjesën veriore të Mitrovicës. Barrikada e tretë gjendet në vendin e quajtur Vodica, përkatësisht në dalje të rrugës nga Leposaviqi për në Mitrovicë.⁹⁷

Republika e Kosovës dhe Republika e Serbisë në vitin 2013 kanë nënshkruar marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore,⁹⁸ që nënkupton eliminimin e të gjitha barrikadave dhe sigurimin e lirisë së lëvizjes. Më 18 qershor 2014, grupe qytetarësh me përkatësi serbe nga veriu i Mitrovicës, larguan barrikadën mbi urën kryesore të lumit Ibër në qytetin e Mitrovicës. Mirëpo, vetëm disa orë më vonë, ata sërish vendosën një barrikadë tjetër, duke sjellë vazo betoni të mbjella me lule dhe pisha dhe e emërtuan “Parku i Paqes”. Ky veprim u ndërmor nga kryetari i komunës në veri të Mitrovicës (i zgjedhur në zgjedhjet lokale të nëntorit 2013, të organizuara për të parën herë nga institucionet e Republikës së Kosovës) z. Goran Rakiq, me praninë e përfaqësuesit të Republikës së Serbisë në Kosovë Gjuriq, së bashku me qytetarë të

⁹⁵ *Informatë nga z. Besim Hoti*, zëvendës drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë Mitrovicë - Veriu, më 10 dhjetor 2014.

⁹⁶ *Intervistë me z. Flamur Gacaferrri*, drejtor i Shkollës së Mesme të Ulët “Aziz Sulejmani”, më 20 maj 2014.

⁹⁷ *Po aty: Informatë nga z. Besim Hoti*, zëvendës drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë Mitrovicë - Veriu, më 10 dhjetor 2014.

⁹⁸ *Ligji Nr. 04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë*, neni 1.

asaj pjese të qytetit. Po ashtu, ata filluan ndërtimin e sheshit “Car Lazar”, duke e vështirësuar kështu edhe më shumë lirinë e lëvizjes së qytetarëve. E tërë kjo ka ndodhur nën vëzhgimin e Policisë së Kosovës, pjesëtarëve të EULEX-it dhe vëzhguesve të tjerë.

Në shenjë revolte, si reagim ndaj ndërtimit të të ashtuquajturit “Park i Paqes” dhe sheshit “Car Lazar”, më 10 dhe 11 korrik 2014, në dy pjesë të ndryshme të qytetit të Mitrovicës, në “Lagjen e Boshnjakëve” dhe në hyrje të fshatit Suhodoll, qytetarët shqiptarë bllokuan rrugët, duke vendosur vazo të betonit me diametër prej 1.5 metra, duke i emërtuar si “Sheshi Adem Jashari” dhe “Sheshi UÇK”.

Qytetarët shqiptarë të fshatrave Koshtovë, Cerajë dhe Bistricë të komunës së Leposaviqit, edhe pse kanë kaluar 15 vite nga mbarimi i luftës në Kosovë, vazhdojnë të kenë të kufizuar lëvizjen e lirë. Megjithatë, ajo që është pozitive dhe duhet theksuar është se, gjatë këtij viti nuk është evidentuar dhe raportuar për ndonjë incident. Policia e Kosovës konsideron se lëvizja e lirë në këto fshatra është më e mirë.⁹⁹

Shikuar në përgjithësi, situata e sigurisë dhe liria e lëvizjes në të gjitha komunat në pjesën veriore të Kosovës të banuara me shumicë serbe: Zubin Potoku, Leposaviqi, Zveçani, si dhe pjesa veriore e Mitrovicës, ende nuk është fare e mirë dhe, varësisht nga rrethanat politike, di të bëhet shumë e rrezikshme. Qytetarët shqiptarë ende kanë vështirësi sa i përket lirisë së lëvizjes. Sidomos ende ekziston rrezik i përhershëm për personat që përdorin gjuhën shqipe, apo në këtë pjesë të territorit lëvizin me automjetet e tyre me tabela që mbajnë shenjën RKS ose edhe KS. Natyrisht, pas bisedimeve në Bruksel ekzistojnë shenja që tregojnë se gjërat sadopak po përmirësohen, por fatkeqësisht, situata ende është jostabile. Në anën tjetër, Marrëveshja lidhur me targat e automjeteve edhe më tej nuk po zbatohet në veri të Kosovës.¹⁰⁰

Menaxhimi i integruar në përputhje me marrëveshjen për menaxhim të integruar të kufijve, në gjashtë kalime të përkohshme kufitare edhe më tej funksionon pa probleme të mëdha.

2.5.3. Udhëtimi në BE

Kur flasim për udhëtimin e qytetarëve të Kosovës në vendet anëtare të BE, edhe më tej është në fuqi regjimi i vizave, edhe pse Republika e Kosovës në proces të liberalizimit të vizave me

⁹⁹ *Informata nga* z. Besim Hoti, zëvendës drejtor i Drejtorisë Rajonale të Policisë Mitrovicë - Veriu, më 10 dhjetor 2014.

¹⁰⁰ Sipas marrëveshjes për lirinë e lëvizjes, përdorimi i targave RKS ose KS u lejohe vetëm pronarëve të automjeteve të cilët qëndrojnë në Kosovë. MPB e Republikës së Kosovës nga data 1.11.2011 e ka vazhduar mundësinë për regjistrimin e automjeteve me targa KS dhe ka futur në funksion politikën e re për automjetet me targa të regjistrimit të ish RFJ ose Serbisë, të cilat janë të regjistruara ndërmjet 10.6.1999 dhe 31.10.2011, duke iu lejuar në këtë mënyrë pronarëve të atyre automjeteve që t'i regjistrojnë me targa KS ose RKS. Por, mbetet të verifikohen ato automjete përmes INTERPOL, prandaj lëshohen targa të përkohshme deri në mbarim të verifikimit afati i të cilit është zgjatur. MPB, nga data 18.12.2011 zbaton politikë të re me të cilën qytetarëve u lejohe që të ndërrojnë patentë shoferët e RFJ/Serbisë të lëshuara ndërmjet 10.6.1999 dhe 31.10.2011 me patentë shofer të Kosovës. Madje, me këtë vendim u lejohe parashtruesve të kërkesave që të shtojnë kategori shtesë në patentë shoferin e tyre të Kosovës, nëse të njëjtat janë marrë nga organet serbe në Kosovë gjatë periudhës 10.6.1999 dhe 31.10.2011 ose nëse janë legalizuar nga organet serbe jashtë territorit të Kosovës. Ky vendim mbetet në fuqi deri më 31.12.2014, kur skadon afati për parashtrimin e kërkesave të tilla.

BE ka hyrë në mesin e vitit 2012. Kosova edhe më tej ka mbetur vendi i vetëm në Evropë pa liberalizim të vizave dhe lëvizje të lirë në hapësirën e Shengenit. Ende mbetet e paqartë se kur qytetarëve të Kosovës do t'u mundësohet lëvizja e lirë në zonën Shengen.

Rekomandimet:

- *Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me organet përgjegjëse, duhet të ndërmarrë të gjitha masat ligjore për parandalimin e incidenteve me motive etnike në Kosovë, dhe të veprojë me efikasitet për ndriçimin e incidenteve të tilla dhe kryerësit e këtyre veprimeve të nxirren para drejtësisë.*
- *Qeveria e Kosovës të ndërmarrë masat përkatëse për lirimin nga pagesa e sigurimit për automjetet në vendkalimet kufitare dhe nga pagesa e dyfishtë e sigurimit të mjeteve motorike.*
- *Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me organet përgjegjëse, të ndërmarrë të gjitha masat e parashikuara me ligj për largimin e të gjitha barrikadave dhe pengesave në rrugë, përfshirë të ashtuquajturin “Parku i Paqes” në urën kryesore të lumit Ibër, sheshin e ashtuquajtur “Car Lazar”, si dhe të ashtuquajturat sheshe “Adem Jashari” dhe “UÇK”, për të mundësuar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave në pjesën veriore të Kosovës.*
- *Qeveria e Republikës së Kosovës, Policia e Kosovës dhe Institucionet tjera përgjegjëse, të ndërmarrin të gjitha veprimet sipas obligimit ligjor për garantimin e jetës, pronës, shëndetit dhe sigurisë publike, për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.*

2.6. E drejta e privatësisë

Çdokush ka të drejtë në respektim të jetës private dhe familjare, të shtëpisë dhe të korrespondencës së tij. Këto janë katër dimensione të mëvetësisë personale,¹⁰¹ të cilat mbrohen me nenin 8 të KEDNJ dhe nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në periudhën raportuese, IAP ka pranuar një numër ankesash të qytetarëve dhe ka hapur raste me iniciativë të vet - *ex officio*, lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtës së privatësisë. Këto ankesa kanë të bëjnë me sektorin publik dhe atë privat.¹⁰²

Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me informatat se menaxhmenti i spitalit rajonal në Mitrovicë “Dr. Sami Beqiri” ka shpërndarë nëpër reparte të dhënat personale të punonjësve dhe pacientëve, duke publikuar njoftimin në tabelën e shpalljeve të spitalit më 24 tetor 2014.¹⁰³

Është e rëndësishme të theksohet se lidhur me të drejtën e privatësisë ASHMDHP, me vendimin e publikuar, ia ka ndaluar përkohësisht Spitalit Gjinekologjik dhe për Infertilitet

¹⁰¹ Ivana Rogana, “Mbrojtja e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare sipas Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut” Doracakët për të drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës, i botuar nga Këshilli i Evropës, Strasburg, 2012, fq. 9.

¹⁰² Bisedë e IAP-së me Mbikëqyrësin Kryesor Shtetëror të ASHMDHP-së, z. Ruzhdi Jashari, më 28.10.2014.

¹⁰³ Bisedë e IAP-së me drejtorin operativ të spitalit rajonal në Mitrovicë, z. Ixhmet Rexhepi, më 3.11.2014.

“Bahçeçi” përpunimin e të dhënave personale, meqenëse ka mungesë të akteve të brendshme rregullative, nuk ka bërë klasifikimin e të dhënave personale, për shkak të mosndërmarrjes së masave për ruajtjen e konfidencialitetit dhe parandalimin e shkatërrimit të të dhënave personale si dhe për mos emërimin e personave kompetentë që janë përgjegjës për sigurimin e dosjeve.¹⁰⁴

2.6.1. E drejta për mjedis të shëndetshëm dhe e drejta e banimit

E drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe e drejta e banimit zë në një vend të veçantë në dispozitat ligjore të KEDNJ dhe në Kushtetutë. Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga qytetarët dhe ka hapur raste *ex officio*, në lidhje me ndotjen e ambientit nga hedhja e mbeturinave dhe rrjedhën e ujërave të zeza në vendet e banuara.¹⁰⁵ Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimet për të drejtën për një mjedis të shëndetshëm, duke tërhequr vëmendjen për rrezikun e përhapjes së sëmundjeve nga ndotja, për shkak të hedhjes së mbeturinave dhe kundërmimit të padurueshëm,¹⁰⁶ si dhe ndotjes së ujit të pijshëm, duke cenuar në këtë mënyrë edhe të drejtën e privatësisë.¹⁰⁷

Po ashtu shqetësuese është dukuria e cenimit të së drejtës së banimit, si e drejtë e privatësisë në rastet e gropimeve me fillimin e ndërtimeve në afërsi të shtëpive private, duke rrezikuar shembje dhe dëmtim të shtëpive.¹⁰⁸

Edhe këtë vit janë pranuar ankesa nga qytetarët, në lidhje me rrezikun që u kanoset nga shtyllat elektrike të vendosura pranë shtëpive të tyre. Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimet dhe ka konstatuar se është cenuar e drejta e privatësisë në pronën e qytetarit dhe ka ndërmarrë veprime në drejtim të mbrojtjes së saj.¹⁰⁹

2.6.2. Kontrolli dhe përgjimi i mjeteve të komunikimit

Edhe viti 2014 shënon mungesën e ligjit që rregullon përgjimin e telekomunikimeve. Mungesa e këtij ligji lë hapësirë të mjaftueshme për keqpërdorime.

Nga informatat e pranuar nga Policia e Kosovës, si raste të së drejtës së privatësisë janë evidentuar gjithsej 36 raste: 13 raste të cenimit të fshehtësisë së korrespondencës dhe të bazave të të dhënave kompjuterike (neni 202 të KPRK), 4 raste të përgjimit të paautorizuar

¹⁰⁴ Vendimi nr. 83/2014, datë 26 nëntor 2014, ueb faqja e ASHMDHP, www.amdp-rks.org (27.11.2014).

¹⁰⁵ LAP, rastet A. nr. 161/2014 dhe A. nr. 394/2014, lidhur me rrjedhjen e ujërave të zeza nëpër vendbanimet e ankuesve.

¹⁰⁶ LAP, rasti A. nr. 104/2014, ankesa e qytetarit të komunës së Pejës, lidhur me parandalimin e hedhjes së mbeturinave të kontaminuara nga fabrika e çipsave, objekt i cili gjendet në afërsi të shtëpive të banuara. IAP ka konstatuar se ka shkelje të së drejtës së privatësisë dhe për mjedis të shëndetshëm. IAP ka kontaktuar organet komunale të Pejës për zgjidhjen e këtij problemi. Ky rast gjendet në procedim.

¹⁰⁷ LAP, rasti A. nr. 299/2014, cenimi i të drejtës së privatësisë, me rastin e ujit të pijshëm i cili ka kundërmuar në një lagje në Lipjan, ku kanë qenë varrezat afër shtëpive të banuara.

¹⁰⁸ LAP, rasti A. nr. 515/2014.

¹⁰⁹ LAP, rastet A. nr. 68/2014, A. nr. 88/2014 dhe A. nr. 362/2014.

(neni 204 KPRK) dhe 19 raste të fotografimit dhe incizime të tjera të paautorizuara (neni 205 KPRK).¹¹⁰

Avokati i Popullit ka shprehur shqetësimin e madh edhe për shkeljen e privatësisë nga përdorimi i teknologjisë digjitale dhe rrjeteve sociale e private, përgjimet, publikimi i mesazheve të telefonit, publikimi i fotografive në rrjetin social facebook, si edhe për shkak të kanosjeve nëpërmjet rrjeteve sociale. Kjo dukuri, po i shkakton probleme qytetarit në familje, në vendin e punës dhe në rrethin ku jeton,¹¹¹ sidomos me publikimin në media të të dhënave personale dhe cenimin e privatësisë.¹¹²

Rekomandime:

- *Qeveria e Kosovës sa më shpejtë ta procedojë për miratim Ligjin për përgjimin e telekomunikimeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës.*
- *Institucionet përgjegjëse të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e të drejtës së privatësisë, sidomos nga ndotja e ambientit dhe ndërtimeve pa leje.*

2.7. E drejta e martesës dhe e familjes

E drejta e martesës dhe e familjes, si një nga të drejtat elementare, paraqet një spektër shumëdimensional të të drejtave. Në radhë të parë ajo i rregullon marrëdhëniet martesore të bashkëshortëve (barazinë e tyre) raportet e tyre ekonomike pasurore (e drejta e pronës) si dhe raportet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të tyre (kujdesi prindëror).

Rastet e paraqitura në IAP edhe gjatë këtij viti dëshmojnë se jetësimi i kësaj të drejte në Kosovë si një shoqëri demokratike, lë shumë për të dëshiruar. Avokati i Popullit, edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit, ka marrë një numër të ankesave, që dëshmojnë pothuajse përsëritjen e problemeve të ngjashme sikur në periudhën paraprake lidhur me këtë të drejtë për shkak të konflikteve të natyrave të ndryshme brenda familjes. Në të shumtën e rasteve, palët iu drejtohen gjykatave për zgjidhjen e këtyre konflikteve, të cilat shoqërohen me zvarritjen e procedurave të shkurorëzimit, mosekzekutimin e vendimeve mbi pagesat e alimentacionit, mosrealizimin e kontakteve të rregullta më fëmijë nga prindërit e divorcuar, si dhe zvarritjen e procedurave për të vendosur përkritazi me të drejtën e besimit të fëmijëve në ruajtje dhe edukim.

Edhe pse shkaqet e zvarritjeve procedurale nëpër gjykata dhe institucionet përgjegjëse burojnë prej shumë faktorëve, asnjë nga këta faktorë nuk mund të arsyetojë një gjendje të tillë në këtë rrafsh. Pritjet me vite të tëra për ekzekutimin e një aktgjykimi për alimentacion, apo të një aktgjykimi për shkurorëzim, paraqesin mangësi të dukshme lidhur me realizimin dhe jetësimin e të drejtës martesore dhe të familjes.

Në IAP është paraqitur rasti, një shembull tipik i zvarritjes procedurale gjyqësore, ku ankuesi i ishte drejtuar ish-Gjykatës së Qarkut në Pejë më 13 tetor 2010, me padi për zgjidhjen e martesës. Për shkak të zvarritjes, ankuesi kishte arritur të merrte aktgjykimin për zgjidhjen e

¹¹⁰ Përgjigja e Zyrës së Informimit të Drejtorisë së Policisë së Përgjithshme të Kosovës, në kërkesën e IAP-së, Prishtinë, 2 dhjetor 2014.

¹¹¹ IAP, rasti A. nr. 517/2014.

¹¹² IAP, rasti A. nr. 475/2014.

kurorës tek në qershorin e vitit 2014.¹¹³ Realisht, gjykata kompetente nuk është marrë fare me çështjen e vendosjes për ruajtje dhe edukim të fëmijëve, si dhe me çështjen e alimentacionit, për shkak se këto çështje paraprakisht kanë qenë të vendosura nga gjykata në Zvicër. E në anën tjetër vetëm procesi gjyqësor për zgjidhjen e kurorës ka zgjatur 4 vite.

Një veprim i tillë i gjykatës është në kundërshtim me KEDNJ, e cila garanton që: “Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile, çdo kush ka të drejtë për proces të hapur dhe të drejtë brenda një afati të arsyeshëm [...]”¹¹⁴ Po ashtu, kjo është në kundërshtim me përcaktimet sipas kuptimit të Ligjit për Procedurës Kontestimore, sipas të cilit, “Gjykata ka për detyrë të përpigjet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”¹¹⁵

2.7.1. Roli i Qendrave për Punë Sociale

Në situatën e tanishme me problemet e familjes merren edhe Qendrat për Punë Sociale (QPS), të cilat kanë mjaft kompetenca dhe përgjegjësi ligjore, lidhur me kujdestarinë, adoptimin, krijimin dhe ekzekutimin e marrëveshjeve për realizimin e kontakteve të prindërve me fëmijë, dhënien e propozimit gjykatave për besimin në ruajtje dhe edukim të fëmijëve prindit të caktuar etj.

Në kohën kur dukuria e dhunës në familje dhe çështja e divorcit tregojnë tendenca rritjeje, sidomos të divorcit faktik, ku zakonisht fëmijët ngelin te njëri prind, për shkak të raporteve të acaruar mes vete, ata të shumtën e herëve ju shmangen obligimeve ligjore, duke mos respektuar kontaktet prind-fëmijë.

Çështja e kontaktit të prindit me fëmijë, në fazën paraprake të divorcit, natyrisht përcillet me probleme të mëdha për faktin se QPS-të nuk janë kompetente për nxjerrjen e ndonjë vendimi administrativ që do të obligonte bashkëshortët të sillen në pajtim me të, lidhur me çështjen në fjalë, ngase për këtë çështje duhet një vendim gjykate. Sa më tepër të zgjasin procedurat e shkurorëzimit në gjykatë, çështja e alimentacionit, e kontaktit të prindit me fëmijë etj., me një fjalë jetësimi i të drejtës martesore dhe të familjes, mbeten problematike.

Në IAP është paraqitur rasti ku ankuesja “ka arritur që brenda pesë viteve fëmijët e saj t’i takojë vetëm njëherë”,¹¹⁶ ndërsa kujdestarinë ndaj tyre e ushtronte halla e tyre.¹¹⁷ Kjo dëshmon për një gjendje për brengosje. Edhe pse ka të bëjë me familjet në hasmëri, pamundësia e kontaktimit të nënës me fëmijët e saj, pa marrë parasysh karakterin tragjik dhe hasmërinë e dy familjeve është e pajustificueshme.

Ky rast dhe rastet të ngjashme, dëshmojnë për jo efikasitetin dhe pafuqinë e institucioneve kompetente në drejtim të plotësimit të kërkesave të ligjshme të ankueses dhe kërkesave të ngjashme, e kjo bie ndesh me Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), sipas së cilës:

¹¹³ IAP, rasti A. nr. 559/2013.

¹¹⁴ KEDNJ, neni 6, paragrafi 1.

¹¹⁵ Ligji Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, neni 10.

¹¹⁶ Deklaratë e punëtorit social në QPS në Drenas, më 5 dhjetor 2014.

¹¹⁷ IAP, rasti A. nr. 116/2014.

“Shtetet palë respektojnë të drejtën e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, që të mbajë rregullisht marrëdhënie vejjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.”¹¹⁸

Po ashtu kjo bie ndesh edhe me Ligjin për Familje të Kosovës, ku parashihet se: *“Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët të cilët nuk jetojnë bashkë me prindërit kanë të drejtë t’i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë.”¹¹⁹*

Një nga kompetencat e QPS-ve është edhe dhënia e propozimit lidhur me besimin e fëmijëve në ruajtje dhe edukim prindit të caktuar, të cilin QPS-të si institucione profesionale ua ofrojnë gjykatave. Problem serioz në këso situata paraqesin rastet kur subjektet e divorcit vijnë nga komuna të ndryshme, dhe për shkak të kompetencës territoriale, për dhënien e mendimit gjykatës lidhur me besimin e fëmijëve në ruajtje dhe edukim vendosin dy QPS, duke sjellë propozime të ndryshme për gjykatën.¹²⁰

Nga analiza e rasteve të paraqitura në IAP mund të vijmë në përfundim se faza më e rëndë në periudhën e një shkurorëzimi është divorci faktik, ku çështja e alimentacionit, çështja e ushtrimit të kujdesit ndaj fëmijëve mbesin të parregulluara dhe konfliktuoze. Janë disa veprime paraprake nga ana e QPS-ve të cilat në fakt, janë në pritje të vendimit të gjykatës, andaj zvarritjet procedurale nga ana e gjyqësorit e bëjnë shumë të rëndë periudhën e divorcit faktik, duke stërngarkuar në këtë rast edhe punën e QPS-ve.

2.7.2. Problemet me pagesën e alimentacionit

Në rastin kur gjykata e sjell vendimin për shkurorëzimin e bashkëshortëve, ajo njëherësh përcakton edhe obligimin për pagesën e alimentacionit. Mirëpo, në shumicën e rasteve palët nuk i përmbushin obligimet sipas vendimeve gjyqësore në mënyrë vullnetare, andaj lidhur me pagesën e alimentacionit, si dhe me realizimin e kontaktit të prindit me fëmijë, palët përsëri detyrohen t’i drejtohen gjykatës lidhur me këto çështje.¹²¹

Rasti i paraqitur në IAP dëshmon, se 6 vite u janë dashur Gjykatave Themelore në Prizren, Ferizaj, dhe Prishtinë vetëm për përcaktimin e kompetencës, lidhur me këtë lëndë.¹²²

Megjithatë ka edhe raste inkurajuese në këtë drejtim. Në IAP është paraqitur rasti lidhur me shkëputjen e një bashkësie jashtëmartesore, ku nga të gjeturat është konstatuar se ka pasur, një koordinim edhe bashkëveprim në mes të institucioneve si; polici, prokurori, QPS, IAP, gjykatë, dhe është arritur të bëhet shkëputja e asaj bashkësie jashtëmartesore të pretenduar që mbahej me dhunë nga ish-bashkëshorti, i cili është dënuar për vepër penale të kryer ndaj ankueses dhe familjes së saj. Gjykata gjithashtu ia ka besuar fëmijën në ruajtje dhe edukim

¹¹⁸ Konventa për të drejtat e fëmijëve, neni 9, paragrafi 3.

¹¹⁹ Ligji Nr. 32/2004 për familjen, , neni 125, paragrafi 2.

¹²⁰ Deklaratë e nëpunësit të QPS në Ferizaj dhënë më 5 nëntor 2014. *“natyrisht se kjo vendimarrje e dy QPS-ve është çështje e kompetencës dhe si e tillë është parimore, por për prindërit pretendues për fitimin e kësaj të drejte, përfaqëson veprime kontradiktore të QPS-ve që sjellin vendime jo objektive, ndërsa gjykatat të shumtën e herëve vendosin në bazë të propozimit, për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve.”*

¹²¹ LAP, rasti A. nr. 471/2014. Në IAP është paraqitur rasti ku ankuesja ka bërë ankesë kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë për shkak të zvarritjes procedurale në lëndën e cila kishte të bënte me pagesën e alimentacionit, ndërsa kjo gjykatë kishte caktuar seancën gjyqësore lidhur me këtë lëndë me tri vite vonesë.

¹²² LAP, rasti A. nr. 522/ 2013.

ankueses. Nga të gjeturat e IAP mund të konstatojmë se ky rast është trajtuar mirë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor.¹²³

Divorci si një problem shumëdimensional, bëhet edhe më i komplikuar dhe më i rëndë edhe për faktin e mungesës së një praktike juridike moderne, si dhe të ekzistimit të një qasjeje mjaft tradicionale lidhur me këtë dukuri. Në shumë raste, kjo pasqyrohet edhe në takimet e prindërve me fëmijët, të realizuara në ambiente të QPS-ve. Nga analiza e disa rasteve të pranuar në IAP, rezulton që këto ambiente jo gjithëherë karakterizohen me siguri të mjaftueshme dhe janë miqësore për fëmijë.¹²⁴

Për Avokatin e Popullit posaçërisht brengosëse janë mostrajtimet adekuate dhe me kohë, të rasteve të shkurorëzimit të bashkëshortëve, nga ana e institucioneve përkatëse. Në këto raste zakonisht viktimat janë fëmijët e pafajshëm. Ata pa fajin e tyre duhet të jetojnë ndaras nga njëri prind. Ata, fatkeqësisht shpeshherë janë edhe subjekt i zbrazjes së energjive negative të prindërve të tyre, që sigurisht ndikon negativisht në zhvillimin, edukimin dhe mirëqenien e tyre edhe në të ardhmen.¹²⁵

Duke u nisur nga tëra këto, Avokati i Popullit konsideron se në çështjet e së Drejtës Martesore dhe të Familjes, rol të rëndësishëm luajnë shumë faktorë dhe institucione, por roli dominues natyrisht në këtë drejtim i takon gjyqësorit, meqë ai përfundimisht është vendimmarrës.

Rekomandime

- *Gjykatat, në vendosjen e lëndëve të shkurorëzimeve, të jenë më azhure dhe t'u japin prioritet vendosjes së lëndëve lidhur me kontestet e shkurorëzimit, besimin e fëmijëve dhe alimentacionin.*
- *Gjykata dhe QPS të ndërmarin veprime në drejtim të ekzekutimit të vendimeve që kanë të bëjnë me pagesën e alimentacionit dhe realizimin e kontakteve prind - fëmijë.*

2.8. Liria e besimit, ndërgjegjes dhe e fesë

Liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë, si njëra nga të drejtat themelore të njeriut, garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe KEDNJ. Meqenëse Ligji i vjetër për Liritë Fetare Nr. 02/L-31 nuk përcakton në mënyrë të qartë të drejtën për lirinë fetare dhe të besimit, ky ligj ndodhet në proces të plotësimit dhe ndryshimit. Nevojën për zgjidhjen e këtyre çështjeve, Avokati i Popullit e ka theksuar në raportet vjetore të IAP-së për vitet 2012 dhe 2013.¹²⁶

Me miratimin e këtyre ndryshimeve do të rregullohej në mënyrë më të përshtatshme statusi ligjor i të gjitha bashkësive fetare, do të pamundësohej trajtimi i ndryshëm i bashkësive fetare

¹²³ LAP, rasti A. nr. 612/ 2013.

¹²⁴ *Po aty.* Ankuesja ka paraqitur problemet e saj lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit të gjykatës. Kur ajo kishte dërguar fëmijën në QPS për takim me babanë, ai ia ka marrë fëmijën 22 muajsh nga dora me agresivitet, dhe për pasojë tani fëmija ka probleme të frikës. Këtë rast ankuesja e kishte paraqitur edhe në polici.

¹²⁵ LAP, rasti A. nr. 128/2014. Ankuesja, përpos ekzekutimit të parregullt të aktgjykimit për kontakt me fëmijët e saj, ankohet kundër ish-bashkëshortit të saj, për shkak se gjatë realizimit të takimit me fëmijët e saj, ata për shkak të presionit të tij, nuk bisedojnë fare me të, se djali i madh e injoron nënën e vet dhe kërkon nga ankuesja të mos kërkojë të takohen, sepse fëmijët janë të manipuluar nga babai i tyre etj.

¹²⁶ LAP, *Raporti vjetor për vitin 2012*, fq. 40 dhe *Raporti vjetor për vitin 2013*, fq.63.

dhe do t'u ofroheshin mundësi të barabarta në ushtrimin e të drejtës së Lirisë së fesë, bindjes dhe ndërgjegjës të gjitha bashkësive fetare.

Domosdoshmëria e miratimit të Ligjit për restitucionin e pronës është një nga problemet që është vënë në dukje nga përfaqësuesit e të gjitha bashkësive fetare gjatë vitit 2014. Përkatësisht, sipas deklaratave të personaliteteve të të gjitha bashkësive fetare,¹²⁷ në periudhën prej disa dekadave, pas luftës së dytë botërore, prona e bashkësive fetare në mënyra të ndryshme u është nacionalizuar, ndërsa çështja e kthimit të tyre, deri më tani, nuk është iniciuar në mënyrë gjithëpërfshirëse.¹²⁸

2.8.1. Mirëmbajtja e trashëgimisë kulturore dhe varrezave

Mirëmbajtja e trashëgimisë kulturore është problem të cilin gjatë vitit 2014 e kanë vënë në dukje bashkësitë fetare, sepse në Kosovë ekziston numër i madh i objekteve fetare që janë pjesë e trashëgimisë kulturore nuk janë të mbrojtura sa duhet nga shkatërrimi.¹²⁹ Obligimi për mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore është i paraparë me Kushtetutë.¹³⁰

Mirëmbajtja e varrezave në Kosovë, si ato të vjetra, joaktive dhe atyre aktive, është çështje që i kushtohet vëmendje nga të gjitha bashkësitë fetare. Përfaqësuesit e bashkësive fetare i kanë drejtuar kërkesë ministrive kompetente dhe kanë kërkuar nga të gjitha organet komunale në Kosovë që të sigurojnë hapësira për varreza.

2.8.2. Informimi i publikut dhe bashkëpunimi ndërfitare

Informimi i pamjaftueshëm për publikun dhe mungesa e numrit të mjaftueshëm të shenjave me njoftime për lokacionet e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare në rrugët e Kosovës është një nga problemet ekzistuese, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në forcimin e ndërgjegjës dhe informimit të shoqërisë për rëndësinë e trashëgimisë kulturore, e si rrjedhim edhe në kujdesin ndaj saj.

Bashkëpunimi ndërmjet bashkësive fetare në Kosovë, gjatë vitit 2014 ishte shumë i mirë. Gjatë muajit maj të vitit 2014 është mbajtur "Java e tolerancës".¹³¹ Një përparim në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet bashkësive fetare, por edhe ndërmjet bashkësive fetare dhe shtetit është edhe njoftimi për formimin e Sekretariatit/Këshillit për bashkësitë fetare. Funkzioni i këtij Këshilli do të duhej të ishte mbledhja dhe sistemimi i të dhënave nga terreni, publikimi i tyre dhe bashkëpunimi me organet e tjera.

¹²⁷ Përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë në Konferencën për dialog ndërfitar më 30 tetor 2014 në Prishtinë.

¹²⁸ Për çështjen e miratimit të Ligjit për restitucionin, shih pjesën për mbrojtjen e pronës në këtë raport.

¹²⁹ Konferenca për dialog ndërfitar, më 30 tetor 2014, në Prishtinë.

¹³⁰ Kushtetuta e Kosovës, neni 9.

¹³¹ Ministria e Punëve të Jashtme, *Lajme* „Konferenca ndërfitare mbledh udhëheqës global fetarë e udhëheqës të shoqërisë civile për të shënuar fillimin e Javës së Tolerancës dhe Pajtimit”, 23 maj 2014, në <http://www.mfa-ks.net/?page=3,4,2345&offset=82> (15.12.2014).

2.8.3. Statusi i bashkësive fetare në Kosovë

2.8.3.1. Bashkësia Islame e Kosovës (BIK)

Problemi kryesor, i cili duhet zgjidhur është Ligji për rregullimin e statusit juridik të bashkësive fetare i cili ende nuk është miratuar. Mungesa e ligjit edhe më tutje shkakton probleme me rastin e regjistrimit të pronës, në zgjidhjen e çështjeve tatimore. BIK është nënshkruese e letrës së përbashkët të cilën bashkësitë fetare gjatë vitit 2014 ia kanë drejtuar Kuvendit të Kosovës me kërkesën për përsheptimin e procesit të nxjerrjes së ligjit.¹³²

Moslejimi i bartjes së shamisë në shkolla është problem i cili vazhdon me vite. Lidhur me këtë çështje IAP në vazhdimësi ka tërhequr vëmendjen dhe ka dhënë rekomandime. Megjithatë kjo çështje në nivele të ndryshme është zgjidhur në mënyra të ndryshme, duke mos pasur një qasje unike në lidhje me këtë.

Në shtator të vitit 2014, në kuadër të një aksioni të Policisë së Kosovës, u arrestua një numër personash, duke përfshirë edhe pjesëtarë të BIK-ut, me dyshime për organizim dhe pjesëmarrje të tyre në luftërat jashtë vendit. Në raste të tilla, procedimi para organeve të ndjekjes penale duhet të zhvillohet pa zvarritje të panevojshme dhe me kujdes të veçantë.¹³³

2.8.3.2. Bashkësia e Tarikateve të Kosovës

Përfaqësuesit e Bashkësisë së Tarikateve të Kosovës (Dervishët) i kanë shprehur pakënaqësinë e tyre Avokatit të Popullit për trajtim jo të barabartë në raport me bashkësitë tjera fetare dhe mospërfshirjen e tyre në draftin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për liritë fetare në Kosovë, si dhe për mospërfshirjen në diskutimet që i kanë paraprirë hartimit të këtij drafti.¹³⁴ Kjo është rregulluar në ndryshimet e bëra në draftin e fundit. Bashkësia e Tarikateve të Kosovës, ka një traditë të gjatë historike, një numër të konsiderueshëm të besimtarëve dhe paraqet një pjesë të trashëgimisë kulturore të Kosovës.

2.8.3.3. Kisha Ortodokse Serbe (KOS)

Mungesa e ligjit për rregullimin e pozitës juridike, po manifestohet në sfera të ndryshme të jetës së KOS-it, ndërsa një nga problemet i cili është theksuar, është çështja e ndërtimit të objekteve të reja fetare dhe çështja e mirëmbajtjes së objekteve të vjetra aktive.¹³⁵

Ndër incidentet që kanë shkaktuar pakënaqësi të KOS-it dhe të cilët e kanë shqetësuar këtë komunitet janë edhe mbishkrimet në manastirin e Deçanit.¹³⁶ Po ashtu, shqetësues është edhe

¹³² Përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë në Konferencën për dialog ndërfaqet, më 30 tetor 2014, në Prishtinë.

¹³³ Policia e Kosovës, *Lajme* "Policia e Kosovës realizon një operacion të gjerë policor në shkallë vendi" 17 shtator 2014, në: <http://www.kosovopolic.com/?page=1,26,4476> (15.12.2014).

¹³⁴ IAP, rasti A. nr. 189/2014. Ankuesi ka paraqitur pakënaqësinë për trajtim jo të barabartë të Bashkësisë së Tarikatit të Kosovës në projektligjin për Ligjin për liritë fetare në Kosovë, si dhe mospërfshirjen e tyre në diskutimet që i kanë paraprirë draftimit të projektligjit.

¹³⁵ Përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë në Konferencën për dialog ndërfaqet, më 30 tetor 2014, në Prishtinë.

incidenti me rastin e tentimit të besimtarëve serbë për të vizituar varrezat me rastin e festës së “Zonja e Madhe” në fshatin Mushtisht të komunës së Suharekës.¹³⁷ Këto ngjarje janë dënuar nga të gjitha bashkësitë fetare. Policia e Kosovës ka reaguar shpejt në të gjitha rastet.

Funksioni i liturgjisë në kisha është rivendosur, si dhe jeta e famullisë në Vushtrri dhe Ferizaj. Në Ferizaj edhe më tej nuk ka familje të kthyer, por prifti lokal me familje jeton në Ferizaj dhe kisha është në funksion.¹³⁸

2.8.3.4. *Bashkësitë e tjera fetare*

Për pjesëtarët e besimit katolik është me shumë rëndësi çështja e miratimit të ndryshimeve të Ligjit për liritë fetare në Kosovë. *Kisha katolike* ka qenë shumë aktive në bashkëpunimin ndërfaqet në Kosovë gjatë vitit 2014.

Problemi kryesor i *Kishës Ungjillore protestante* në Kosovë vazhdon të jetë çështja e pazgjidhur e varrezave për bashkësinë e tyre. Ata kanë kërkuar nga të gjitha komunat në Kosovë që t’ua miratojnë hapësirën për ndërtimin e varrezave për bashkësinë e tyre. Megjithatë kjo çështje edhe më tutje nuk është rregulluar.

Bashkësia Hebreje ka qenë gjithmonë pjesë aktive e bashkëpunimit ndërfaqet në Kosovë. Gjatë vitit 2014 kanë qenë të përfshirë në ngjarjet e mëdha lidhur me promovimin e bashkëpunimit ndërfaqet. Çështja lidhur me ndryshimin e Ligjit për liritë fetare kanë pasur vëmendjen edhe të bashkësisë fetare hebreje.

2.9. Liria e shprehjes

Në Kosovë, liria e shprehjes garantohej në mënyrë të drejtpërdrejtë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 40, por gjithashtu ajo është e mbrojtur edhe me DUDNJ, neni 19, si dhe me KEDNJ, neni 10, që zbatohen drejtpërdrejtë në vendin tonë. Liria e shprehjes nënkupton mendimin e lirë pa ndërhyrje, si dhe marrjen dhe dhënien e informacionit dhe ideve, pa marrë parasysh kufijtë dhe pa ndërhyrjen e autoriteteve publike.

Megjithatë, ushtrimi i lirisë së shprehjes nuk është i pakufizuar. Shteti ka të drejtën legjitime për të ndërmarrë veprime që kufizojnë lirinë e shprehjes, kur një gjë e tillë është e domosdoshme “[...] për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”¹³⁹ KEDNJ qartëson se “Ushtrimi i këtyre lirive, megjë përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për

¹³⁶ Ministria për komunitete dhe kthim, Lajme “Jevtić: Grafiti u Dečanima uznemirujući” në: <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,772> (15.12.2014).

¹³⁷ Po aty, Lajme, “Jevtić: Sprečavanje raseljenh Srba da posete svetinje u Mušutištu i Đakovici čin usmeren protiv procesa povratka”, 28.8.2014, në: <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,748> (5.12.2014).

¹³⁸ Po aty, Lajme, “Jevtić: Posle dugo godina pedesetak u Srbiji raseljenih Uroševčana ponovo na liturgiji u hramu u Uroševcu”, 30.8.2014, në: <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,757> (15.12.2014).

¹³⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 40, paragrafi 2.

mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”¹⁴⁰

Në IAP, gjatë vitit 2014, nuk është drejtuar ndonjë ankesë, që ka të bëjë me lirinë e shprehjes, por kjo nuk e ka penguar Avokatin e Popullit të përcjellë respektimin e lirisë së shprehjes. Me vëmendje të veçantë janë përcjellë rastet e raportuara publikisht për cenimin e lirisë së shprehjes si dhe gjuhës së përdorur. Meqenëse mediat janë në funksion të realizimit të lirisë së shprehjes, ato janë parë si burim thelbësor i informacionit, ashtu si edhe platformat elektronike mediale, përmes të cilave, tashmë, zhvillohet komunikim interaktiv, përfshirë këtu edhe rrjetet sociale.

Mundësitë që ofron interneti i bëjnë shërbim lirisë së shprehjes, por gjithashtu edhe japin mundësi keqpërdorimi. Mungesa e bazës ligjore për funksionimin dhe strukturimin e portaleve elektronike, vazhdon të paraqes problem në rritje sa i përket besueshmërisë së informacioneve, por edhe identifikimit të përgjegjësive për informacionin e shpërndarë. Këto hapësira komunikimi kanë shërbyer shpesh herë si mjedise ku është abuzuar me lirinë e shprehjes, duke vënë në dyshim qëllimin, por edhe saktësinë, e informacionit.

Nëse gjuha e përdorur është e pranueshme apo jo, vlerësohet mbi bazën e disa indikatorëve: të kontekstit në të cilin thuhet, nga kush dhe në çfarë forme thuhet, si shpërndahet dhe cilat janë mundësitë që gjuha e përdorur të nxisë urrejtjen.¹⁴¹ Së këndejmi, rezulton se në shumë raste, diskursi publik i komunikimit ka qenë jotolerant, kërcënues e denigruar.

IAP nuk ka informacion se gjuha e përdorur kundër grupeve të caktuara apo individëve, mund të jetë bërë në formë të organizuar, por thekson se kjo nuk e zvogëlon domosdoshmërinë e trajtimit adekuat të cilës do formë të gjuhës së urrejtjes, të cenimit të privatësisë, si dhe të keqpërdorimit të të dhënave personale.

2.10. Liria e mediave

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 42 të saj, garanton lirinë dhe pluralizmin medial.¹⁴² Në po këtë nen, ndalohet censura dhe pengimi i shpërndarjes së informacionit apo ideve përmes mediave, mirëpo, gjithashtu, në pajtim me paragrafin 2, të nenit 10, të KEDNJ, legjitimohet ndërhyrja e shtetit, në rastet kur kjo bëhet për parandalimin e nxitjes së dhunës në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.¹⁴³

Liria e medias është pashmangshmërisht e lidhur me lirinë e shprehjes. Së bashku, ato sigurojnë rolin aktiv të qytetarit në jetën publike e në proceset demokratike. Përkundër rolit të tyre domethënës, një varg gazetarësh, gjatë vitit 2014-të, kanë qenë cak i sulmeve dhe kërcënimeve.

¹⁴⁰ KEDNJ, neni 10, paragrafi 2.

¹⁴¹ Për më tepër, shih *Rabat Plan of Action on the prohibition of advocacy of national, racial or religious hatred that constitutes incitement to discrimination, hostility or violence*, Conclusions and recommendations emanating from the four regional expert workshops organized by OHCHR, in 2011, and adopted by experts in Rabat, Morocco on 5 October 2012, në:

http://www.ohchr.org/documents/issues/opinion/seminarrabat/rabat_draft_outcome.pdf (10. 12.2014).

¹⁴² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 42, paragrafi 1.

¹⁴³ Po aty, paragrafi 2.

Në tetor, brenda mediumit ku punon dhe gjatë kryerjes së detyrës së tij, është sulmuar dhe rrezikuar për jetë, gazetari Milot Hasimja. Në shtator, kërcënimet ndaj gazetarit Artan Haraqia të portalit “Indeksonline”, si dhe kërcënimet ndaj gazetarit Visar Duriqi të “Gazeta Express” dhe Liridon Llapashticës nga gazeta “Zëri”, gjithashtu janë konsideruar serioze dhe të papranueshme. Shkelje e rëndë e lirisë së medias në Kosovë konsiderohet edhe presioni nga zyrtarë të misionit të EULEX-it në Kosovë, ndaj gazetarit të “Kohës Ditore” Vehbi Kajtazi, me qëllim të ndalimit të raportimit mbi dyshimet për përfshirje në korrupsion të zyrtarëve të EULEX-it. Po ashtu, e papranueshme është edhe kanosja e gazetarit Zekirja Shabani nga pronari i gazetës në të cilën punonte.

Duhet theksuar se në IAP nuk ka pasur ndonjë ankesë të drejtpërdrejtë sa i përket cenimit të lirisë së mediave, prandaj Raporti ju referohet rasteve të raportuara publikisht. Për të qenë edhe më të saktë, IAP iu ka drejtuar Policisë së Kosovës me kërkesën për t’u informuar lidhur me rastet e sulmeve ndaj gazetarëve gjatë vitit 2014. Në përgjigjen e tyre, të pranuar përmes postës elektronike, mësohet se janë gjithsej 20 raste të raportuara, që kanë të bëjnë me lirinë e mediave. Prej tyre, 15 raste janë kanosje, 2 raste të lëndimit trupor, 1 rast i regjistruar si sulm, 1 rast si sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe 1 rast prishje e rendit dhe qetësisë publike.¹⁴⁴

Për Avokatin e Popullit mbetet shqetësues mosrespektimi i Ligjit të Punës, në mënyrë të veçantë sa i përket kontratave të punës së gazetarëve në media, sidomos në RTK. Kjo çështje konsiderohet presion i drejtpërdrejtë në punën e gazetarëve dhe kërkon vëmendjen e institucioneve kompetente, për të krijuar një ambient më të favorshëm për gazetari cilësorë dhe në funksion të informimit të drejtë e të saktë

Gjendja e krijuar në RTK, midis menaxhmentit dhe Sindikatës së Pavarur të këtij mediumi publik, gjithashtu është brengosëse. Mosrespektimi i vendimeve të Inspektoratit të Punës paraqet shqetësim të veçantë. Ky shqetësim është veçanërisht i madh, sepse RTK është institucion publik që ka përgjegjësi të veçantë në zbatimin e ligjeve.

Po të njëjtat instrumente vendore e ndërkombëtare që mbrojnë lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes, po ashtu e obligojnë shtetin të mbrojë të drejtat e individëve nga shpërdorimi i fuqisë mediale.

Avokati i Popullit u tërheq vërejtjen mediave, por edhe avokatëve, policisë dhe prokurorisë, që në rastet e veprimtimit sipas kompetencave të tyre, të mos shndërrohen në instrumente që cenojnë privatësinë dhe dinjitetin e individëve. Jo më pak shqetësuese janë rastet kur çështje personale të individëve, iniciuar nga mediat dhe përmes mediash, bëhen objekt debatesh publike, pa pasur një interes të përgjithshëm që do ta arsyetonte një cenim të tillë të së drejtës së privatësisë.

Paqëndrueshmëria e financiare dhe mospublikimi i burimeve financiare të mediave, e vë seriozisht në dyshim besueshmërinë e informacionit të shpërndarë përmes tyre, e së këndejmi edhe qëllimin e informacionit. Po ashtu, mungesa e një ligji për organizimin dhe funksionimin e mediave, shihet si problem më vete.

¹⁴⁴ Përgjigja e pranuar nga Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e Policisë së Kosovës, më 9 janar 2015, në ora 15:10 në kërkesën e dërguar nga IAP, më 9 janar 2015, në ora 14:05.

2.11. Liria e asociimit

E drejta e çdo qytetari për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitetet e një organizate, është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹⁴⁵ dhe me KEDNJ.¹⁴⁶ Liria e asociimit në Republikën e Kosovës është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-57 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.

IAP gjatë këtij viti raportues ka pranuar disa ankesa të cilat ndërlidhen me cenimin e ushtrimit të kësaj të drejte. Një nga rastet për të cilat IAP ka hapur hetime, kishte të bënte me ankesën e përfaqësuesit të Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës kundër Departamentit për Regjistrimin dhe Ndërlidhje me OJQ, në kuadër të MAP-it (MAP).¹⁴⁷ Përfaqësuesi i asociacionit ankohej se Departamenti në fjalë, përkundër obligimeve ligjore, nuk po zbatonte vendimin e formës së prerë të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të OJQ-ve, lidhur me përditësimin e të dhënave të asociacionit.¹⁴⁸ Më 22 shtator 2014, IAP i dërgoi shkresë ministrit të MAP-it, nga i cili kërkoi të informohet për arsyet e moszbatimit të vendimit të lartpërmendur. Mirëpo, deri në kohën kur është publikuar ky raport, IAP nuk ka pranuar përgjigje nga ministri i MAP-it.

Një nga format e ushtrimit të lirisë së asociimit nga ana e qytetarëve, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është edhe liria e organizimit sindikal.¹⁴⁹ IAP gjatë vitit 2014, ka pranuar disa ankesa nga përfaqësuesit e organizatave sindikale të punëtorëve, të cilat kishin të bënin me cenimin e të drejtës së organizimit sindikal. Përfaqësuesit e organizatave sindikale pohonin se ishin përballur me veprime joligjore dhe me kërcënime për largim nga vendi i tyre i punës, vetëm për faktin se ata kishin ngritur zërin për padrejtësitë që po u bëheshin punëtorëve (anëtarë të sindikatës) në institucionet ku ishin duke punuar. Për këtë arsye, më 23 shtator 2014, IAP ka lëshuar një deklaratë për media, përmes së cilës kishte bërë thirrje që të ndalohen veprimet e tilla nga institucionet e caktuara.¹⁵⁰

Megjithatë, nëse i referohemi ambientit të përgjithshëm në lidhje me ushtrimin e të drejtës për liri të asociimit në Kosovë, IAP vëren se ka pasur disa zhvillime pozitive në aspektin e angazhimit institucional që shoqëria civile të jetë pjesë e vendimmarrjes në politikat publike si dhe në aspektin ligjor. Më 3 prill 2014, Kuvendit i Kosovës, miratoi deklaratën për partneritet ndërmjet Kuvendit dhe shoqërisë civile, deklaratë kjo e cila ka për qëllim lehtësimin e pjesëmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në procesin e hartimit të legjislacionit dhe pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në aktivitetet e mbikëqyrjes së implementimit të ligjeve, si dhe sigurimin e mbështetjes së Kuvendit të Kosovës në zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile në Kosovë.¹⁵¹

¹⁴⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 44.

¹⁴⁶ KEDNJ, neni 11.

¹⁴⁷ IAP, rasti A. nr. 237/2014, Ankesa është paraqitur për mosrespektim të ligjit nga MAP-i.

¹⁴⁸ Rregullorja nr. 02/2012 mbi themelimin dhe funksionimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të OJQ-ve, neni 5 pika 4: “Vendimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave të OJQ-ve është përfundimtar në procedurën administrative”.

¹⁴⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 44, pika 2, “Liria për të themeluar sindikata dhe për t’u organizuar me qëllim që të mbrohen interesat është e garantuar”.

¹⁵⁰ IAP, Deklaratë për media, në: <http://ombudspersonkosovo.org/sq/lajme/DEKLARATE-E-AVOKATIT-TE-POPULLIT-LIDHUR-ME-LIRINE-E-MEDIAVE-NE-KOSOVE-1295> (15.12.2014).

¹⁵¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, në: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,6318> (15.12.2014).

Po ashtu, një zhvillim pozitiv që vlen të theksohet është miratimi i udhëzimit administrativ për funksionimin dhe organizimin e OJQ-ve, nga Qeveria e Kosovës në shtator të vitit 2014.¹⁵² Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat e regjistrimit, përditësimit të të dhënave në regjistrin publik, shuarjen dhe çregjistrimin e organizatave joqeveritare nga regjistri i OJQ-ve.

Rekomandime:

- *Ministria e Administratës Publike të zbatojë vendimet e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të OJQ-ve, në përputhje me Rregulloren nr. 02/2012 mbi themelimin dhe funksionimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të OJQ-ve dhe me Ligjin nr. 04/L-57 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.*
- *Ministria e Administratës Publike të respektojë Ligjin nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku kërkohet që institucionet publike duhet të përgjigjen me kohë në shkresat dhe kërkesat e Avokatit të Popullit dhe të bashkëpunojë me të për çështjet e ngritura.*
- *Institucionet publike të respektojnë të drejtën e çdo qytetari për liri të asociimit, përfshirë këtu edhe lirinë e organizimit sindikal.*

2.12. Liria e tubimit

Gjatë vitit 2014, IAP, nuk ka pranuar ndonjë ankesë në lidhje me të drejtën e lirisë së tubimit. Gjatë këtij viti, sikurse edhe viteve të kaluara, ka pasur organizim të një varg tubimeve publike dhe protestave të ndryshme nga ana e qytetarëve, studentëve, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të ndryshme të interesit. Këto tubime dhe protestat janë organizuar në qytete të ndryshme të Kosovës, në të shumtën e rasteve ato janë organizuar në vende publike dhe para institucioneve specifike. Është për t'u vlerësuar fakti se shumica e këtyre tubimeve dhe protestave janë përcjellë të papenguara nga mediat e ndryshme në vend. Në kuadër të mandatit të vet, edhe IAP ka përcjell me vëmendje disa nga tubimet publike dhe protestat të cilat janë organizuar gjatë këtij viti.

2.12.1. Protesta e studentëve para Rektoratit

Më 5 deri më 7 shkurt 2014, IAP ka monitoruar protestat e organizuara nga studentët e Universitetit të Prishtinës (UP) para Rektoratit të UP-së në Prishtinë.¹⁵³ Kërkesat e studentëve në këtë protestë ishin dorëheqja e menjëhershme e rektorit të UP-së dhe fillimi i hetimeve rreth keqpërdorimeve në UP. Këto kërkesa të studentëve mbështeteshin edhe nga disa përfaqësues të shoqërisë civile të cilët merrnin pjesë në protestë. Gjatë monitorimit të kësaj proteste vërehej prezenca e shtuar e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, përfaqësues të mediave, si dhe të pjesëtarë të KFOR-it, të cilët vëzhgonin protestën.

Më 7 shkurt 2014, situata në mes të protestuesve dhe pjesëtarëve të policisë, ishte tensionuar pasi protestuesit kishin tentuar disa herë të hynin në oborrin e rektoratit dhe kjo situatë i

¹⁵² Qeveria e Republikës së Kosovës, në: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,4437> (15.12.2014).

¹⁵³ IAP, Raport nga monitorimi i protestës, 5 shkurt 2014

kishte shtyrë policët, të përdorin sprej dhe gaz lotsjellës, për t'i shpërndarë protestuesit.¹⁵⁴ Gjatë këtyre protestave policia, arrestoi disa dhjetëra protestues, të cilët janë vizituar nga përfaqësuesit e IAP-së.¹⁵⁵

Pas përcjelljes me vëmendje të këtyre protestave, dhe situatës së krijuar midis protestuesve dhe Policisë së Kosovës, më 7 shkurt 2014, Avokati i Popullit reagoi përmes deklaratës për media, duke tërhequr vëmendjen se: *“Situata e krijuar dhe konfrontimi i dhunshëm para Rektoratit janë produkt i mungesës së debatit të domosdoshëm të botës akademike.”* Me këtë rast, Avokati i Popullit kërkoi që *“Ky debat i zhvendosur në rrugë, të rikthehet brenda botës universitare, për të gjetur zgjidhje të pranueshme dhe në pajtim me standardet universale akademike.”* Duke qenë se situata e krijuar kishte tendencë për eskalim të mëtejme, Avokati i Popullit, bazuar në kompetencat kushtetuese dhe ligjore, ka shprehur *“gatishmërinë që të ndërmjetësojë për të tejkaluar ngërçin mes studentëve dhe organeve udhëheqëse të Universitetit të Prishtinës, nëse të dy palët pajtohen me këtë”*.¹⁵⁶

2.12.2. Protesta e ish-punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore

Më 6 shkurt 2014, me kërkesën e përfaqësuesve të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura dhe punëtorëve të disa ish-ndërmarrjeve shoqërore, IAP monitoroi protestat e mbajtur para teatrit të qytetit të Gjilanit.¹⁵⁷ Kërkesat e kryesore të punëtorëve ishin: kompensimi i pagave të papaguara, përshpejtimin e pagesës së 20 %, kërkesa për formimin e fondit social nga fondi i likuidimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe kërkesa të tjera.

Protesta të ngjashme të punëtorëve të ish-ndërmarrjeve shoqërore me kërkesa të tilla ishin organizuar në vazhdimësi edhe gjatë vitit 2013 dhe vite të tjera të mëhershme. Po ashtu duhet përmendur se punëtorët e ndërmarrjeve të lartpërmendura, me qëllim të realizimit të kërkesave të tyre, në disa raste, gjatë viteve të kaluara, kishin hyrë në grevë urie ku edhe ishin vizituar edhe nga Avokati i Popullit.¹⁵⁸ Punëtorët e këtyre ndërmarrjeve edhe gjatë vitit 2014 kishin mbajtur grevë urie para objektit të Qeverisë së Kosovës në Prishtinë.

2.12.3. Protesta e organizatave joqeveritare

Më 22 qershor 2014, IAP ka monitoruar protestën e organizuar nga disa OJQ në Mitrovicë.¹⁵⁹ Gjatë vëzhgimit të protestës, përveç pranisë së Policisë së Kosovës, janë vërejtur edhe forca të

¹⁵⁴ LAP, Raport nga monitorimi i protestës, 7 shkurt 2014

¹⁵⁵ LAP, Raport nga monitorimi i protestës, 7.2.2014: ”Në këtë protestë kishte 31 protestues të ndaluar. Nga bisedat me disa nga at, sjelljet e policisë ishin korrekte, iu është dhënë ndihma mjekësore dhe ishin njoftuar me të drejtat e tyre. Lëndimet e tyre ishin të natyrës së lehtë, kryesisht nga sprej dhe gazi lotsjellës.”

¹⁵⁶ LAP, Deklaratë për media, 7.2.2014, në: <http://ombudspersonkosovo.org/sq/lajme/DEKLARATE-E-AVOKATIT-TE-POPULLIT-LIDHUR-ME-PROTESTAT-PARA-REKTORATIT-TE-UNIVERSITETIT-TE-PRISHTINES-383> (12.12.2014).

¹⁵⁷ LAP, Raport nga monitorimi i protestës, 6 shkurt 2014.

¹⁵⁸ LAP, Komunikatë për media, 18.6.2013, në: <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/lajme/KOMUNIKATE-LIDHUR-ME-GJENDJEN-SHENDETESORE-TE-GREVISTEVE-NE-GREVEN-E-URISE-NE-PRISHTINE-1235> (13.01.2015).

¹⁵⁹ LAP, Raport nga monitorimi i protestës, 22 qershor 2014.

shumta të KFOR-it dhe EULEX-it. Në fillim protestat ishin të qeta, por, me kalimin e kohës situata eskaloi, kur qytetarët shpërthyen kordonin e policisë dhe filluan të silleshin në mënyrë të dhunshme. Me këtë rast, protestuesit filluan të gjuanin gurë, të thyejnë xhamat e lokaleve afariste dhe dogjën disa vetura zyrtare në parkingun e komunës së Mitrovicës. Si kundërveprim i kësaj gjendje policët filluan të gjuajnë gaz lotsjellës në drejtim të protestuesve me qëllim të shpërndarjes së tyre.¹⁶⁰ IAP ka konstatuar se gjatë arrestimit nga policia nuk ishte përdorur dhunë.

2.12.4. Protesta e Organizatës së Veteranëve të Luftës

Më 4 dhjetor 2014, IAP ka monitoruar protestën e organizuar nga Organizata e Veteranëve të Luftës (OVL) së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të mbajtur para Rektoratit të UP.¹⁶¹ Duke parë me shqetësim të madh tendencën e ashpërsimit të veprimeve nga organizatat e dala nga lufta, sidomos pas nxjerrjes së Vendimit të ministrit të MASHT-it, z. Ramë Buja, më 3 dhjetor 2014 Avokati i Popullit reagoi me deklaratë për media, përmes së cilës njofton të gjitha palët dhe opinionin se ka hapur hetime sipas detyrës zyrtare në lidhje me ngjarjet rreth UP-së.¹⁶² Njëkohësisht, përveç kërkesës për ndërprerjen e të gjitha veprimeve që do të dëmtonin rëndë UP-në, Avokati i Popullit u drejtoi një kërkesë urgjente ish-kryeministrit dhe ish-ministrit të MASHT-it që, bazuar në kompetencat e tyre ligjore, të pezullojnë zbatimin e vendimit të Ministrit të MASHT-it, deri në përfundimin e hetimeve të Avokatit të Popullit, të nisura sipas detyrës zyrtare.¹⁶³ Po e njëjta kërkesë u është drejtuar edhe kryeministrit të ri z. Isa Mustafa, si dhe ministrit të ri të MASHT-it, z. Arsim Bajrami. Fatkeqësisht, as asnjëri nga këta zyrtar, edhe pas kalimit të afatit ligjor për përgjigje, nuk janë përgjigjur në kërkesën urgjente të Avokatit të Popullit.

Në disa raste të veçanta, kjo protestë u karakterizua me një gjendje jashtëzakonisht të tendosur dhe me kërcënime të rënda për Rektorin e UP nga protestuesit. Kishte veprime kërcënuese por të cilat nuk janë përcjellë me veprime të dhunshme nga protestuesit dhe as nga policia.

Si përfundim, Avokati i Popullit, sikurse në Raportin Vjetor 2012 dhe 2013, ri-përsërit kërkesën dhe rekomandimin e për ndryshimin e një pjese të Ligjit për tubime publike, respektivisht të pikës 3 të nenit 12, i cili, duke lënë një pjesë të kompetencës në duar të “kujdestarit” të caktuar nga organizatori i tubimit, që: “[...] menjëherë duhet që të kap dhe dorëzoj tek policët pjesëmarrësin apo personin tjetër që qarkullon pranë vendit të tubimit publik nëse prish rendin,

¹⁶⁰ IAP, *Raport nga monitorimi i protestës*: Sipas informatave të marra nga zëdhënësi i stacionit policor në Mitrovicë, pasojat e kësaj proteste ishin: 13 të burgosur, 6 vetura të djegur, 2 gazetarë dhe 13 policë dhe 10 qytetarë të lënduar, që kanë kërkuar ndihmën mjekësore.

¹⁶¹ IAP, *Raport nga monitorimi i protestës*, 4.12.2014, “Kërkesa e tyre ishte dorëheqja e rektorit të UP, për shkak të kundërshtimit për regjistrimin e studentëve sipas listave të ofruara nga kategoritë e dala nga lufta”.

¹⁶² IAP, *Komunikatë për media*, 3 dhjetor 2014, në:

<http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/lajme/DEKLARATE-E-AVOKATIT-TE-POPULLIT-LIDHUR-ME-REGJISTRIMIN-E-FEMIJEVERE-TE-KATEGORIVE-TE-DALA-NGA-LUFTA-E-UÇK-se-NE-UNIVERSITETIN-E-PRISHTINES-1304> (13.01.2015).

¹⁶³ IAP, *Deklaratë e Avokatit të Popullit lidhur me regjistrimin e fëmijëve të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së në Universitetin e Prishtinës*, 3.12.2014, në: http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/K%C3%ABrkesa_drejtuar_ministrit_Buja_651117.pdf, 2.12.2014, në: http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/K%C3%ABrkesa_drejtuar_Kryeministrit_Tha%C3%A7i_289071.pdf, 2 dhjetor 2014.

qetësinë, mban armë apo objekte të rrezikshme apo shenja të ndaluara¹⁶⁴. Ky rekomandim nuk është zbatuar ndonjëherë.

Si në raportet e mëhershme, Avokati i Popullit vazhdon të tërheq vëmendjen se neni 12, paragrafi 3 i Ligjit për tubime publike nuk përputhet me parimet e nenit 11 të KEDNJ-së, e as me praktikën e GJEDNJ-së. Në lidhje me këtë AP ri-përsëritë kërkesën dhe rekomandimin për plotësim dhe ndryshim të këtij ligji, ashtu që të harmonizohet me standardet evropiane.

Rekomandime

- *Policia e Kosovës, si institucion kushtetues për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike, duhet medoemos të vendosë kontaktin e komunikimit me organizatorët e tubimeve publike për informim dhe planifikim paraprak të tyre dhe për shkak të sigurisë publike.*
- *Të gjithë organizatorët e tubimeve të njoftojnë paraprakisht organet e rendit në lidhje me mbajtjen e tubimeve në përputhje me ligjin.*
- *Të ndryshohet Ligji për Tubime Publike, respektivisht neni 12 paragrafi 3, në mënyrë që ai të jetë në përputhje të plotë me nenin 11 të KEDNJ për lirinë e tubimit dhe të organizimit dhe praktikën e GJEDNJ.*

2.13. E drejta e votës

E drejta e votimit përfshin të drejtën për të zgjedhë dhe për t'u zgjedhur dhe paraqet një nga të drejtat themelore të njeriut, që është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,¹⁶⁴ si dhe me instrumentet ndërkombëtare më të rëndësishme për të drejtat e njeriut.¹⁶⁵ Kosova, vazhdon të ngecë edhe mëtutje sa i përket reformës zgjedhore. Sikurse zgjedhjet lokale të vitit 2013, ashtu edhe zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 8 qershor 2014, janë zhvilluar pa u përfunduar reforma zgjedhore, procesi i së cilës ka filluar para gati katër vitesh.

2.13.1. Vëzhgimi i zgjedhjeve parlamentare në Republikën e Kosovës

Sipas Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës,¹⁶⁶ mbajtja dhe administrimi i zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, si dhe legjislacioni përkatës zgjedhor, udhëhiqen nga parimet e njohura dhe të pranueshme në demokracitë parlamentare.¹⁶⁷

¹⁶⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45.

¹⁶⁵ DUDNJ, neni 21.3; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 25 (b); Protokollu nr. 1 i KEDNJ-së, neni 3.

¹⁶⁶ Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 2.

¹⁶⁷ Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me rregullat e këtij ligji dhe rregullat e KQZ-së.

Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 7 maj 2014 kanë vendosur që të shpërbëjnë Kuvendin, duke mundësuar kështu zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vend.¹⁶⁸

2.13.2. Fushata e pashpallur zgjedhore e qetë

Fushata zgjedhore e subjekteve politike u zhvillua në periudhën 28 maj - 6 qershor 2014. Përgjithësisht, fushata zgjedhore ka kaluar në atmosferë të qetë dhe pa incidente dhe duke u përmbajtur nga gjuha e urrejtjes. Mirëpo, subjektet politike faktikisht kanë bërë fushatë të pashpallur edhe para fillimit të fushatës zgjedhore.

2.13.3. Zhvillimi i zgjedhjeve

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë mbajtur më 8 qershor 2014. IAP ka monitoruar procesin e Ditës së Votimit me 14 ekipe vëzhguese mobile në tërë territorin e Kosovës (duke përfshirë edhe komunat Mitrovica Veriore dhe Zveçan, si dhe fshatin Çabër të Zubin Potokut), me përjashtim të komunave Leposaviq e Zubin Potok, pos fshatit Çabër). *Ekipet vëzhguese të LAP-së kanë vizituar 146 Qendra të Votimit (QV) dhe 393 Vendvotime (VV) nga gjithsej 798 QV me 2366 VV në 38 komuna të Republikës së Kosovës.*

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 8 qershorit 2014 në përgjithësi kanë qenë të organizuara mirë, përkundër disa lëshimeve, kryesisht të natyrës teknike, por të cilat nuk kanë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit të votimit. Në përgjithësi Dita e Votimit ka kaluar qetë dhe pa incidente. Mund të thuhet se këto janë zgjedhjet më të mira të mbajtura deri më tani në Republikën e Kosovës.

2.13.4. Rastet konkrete të shkeljeve të regjistruara

Personat e vendosur në *Institutin e Shëndetit Mendor (ISHM) në Shtime* nuk ishin të vetëdijshëm për veprimet e veta, prandaj nuk e kuptonin procesin e votimit dhe nuk ishin në gjendje të plotësonin fletëvotimet. Madje, shumë prej tyre nuk mund të mbanin lapsin në dorë dhe fletëvotimet plotësoheshin sipas imponimit të përcjellësit, përkatësisht kujdestarit. Gjithsej ishin 60 pacientë me të drejtë vote.

Sikurse në zgjedhjet lokale të vitit 2013, edhe në zgjedhjet parlamentare të këtij viti u përsërit rasti i dukshëm i diskriminimit në QV 1315E/01D në Lipjan, i cili ishte i përcaktuar si vendvotim për “ashkalit”, edhe pse vërehej që ata votonin edhe në vendvotimet tjera, sidoqoftë është e papranueshme një ndarje e tillë diskriminuese e qytetarëve të Komunës së Lipjanit mbi baza etnike.

Ekipe vëzhguese mobile të IAP-së, gjatë monitorimit të këtyre zgjedhjeve kanë vërejtur se:

¹⁶⁸ Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, më 8 maj 2014 ka shpallur mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare për 8 qershor 2014.

- Pothuajse në të gjitha QV (në tavolinat ndihmëse) ka pasur *Fletëvotime me Alfabetin e Braile-it* (për persona të verbër). Mirëpo, ekipet vëzhguese mobile të IAP-së kanë evidentuar rastet kur fletëvotimet e këtitilla kanë munguar në: QV 1512E (shkolla fillore “Sveti Sava” në fshatin Plemetin, komuna e Obiliqit), QV 2201X (shkolla fillore “Emin Duraku” në Shtime), QV 1311E (shkolla fillore “Braça Aksiq” në Lipjan) dhe QV 3016A (gjimnazi “Hamdi Berisha” në Malishevë).
- Për dallim prej zgjedhjeve lokale të vitit të kaluar, në këto zgjedhje parlamentare *llambat verifikuese ultravjollce* kanë qenë funksionale.
- Kësaj radhe, *Dhënësit e Fletëvotimit* (anëtar të Këshillave të Vendvotimit - KVV), të cilët njëherësh kanë bërë edhe spërkatjen e gishtit të votuesit me ngjyrën e padukshme, kanë votuar të parët për të mënjeluar (evituar) problemet eventuale për të votuar (gjë që ka qenë e evidente në zgjedhjet e kaluara, pasi që në mungesë të dorëzave u janë lagur gishtat me këtë ngjyrë dhe pastaj kanë pasur probleme për të votuar).
- Në *Listat Përfundimtare të Votuesve (LPV)* ende figurojnë një numër i emrave të *personave të rdekur*, edhe pse në numër më të vogël se herët tjera. Raste të këtitilla ka në të gjitha komunitat.
- *Personat me aftësi të kufizuar* (në karroca) në një mori rastesh nuk kanë mundur të kenë qasje të papenguar në vendvotime, për shkak të mungesës së pjerrinave përkatëse në objektet që kanë qenë të caktuara si QV, si dhe ata që i kanë pasur vendvotimet në katet e dyta të QV-ve.
- Ka pasur raste kur *policët që kanë kujdestaruar te QV-të*, sidomos në QV në fshatra, nuk kanë mundur të votojnë (pos me kusht), për shkak se nuk janë zëvendësuar me policë tjerë. Ata kanë dalë në QV në orët e hershme të mëngjesit dhe kanë qëndruar aty deri në përfundimin e numërimit të votave. Gjithashtu, edhe personeli i Qendrës Korrektuese në Lipjan, sikurse edhe zyrtarët korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan dhe personeli shëndetësor kujdestar në Spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë kanë mundur të votojnë vetëm me kusht. Duhet theksuar se Rregullat Zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nuk kanë paraparë kurrfarë zgjidhje për raste të tilla.
- Në *Qendrën Korrektuese në Dubravë*, komuna e Istogut, në LPV kanë figuruar 393 persona. Votimi filloi në orën 9.00 dhe ishte vetëm një kabinë, gjë që ishte e pamjaftueshme, pasi votimi shkonte me vonesa, prandaj ekipi vëzhgues mobil i IAP-së rekomandoi që të bisedohet me KKZ në Istog për të sjellë edhe një kabinë votimi, gjë që u realizua në orën 13.50.
- Në *Qendrën Korrektuese në Lipjan* nga 131 të burgosur, 45 prej tyre nuk kanë mundur të shfrytëzojnë të drejtën e votës pasi që nuk ishin në LPV për shkak të mungesës së letërnjoftimeve.
- Në *Spitalin Rajonal në Gjakovë* nuk është zhvilluar procesi i votimit. Në mungesë të ekipit mobil të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), të drejtën e votimit nuk kanë mundur ta shfrytëzojnë pacientët dhe as personeli shëndetësor në kujdestari.

Duke u bazuar në lëshimet e vërejtura gjatë monitorimit të zgjedhjeve parlamentare nga ekipet vëzhguese mobile të IAP-së, Avokati i Popullit jep këto

Rekomandime:

- *KQZ të rishikojë mundësinë e caktimit të anëtarëve të KVV-ve në vendvotimet apo QV ku ata votojnë apo sa më afër QV-ve ku e kanë vendvotimin.*
- *Anëtarët e KVV-ve që kryejnë rolin e Dhënësit të Fletëvotimeve dhe njëherësh bëjnë edhe spërkatjen e gishtit të votuesve me ngjyrë të padukshme, të pajisen me dorëza, ashtu që të mënjanohet spërkatja e gishtave të tyre me këtë ngjyrë, që edhe ata të votojnë pa problem.*
- *Organet e rendit të iniciojnë procedura penale dhe të vihen para drejtësisë të gjithë ata që kanë shkaktuar incidente dhe kanë penguar procesin e votimit.*
- *KQZ të korrigjojë Listat Përfundimtare të Votuesve, duke i hequr nga to të gjithë emrat e personave të vdekur dhe duke i freskuar ato me emrat e votuesve të rinj, të cilët i kanë mbushur 18 vjet.*
- *Të krijohen kushte përkatëse që të gjithë personat me aftësi të kufizuara (veçanërisht ata në karroca) të kenë qasje të papenguar në të gjitha QV-të dhe vendvotimet ku ata votojnë. Në rastet kur kjo nuk është e mundur apo kërkon më shumë kohë për t'u realizuar, këtyre personave t'u mundësohet votimi në shtëpitë dhe banesat e tyre nga ekipet mobile përkatëse të KQZ-së dhe të KKZ-ve, në pajtim me Rregullën Zgjedhore të KQZ-së.¹⁶⁹*
- *Të rregullohet me dispozita përkatëse ligjore realizimi i të drejtës së votimit për persona të cilët në ditën e votimit, përkatësisht gjatë kohëzgjatjes së procesit të votimit janë në detyrë, përkatësisht kujdestari.*
- *Të përmirësohet komunikimi me votuesit jashtë Kosovës, ashtu që ata të pajisen me kohë me fletëvotime, t'u jepet kohë e mjaftueshme për kthimin e fletëvotimeve të tyre në vend, në mënyrë që të realizojnë të drejtën e tyre për të votuar, në pajtim me Rregullën Zgjedhore të KQZ-së.¹⁷⁰*

2.14. E drejta e pronës

E drejta e pronës në Kosovë garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,¹⁷¹ me DUDNJ,¹⁷² si dhe me KEDNJ dhe Protokollin e saj.¹⁷³ Po ashtu, të drejtat pronësore në Republikën e Kosovës rregullohen me një numër ligjesh të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Deri më 31 dhjetor 2014, IAP ka pranuar 369 ankesa që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pronës, 95 nga të cilat janë hetuar.

¹⁶⁹ Rregulla Zgjedhore nr. 04/2013 Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta, neni 3.

¹⁷⁰ Rregulla Zgjedhore nr. 03/2013 Votimi jashtë Kosovës, nenet 3-5.

¹⁷¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 46.

¹⁷² DUDNJ, neni 17.

¹⁷³ KEDNJ, Protokollin 1, neni 1.

Ankesa janë paraqitur kundër gjykatave të të gjitha instancave, duke përfshirë këtu edhe (DHPGJSK, kundër komunave, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKPv), Agjencisë Kosovare të Pronës (AKPr), kompanive publike, prokurorive publike dhe Policisë së Kosovës.

Gjatë vitit raportues, kundër gjykatave të rregullta janë hetuar 21 ankesa që kanë të bëjnë me procedurat e gjykatave në shqyrtimin e rasteve pronësore. Ankesat kanë të bëjnë kryesisht me zvarritje të procedurave gjyqësore. Zvarritja e procedurave gjyqësore më hollësisht trajtohet në pjesën e raportit që flet për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Sidoqoftë, zvarritjet në zgjidhjen e lëndëve gjyqësore lidhur me pronën, si dhe në ekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme nga ana e gjykatave ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në të drejtën pronësore të qytetarëve.

Zvarritja e zgjidhjes së rasteve pronësore të qytetarëve nga ana e gjykatave, në njërën anë ndikon drejtpërdrejtë në të drejtat pronësore dhe në anën tjetër i bën ato të pabesueshme për qytetarët e Kosovës. Me këtë rrezikohet jo vetëm drejtësia por edhe siguria e qytetarëve, për shkak se i shtynë individët që mosmarrëveshjet pronësore t'i zgjidhin jashtë kornizës së sistemit gjyqësor, me vetëgjyqësi. Fatkeqësisht, rastet e tilla në Kosovë janë të pranishme.

2.14.1. Ankesat ndaj komunave

Ankesat kundër komunave kanë të bëjnë me ndërtimet pa leje, ankesa kundër zyrave kadastrale komunale për mos regjistrim të të drejtës pronësore ose problemeve teknike gjatë regjistrimit, dëmtim të pronave, shpronësim, kompensim, uzurpim të hapësirave publike.

Në shumicën e rasteve të hetuara dhe të mbyllura, bëhet fjalë për ankesa lidhur me të cilat ankuesit nuk i kanë shterur mjetet juridike ose zvarritje nga ana e komunave në shqyrtimin e tyre.

IAP u është drejtuar komunave në të gjitha rastet ku ka pasur zvarritje apo mos përgjigje lidhur me kërkesat e ankuesve, ndërsa ankuesit janë këshilluar, aty ku ka qenë e mundshme dhe e lejueshme, t'i shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion.

2.14.2. Ankesat ndaj Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKPv) është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), e cila ishte themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 dhe e ndryshuar më pas me Rregulloret e UNMIK-ut 2005/18, 2008/16 dhe 2008/27. Përveç këtyre rregulloreve UNMIK-u ka nxjerrë edhe akte tjera ndihmëse në bazë të të cilave AKM kishte administruar dhe privatizuar ndërmarrjet publike, ndërmarrjet shoqërore dhe pronën shoqërore në Kosovë.

Kuvendi i Kosovës më 21 maj 2008 kishte miratuar Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit 2008/03-L-067, i cili shfuqizonte Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 dhe ndryshimet e saj. Kuvendi i Kosovës më 31 gusht 2011, ka miratuar edhe një ligj tjetër për Agjencinë Kosovare të Privatizimit 2011/04-L-034, i cili shfuqizon ligjin 2008/03-L-067.

Ankesat e paraqitura në IAP, ndaj AKPv-së kanë të bëjnë me çështjet si në vijim: listat e punonjësve të 20 % nga të ardhurat e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore; privatizimin e pronave shoqërore, të cilat në të kaluarën kanë qenë pronë e personave fizikë; vonesat në kompensimin e pagave të punonjësve të ndërmarrjes së privatizuar si dhe vlerës nga 20% i privatizimit; vonesat në miratimin e kërkesave për blerjen e banesave mbi të cilat ekziston e drejta e banimit, proces ky i cili udhëhiqet nga agjencia.¹⁷⁴

Dy çështjet e para paraqiten si mjaft shqetësuese, prandaj është e nevojshme që të jepet një vlerësim, me gjithë faktin se procesi i privatizimit ndodhet në një fazë të avancuar. Ky vlerësim bëhet për shkak se çështjet lidhur me këto ankesa ose kanë përfunduar, ose procedurat rreth tyre janë duke u zhvilluar pranë agjencisë ose DHPGJSK-së.

1. Procesi i shpërndarjes së vlerës 20 % nga të ardhurat e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore zbatohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në pajtim me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 *Mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore*, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, “*Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit apo të fillimit të procedurës së likuidimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Kjo kërkesë nuk i përjashton punëtorët nga paraqitja e ankesës në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6., të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar po të mos kishin qenë të diskriminuar.*”¹⁷⁵

Sikur që është theksuar, IAP ka pranuar një numër të ankesave për shkak të mos përfshirjes në listat e punëtorëve që përfitojnë nga 20 % e të ardhurave nga privatizimi, prej të cilave një ankesë grupore me gjithsej 292 ankues, ish punëtorë të NSH “Ramiz Sadiku” të cilët ankohen për diskriminim. Mirëpo, këtu nuk bëhet fjalë për diskriminimin e konstatuar nga DHPGJSK, por për diskriminim të pretenduar nga ankuesit. Përkatësisht, këta ankues e cilësojnë si diskriminues faktin që, sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, punonjësi duhet të jetë në listën e pagave në kohën e privatizimit apo likuidimit dhe të ketë jo më pak se tri vite pune në ndërmarrje shoqërore. Ankesat e drejtuara në IAP kanë të bëjnë me mos përfshirje në listat e punonjësve të cilët ishin pensionuar ose të cilëve i është ndërprerë kontrata e punës para privatizimit ose likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, gjë që ankuesit e konsiderojnë diskriminuese.

AP duke marrë parasysh numrin e madh të ankesave, si dhe kriteret e specifikuar me Rregulloren UNMIK-ut 2003/13, konsideron se këto kritere do të duhej të rishqyrtoheshin. Situatën e bën edhe më të vështirë fakti se kriteret janë vendosur me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13, e cila akoma është në fuqi dhe e cila si e tillë nuk mund t’i nënshtrohet vlerësimit të kushtetutshmërisë, për shkak të kalimit të afatit 6 mujor për Avokatin e Popullit sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

2. Ankesa vazhdojnë të paraqiten edhe lidhur me privatizimin e pronave të cilat në kohën e privatizimit kanë qenë të regjistruara si pronë shoqërore, por që në të kaluarën kanë mundur të jenë pronë private e personave fizik.¹⁷⁶ Këto prona, gjatë

¹⁷⁴ Sipas *Ligjit Nr. 04/L-061 për shfitjen e banesave për të cilat e drejta banesore*, AKPv pranon kërkesa për blerjen e banesave në pronësi shoqërore.

¹⁷⁵ DHPGJSK gjatë shqyrtimit të një numri ankesash kishte konstatuar se gjatë përpilimit të listave të punonjësve kishte pasur përjashtime nga listat për një kategori të caktuar të punonjësve.

¹⁷⁶ *LAP*, rastet A. nr. 7/2014, A. nr. 16/2014, A. nr. 46/2014, A. nr. 156/2014.

viteve 1950-60 janë marrë nga pronarët nëpërmjet procesit të nacionalizimit, konfiskimit, shpronësimit dhe formave tjera të dhunshme, pa kompensuar pronarët. Sidoqoftë, këto prona me rastin e privatizimit të tyre kanë qenë të regjistruara në emër të ndërmarrjeve shoqërore dhe si të tilla i janë nënshtruar procesit të privatizimit.

Shumë qytetarë kanë pohuar se pronat e tyre të cilat janë në proces të privatizimit u janë marrë pa kompensim gjatë viteve 1950-60, andaj edhe kanë parashtruar parashtrësata e tyre në DHPGJSK për të dëshmuar të drejtën e tyre pronësore. Në rast se dëshmohet pronësia e personave fizikë mbi pronën e privatizuar, ajo nuk mund t'i kthehet pronarit dhe as vendimi për privatizim nuk anulohet,¹⁷⁷ por pronarët marrin një pjesë nga shitja e pronës, pasi nga shumta e shitjes së pronës zbriten taksat administrative dhe vlera 20%, që u ndahet punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore.

Legjislacioni i UNMIK-ut i kishte dhënë autoritet AKM-së, ndërsa Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës i jep autoritet kësaj agjencie, të privatizojë dhe të likujdijë ndërmarrjet shoqërore, pa marrë parasysh vlefshmërinë e transformimit të mëhershëm të pronës private nga personat fizik në ndërmarrje shoqërore dhe pa marrë parasysh faktin nëse ky transformim është bërë në mënyrë diskriminuese.¹⁷⁸

Privatizimi i pronave të kontestuara pa u përcaktuar se kush është pronar me vendim të DHPGJSK, mund të rezultojë me shkelje të së drejtës pronësore, duke shndërruar privatizimin e pronës në një shpronësim joligjor. Avokati i Popullit vlerëson se shkeljet e të drejtës pronësore me rastin e privatizimit të pronave të ndërmarrjeve shoqërore kanë ardhur si rezultat i mungesës së një ligji për rikthimin e pronave, i cili do të duhej të miratohej para fillimit të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

3. Lidhur me ankesat për vonesat në kompensimin e pagave të punonjësve të ndërmarrjes së privatizuar dhe me vonesat në kompensimin e 20% nga vlera e privatizimit, IAP ka zhvilluar një takim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit për të mësuar shkaqet e këtyre vonesave.¹⁷⁹

Sipas zyrtarëve të agjencisë, vonesat në kompensimin e pagave të punonjësve të ndërmarrjeve të privatizuara ka ardhur si rezultat i pamundësisë së emërimit të anëtarëve të Bordit të AKPv-së nga Kuvendi i Kosovës dhe se pagesat do të bëhen po sa të formohet Bordi.¹⁸⁰ Ndërsa, për vonesat në shpërndarjen e 20% nga vlera e privatizimit, zyrtarët e agjencisë kanë shpjeguar se kjo ndodhë për shkak se në rast se është parashtruar ndonjë ankesë pranë DHPGJSK kundër listave përfundimtare të punonjësve përfitues nga 20 % e të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, atëherë një shumë e caktuar e vlerës nga 20% vihet në pritje deri sa DHPGJSK të vendos lidhur me ankesën, ndërsa pjesa e cila nuk është kontestuar u shpërndahet përfituesve në mënyrë proporcionale. Për Avokatin e Popullit vonesat në

¹⁷⁷ Raporti i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Departamenti i Monitorimit/Divizioni për Sundimin e Ligjit, Seksioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor, *Privatizimi në Kosovë: Shqyrtim Juridik i Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme*, Maj 2008.

¹⁷⁸ *Property Rights in Kosovo: A Haunting Legacy of a Society in Transition*, February 2009, Written by Edward Tawil for the International Center for Transitional Justice.

¹⁷⁹ Takim me z. Visar Hoxha, udhëheqës i Divizionit të Departamenteve Ligjore të AKPv-së, 17.11.2014.

¹⁸⁰ IAP, rasti A. nr. 23/2014.

shpërndarjen e 20 % me arsyetimin e mos kompletimit të Bordit të AKP-së është e pajustificueshme dhe paraqet shkelje të të drejtave të punëtorëve në bazë të ligjit.

4. Gjatë takimit me zyrtarët e agjencisë është ngritur edhe çështja e vonesave në miratimin e kërkesave të privatizimit të banesave ku ekziston e drejta e banimit. Zyrtarët e agjencisë kanë pohuar se edhe kjo vonesë ka ardhur si rezultat i mungesës së anëtarëve të Bordit të AKPv-së. Zyrtarët e AKPv-së kanë shfrytëzuar rastin që të informojnë IAP-në se shitja e këtyre banesave është njëri nga projektet më të suksesshme të agjencisë ku nga 1000 kërkesa deri tani janë aprovuar 600.

2.14.3. Agjencia Kosovare e Pronës

Agjencia Kosovare e Pronës (AKPr) është themeluar me Ligjin nr. 03/L-079 *për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale*, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. AKPr ka trashëguar disa obligime ligjore nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB), të cilat kanë mbetur akoma pa u përmbushur.

Kundër AKPr-së vazhdimisht janë paraqitur ankesa në IAP, por në numër dukshëm më të vogël se viteve të mëparshme. Mirëpo një numër i ankesave të viteve të mëparshme, që kanë të bëjnë me obligimet që agjencia i ka trashëguar nga DÇPB, kanë mbetur të hapura. Ankesat kundër AKPr-së kanë të bëjnë me:

1. Moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (Komisioni) për pronat në pjesën veriore të Mitrovicës.¹⁸¹
2. Moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të Komisionit për rikthimin e të drejtës së banimit në banesa shoqërore të humbura si pasojë e diskriminimit, sipas kushteve të parapara me nenin 4.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60.¹⁸² Këtu bëhet fjalë për rastet kur është njohur e drejta në kompensim, në pamundësi për t'u njohur e drejta e ri-posedimit për banesa mbi të cilat e drejta valide e banimit ka humbur me humbjen e vendit të punës gjatë viteve 1990, si pasojë e vendosjes së masave të dhunshme.

IAP ka pasur komunikim me zyrtarët e agjencisë për të siguruar informata lidhur me numrin e rasteve që kanë të bëjnë me dy çështjet e lartpërmendura, si dhe përpjekjet e agjencisë për zgjidhjen e këtyre rasteve. AKPr ka njoftuar IAP-në se:¹⁸³

1. Agjencia ka për obligim zbatimin e vendimeve të Komisionit. Agjencia gjatë zbatimit të vendimeve të Komisionit, me kërkesë të paraqitësve të suksesshëm të kërkesave, mund të vë pronat nën administrim, e po ashtu mund të bëjë edhe lirim të pronave.

¹⁸¹ IAP, rastet A. nr. 48/2012, A. nr. 176/2012 dhe A. nr. 125/2013.

¹⁸² Neni 4.5 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe të provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore si dhe të komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore përcakton se: “Çdo person me certifikatë të lëshuar sipas nenit 4.4 të mësipërm ka të drejtë në kompensim të arsyeshëm, të barabartë me shumën e shënuar në certifikatë, e cila paguhet nga fondet që mund të grumbullohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës ose në çdo fond të krijuar për këtë qëllim prej kësaj rregulloreje”.

¹⁸³ Komunikimi elektronik me znj. Elhame Gorani, nëpërmes znj Florije Kika, u.d Drejtoreshë Ekzekutive e AKPr-së, më 24, 25 dhe 26 nëntor 2014.

Në pjesën veriore të Mitrovicës procedura e administrimit të pronave apo lirimit të tyre zgjatë më shumë se sa në pjesët tjera, pasi që në këtë pjesë agjencia nuk ka pasur mbështetjen e organeve të rendit në zbatimin e vendimeve për një kohë të gjatë. Mirëpo, në muajin mars të këtij viti autoritetet e rendit kanë filluar të mbështesin agjencinë. IAP është njoftuar se në pjesën veriore të Mitrovicës agjencia ka nën administrim gjithsej 390 prona dhe 27 dëbime të ekzekutuara.

2. Lidhur me kërkesat për kompensim për humbjen e së drejtës banesore si pasojë e diskriminimit janë gjithsej 143 vendime të Komisionit të cilat duhet të zbatohen. Zbatimi i vendimeve bëhet në atë mënyrë që personat të cilët e kanë humbur të drejtën banesore si pasojë e diskriminimit duhet të kompensohen. Zbatimi i këtyre vendimeve nuk ka filluar ende. Agjencia ka përgatitur kriteret dhe procedurat e nevojshme për përlogaritjen e shumave për kompensim, sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, por që për zbatimin e këtyre vendimeve nevojiten mjete financiare në vlerë prej 3.2 milionë euro. Zyrtarja e agjencisë pohon se agjencia është duke bërë përpjekje të vazhdueshme për sigurimin e këtyre mjeteve.

Sa i përket çështjes së pronave në pjesën veriore të Mitrovicës, Avokati i Popullit konsideron se administrimi i pronave nga agjencia, në tërë territorin e Republikës së Kosovës, paraqet një masë të përkohshme dhe në baza vullnetare të administrimit të pronave për shkak të pamundësisë së bartësve të së drejtës pronësore që të rikthejnë posedimin faktik mbi pronat të cilat i kanë humbur si rezultat i luftës së viteve 1998 dhe 1999. Kjo do të mund të interpretohej si themelim i një posedimi të tërthortë dhe si një formë bilanci në mes të interesave individuale (së drejtës pronësore të individëve në këtë rast) dhe interesit të përgjithshëm (sigurisë së personave të zhvendosur në rastet kur ata për arsye sigurie nuk mund të kthehen në pronat e tyre). Por, duke u bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, Avokati i Popullit konstaton se ky bilanc, për pronarët e kërkuësve të suksesshëm nga pjesa veriore e Mitrovicës nuk është arritur, për faktin se shtyrja e ekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme të Komisionit paraqet një barrë shtesë për pronarët apo bartësit e ndonjë të drejte pronësore mbi këto prona, marrë parasysh se ata prej vitit 1999 janë dëbuar nga pronat e tyre dhe ndodhen në një gjendje pasigurie rreth mundësisë të rikthimit të posedimit. Për më shumë, ata nuk kanë mundësi që të marrin ndonjë kompensim për humbjet që rezultojnë nga pamundësia e tyre për rikthimin e posedimit mbi pronat.¹⁸⁴ Avokati i Popullit konsideron se pengimi i posedimit të qetë, qoftë ai posedim i drejtpërdrejtë me rikthim të posedimit faktik apo i tërthortë me realizimin e qirasë, për një kohë kaq të gjatë paraqet cenim të së drejtës pronësore.

Sa i përket zvarritjes së zbatimit të vendimeve të plotfuqishme të Komisionit për kompensim, Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka nxjerr një raport me të gjetura dhe me rekomandime.¹⁸⁵

Si në rastin e pronave të pjesës veriore të Mitrovicës, ashtu edhe lidhur me kompensimin, bëhet fjalë për zvarritje apo mos zbatim të vendimeve të plotfuqishme të Komisionit. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit dëshiron të përkujtojë se zbatimi i vendimeve duhet të jetë

¹⁸⁴ Rasti *Immobilare Saffi kundër Italisë*, Application no. 22774/93, par. 49-59.

¹⁸⁵ IAP, Raport me Rekomandim për rastin A. nr. 171/2013, Zvarritje procedurale nga Agjencia Kosovare e Pronës për kompensim, në bazë të vendimit të formës së prerë, më 21 shkurt 2014.

pjesë përbërëse e procedurës së “gjkimit” dhe se zbatimi i vendimeve të plotfuqishme garanton sundimin e ligjit.¹⁸⁶

Megjithatë, Avokati i Popullit konsideron, sa i përket zbatimit të vendimeve të Komisionit për rikthimin e posedimit në pjesën veriore të Mitrovicës, se shkelja në rend të parë nuk ka ardhur nga agjencia por nga mospërkrahja e organeve të rendit dhe Qeverisë e cila nuk ka krijuar kushte të nevojshme sigurie. Ndërsa sa i përket kompensimit sipas vendimeve të Komisionit, Avokati i Popullit konsideron se shkelja ka ardhur nga Qeveria e cila nuk ka siguruar përkrahje financiare për zbatimin e vendimeve të Komisionit.

IAP-i ka hetuar pesë ankesa, prej të cilave një grupore me pesëmbëdhjetë ankues, ankesat e të cilëve kanë të bëjnë me mos reagimin apo reagimin jo të duhur të Policisë së Kosovës në mbrojtjen e pronës së tyre. Pas hetimit të rasteve ankuesit janë këshilluar t'i drejtohen organeve kompetente.¹⁸⁷

IAP ka hetuar dy ankesa pronësore kundër prokurorive publike, një kundër Prokurorisë Themelore - Departamenti në Prizren¹⁸⁸ dhe tjetra kundër Prokurorisë Themelore në Gjakovë.¹⁸⁹ Ankesa kundër Prokurorisë Themelore në Prizren ka të bëjë me procedurën lidhur me shkatërrimin e pronës së luajtshme, ndërsa ankesa kundër Prokurorisë Themelore në Gjakovë ka të bëjë me shkatërrim të pronës së paluajtshme dhe vjedhje.

2.14.4. Ankesat ndaj kompanive publike dhe KEDS

IAP gjatë këtij viti raportues ka hetuar tri ankesa kundër kompanive publike, dy prej të cilave pas hapjes së hetimit nga IAP dhe trajtimit të tyre janë zgjidhur pozitivisht për palët dhe janë mbyllur.¹⁹⁰

Kundër KEDS-it (Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike) janë paraqitur 8 ankesa, prej të cilave 7 ankesa janë hetuar dhe janë mbyllur. Ankesat kundër KEDS-it kanë të bëjnë me vendosjen e shtyllave elektrike në prona private pa miratimin e pronarit, kontrolli i pronave nga ana e punonjësve të KEDS-i pa paralajmërim, dëmtimi i pajisjeve elektrike, vendosja e përçuesve elektrikë, duke shkaktuar kështu pengim posedimi, gabimet gjatë vendosjes dhe regjistrimit të njehsorëve elektrikë si dhe me mos përgjigje në ankesat e palëve.

IAP-i duke vepruar sipas kompetencave të përcaktuara me ligj në raste ku KEDS-i nuk i është përgjigjur ankesave të ankuesve, ka kërkuar nga KEDS-i që t'u përgjigjet palëve, ndërsa aty ku ka qenë e zbatueshme i ka këshilluar palët që të shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion.

¹⁸⁶ *Hornsby kundër Greqisë*, Application no. 18357/91, par. 45.

¹⁸⁷ *LAP*, rastet A. nr. 343/2014 dhe A. nr. 341/2014.

¹⁸⁸ *LAP*, rasti A. nr. 267/2014.

¹⁸⁹ *LAP*, rasti A. nr. 269/2014.

¹⁹⁰ *LAP*, rastet A. nr. 76/2014 kundër Kompanisë së Ujësjellësit në Ferizaj dhe A. nr. 115/2004 kundër Kompanisë “Hidro-Regjioni Jugor” në Prizren.

Rekomandime:

Për Kuvendin i Republikës së Kosovës:

- *Të shfuqizojë Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45, duke nxjerrë një ligj me të cilën rregullohet transformimi i pronës shoqërore, si dhe vendosja e kritereve të drejta dhe të balancuara për përfshirjen e punonjësve në listat e punonjësve që përfitojnë nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore.*
- *Të shqyrtojë nxjerrjen dhe miratimin e ligjit për rikthimin e pronave të nacionalizuara gjatë viteve 1950 dhe më vonë, duke u kujdesur për balancimin e interesave, dhe sipas praktikave më të mira të shteteve rajonale dhe evropiane.*

Për Qeverinë e Kosovës:

- *Krijimi i kushteve për rikthimin e posedimit mbi pronat e humbura si pasojë e luftës së viteve 1998-1999 dhe ofrimi i përkrahjes së nevojshme për Agjencinë Kosovare të Pronës në zbatimin e vendimeve për rikthimin e pronës.*
- *Mbështetja financiare për Agjencinë Kosovare të Pronës apo agjencisë pasardhëse të saj, për zbatimin e vendimeve për kompensim, sipas kushteve të përcaktuara me nenin 4.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.*

2.15. E drejta për arsimin

Kushtetuta përcakton detyrimin që institucionet publike t'i sigurojnë mundësi të barabarta arsimimi çdo personi sipas aftësive dhe nevojave të tij/saj.¹⁹¹ Këtë e garanton edhe KEDNJ me Protokollin e saj.¹⁹²

Gjatë vitit 2014, IAP ka pranuar gjithsej 56 ankesa në lidhje me të drejtën për arsim.¹⁹³ Prej tyre 26 janë hetuar, ndërsa 30 ankesa janë shpallur të papranueshme. Në krahasim me vitin 2013 kemi rritje të ankesave në fushën e arsimit. Ankesat e hetuara ishin të drejtuara kundër UP “Hasan Prishtina”, DKA-ve, MASHT-it etj.

2.15.1. Arsimi para-universitar

Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsim cilësor, sigurimi i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim, përmirësimi i infrastrukturës shkollore, si dhe parandalimi, luftimi dhe referimi i dhunës në shkolla, mbeten disa nga objektivat më të rëndësishme nga fusha e arsimit, realizimi i të cilave kërkon angazhim të vazhdueshëm të institucioneve të Kosovës.

¹⁹¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 47 paragrafi 2.

¹⁹² Po aty, neni 22 paragrafi 2.

¹⁹³ Statistikat nga 1 janar deri më 15 dhjetor 2014.

Institucionet duhet të garantojnë cilësinë në arsim, të drejtën e fëmijëve dhe të rinjve për arsimim në një mjedis të sigurt pa dhunë, fyerje ose forma të tjera të diskriminimit. Për krijimin e një ambienti më të sigurt dhe më të përshtatshëm në institucionet arsimore, si dhe për parandalimin e dukurive negative, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Rregulloren e cila përcakton procedurat e zgjidhjes së rasteve të dhunës në shkollë dhe referimin tek institucionet tjera përgjegjëse.¹⁹⁴

Edhe pse Avokati i Popullit në raportin e vitit të kaluar ka rekomanduar zbatimin e kësaj rregullore, pas shumë vizitave në institucione shkollore si dhe duke u bazuar në rastet e dhunës të cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2014 në hapësirat arsimore, rreth apo në afërsi të tyre, vërehet se kjo rregullore ende nuk zbatohet mjaftueshëm.¹⁹⁵

Edhe pse procesi mësimor në institucionet parauniversitare fillon më 1 shtator,¹⁹⁶ jemi dëshmitarë se në shumë shkolla, për shkak të renovimeve të vonuara, procesi mësimor ka filluar me vonesë. Po ashtu, edhe fillimi i sezonit të ngrohjes mbetet sfida për institucionet shkollore, sepse edhe këtë vit shkollor, për shkak të mungesës së derivateve apo lëndës për ngrohje, në shumë shkolla nxënësit kanë qenë të detyruar të zhvillojnë procesin mësimor në temperatura të ulëta, e si rrjedhojë, në disa shkolla kemi pasur ndërprerje të procesit mësimor pas protestës së nxënësve dhe prindërve.

Për shkak të reformave në arsimin parauniversitar, disa komuna kanë pasur probleme lidhur me procesin e rekrutimit të mësimdhënësve. Konkursët e shpallura, por edhe kriteret e rekrutimit, në disa komuna ishin në kundërshtim me ligjin, në disa raste madje edhe kriteret diskriminuese.¹⁹⁷

2.15.2. Arsimi universitar

Këtë vit akademik UP-në e kanë përcjellë sfida të mëdha, në fillim të këtij viti, pas protestave të organizuara nga grupe të ndryshme të studentëve, situata kulmoi me dorëheqjen e rektorit dhe të një pjese të Këshillit Drejtues. Kjo situatë e tensionuar vazhdoi pothuajse gjatë tërë vitit. Universiteti ishte në qendër të vëmendjes. Pas zgjedhjes së rektorit aktual, u krijua një përshtypje se situata do të fillojë të përmirësohet dhe se problemet në UP, më në fund, do të fillojnë të adresohen për t'u zgjidhur.

Mirëpo, pas vendimit të ministrit të MASHT-it dhe kërkesës së shoqatave të dala nga lufta për regjistrimin në UP të kandidatëve sipas listave të dërguara nga këto shoqata, dhe pas protestave të shoqatave në fjalë, UP përsëri gjendet në një udhëkryq. Është obligim i të gjithëve, shoqërisë dhe institucioneve shtetërore, që të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore që të ruhet autonomia e UP, si institucioni më i lartë publik arsimor - shkencor.

¹⁹⁴ Rregullore e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar.

¹⁹⁵ Deklarata e Avokatit të Popullit lidhur me vrasjen e nxënësit në Mitrovicë, më 28.1.2014.

¹⁹⁶ Ligji nr. 042/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 2, paragrafi 1.37. “Vit shkollor - periudha kohore që fillon me 1 shtator të një viti dhe që përfundon më 31 gusht të vitit pasues ...”

¹⁹⁷ DKA Prishtinë, Konkursi i datës 24.9.2014, “Kandidati mund të aplikoj më së shumti në tri (3) vende pune, Andaj rekomandoheni të aplikoni vetëm në një vend pune.”; DKA, Gjilan, Procesverbal i të intervistuarve-pjesa e II, “Kandidati vendas, kandidati që jeton në lokalitetin ku gjendet shkolla, 1 pikë(ky kriter vlen vetëm në fshatra), dhe kriteri tjetër “Kandidati banor i Komunës së Gjilanit, 5 pikë”; DKA, Viti, Formulari i vlerësimit të kandidatëve, “Kandidati vendas(kandidati që jeton në lokalitetin ku gjendet shkolla 1 pikë).

Në këtë rast Avokati i Popullit thekson se duhet të ndërpriten ndërhyrjet nga jashtë dhe të respektohet autonomia e UP. Kjo vlen sidomos për Qeverinë e Kosovës, MASHT dhe të gjithë personat dhe institucionet publike, persona fizikë dhe juridikë, shoqata të dala nga lufta, dhe shoqata studentore, që bëjnë përpjekje për të ndikuar në menaxhimin dhe zhvillimin e pavarur të UP-së.

Edhe në universitetet tjera publike,¹⁹⁸ edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë nga hapja e tyre, vërehet se menaxhimi i tyre ende vazhdon me ushtrues të detyrës së rektorëve dhe prorektorëve, e kjo dukuri ndikon negativisht në menaxhimin e universiteteve publike.

Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, për zbritjen e çmimeve të disa shërbimeve për studentë, ka krijuar lehtësime për studentët dhe familjet e tyre, ka krijuar mundësi më të mira për studim për të gjithë, mirëpo kjo nuk guxon të krijojë dhe të përcillet me probleme buxhetore në institucionet universitare. Sepse edhe ashtu arsimit si fushë më vete është e nën-financuar në Kosovë dhe ka nevojë për përkrahje shumë më të madhe materiale e financiare sesa tani.

Gjendjen në UP, më së miri e sqaron deklarata e ish ministrit të MASHT-it, i cili para dorëzimit të detyrës, deklaroi se: “[...] gjendja në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” nuk është stabilizuar, sado që gjatë mandatit të tij, universiteti ka ndërruar tre rektorë.”, si dhe “[...] më vjen keq për ministrin që vjen [...] që kjo patate e nxehtë po i mbetet në dorë”.¹⁹⁹

Nuk ka dyshim se zhvillimet në UP dhe rreth tij e kanë lëkundur besimin edhe ashtu të lëkundur, që ky institucion gëzonte në opinionin publik dhe, në një masë, edhe reputacionin e tij në rajon dhe më gjerë (rangimi i fundit ndërkombëtar i UP në vendin 4937 në botë, nga gjithsej 20.000 universitete të vlerësueshme në tërë botën). Prandaj organet udhëheqëse duhet të angazhohen fuqishëm për kthimin e besimit të opinionit publik në UP.²⁰⁰

2.15.3. E drejta për arsimim e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Avokati i Popullit, në raportet e mëparshme vjetore, po ashtu ka rekomanduar që të sigurohen kushte sa më të përshtatshme për nxënësit me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor në Kosovë. Të gjithë jemi dëshmitarë se kjo kategori e nxënësve me vështirësi i realizon këto të drejta. Sidomos ka probleme me sigurimin e transportit të nxënësve me nevoja të veçanta por edhe të nxënësve të tjerë për të cilët komunat kanë obligim ligjor të sigurojnë transportin për shkak të largësisë së shkollave.²⁰¹ Përkrahja dhe përmirësimi i kushteve për këta nxënës si dhe krijimi i kushteve për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt arsimor duhet të jetë prioritet i MASHT-it dhe komunave.

Fatkeqësisht, përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin kosovar është ende e vogël. Në shkolla speciale, në klasa të bashkangjitura dhe nxënës të ndihmuar, në vitin

¹⁹⁸ Informatat e marra në: <http://www.upgj.org/>, Universiteti “Kadri Zeka” në Gjiilan, <http://www.unigjk.org/> Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” dhe <http://www.umib.net/>, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (12.12.2014).

¹⁹⁹ Konferenca për shtyp, më 10.12.2014.

²⁰⁰ *Programi i Punës i Rektorit të UP*, 17 shtator 2014, f. 1.

²⁰¹ *LAP*, rastet A. nr. 525/2013 dhe A. nr. 528/2014, ankesa për shkak të mos sigurimit të transportit për nxënës.

shkollor 2013/2014, janë përfshi gjithsej 1.239 nxënës.²⁰² Në Kosovë janë identifikuar rreth 6.100 fëmijë me nevoja të veçanta, por supozohet se ky numër është edhe më i madh por nuk janë të regjistruar.²⁰³

2.15.4. Ankesat për arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Pas ankesës së një nxënësi me aftësi të kufizuara, lidhur me pamundësinë e tij për vijimin e mësimimit në shkollën e mesme të lartë për shkak të mungesës së transportit, Avokati i Popullit ka ndërmjetësuar për zgjidhjen e rastit. Pas shumë bisedave me përgjegjësit e komunës si dhe me përgjegjësit e MASHT-it, institucionet përgjegjëse kanë siguruar transportin dhe nxënësi ka vijuar procesin mësimor.²⁰⁴ Me këtë rast kemi neglizhim nga institucionet përgjegjëse në nivel komunal për respektimin e ligjeve në fuqi dhe konstatohet shkelje e së drejtës për arsimin, pasi që sipas ligjit autoritetet komunale obligohen që të sigurojnë transportin falas për fëmijët me aftësi të kufizuara.²⁰⁵

IAP, ka pranuar një ankesë në emër të një familje të komunitetit boshnjak, e cila për dy fëmijë me aftësi të kufizuara ka kërkuar hapjen e një paraleleje në gjuhën boshnjake në Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Mitrovicë. Komisioni profesional ka bërë vlerësimin e aftësive për mësim të fëmijëve, me ç’ rast ka konstatuar se fëmijët mund t’i vijojnë mësimet në gjuhën boshnjake në shkollën e mesme të ultë “Bedri Gjinaj” në Mitrovicë.²⁰⁶ Ankesa me ndërmjetësimin e Avokatit të Popullit është zgjidhur në të mirën e fëmijëve.²⁰⁷

Pas ankesës së nënës për fëmijën e vet me aftësi të kufizuara, nxënës të klasës së VII,²⁰⁸ ngase klasa e tij është caktuar në katin e dytë, prandaj ai nuk mund të vijojë mësimin, ka ndërmjetësuar IAP. Pas veprimt të IAP-së, menjëherë janë marrë masat e duhura nga DKA dhe drejtorja e shkollës. Është ndërruar klasa prej katit të dytë në katin përdhësë dhe nxënësi ka vazhduar mësimin. Institucionet publike, janë të obliguara që të ofrojnë mbështetje përkatëse bazuar në nevoja të nxënësve, ndërsa gjatë marrjes së vendimeve, ato duhet të kenë prioritet gjithnjë interesin më të mirë të fëmijës dhe të marrin parasysh nevojat e tyre.²⁰⁹

2.15.5. Rasti ex officio kundër MASHT-it

Avokati i Popullit ka hapur hetimet me vetiniciativë lidhur me ndikimet në të drejtat e njeriut, të parapara me Kushtetutë dhe ligje në fushën e arsimit universitar, të vendimit nr. 178/01B të

²⁰² MASHT, *Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2013/2014*, në:

http://www.mashtgov.net/advCms/documents/Statistikat_e_arsimit_ne_Kosove_2013_14.pdf faqe 43, grafikoni 25 (9.12.2014).

²⁰³ MASHT, *Filloi fushata vetëdijesuese për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta*, në: <http://www.mashtgov.net/advCms/channels/news/newsPrint.php?id=1,3009> (9.10.2014).

²⁰⁴ IAP, rast A. nr. 515/2013.

²⁰⁵ *Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës*, neni 40, paragrafi 4.

²⁰⁶ *Po aty*, neni 41, paragrafi 3.

²⁰⁷ IAP, rast A. nr. 483/2013, kërkesë për hapjen e paraleles për mësim në gjuhën boshnjake në Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Mitrovicë.

²⁰⁸ IAP, rast A. nr. 2/2014.

²⁰⁹ *Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës*, neni 40, paragrafi 2.1 dhe 2.2.

ministrit të MASHT-it, të datës 13 nëntor 2014. Ky vendim ka të bëjë me regjistrimin e fëmijëve të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së, në UP “Hasan Prishtina”.²¹⁰ Nga informatat e ofruara prej Rektorit të UP “Hasan Prishtina”, theksohet se UP nuk ka kushte për rritjen e numrit të studentëve për shkak se ka mungesë të stafit akademik, si dhe të laboratorëve dhe hapësirave të tjera të domosdoshme për punë arsimore dhe shkencore.²¹¹

Lidhur me këtë çështje, pasi që është përmbushur kriteri substancial për rekomandimin e një pezullimi, ngase “*ekzekutimi i ndonjë vendimi administrativ mund të ketë pasoja të pariparueshme për personin fizik apo juridik*”,²¹² Avokati i Popullit i është drejtuar ish-kryeministrit të Kosovës dhe ish-ministrit të MASHT-it, respektivisht Kryeministrit dhe ministrit aktual, me kërkesë për masë të përkohshme për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 178/01B të Ministrit të MASHT-it, deri në përfundimin hetimeve. Pas dështimit për bashkëpunim dhe duke parë seriozitetin e çështjes, Avokati i Popullit, përmes një deklaratë për media, ka shprehur shqetësimin për rritjen e tensioneve kohëve të fundit rreth Universitetit të Prishtinës. Avokati i Popullit thekson se çdo ndërhyrje e jashtëligjshme në zhvillimin e rregullt të procesit mësimor, konsiderohet totalisht e papranueshme.²¹³

2.15.6. Ankesa e përfaqësuesve të komunitetit ashkali

Avokati i Popullit ka pranuar ankesën e përfaqësuesve të komunitetit ashkali,²¹⁴ të cilët ankohen kundër Rektorit të UP “Hasan Prishtina”. Ata kanë pohuar se janë 44 vende të rezervuara për kandidatët nga radhët e komunitetit ashkali, të cilët dëshirojnë të studiojnë në UP. Sipas tyre për këtë vit akademik kanë aplikuar gjithsej 12 kandidatë prej të cilëve janë pranuar vetëm 5. Ata kanë pohuar se janë takuar edhe me zëvendës ministrin e MASHT-it si dhe me rektorin e UP por që nuk kanë hasur në përkrahje. Gjatë takimit që Avokati i Popullit ka pasur me Rektorin më 14 nëntor 2014, është ngritur edhe çështja e regjistrimit në UP të kandidatëve nga komuniteti ashkali. Rektori ka shpjeguar se kandidatët që i përkasin minoriteteve e kanë një kuotë të caktuar të vendeve në UP. Mirëpo, në asnjë rast nuk do të mund të regjistrohen kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet minimale, përkatësisht nuk arrijnë të kalojnë pragu prej 30% të testit pranues.

Avokati i Popullit konstaton se kërkesa që kandidatët e këtyre kategorive të pranohen pavarësisht rezultateve të treguara në testin pranues apo pavarësisht aftësive të tyre, është e papranueshme, pasi që sipas kushtetutës dhe ligjeve të aplikueshme në Kosovë, të gjithë janë të barabartë para ligjit, kushtetuta përcakton detyrimin që institucionet publike t’i sigurojnë

²¹⁰ LAP, rasti *ex officio* nr. 518/2014. Në muajin shkurt 2015, Avokati i Popullit ka nxjerrë Raportin me rekomandime për palët dhe institucionet përgjegjëse në lidhje me këtë çështje. Deri në mbyllje të këtij raporti, përveç Rektorit të UP “Hasan Prishtina”, asnjëra nga institucionet përgjegjëse nuk është përgjigjur në rekomandimet e Avokatit të Popullit. Qeveria e Kosovës dhe Ministria përkatëse (MASHT) kanë dështuar plotësisht të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit në lidhje me këtë çështje.

²¹¹ Letra e rektorit të UP “Hasan Prishtina” dërguar Avokatit të Popullit, në të cilën ai konfirmon se “[r]ritja eventuale e numrit të studentëve do ta rëndonte procesin mësimor i cili po zhvillohet në mungesë të infrastrukturës hapësinore e laboratorike”.

²¹² Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 5.

²¹³ Deklarata e Avokatit të Popullit, data 3.12.2014, në: <http://www.ombudspersonkosovo.org/sq/lajme/DEKLARATE-E-AVOKATIT-TE-POPULLIT-LIDHUR-ME-REGJISTRIMIN-E-FEMIJEVERE-TE-KATEGORIVE-TE-DALA-NGA-LUFTA-E-UÇK-se-NE-UNIVERSITETIN-E-PRISHTINES-1304>.

²¹⁴ LAP, rasti A. nr. 522/2014.

mundësi të barabarta arsimimi çdo personi sipas aftësive dhe nevojave të tij/saj.²¹⁵ Caktimi i kuotave për kategori të caktuara, nuk përbën kërkesë për pranim me automatizëm në bazë të përkatësisë së grupit të beneficuar, por në radhë të parë përbën një veprim të vullnetit të mirë për favorizim të grupeve të caktuara shoqërore në rast se i takojnë grupeve më të cenuara, për shkak të rrethanave të caktuara në të kaluarën por edhe tani.

Rekomandime:

- *Institucionet përgjegjëse komunale të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe ngritjen e infrastrukturës fizike të shkollave para fillimit të vitit shkollor.*
- *Komunat të ndajnë një buxhet të veçantë për sigurimin e transportit për fëmijët me nevoja të veçanta.*
- *Të gjitha institucionet përgjegjëse të zbatojnë me përpikëri Protokollin për Parandalimin dhe Refërimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar.*
- *DKA-të, gjatë hartimit të konkurseve dhe kriterëve për punësim, të hartojnë kriteret e cilat nuk bien në kundërshtim me ligjin, në mënyrë që të gjithë kandidatët të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit.*
- *MASHT në bashkëpunim me institucionet tjera përgjegjëse, të angazhohen për themelimin e një regjistri për të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta në Kosovë.*
- *Bartësit e arsimit të lartë në Kosovë, në vend të ushtruesve të detyrës së rektorit dhe prorektorit, sa më parë të zgjedhin rektorët dhe prorektorët në universitetet publike.*
- *Qeveria e Republikës së Kosovës dhe MASHT-i, të respektojnë autonominë e bartësve të arsimit të lartë publik.*

2.16. E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit është një nga të drejtat themelore të njeriut, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,²¹⁶ si dhe me instrumentet ndërkombëtare më të rëndësishme të zbatueshme në Republikën e Kosovës.²¹⁷

2.16.1. Ankesat e regjistruara në IAP

Me pretendimin se është shkelur e drejta e marrëdhënies së punës, për vitin 2014, IAP ka regjistruar 379 ankesa të qytetarëve. Prej tyre 297 ankesa janë vendosur si të papranueshme, ndërsa 82 prej tyre janë hapur për hetime.

²¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 47, paragrafi 2; Ligji për Arsimin e Lartë, neni 2, paragrafi 1.3.

²¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 49.

²¹⁷ Po aty, neni 22.

Avokati i Popullit, vëren se ankesat e pranuarat si për sektorin publik ashtu edhe atë privat kanë të bëjnë me: pohimet për shkelje të procedurave të punësimit; të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë jo ligjore; kohëzgjatjen e orarit të punës; kompensimin jashtë orarit; mos shfrytëzim të së drejtës për pushim vjetor apo të pushimit të lehonisë; mos realizim të së drejtës në pagë.

Në njërën nga ankesat e pranuarat në IAP, kundër DKA në Gjakovë, lidhur me konkursin e shpallur nga DKA për pozitën e lirë të punës mësimdhënëse për lëndën e biologjisë në Gjimnazin "Hajdar Dushi" në Bishatzhin.²¹⁸ Ankuesi pohon se ai ishte i vetmi kandidat i cili i plotësonte kriteret sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT 09/2014, prandaj pretendon se DKA qëllimisht e ka gabuar emrin e tij në listat e publikuara për intervistë, duke e përfshirë në listën e ngushtë personin inekzistent, për t'ia pamundësuar ankuesit të marrë pjesë në intervistë. Një qasje e tillë e DKA-së lë hapësirë për dyshime në procesin e rekrutimit.²¹⁹

Në IAP është regjistruar ankesa e parashtruesit, kundër Shkollës së Mesme Teknike "Mithat Frashëri" në Gurrakoc, komuna e Istogut, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në këtë shkollë, pa paralajmërim. Bazuar në pohimet e ankuesit, ai ka punuar në Shkollën e Mesme Teknike "Mithat Frashëri" në Gurrakoc, në paralelet e ndara në Rudina të Dubravës, prej vitit 2002 deri më 4 shtator 2014, kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës pa paralajmërim, veprim ky i cili bie ndesh me procedurat e ligjore të marrëdhënies së punës.²²⁰

2.16.2. Mbrojtja dhe siguria në punë

Edhe pse mbrojtja dhe siguria në punë është e garantuar me dy ligje në fuqi: Ligjin e punës²²¹ dhe Ligjin për Sigurinë dhe shëndetin në punë,²²² gjatë kësaj periudhe janë shënuar raste të vdekjes së punëtorëve dhe të lëndimit të tyre në vendin e punës. Për Avokatin e Popullit është një shqetësim serioz, veçanërisht mungesa e hetimit të rasteve nga Inspektorati i Punës dhe organet hetuese, si dhe mosndëshkimi i punëdhënësve për shkak të mos sigurimit të punëtorëve dhe vendeve të punës. Gjatë periudhës së raportimit, sipas të dhënave zyrtare në Kosovë 8 persona kanë humbur jetën në vendin e punës, ndërsa 52 të tjerë kanë pësuar lëndime.²²³

Rekomandimet:

- ***Inspektorati i Punës të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të Ligjit të punës dhe Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe të marrë masa të duhura ligjore për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve.***
- ***Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale së bashku me Inspektoratin e Punës, të ndërmarrin masa për parandalimin e dukurisë së punës së fëmijëve, duke hartuar programe konkrete për kthimin e tyre për procesin e rregullt mësimor.***

²¹⁸ LAP, rasti A.nr. 486/2014.

²¹⁹ Udhëzimi Administrativ i MASHT-it 09/2014, neni 8 paragrafi 2 "Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi".

²²⁰ LAP, rasti A. nr. 542/2014.

²²¹ Ligji i Punës nr.03/L-212, neni 42, paragrafët 1 dhe 2.

²²² Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë, nr. 04/L-161.

²²³ Intervistë me z. Basri Ibrahim, Kryeinspektor në MPMS të Republikës së Kosovës, më 12 dhjetor 2014.

2.17. E drejta e qasjes në dokumente publike

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën e qasjes në informacione publike me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj,²²⁴ ndërsa LQDP qartë i definon të drejtat e qytetarëve për qasje në dokumente publike.²²⁵

E drejta e Qasjes në Dokumente Publike përfshin të drejtën që ka çdo person për të njohur përmbajtjen e dokumenteve që prodhohen dhe mbahen nga autoritetet publike, përcakton dhe vendos rregulla për mirëfunksionimin dhe transparencën e administratës publike në raport me publikun në lidhje me veprimtarinë e saj.

Qarkullimi i lirë i informacionit është mjet i rëndësishëm për ndërtimin e besimit mes institucioneve dhe qytetarëve, për të krijuar transparencë të veprimeve, efikasitet dhe efektivitet të administratës publike, për ndërgjegjësim reciprok të qytetarëve për shërbimet që i pret nga administrata dhe i administratës për detyrimet e saj për ofrimin e shërbimeve qytetarit.

2.17.1. Mangësitë e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike

Edhe në raportin e vitit të shkuar është theksuar se LQDP përmban mangësi që e bëjnë këtë ligj vështirë të zbatueshëm. Ligji nuk e specifikon qartë se cila është Gjykata kompetente apo edhe institucionet e tjera publike, për trajtimin e rasteve që lidhen me mohimin e të drejtës për qasje në dokumente publike. Neni 10 i Ligjit në të cilin flitet për rastet e mos përgjigjes së institucionit publik, theksohet vetëm se: *“Refuzimi i kërkesës së kërkuarit, si dhe mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuarit që të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi.”*

Përveç se i njëj të drejtën kërkuarit që *“[...] të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi”*, ligji nuk përcakton shprehimisht se cilat janë *‘institucionet tjera publike’* me fuqi ekzekutive, që mund të obligojnë përgjegjësit në kuadër të këtyre institucioneve për të respektuar dhe zbatuar të drejtën e garantuar për qasje në dokumentet publike.

Lista e përjashtimeve të së drejtës së qasjes në dokumente që është përmbledhur në nenin 12 të LQDP, po ashtu përbën një kufizim jashtëzakonisht elastik, që i lë fushë relativisht të madhe për interpretim arbitrar personit përgjegjës në institucionin përkatës.²²⁶ Në këtë rast,

²²⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 41.

²²⁵ Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), neni 4.

²²⁶ Po aty, “1. Çdo kërkuar ka të drejtë të ketë qasje në dokumente publike. Kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së:

- 1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;
- 1.2. sigurisë publike;
- 1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale;
- 1.4. hulumtimeve disiplinore;
- 1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike;

mundësia e interpretimit arbitrar është aq e madhe, saqë çdo kërkesë për dokumente publike mund t'i mvishet një kufizim. Kufizimet për realizimin e kësaj të drejte janë shumë të konkretizuara, me kufij jashtëzakonisht elastikë në kuptimin negativ.

Bazuar në praktikën e këtyre viteve, duket se vazhdon të jetë mjaft dekurajuese për qytetarët që t'i drejtohen gjykatës për të realizuar të drejtën e tyre për qasje në dokumente publike, për shkak të zvarritjes së procedurave gjyqësore. Nga të dhënat dhe informatat që posedon Avokati i Popullit, as në vitin 2014 nuk ka asnjë vendim gjykate në Republikën e Kosovës në lidhje me ndonjë rast që ka të bëjë me qasjen në dokumente publike.

2.17.2. Afatet për përgjigje dhe vonesat e institucioneve përgjegjëse

Numri i ankesave të paraqitura në IAP, përkitazi me mohimin e qasjes në dokumente publike, për vitin 2014 është 40. Nga ky numër i përgjithshëm i ankesave, për 28 raste janë zhvilluar hetime, ndërsa ankesat tjera janë shpallur të papranueshme në fazën e shqyrtimit, bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit. Bazuar në numrin e përgjithshëm të ankesave drejtuar në IAP në vitin 2014, vërehet një rritje krahasuar me numrin e ankesave të parashtruara në vitin paraprak.

Avokati i Popullit gjatë këtij vitit të raportimit vëren se në të shumtën e rasteve institucionet vonohen në kthimin e përgjigjeve brenda afateve të përcaktuar më ligj.²²⁷ Nga diskutimet e ndryshme profesionale është vlerësuar se afati shtatë ditor për të ofruar qasje në dokumentet e kërkuara është i shkurtër. Mirëpo, lidhur me të drejtën e publikut për të marrë informacione, brenda një afati të arsyeshëm, Avokati i Popullit vlerëson të paevitueshëm dhe vendimtar mendimin e GJEDNJ-së, që vonesat në dhënien e informatës mund t'i heqin në mënyrë të pashmangshme të gjithë vlerën informatës dhe interesimin lidhur me të,²²⁸ *“Sepse një lajm përbën një shërbim që ikën shpejt dhe vonimi i botimit të tij, edhe për një periudhë të shkurtër kohore, mund t'i mohojë këtij lajmi të gjithë vlerat dhe interesin.”*²²⁹

1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat;

1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike;

1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;

1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;

1.10. mjedisit, apo,

1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje.

2. Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin.”

²²⁷ *LQDP*, neni 7 paragrafi 8 “Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj”.

²²⁸ Rasti *The Sunday Times V. The United Kingdom*, (Application no. 13166/87), 26 nëntor 1991.

²²⁹ *Liria e Shprehjes*, Një udhëzues për implementimin, e Nenit 10 të KEDNJ, fq, 21, paragrafi 34, Rasti *The Sunday Times V. The United Kingdom*, (Application no. 13166/87), 26 nëntor 1991 dhe Rasti *Observer And Guardian V. The United Kingdom*, (Application no. 13585/88), 26 nëntor 1991.

2.17.3. Mbrojtja e privatësisë dhe e të dhënave personale

Në trajtimin e rasteve, dokumentet e kërkuara janë të natyrave të ndryshme. Përderisa ligji jep më shumë specifika që i rezervojnë kompetencë autoriteteve që të refuzojnë qasjen ankuesve/kërkuesve të informatave, kur kjo ka të bëjë me elemente të sigurisë në vend, mbetet jashtëzakonisht e diskutueshme pjesa kur preken elementet e privatësisë dhe të dhënave personale. Është një vijë e hollë që ndan këto dy të drejta dhe balancimi i tyre në zgjidhjen e rasteve, duke ruajtur privatësinë, pa dëmtuar të drejtën e qasjes në dokumente zyrtare, është një sfidë e vazhdueshme gjatë trajtimit të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Në mars të vitit 2014, një OJQ parashtrroi ankesë në IAP në lidhje me mos pranimin e përgjigjeve nga 7 komunitat e Kosovës (Prizren, Lipjan, Shtërpçë, Mamushë, Klllokot, Partesh dhe Klinë). Kërkesa konsistonte në qasjen në informata dhe në të dhënat jopersonale nga raporti vjetor i ngarkesës dhe inkasimit të tatimit në pronë nga viti 2012. Edhe pse kjo OJQ nuk është dëshmuar korrekte në lidhje me bashkëpunimin me IAP, duke mos e njoftuar atë në lidhje me përgjigjet që kishte pranuar nga disa nga komuna, këto kërkesa nxorën në pah veprime që bien ndesh me mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve nga organet e administratës komunale dhe mospërgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj. Në përgjigjet e tyre disa nga këto komuna ofruan listën e plotë me emra, adresa, detyrime dhe të dhëna tjera pa asnjë lloj kufizimi, që objektivisht janë shkelje e së drejtës në privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

2.17.4. Mohimi i paarsyetuar i qasjes në dokumente publike

Në dhjetor 2014 Avokati i Popullit hartoi një raport me rekomandime të cilin ia drejtoi MBPZHR lidhur me mohimin e të drejtës për qasje në dokumentet publike duke konstatuar shkelje të ligjit. Bazuar në Ligjin për qasje në dokumente publike njëra nga OJQ-të i ishte drejtuar ministrisë, me kërkesë për qasje *“Në listën e OJQ-ve, që ju janë dhënë donacione”*, e cila në bazë të kërkesës duhet të përmbante të dhënat *“Për çka janë dhënë donacionet, titulli i projektit, nga kush është realizuar projekti, dhe sa është shuma financiare që është ndarë për secilën OJQ, dhe secilin projekt”*. Në këtë rast ministria nëpërmjet një shkrese kishte njoftuar subjektin e kërkesës se kërkesa e saj është refuzuar, me arsyetimin se *“Bazuar në raportimet e mëhershme të OJQ-së... materialet zyrtare i trajton me qasje propagandistike dhe qëllime komerciale...”*.

Avokati i Popullit vlerësoi se një arsytim i tillë i ministrisë nuk ishte i mjaftueshëm, duke mos përfillur të drejtën e OJQ-së për qasje në informatat e kërkuara, duke mos i arsyetuar kufizimet për qasjen në dokumentet publike, esencën e së drejtës që kufizohet, rëndësinë e qëllimit të kufizimit, natyrën dhe vëllimin e kufizimit, raportin midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe shqyrtimin e mundësisë së realizimit të këtij qëllimi me kufizimin më të vogël.

Raportin me rekomandime Ministria e ka shpërfillur plotësisht deri tani, gjë që dëshmon qartë nevojën e ndryshimit të Ligjit për të veshur ndonjë institucion me fuqi ekzekutive me kompetencën për të detyruar shkelësit e së drejtës për qasje në dokumente publike që të respektojnë Ligjin dhe Kushtetutën.

2.17.5. Gjetja e punëve përgatitore të hartimit të Kushtetutës

Padyshim që njëra ndër çështjet më të rëndësishme që duhet të theksohet e që lidhet me qasjen e publikut në dokumentet publike, është kërkesa e Avokatit të Popullit dhe gjetja e dokumenteve të punëve përgatitore (*travaux preparatoires*)²³⁰ për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kërkesat e vazhdueshme nga GJKK, gjatë një periudhe prej më shumë se katër vite, për konsultim në rastet e trajtuara nga kjo gjykatë KI47/10, KO98/11 KO103/14 dhe KO119/14, nuk rezultuan të suksesshme, përderisa në media u raportua se këto dokumente gjenden të arkivuara dhe “pa pronar” në një objekt të Qeverisë.²³¹

Zbardhja e këtij informacioni shqetësues në media e ka detyruar Avokatin e Popullit të hapë rast *ex officio* në lidhje me këto dokumente me pesë qëllime kryesore: (1) për të konstatuar nëse është me bazë raportimi për ekzistencën dhe vendndodhjen, respektivisht arkivimin e këtyre dokumenteve në objektin e Qeverisë; (2) për të hetuar nëse ndonjë institucion ose organ i pushtetit shtetëror ka vepruar në kundërshtim me nenin 41, paragrafi 2 të Kushtetutës, e cila përcakton se “[d]okumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike[.]”; (3) për t’u siguruar që këto dokumente të dërgohen pa vonesë tek GJKK, në përputhje me kërkesat e vazhdueshme të kësaj Gjykate; (4) për të mundësuar qasje në *travaux preparatoires* nga IAP gjatë punës së vet, dhe; (5) për të publikuar dhe për të ruajtur këto dëshmi institucionale dhe historike të themelimit të Republikës së Kosovës, si për qytetarët e sotëm, ashtu edhe për brezat e ardhshëm.

Pas hulumtimit këmbëngulës dhe komunikimeve të suksesshme me zyrat përgjegjëse në Kuvend, Presidencë, Qeveri dhe Arkivin Shtetëror të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit, më 5 dhjetor 2014 ka marrë konfirmimin zyrtar që ZKM, e cila posedonte të gjitha dokumentet, i dërgoi të njëjtat në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës (AShAK) më 24 nëntor 2014, dhjetë ditë pas kërkesës së parë nga ana e Avokatit të Popullit.

Më 8 dhjetor 2014 Avokati i Popullit vizitoi Arkivin për të konfirmuar drejtpërsëdrejti ekzistencën dhe ruajtjen e këtyre dokumenteve. Në AShAK kanë shprehur përkushtimin e tyre për të dërguar, sa më shpejtë, pas sistematizimit arkivor, një kopje të të gjitha dokumenteve të kërkuara tek IAP, në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Nëpërmjet një deklaratë për media Avokati i Popullit njoftoi publikun se këto hetime kanë qenë të suksesshme dhe dokumentet e punëve përgatitore - *travaux preparatoires* - të Komisionit Kushtetues, tani janë gjetur dhe ndodhen në vendin e duhur e të sigurt. Po ashtu, nëpërmjet kësaj deklaratë, Avokati i Popullit u ka bërë thirrje të gjitha institucioneve përgjegjëse që të hetojnë arsyet dhe shkaqet e “humbjes” dhe moszbulimit të punëve përgatitore për këto gjashtë vite të fundit, dhe ato t’i bëjnë të njohura për publikun.

²³⁰ *Travaux preparatoires* janë të gjitha dokumentet e punuara, të grumbulluara dhe të ruajtura, të çfarëdo forme qofshin ato, gjatë procesit të hartimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nga Komisioni për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

²³¹ “Arkiva e draftimit të Kushtetutës në objekt të Qeverisë dhe ‘pa pronar’”, *Kosova Press*, 1 tetor 2014, në: <http://www.kosovapress.com/sq/nacionale/arkiva-e-draftimit-te-kushtetutes-ne-objekt-te-qeverise-dhe-pa-pronar-26024/> (15.12.2014).

Rëndësia e informimit në një shtet demokratik, theksohet në opinionin e GJEDNJ-së, sipas të cilit *“T’i mobosh publikut informacione mbi funksionimin e organeve të shtetit, do të thotë të shkelësh të drejtën themelore të demokracisë.”*²³²

Nisur nga nevoja e madhe që ka shoqëria kosovare për një administratë të përgjegjshme dhe transparente, Avokati i Popullit e konsideron të domosdoshme që për institucionet kompetente, në radhë të parë për Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, të nxjerrë këto

Rekomandime:

- *Të synohet shtimi i aktiviteteve për rritjen e vetëdijes për të drejtën e qasjes në dokumente publike, nëpërmjet fushatave informuese, që për synim do të kishin në rend të parë zyrtarët përgjegjës të institucioneve por edhe qytetarët në lidhje me këtë të drejtë.*
- *Shtimin dhe intensifikimin e trajnimeve të vazhdueshme të zyrtarëve, për të krijuar dhe trajtuar në mënyrë profesionale regjistrat e dokumenteve publike dhe për t’iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve me korrektësi dhe duke respektuar normat ligjore.*
- *Të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të filluar me amendamentimin e Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike, për ta bërë këtë ligj të qartë, të thjeshtë dhe të zbatueshëm.*
- *Të synohet krijimi i një mekanizimi me fuqi ekzekutive për trajtimin e ankesave që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike.*

2.18. Përgjegjësia për mjedisin jetësor

Përgjegjësia kushtetuese e të gjithëve për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm, cilësor dhe të sigurt për qytetarët e Kosovës dhe përafrimi gradual i një gjendjeje të përafërt me standardet mjedisore të Bashkimit Evropian, mbetet sfidë.

Edhe pse Kushtetuta e Republikës së Kosovës përgjegjësinë e secilit për mbrojtjen e mjedisit jetësor e ka kategorizuar në grupin e të drejtave të njeriut, mjedisi dhe mbrojtja e tij kanë vazhduar të mbeten jashtë prioritetëve të programeve qeveritare.

Mbrojtja e ambientit duke mos qenë një ndër prioritetet e Qeverisë ndikon në çështjet e shëndetit publik dhe cilësinë e jetës.²³³ Po ashtu edhe taksa ekologjike e mbledhur gjatë regjistrimit të veturave, nuk ka filluar të ndahet për fushën e mjedisit dhe vazhdon të mbetet edhe më tej si e hyrë në kundërshtim me qëllimin e mbledhjes së saj. Gjithashtu edhe

²³² Rasti *Observer And Guardian V. The United Kingdom*, (Application no. 13585/88), Partly Dissenting Opinion Of Judge Pettiti, Joined By Judge Pinheiro Farinha. “In this respect there was a violation of the right to receive information, which is the second component of Article 10 (art. 10). To deprive the public of information on the functioning of State organs is to violate a fundamental democratic right”.

²³³ *Kosovo Progress Report 2014*, pg. 4, “The lack of interest in the environment has become a serious issue for public health and the quality of life in Kosovo”.

bashkëpunimi ndërinstitucional, i organeve në mbrojtje të mjedisit, është duke ecur me hapa të ngadaltë.²³⁴

Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj të drejte, dhe reflektimin e saj të drejtpërdrejtë në të drejtën për jetë, të drejtën e privatësisë dhe gëzimit të shtëpisë, të drejtën familjare, të drejtën e pronës, shëndetin publik etj., shqetësues është zbatimi i zbehtë i legjislacionit mjedisor si nga qytetarët e po ashtu edhe nga institucionet.

Gjatë vitit raportues, IAP ka pranuar 22 ankesa lidhur me shkeljen e nenit 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “Përgjegjësia për mjedisin jetësor”,²³⁵ ndërsa për 10 prej tyre është vlerësuar se ka hapësirë për të zhvilluar hetime.

Zgjerimi i pakontrolluar urban, ndërhyrjet abuzuese, ndërtimet pa kriter, mosrespektimi i planeve rregulluese dhe normave të ndërtimit, humbja e tokave bujqësore, ndotja e ajrit, ujërave, shkatërrimi i sipërfaqeve pyjore, mosmenaxhimi i duhur i mbeturinave, dëmtimi dhe zhdukja e biodiversitetit, mungesa e sistemeve të mjaftueshme monitoruese, zhurma, mungesa e respektimit të parimeve bazë mjedisore, parimit të informimit, të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, të qasjes në drejtësi, janë problemet e shumta mjedisore që janë përcjellë edhe gjatë vitit 2014.

2.18.1. Ndotja e ajrit

E drejta e qytetarëve për mjedis të shëndetshëm ka vazhduar të cenohet nga ndotja e ajrit, nga prodhimtaria industriale, mjetet e vjetra të transportit, përdorimi i karburanteve të cilësisë së ulët, ndotja e pakontrolluar nga ndërtimi i rrugëve dhe objekteve në ndërtim, ushtrimi i veprimtarive të gurthyesve dhe guroreve, djegia e hamulloreve, mosmenaxhimi i duhur i deponive, mbeturinave urbane dhe industriale.

Bazuar në raportet e organeve kompetente, Kosova është duke u ballafaquar me ndotje të madhe të ajrit. Ka tejkalime me PM10 dhe PM2.5,²³⁶ me përkeqësim të situatës sidomos gjatë periudhës së dimrit, e që ndikohet nga shfrytëzimi i materialeve të ndryshme për ngrohjen. Ndotësit kryesorë janë KEK-u, komplekset industriale Trepça, Ferronikeli, Sharrceci, emisionet nga ngrohoret e Gjakovës dhe Mitrovicës. Ngrohitorja e Prishtinës ka shënuar përmirësim sa i përket ndotjes së ambientit pas fillimit të shfrytëzimit të sistemit të ngrohjes me avull nga termocentralet.

Monitorimi i cilësisë së ajrit, për arsye teknike nuk ka qenë i vazhdueshëm. Ndërsa mbikëqyrja e raporteve mbi shkarkimet e operatorëve është jo e kënaqshme. Informimi lidhur me cilësinë e ajrit mbetet ende i dobët.

²³⁴ *Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit*, 2.4. bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

²³⁵ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 52 [*Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor*], 1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.

²³⁶ *MMPH, Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit (AMM)*, Raport për gjendjen e mjedisit 2011-2012, f. 43.

2.18.2. Ndotja e ujit

E drejta e qytetarëve për ujë të pijshëm kualitativ dhe qasjes në sisteme të ujësjellësit, përmirësimi i mungesës së ujit,²³⁷ nuk ka shënuar ndonjë përmirësim të dukshëm. Në Kosovë vazhdon dhe është në rritje ndotja e lumenjve nga shkarkimi i pakontrolluar i ujërave të ndotura, të patrajtuara të kanalizimit, produkteve kimike dhe mbeturinave të amvisërisë dhe atyre inerte. Po ashtu, problem në vete mbetet shkatërrimi i shtretërve të lumenjve nga eksploatuesit e zhavorrit.

Administrimi, menaxhimi dhe zhvillimi i resurseve ujore, nuk është i kënaqshëm pjesërisht edhe për shkak të mungesës së mjeteve. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka vazhduar të ketë probleme me akumulimin e pagesave/mjeteve të destinuara për administrimin, menaxhimin dhe zhvillimin e resurseve ujore, si nga personat fizikë, po ashtu edhe nga ata juridikë, për shfrytëzimin e ujërave dhe shkarkimin e tyre.

2.18.3. Dëmtimi dhe shkatërrimi i tokës bujqësore dhe pyjeve

Ka vazhduar me intensitet të njëjtë, degradimi i sipërfaqeve tokësore nga ndikimi i aktiviteteve të njeriut. Parcializimi i tokës bujqësore, ndërrimi i pakontrolluar i destinimit të tokës nga bujqësore në ndërtimore, ndërtimet e paplanifikuara, mosmenaxhimi i deponive, deponitë e egra me mbeturina të ndryshme, eksploatimi i zhavorrit, shkarkimet e pakontrolluara, e kanë karakterizuar edhe këtë vit. Sipas të dhënave të MBPZHR-së llogaritet që në Kosovë gjatë një viti 400 hektarëve të tokës bujqësore u ndërrohet destinimi në tokë ndërtimore.²³⁸

Edhe pse Ligji Nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor, ka paraparë zonimin e parcelave, mos kompletimi i ligjit me akte normative përcjellëse, dhe mos sanksionimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa leje, ka ndikuar në humbjen e tokave bujqësore.

IAP, më 15.10.2014 organizoi tryezën me titull “Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor”, me fokus të veçantë në komunën e Obiliqit. Ky organizim, ndër të tjera kishte për qëllim të mblidhte për një diskutim të përbashkët qytetarët e afektuar nga ndotja dhe disa nga udhëheqësit e institucioneve përgjegjëse. Në tryezë u diskutua edhe shkarkimi i ujërave industriale nga KEK-u, mosmenaxhimi i deponisë së Mirashit dhe deponive industriale, dhe dëmtimi i tokave.

2.18.4. Planifikimi hapësinor

Qytetarët e Kosovës, kanë vazhduar të ballafaqohen me probleme pothuaj se të njëjta sa i përket planifikimit hapësinor. Edhe pse Ligji Nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor, është miratuar më 31 korrik 2013, MMPH nuk ka arritur ta kompletojë atë me akte nënligjore.²³⁹

²³⁷ Qendra Regjionale për Mjedis REC, Raporti i Gjetjeve nga Sondazhi për Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, Anketë e qytetarëve lidhur me problemet mjedisore, “44.15, e kanë konsideruar qasjen në ujë të pijshëm dhe ujësjellës si problemin kryesor mjedisor”.

²³⁸ MMPH, AMM, Raport për gjendjen e mjedisit 2011-2012, f. 73.

²³⁹ Ligji Nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor, neni 2: “Qeveria dhe Ministria nxjerrin akte nënligjore që kërkohen me këtë ligj dhe i harmonizon aktet nënligjore ekzistuese brenda një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Neglizhimi i respektimit të rregullave për krijimin e mjediseve urbane, dështimi i organeve kompetente për të parandaluar, kontrolluar dhe zvogëluar ndikimin negativ në mjedis, në Kosovë ka shkaktuar krijimin e një mjedisi kaotik, të pa-sigurt, të pa-shëndetshëm, me ndikim të drejtpërdrejt në të drejtat e qytetarëve.

Ligji Nr. 04/L-110 për ndërtim, obligon nxjerrjen e Kodit Unik të Ndërtimit, por edhe pas dy viteve pritje ai ende nuk është miratuar. Të drejtat e njeriut kanë vazhduar të cenohen nga ndërtimet në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë, në veçanti ndërtimet e larta, pa hapësira të mjaftueshme në mes të objekteve, tejkallimet nga vija rregulluese dhe vija e ndërtimit, tejkallimet horizontale dhe vertikale të objekteve, ndriçimi dhe ventilimi joadekuat, mungesa e shkallëve emergjente, e hapësirave për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, e masave të sigurisë së jetës dhe pronës nga zjarri, mungesa e hapësirave përcjellëse, parkingjeve dhe garazheve, në veçanti hapësirave të gjelbra, si dhe mangësitë tjera që i atribuohen mjedisit ndërtimor.

Zhvillimi i pa kriter, ka ndikuar në krijimin e një mjedisi të pa sigurt, të pa shëndetshëm dhe kufizimin të lirisë së lëvizjes së qytetarëve. Edhe këtë vit nuk është shënuar ndonjë përparim në përmirësimin e hapësirave dhe shtigjeve për lëvizjen e papenguar të qytetarëve.

Mungesa e trotuareve/shtigjeve për këmbësorë, e sidomos mungesa e infrastrukturës, zaptimi i trotuareve në forma të ndryshme që është pengesë e pakalueshme për persona me aftësi të kufizuara, gjerësia joproportionale e trotuareve me numrin e banorëve, mungesa e lidhjes me rrugët e qarkullimit kryesor, barrierat e vendosura në mënyrë arbitrare, mospërkrahja e objekteve në ndërtim, dhe vendosja e materialit ndërtimor, e mallrave pranë dyqaneve, gropat, mungesa e kapakëve/mbulesave të pusetave, mungesa e parkingjeve publike, janë disa nga problemet e identifikuar edhe këtë vit me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e qytetarëve.

2.18.5. Problemet me menaxhimin e mbeturinave

Mbulimi i të gjitha hapësirave publike në Kosovë me mbeturina, të cilat hidhen nga vetë qytetarët e pandërgjegjshëm, por dhe nga kompanitë e ndryshme, është një problem tepër i rëndë dhe që kërkon veprim urgjent të shtetit. Problemet rreth menaxhimit të mbeturinave nuk kanë shënuar përmirësim. Po ashtu, probleme akute janë edhe rrjedhja e ujërave të deponive dhe depërtimi i tyre në ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

Nga të dhënat zyrtare janë identifikuar rreth 400 deponi ilegale me sipërfaqe të përgjithshme prej 301.18 ha.²⁴⁰ Problem më vete është edhe hedhja e mbeturinave, sidomos atyre inerte në lumenj. Në anën tjetër, nuk është vërejtur vullnet për ndërmarrjen e veprimeve për fillimin e ndarjes, klasifikimit, riciklimit dhe ripërdorimit të mbeturinave.

2.18.6. Ndikimi i ndotjes së mjedisit në shëndetin e njeriut

Sipas një studimi për ambientin ndotja e ajrit shkakton 835 vdekje të parakohshme, 310 raste të reja të bronkitit kronik, 600 shtrirje në spital, dhe 11.600 vizita emergjente mjekësore.²⁴¹

²⁴⁰ MMPH, AMM, Raporti “Mbeturinat dhe Kimikatel”, f. 37.

²⁴¹ 241Kosovo Country Environmental Analysis Cost Assessment of Environmental Degradation, Institutional Review, and Public Environmental Expenditure Review, World Bank, January, fq 10.

Ndikimi i ndotjes së ajrit, dhe i pirjes së duhanit, është duke ndikuar në probleme kardiovaskulare, malinje dhe të organeve respiratore.

Sipas një hulumtimi, numri i fëmijëve 5-vjeçarë me probleme të organeve respiratore, në komunën e Obiliqit, është dyfish më i lartë se në komunën e Pejës. Ndërsa, sipas një hulumtimi 5-vjeçar, numri i të sëmurëve duhanpirës, nga sëmundjet malinje në Prishtinë, është dy herë më i madh në krahasim me atë në Prizren.²⁴²

Është brengosës fakti i mangësive që i atribuohen planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës teknike, si dhe ndikimi i tyre në shëndetin e qytetarëve, nga mungesa e hapësirave për aktivitete fizike e rekreative, dhe pengesave për lëvizjen/ecjen e këmbësorëve.

Shqetësues për Avokatin e Popullit është mjedisi i krijuar nga mungesa e hapësirave të gjelbra, shtigjeve për ecje, hapësirave rekreative dhe ndikimi në mirëqenien fizike dhe psikike të fëmijëve, e sidomos pamundësinë e qarkullimit të personave me aftësi të kufizuara.

Edhe pse Kosova vazhdon të mos jetë palë e konventës Aarhus, parimi i informimit është i integruar në legjislacionin mjedisor. Në shumë objekte në ndërtim, mungojnë tabelat informuese, si formë e veçantë e informimit mjedisor, e sidomos mungon qasja në të dhënat lidhur me shkarkimet e operatorëve të mëdhenj. Vështirësimin e qasjes në informata mjedisore, e ka përkrahur edhe kategorizimi i informacionit mjedisor, në grupin e informacioneve të kufizuara me LQDP.²⁴³

Duke u bazuar në të dhënat e raportit, Avokati i Popullit, me qëllim të krijimit të një mjedisi të shëndetshëm për popullin e Kosovës, sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, shfrytëzimit racional të resurseve natyrore dhe kufizimit të emisioneve, shkarkimeve të ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin, përmirësimin e mjedisit të dëmtuar, bashkërendimin e veprimtarive shtetërore, nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtari të mbrojtjes së mjedisit, promovimin e rëndësisë për informacion mjedisor

Rekomandon:

- *Të ndërmerren fushata të vazhdueshme për informim të publikut me qëllim të vetëdijesimit lidhur me ruajtjen e ambientit.*
- *Të koordinohen veprimet e policisë, gjykatave dhe inspektorëve mjedisor, për parandalimin e eksploatimit të lumenjve nga personat e pandërgjegjshëm dhe në kundërshtim me ligjin.*
- *Të ndërmerren masa nga institucionet përgjegjëse për ruajtjen e tokave bujqësore nga ndërrimi i destinimit të pakontrolluar në tokë ndërtimore.*
- *Të ndërmerren masa për sanimin e pasojave të ndërtimeve pa kriter dhe pa leje.*
- *Organet kompetente të zbatojnë me përpikëri nenin 12, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 04/L-188, për trajtimin e ndërtimeve pa leje, që në fazën e inspektimit të ndërtimit pa leje të refuzojnë Aplikimet për Leje për legalizim në rastet e parapara me ligj;*

²⁴² Dr. Gazmend Zhuri në tryezën e IAP-së “Përgjegjësia për mjedisin jetësor” me fokus të veçantë në komunën e Obiliqit, më 15 tetor 2014.

²⁴³ Ligji Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, neni 12 “Përjashtimet e së drejtës së qasjes në dokumente 1. Çdo kërkuar ka të drejtë të ketë qasje në dokumente publike. Kufizimi i kësaj të drejte ushtrohet proporcionalisht dhe vetëm për qëllime të mbrojtjes së [...]1.10. mjedisit”.

Pjesa e dytë - Diskriminimi

2.19. Barazia para ligjit

2.19.1. Zbatueshmëria e ligjeve

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton barazinë para ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim.²⁴⁴

Nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2014, në Departamentin kundër Diskriminimit (DKD) në IAP janë pranuar 65 ankesa të qytetarëve të Kosovës, qofshin ankesa individuale apo sipas detyrës zyrtare, në të cilat pretendohet se janë shkelur të drejta të mbrojtura me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, që kanë të bëjnë me barazinë para ligjit. Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me diskriminim në sferën sociale, shëndetësore, pronësore, marrëdhënie pune.

Ligji kundër Diskriminimit, edhe përkundër faktit që ka kaluar nëpër faza të plotësim ndryshimit, ende nuk ka arritur të miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit ka rekomanduar ndryshimet në këtë ligj edhe në raportet vjetore paraprake.²⁴⁵ Bazuar në përvojën e deritashme, pikërisht për shkak të mangësive të theksuara vazhdon të ketë një moszbatim të Ligjit kundër Diskriminimit. Deri më tani IAP ka të njohur vetëm një rast të trajtimit të rasteve të diskriminimit të trajtuar nëpër gjykata.²⁴⁶

2.19.2. E drejta e punës dhe diskriminimi në moshë

Ashtu siç është raportuar edhe në raportin paraprak, në IAP ka të regjistruara raste për të cilat MPMS, ka lidhur marrëveshje me KEK-un për punësim të 100 punëtorëve të cilët janë të përfshirë në skemën sociale.²⁴⁷ Pas fazës së testimit dhe pas lajmërimit të kandidatëve se janë pranuar në punë nga Korporata Energjetike e Kosovës, ata janë ri-lajmëruar se nuk mund të fillojnë punën sepse nuk e plotësojnë kriterin e moshës, sipas marrëveshjes midis tyre dhe MPMS.

Në raportin vjetor paraprak Avokati i Popullit, ka raportuar se MPMS, nuk i është përgjigjur letrave të Avokatit të Popullit, lidhur me këtë çështje, prandaj më 27 shkurt 2014, Avokati i Popullit ka publikuar Raport me rekomandim për MPMS lidhur me diskriminim në moshë,²⁴⁸ por deri më tani IAP nuk ka pranuar asnjë informacion zyrtar për zbatimin e rekomandimeve.²⁴⁹

Avokati i Popullit, po ashtu përmes raportit *ex-officio*, ka ngritur çështjen e funksionimit të Këshillit Ekonomiko-Social (KES), si dhe ka vlerësuar se mosshtrimi i kompetencave nga

²⁴⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24.

²⁴⁵ Shih: Raportet vjetore të Avokatit të Popullit, 2010, 2011, 2012, 2013 - Barazia para ligjit.

²⁴⁶ LAP, rasti *ex officio* A. nr. 170/2010.

²⁴⁷ LAP, rastet A. nr. 454/2013, A. nr. 449/2013 dhe A. nr. 566/2013.

²⁴⁸ IAP, Raporti vjetor 2013, <http://www.ombudspersonkosovo.org>

²⁴⁹ IAP, Raport me rekomandim për MPMS, në lidhje me rastet A. nr. 454/2013, A. nr. 449/2013 dhe A. nr. 566/2013.

KES-i, sipas Ligjit për Këshillin Ekonomik Social, ka implikime negative në realizimin e të drejtave të të punësuarve në sektorin publik dhe privat.²⁵⁰ Pas rekomandimeve të Avokatit të Popullit drejtuar ministrive përkatëse, KES ka arritur të harmonizojë qëndrimet në lidhje me një dokument shumë të rëndësishëm në fushën e punësimit, Kontratën Kolektive²⁵¹

Në kuadër të fushatës “Njihuni me të Drejtat Tuaja”, IAP ka vizituar shkolla fillore dhe të mesme nëpër pothuaj të gjitha komunat e Kosovës. Gjatë vizitës është hasur në raste të diskriminimit. Një rast i tillë i diskriminimit është evidentuar në paralelen e ndarë të shkollës fillore “Migjeni” në fshatin Shipitullë. Edhe përkundër faktit që Ligji i punës, neni 20.2 parasheh që orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, punëtori teknik në këtë shkollë punon 72 orë në javë pa kompensim.

2.19.3. Personat me aftësi të kufizuara (PAK)

Përkundër faktit që personave me aftësi të kufizuara kanë nevoja të veçanta për jetesë, ata edhe më tej vazhdojnë të përfshihen në një kategori me kompensim material jopërkatës, sipas Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë. Në raportet vjetore paraprake, Avokati i Popullit ka rekomanduar nxjerrjen e një ligji i cili do të caktonte kategorizimin me shkallën objektive të aftësisë së kufizuara, por deri më sot Qeveria e Kosovës nuk ka ndër marrë asnjë veprim në këtë drejtim.²⁵²

2.19.4. Infrastruktura ligjore dhe zbatimi i saj në praktikë

Kosova ka një infrastrukturë të kënaqshme ligjore për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK), megjithatë vihet në pikëpyetje sa këto ligje janë të zbatueshme dhe në përputhje me nevojat e kësaj kategorie të shoqërisë sonë.

Ligji Nr. 04/L-092 për personat e verbër, në raport me ligjet tjera të cilat e rregullojnë çështjen e aftësisë së kufizuara është më i avancuar dhe do të duhej të shërbente si model për ligjet tjera që gjithashtu e rregullojnë pozitën e PAK. Megjithatë, është shqetësues fakti i mospagesës së pjesës së mbetur retroaktive për personat e verbër për vitin 2013. Ky shqetësim është ngritur nga Shoqata e të Verbërve dhe me të Parë të Dobësuar e Kosovës.

IAP ka bashkëpunim të mirë me OJQ të cilat i përfaqësojnë interesat e PAK. IAP në vazhdimësi shkëmben informata me këto organizata të cilat i përfaqësojnë interesat e PAK. Gjatë këtij viti raportues janë ngritur shqetësime nga këto organizata pothuajse në të gjitha sferat ku PAK ballafaqohen me problemet e tyre. Një ndër shqetësimet është çështja e avancimit të legjislacionit për përkrahjen materiale të PAK.

Bazuar nga të dhënat të cilat i posedon IAP, ligje të veçanta që i përkasin veçanërisht kësaj kategorie dhe që vihet në pikëpyetje zbatueshmëria e tyre janë: Udhëzimi Administrativ nr. 09/2010, për përcaktimin e vendeve të punës dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me aftësinë e tyre për punë, Ligji Nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me

²⁵⁰ IAP, rasti *ex officio* A. nr. 402/2013.

²⁵¹ IAP, *Përgjigje nga Këshilli Ekonomiko-Social*.

²⁵² IAP, *Raporti vjetor* për vitin 2013, fq. 112; IAP, *Raporti vjetor* për vitin 2011, fq. 22.

Aftësi të Kufizuara në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-110 për ndërtim dhe Udhëzimi Administrativ nr. 2007/33 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasje të personave me aftësi të kufizuara.

Ligji për punësimin e PAK i cili përcakton se institucionet me rastin e tejkalimit të numrit të 50 të punësuarve është i obliguar që të sigurojë edhe punësimin e një personi nga kjo kategori, nuk është duke gjetur zbatim në praktikë.

Ligji Nr. 03/L-022 për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, parasheh që fëmijët nën moshën 18-vjeçare të kenë përkrahje materiale në vlerë prej 100 eurosh. Pas moshës 18-vjeçare PAK trajtohen me Ligjin nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë me mbështetje financiare prej 75 euro.

Me këtë rast edhe pse nevojat financiare janë në rritje për PAK, shumica e mbështetjes bie për 25 euro. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës edhe përkundër rekomandimeve të Avokatit të Popullit në Raportet vjetore paraprake, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të plotësuar Ligjin nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, lidhur me kategorizimin e PAK sipas shkallës objektive të aftësisë së kufizuar.

Për IAP shqetësuese janë edhe rastet e rivlerësimit të PAK për të drejtën në pension. Edhe përkundër faktit se PAK kanë diagnozë të njëjtë dhe janë për një kohë të gjatë shfrytëzues të këtij pensioni, pas rivlerësimit nga ana e komisionit mjekësor, ata nuk përfshihen në listën e përfituesve të pensioneve për PAK, sepse sipas vlerësimit të komisionit mjekësor ata nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara, duke mos arsyetuar mirë vendimet e tyre dhe duke shfrytëzuar një formë standarde pothuajse për të gjithë.

Sipas informatave të siguruar nga OJQ “Hendikos”, deri më tani shfrytëzues të pensioneve të PAK kanë qenë 27.000 persona, ndërsa tani janë 17.000. Kjo bën që PAK të dyshojnë në korrektësinë e punës së komisionit mjekësor. Gjithashtu nga “Hendikos” është shfaqur edhe shqetësimi se ligji për personat tetraplegjik dhe paraplegjik është edhe sot në Qeveri i papërfunduar. Këtë shqetësim e ka ngritur edhe Avokati i Popullit në raportet paraprake vjetore.

2.19.5. Kushtet për arsimin të PAK në shkollat publike

Sa i përket çështjes së arsimit edhe sot ka probleme në të gjitha fushat për gjithëpërfshirje. Qasja fizike e personave me aftësi të kufizuara nuk është e mundur nëpër shumë shkolla publike. Në Prishtinë janë vetëm tri shkolla, që vetëm pjesërisht i plotësojnë kushtet për qasje të lirë të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Avokati i Popullit ka vizituar shkollën fillore “Model”, në Prishtinë dhe shkollën fillore “Asim Vokshi” gjithashtu në Prishtinë. Këto janë shkolla që plotësojnë kushtet për PAK.

Avokati i Popullit përmes mediave audio-vizuale dhe të shkruara duke e ngritur si shqetësim këtë çështje ka kërkuar që të krijohen kushte në të gjitha shkollat për vijimin e mësimin për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit i viziton edhe qendrat burimore aty ku mësimin e ndjekin fëmijët me aftësi të kufizuar. Në raste të caktuara u rekomandon institucioneve përgjegjëse përmirësimin në rastet e shkeljeve të gjetura. Gjatë këtij viti raportues është publikuar informatori i IAP-së në alfabetin *Braille*.

2.19.6. Kufizimi dhe pengimi i lëvizjes së lirë për PAK

Një problem tjetër me të cilin ballafaqohen fëmijët me aftësi të kufizuar është edhe mungesa e transportit i cili nuk organizohet nga institucionet dhe kjo bën që shumë nga familjet të mos kenë mundësi materiale për t'i dërguar fëmijët në shkollë. Prandaj, përkundër faktit që arsimi fillor është i obliguar, kjo kategori e personave nuk arrin ta realizojnë këtë drejtë.

Çështja e lëvizjes së lirë të PAK vazhdon të mbetet problem edhe nëpër institucionet tjera publike, duke përfshirë edhe QKUK. Sipas informatave të cilat IAP i ka siguruar nga "Hendikos", ka raste kur mjeku është detyruar të dalë në oborrin e spitalit për ta kontrolluar pacientin në mungesë të qasjes në objekt për shkak të përdorimit të karrocës si mjet ndihmës për lëvizje. Ky rast është evidentuar në Klinikën e Dermatologjisë në QKUK.

Komuna e Prishtinës e ka kërkuar nga "Hendikos" listën e PAK të cilët jetojnë nëpër banesa kolektive për rregullimin e infrastrukturës për qasje të lirë. Por kjo ka mbetur si më parë sepse edhe sot nuk është ndërmarrë asgjë. Nismat e këtilla shpeshherë bëhen vetëm për qëllime propagandistike nga politikanët, sidomos në prag apo gjatë fushatave për qëllime zgjedhore.

Në shëndetësi PAK janë të liruar nga pagesa vetëm për kontrole mjekësore. Medikamentet janë të obliguar t'i sigurojnë vetë. Në listën esenciale nuk ka mjaftueshëm barëra për këtë kategori.

2.19.7. E drejta për arsimin

Kundër Rektoratit të UP-së janë parashtruar ankesa për diskriminim nga qytetarët e Kosovës. Parashtruesit e ankesave pohojnë se UP nuk i trajton në mënyrë të barabartë kandidatët për regjistrim në fakultete publike me gjeneratat paraprake.

Sipas reformave në arsimin e Kosovës në vitin 2014, është hequr klasa e 13, rrjedhimisht numri i të diplomuarve në arsimin parauniversitar për vitin 2014 është dyfishuar, sepse dy gjenerata diplomojnë në të njëjtën kohë, ndërsa numri i vendeve të lira për regjistrimin e studentëve të rinj në UP ka mbetur i njëjtë. Kjo ka bërë që konkurrenca për t'u regjistruar në fakultete publike ka qenë më e madhe, duke pasur parasysh se kandidatë për t'u regjistruar kanë qenë dy gjenerata, klasat e 12-ta dhe të 13-ta. Pas ankesës së një grupi nxënësish, Avokati i Popullit e ka ngritur këtë çështje pranë Rektoratit të UP-së dhe MASHT-it.²⁵³

Si përgjigje në letërën e Avokatit të Popullit, Rektorati i UP-së e ka shqyrtuar kërkesën e maturantëve për rritjen e numrit të studenteve për t'u regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë. Rektori i UP-së në këtë përgjigje ka pohuar se është e pamundur rritja e numrit të studentëve në UP, e posaçërisht në Fakultetin e Mjekësisë, për shkak se është jashtë kapaciteteve të

²⁵³ IAP, Rasti A. nr. 383/2014. Në IAP është pranuar ankesa nga një grup studentësh të cilët kanë aplikuar në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Prishtinës. Ankesën ata e kanë parashtruar kundër Rektoratit të UP-së lidhur me mos përgjigje në kërkesën e tyre për rritjen e numrit të studenteve, të cilët do të pranohen në Fakultetin e Mjekësisë, për shkak të faktit se këtë vit konkurrent për regjistrim ishin dy gjenerata të diplomuar në shkollë të mesme.

infrastrukturës–hapësirës, si dhe numrit të personelit akademik.²⁵⁴ Lidhur me këtë rast nga IAP është kontaktuar zyra ligjore në MASHT, ku është kërkuar informatë lidhur me veprimet paraprake të cilat i ka ndërmarrë kjo ministri para reformave në arsimin parauniversitar.

Nga MASHT-i, Avokati i Popullit ka pranuar informatë se në kuadër të reformave në arsimin parauniversitar, pothuajse në të gjitha qytetet e Kosovës janë hapur universitete publike. Kjo bën që UP të shkarkohet nga mbingarkesa e kandidatëve të interesuar për regjistrim. Përfaqësuesi i Zyrës Ligjore në MASHT ka njoftuar IAP-në se rritja e numrit të studentëve në UP bëhet me kërkesën e Rektoratit të UP-së, por një gjë e tillë në këtë vit akademik nuk është bërë.

Këtë vit raportues, IAP ka ngritur *ex officio* çështjen e vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të Ministrit të MASHT-it, nr. 178/01B, të datës 13 nëntor 2014, për regjistrimin e fëmijëve të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së në UP “Hasan Prishtina” në vitin akademik 2014/2015. IAP ka parashtruar kërkesë për masë të përkohshme lidhur me zbatimin e Vendimit nr. 178/01B, të datës 13 nëntor 2014, deri pas përfundimit të hetimeve në IAP, lidhur me ligjshmërinë e këtij vendimi.²⁵⁵ Me gjithë kërkesën dhe rekomandimin e Avokatit të Popullit, ky vendim vazhdon të jetë ligjërisht në fuqi.

2.19.8. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK)

Duke pasur parasysh faktin se shumë ish të punësuar nëpër ndërmarrje publike kanë mbetur pa punë edhe më tej vazhdojnë të mbeten pa mbështetje ligjore apo institucionale, çështja e privatizimit, si dhe procedurat para DHPGJSK, sipas pohimeve të ankuesve i kanë sjellë në pozitë diskriminuese në realizimin e të drejtave të tyre.

Në IAP, gjatë këtij viti raportues, janë pranuar ankesa të qytetarëve të Kosovës, lidhur me lartësinë e taksave gjyqësore për t’u parashtruar kërkesat e punëtorëve për shqyrtim nga DHPGJSK. Sipas pohimeve të ankuesve, taksa gjyqësore ka qenë e papërbalueshme dhe rrjedhimisht në shumë raste ka ndikuar që në mungesë të mjeteve financiare ish-punëtorët nuk kanë mundur të kërkojnë mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre të garantuara me kushtetutë dhe ligje. DHPGJSK, në emër të taksës gjyqësore, sipas vendimit nr. 25, të datës 5 mars 2014, të KGJK-së, nga punëtorët ka kërkuar pagesa fikse për taksa gjyqësore prej 100 eurosh, për çfarëdo padie kundër AKPv për çështje të të drejtave të punëtorëve, që rrjedhin nga procesi i privatizimit, edhe pse KGJK, me Udhëzimin Administrativ nr. 2008/02 i ka pasur të përcaktuara taksat gjyqësore, për procedurat në gjykatat e Republikës e Kosovës.²⁵⁶

Për të hetuar këtë rast Avokati i Popullit i është drejtuar me dy letra KGJK-së me kërkesën që taksat gjyqësore të mbesin sipas Udhëzimit Administrativ. Sipas përgjigjes së KGJK-së, theksohet se është rishikuar vendimi nr. 25, i datës 5 mars 2014, për taksat gjyqësore për DHPGJSK dhe është nxjerrë vendimi me nr. 97/2014, sipas të cilit është bërë unifikimi i taksave gjyqësore.²⁵⁷

²⁵⁴ IAP, Përgjigje nga Rekorati i UP-së.

²⁵⁵ IAP, Raport me rekomandim *ex officio* 518/2014.

²⁵⁶ IAP, rastet A. nr. 266/2014, A. nr. 265/2014 dhe A. nr. 294/2014.

²⁵⁷ Po aty.

2.19.9. Çështja e strehimit

Sikurse në raportet vjetore paraprake të IAP-së, shqetësuese mbetet gjendja e familjeve pa strehë të cilat, në pamundësi për të bërë zgjidhje vetanake për strehim, edhe më tej vazhdojnë t'u drejtohen komunave për të kërkuar ndihmë për strehim. Gjatë këtij viti raportues numri i ankesave lidhur me strehime në IAP, në raport me vitet paraprake, ka qenë më i vogël.

Komuna e Prishtinës, përveç ndërtimit të dy ndërtesave kolektive të cilat i kanë lëshuar në shfrytëzim në vitin 2012, ka në ndërtim e sipër edhe dy ndërtesa tjera të cilat u dedikohen rasteve sociale. Kontejnerët tek fusha e pajtimit edhe më tej vazhdojnë të jenë të mbushura me banorë të cilët jetojnë në kushte të cilat nuk përkojnë me jetë dinjitoze. Këto raste Avokati i Popullit gjithashtu i ka paraqitur edhe në raportet paraprake dhe përmes medieve.

Komuna e Prishtinës edhe gjatë këtij viti nuk ka arritur t'u garantojë qytetarëve taksapagues shfrytëzimin e lirë dhe të papengueshëm të pronave të tyre private dhe pronave publike. Në IAP vazhdon të mbetet e hapur ankesa e banorëve të cilët jetojnë në lagjen tek tregu i gjelbër në qendrën e qytetit të Prishtinës. Ankesa e qytetarëve është hapur si rast i veçantë në IAP pas një numri të shumtë ankesash dhe peticionesh të drejtuara në Komunë të Prishtinës por që asnjë herë nuk ka pranuar përgjigje.²⁵⁸

Rekomandim:

- *Qeveria e Kosovës të ndryshojë Ligjin nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, lidhur me kategorizimin me shkallën objektive të aftësisë së kufizuar, në mënyrë që kompensimi material i shfrytëzueseve të pensioneve të bëhet në përputhje me nevojat dhe kërkesat e aftësisë së kufizuar.*
- *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale t'i përgjigjet rekomandimeve të Avokatit të Popullit në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe Ligjin për Avokatin e Popullit.*
- *Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të sigurojë kushte për gjithëpërfshirje të nxënësve me aftësi të kufizuar në shkollim.*
- *Qeveria e Kosovës si dhe Inspektorati i Punës, të monitorojnë zbatimin e ligjit të punës sa i përket punësimit të PAK në kuotën 50+1 sipas këtij ligji.*
- *Qeveria e Kosovës dhe organet komunale, të bëjnë monitorimin si dhe zbatimin e Ligjit për ndërtim Nr.04/L-110 dhe Udhëzimin Administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasje të personave me aftësi të kufizuara – Nr.2007/33.*

²⁵⁸ IAP, A.nr. 494/2013. Ankuesit pohojnë se të gjithë banorët e kësaj lagje e kanë të pamundur zhvillimin normal të jetës në këtë lagje sepse po iu vështirësohet edhe liria e lëvizjes, si dhe shfrytëzimi i lirë i pronave të tyre për shkak të kaosit urbanistik të krijuar nga shitësit ambulantë në hapësirat publike konkretisht në rrugë, në hyrje dhe dalje të lagjes. Avokati i Popullit, përmes letrave të dërguara, e ka ngritur ankesën e banorëve të kësaj lagje edhe gjatë këtij viti raportues në komunën e Prishtinës, si dhe ka zhvilluar takime me Drejtorin e Inspektionit në Komunë. Në letrën e parë, Komuna e Prishtinës është përgjigjur, si jo kompetente për këtë çështje. Sipas Komunës së Prishtinës, tregu i qytetit bie nën kompetencë të AKPv-së.

2.20. Barazia gjinore

Edhe pse në Republikën e Kosovës është bërë një progres në arritjen e barazisë, gratë si kategori e cenueshme, vazhdojnë të përballen me shumë sfida dhe trajtim të pabarabartë dhe diskriminues në shumë aspekte.

Diskriminimi në bazë të gjinisë përfshin dallimin në trajtim, kufizimin ose përjashtimin në bazë të gjinisë. Një element bazë i një shoqërie demokratike është ekzistenca e ligjit i cili ndalon trajtimin e pabarabartë në baza gjinore. Ligji për Barazinë Gjinore është i domosdoshëm për eliminimin e fenomenit të trajtimit të pabarabartë të individëve të gjinive të ndryshme. Republika e Kosovës, në vitin 2004, e ka miratuar një ligj të tillë, mirëpo fatkeqësisht ai ka hasur në probleme të ndryshme gjatë zbatimit. IAP këto mangësi e probleme i ka paraqitur në vazhdimësi në raportet vjetore të viteve të kaluara. Ky ligj tani është në proces të plotësimit dhe ndryshimit për eliminimin e mangësive ligjore të evidentuara.

Përvoja shumëvjeçare në IAP tregon se gratë, në shumicën e rasteve, ankohen për problemet që lidhen me të drejtën në punë, statusin ekonomik, mbrojtjen shëndetësore, të drejtën në trashëgimi si dhe lidhur me dhunën në familje.

Gjatë vitit 2014, nga gratë në IAP janë regjistruar 507 ankesa, apo 23 % e të gjitha ankesave të paraqitura në vitin 2014 në IAP. Kjo shifër, që realisht nuk përbën as një të katërtën e ankesave të paraqitura në IAP, nuk është ndonjë risi. Ky trend i rënies së pjesëmarrjes së ankueseve femra në IAP, vazhdon tani e shumë vite. Edhe pse nuk është një numër i nxjerrë nga ndonjë hulumtim shkencor i arsyeve të kësaj përqindjeje të pjesëmarrjes në rënie të lehtë, në të vërtetë kjo përqindje është në korrelacion të drejtpërdrejtë me pjesëmarrjen e femrës në jetën publike në përgjithësi në Kosovë.

2.20.1. E drejta në punë dhe vendimmarrje

Roli i gruas në tregun e punës ka rëndësi shumë të madhe nga aspekti i barazisë gjinore. Pjesëmarrja e tyre është jashtëzakonisht domethënëse dhe njëkohësisht tregon shkallën e demokracisë së arritur në një shoqëri. Përfshirja e grave në jetën publike në përgjithësi, dhe në vendimmarrje në institucionet publike të nivelit politik në veçanti, nuk është e mjaftueshme.

Edhe pse në Kuvendin e Republikës së Kosovës përfaqësimi i grave është 30 % sipas kuotës gjinore, një gjendje e pafavorshme për gratë ekziston në Qeverinë e Kosovës, e cila në përbërjen e saj ka vetëm dy gra ministre. Ky fakt tregon se derisa përfaqësimi gjinor mund të jetë i mirë në letër, si normë ligjore, në realitet ekziston një dominim i madh i burrave në procesin politik dhe vendimmarrës. Kjo është në shpërpjesëtim të madh me përbërjen e popullsisë. Për këtë shkak, kuota gjinore si detyrim ligjor, duhet të ekzistojë edhe për një periudhë kohore si pjesë e legjislacionit të Kosovës, derisa të krijohet një kulturë e pjesëmarrjes së grave në pozitat udhëheqëse. Kuota gjinore mund të hiqet dhe të zëvendësohet me konkurrencën reale, vetëm kur pjesëmarrja e femrës në jetën publike dhe sidomos atë institucionale të jetë në përpjesëtim të drejtë me përbërjen reale të popullsisë. Kjo kuota duhet të aplikohet për të gjitha institucionet publike duke përfshirë edhe Qeverinë e Republikës së Kosovës.

2.20.2. E drejta e pronës dhe trashëgimisë

Barazia gjinore nënkupton një shoqëri në të cilën gratë dhe burrat gëzojnë të njëjtat të drejta dhe kanë të njëjtat obligime në të gjitha sferat e jetës. Megjithatë, të drejtat e grave mbetën ende një nga sfidat kryesore për zhvillimin e shoqërisë së Kosovës, në veçanti në lidhje me të drejtën e tyre për ta trashëguar pronën.

Edhe pse ekziston një infrastrukturë e mirë ligjore që garanton të drejta të barabarta në pronë dhe trashëgimi për të dyja gjinitë, në praktikë gratë në një përqindje shumë të vogël janë pronare të pronës së luajtshme dhe paluajtshme. Gjithashtu, ka shumë raste kur gratë përjashtohen nga familja dhe stigmatizohen nëse kërkojnë të realizojnë të drejtën në pronë familjare.

2.20.3. Ankesat në lidhje me të drejtën në pronë dhe trashëgimi

Në njërin nga rastet e regjistruara në IAP, ankuesja ka kërkuar monitorimin e rastit të saj në gjykatë, pasi që xhaxhai i saj i pamundëson që të bëhet pronare e shtëpisë të cilën babai i saj e kishte ndërtuar derisa ishte gjallë, në të njëjtin truall me xhaxhain. Ajo pohon se xhaxhai i saj ka deklaruar se ajo nuk mund të jetë trashëgimtare e pronës sepse, sipas së drejtës zakonore, gratë nuk gëzojnë të drejtën e trashëgimisë. Për këtë shkak, ankuesja ka parashtruar padi në gjykatë kundër xhaxhait, për pamundësimin e realizimit të drejtës së saj në pronë familjare. Rasti është në procedurë gjyqësore dhe IAP është në përcjellje të rastit.²⁵⁹

Në rastin tjetër të paraqitur nëpërmjet postës elektronike zyrtare, ankuesja kërkoi që të merrte një këshillë në lidhje me të drejtën e saj për trashëgimi, meqenëse ajo nuk ishte përfshirë në ndarjen e pasurisë trashëgimore, me ç'rast kishin përfituar vetëm dy vëllezërit e saj. Avokati i Popullit në përgjigjen e dërguar ka shpjeguar se në Ligjin Nr. 2004/26 për Trashëgimi të Kosovës,²⁶⁰ në nenin 3 theksohet se të gjithë fëmijët e trashëgimlënësit në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi. Ankuesja është këshilluar që përmes gjykatës të kërkojë të drejtat e saj në trashëgimi lidhur me pronën familjare.

2.20.4. E drejta për mbrojtje shëndetësore

Avokati i Popullit në vazhdimësi, në raportet vjetore të vitit 2010, 2011, 2012 dhe 2013, i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës për miratimin e Ligjit për mbrojtje shëndetësore, i cili në vitin 2014 është miratuar, por zbatimi tij parashihet të fillojë me funksionalizimin e fondit të sigurimit. Kosova është i vetmi vend në Evropë i cili nuk e ka këtë ligj në zbatim. Mbrojtja shëndetësore garantohet edhe me Kushtetutën e Kosovës, por gjithashtu edhe me instrumentet ndërkombëtare të cilët janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.

²⁵⁹ IAP, rasti A. nr. 316/2014.

²⁶⁰ Ligji Nr. 2004/26 për trashëgiminë, neni 3.1. "Të gjithë personat fizikë në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi."

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj më 31 tetor 2014, gjatë miratimit të projektbuxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015, ka theksuar se në vitin 2015 do të fillohet me implementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore. Zbatimi i këtij ligji, në masë të konsiderueshme do të sigurojë financimin e shëndetësisë, dhe së bashku me të edhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve.²⁶¹

Një ngjarje me rëndësi për shëndetin e grave të Republikës së Kosovës është sigurimi i aparatit të mamografit mobil i financuar nga gratë deputete të legjislaturës së katërt të Kuvendit të Kosovës, i cili i është dorëzuar MSH-së më 31 tetor 2014. Ky mamograf do të jetë në shërbim të të gjitha grave pa dallim, si në qytete ashtu edhe në fshatrat e Kosovës dhe do të ndihmojë në diagnostifikimin dhe luftimin e sëmundjes së kancerit të gjirit.

2.20.5. Dhuna në familje

Dhuna në familje vazhdon të jetë problem evident në shoqërinë tonë. Vetëm një numër i vogël i rasteve të dhunës në familje raportohet tek autoritetet kompetente për trajtimin e kësaj çështjeje, por ekziston perceptimi që në realitet ky numër është shumë më i madh. Shumë shpesh, dhuna në familje trajtohet si problem i brendshëm i një familje. Për shkak të lidhjeve të konsiderueshme emocionale mes viktimave dhe kryerësve të akteve të dhunës, shpesh herë ndodhë që femrat që i raportojnë këto raste nuk kërkojnë urdhrat mbrojtëse nga gjykatat kompetente. Posaqërisht në zonat rurale, pozita sociale e femrës është qartazi e nënshtruar ndaj asaj të mashkullit dhe shoqëria është shumë pak e vetëdijshme për konceptin e barazisë gjinore. Gjithashtu, në shumicën e rasteve viktimat më të shpeshta të dhunës në familje janë fëmijët, gratë, dhe pleqtë.

Një ndër arsyet kryesore që vazhdon të jetë burim i dhunës në familje është situata e rëndë socio-ekonomike në vendin tonë. Papunësia dhe varfëria ende janë faktorë, të cilët më së shumti ndikojnë në rritjen e numrit të rasteve të dhunës në familje.

Edhe pse ekziston një bazë solide ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje, është e nevojshme që në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të përfshihet edhe Konventa e Këshillit të Evropës për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e ashtuquajtura Konventa e Stambollit,²⁶² e cila hyri në fuqi në gusht të vitit 2014. Një thirrje e tillë bëhet edhe në Strategjinë për Zgjerim të Komisionit Evropian.²⁶³

2.20.6. Gratë dhe vajzat, viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës

Në Raportin vjetor të IAP-së të vitit 2012 dhe të vitit 2013, Avokati i Populli ka kërkuar rregullimin ligjor të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Ai gjithashtu ka kërkuar që grave dhe vajzave, viktimave të luftës në Kosovë, duhet t'u sigurohet përkrahja

²⁶¹ Shih në: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,4499> (31.12.2014).

²⁶² Konventa e Këshillit të Evropës për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (*Konventa e Stambollit*), e qasshme në: <http://www.conventions.coe.int/Treaty/Commun/QueVoulezVous.asp?NT=210&CM=8&DF=&CL=ENG> (15.01.2015).

²⁶³ Komisioni Evropian, *Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore*, 08.10.2014, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-strategy-paper_en.pdf (15.01.2015).

institucionale dhe ligjore, me fokus të veçantë për heqjen e paragjyqimeve ndaj tyre, me qëllim të rikthimit të dinjitetit njerëzor për këtë pjesë të shoqërisë sonë.

Kuvendi i Kosovës më 20 mars 2014 ka miratuar Ligjin Nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre, i cili krijon kushte ligjore për rehabilitimin dhe dëmshpërblimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Gjithashtu, në muajin korrik të vitit 2014 është nënshkruar peticioni “Drejtësi Ndërkombëtare për Gratë e Dhunuara gjatë Luftës së fundit në Kosovë”, i cili ka arritur të mbledh 115.759 nënshkrime të qytetarëve të Kosovës, me të cilin synohet të kërkohej drejtësi ndërkombëtare për të gjitha ato gra që kanë qenë viktimë të dhunës seksuale në luftën e fundit në Kosovës.

Rekomandim:

- *Grave dhe vajzave, viktima të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, t’iu sigurohet përkrahje institucionale dhe ligjore, me qëllim të rikthimit të dinjitetit njerëzor, dhe të merren masa për rehabilitimin e tyre shoqëror, shpirtëror dhe material.*

2.21. Të drejtat e fëmijëve

Me gjithë përpjekjet e autoriteteve publike në Republikën e Kosovës për përmirësimin e gjendjes sa u përket të drejtave të fëmijëve, sidomos në fushën e rregullimit normativ, gjendja e përgjithshme në këtë fushë lë shumë për të dëshiruar dhe kërkon angazhim më të përkushtuar shoqëror dhe institucional.

IAP gjatë këtij viti raportues ka pranuar 55 ankesa, të parashtruara kryesisht nga prindër të fëmijëve. Nga ky numër, 26 janë pranuar për t’u hetuar, ndërsa të tjerat janë shpallur të papranueshme, ngase çështjet me të cilat kanë pasur të bëjnë ato kanë qenë jashtë juridiksionit të IAP-së, nuk ka shkelje të drejtave të njeriut, apo ankuesit kanë pasur mundësi t’i shfrytëzojnë ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike.

2.21.1. Kontaktet e fëmijës me prindin që nuk ushtron kujdesin prindëror

IAP edhe gjatë kësaj periudhe ka pranuar një numër të ankesave kundër gjykatave, që kanë të bëjnë me zvarritje të procedurës gjyqësore për të vendosur për besimin e fëmijëve,²⁶⁴ alimentacion,²⁶⁵ lidhur me kërkesën për njohjen e së drejtës për përkrahje materiale, familjeve që në përkujdesje kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme.²⁶⁶ Po ashtu, ka pasur ankesa edhe për moszbatim të vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, lidhur me mosrealizimin e kontakteve personale të fëmijëve me prindin.²⁶⁷ Për shkak të mosrealizimit të kontakteve

²⁶⁴ LAP, rasti A. nr. 385/2014.

²⁶⁵ LAP, rasti A. nr. 339/2014.

²⁶⁶ LAP, rasti A. nr. 192/214.

²⁶⁷ LAP, rasti A.nr. 243/2013.

apo pamundësinë e realizimit të kontakteve të rregullta me fëmijë, IAP ka pranuar ankesa edhe kundër qendrave për punë sociale.²⁶⁸

Në këto situata, IAP u është drejtuar institucioneve përkatëse me rekomandime, duke kërkuar nga to ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme, në mënyrë që fëmijët të mund t'i realizojnë të drejtat e tyre, të garantuara me Kushtetutë, ligje si dhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijës.²⁶⁹

2.21.2. E drejta e fëmijëve për shkollim

Ofrimi i arsimit cilësor për të gjithë, përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim, sigurimi i infrastrukturës përkatëse shkollore, si dhe parandalimi dhe luftimi i dhunës në shkolla, mbeten qëllime për realizimin e të cilave kërkohet angazhim i vazhdueshëm i institucioneve të Republikës së Kosovës. Një numër i ankesave të pranuar kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Tetë nga to i referohen të drejtës për arsimim. Në tri nga këto ankesa, pas përfundimit të hetimeve, është konstatuar se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut, ndërsa ankesat tjera janë zgjidhur sipas kërkesës së ankuesve.

Nga ankesat e pranuar disa i referohen çështjes së sigurimit të transportit, për të vijuar mësimet në shkollë, të dy fshatrave të komunave Kaçanik dhe Shtime.²⁷⁰ Autoritetet përgjegjëse të këtyre komunave kishin mbyllur shkollat në këto fshatra dhe kishin vendosur që fëmijët të vazhdojnë mësimet në fshatrat fqinje. Për shkak të rrugës së papërshtatshme dhe të pasigurt, fëmijët e këtyre fshatrave nuk kishin vazhduar mësimet në shkollat e fshatrave më të afërta dhe kishin braktisur shkollën.

Në rastin e komunës së Kaçanikut, me ndihmën edhe të IAP-së, fëmijëve u është siguruar transporti nga autoritetet komunale. Pjesa e rrugës e cila ka qenë e rrezikshme dhe e pasigurt për kalim është asfaltuar. Pas një vit ndërprerjeje, fëmijët tani vazhdojnë mësimet. Ndërsa për rastin e komunës së Shtimes, IAP është duke punuar që autoritetet përgjegjëse komunale këtyre fëmijëve t'u ofrojnë mundësinë e gëzimit të së drejtës për arsim pa pengesa.

Sa i përket çështjes së sigurimit të transportit për të vijuar mësimin, IAP përveç tjerash ka ndihmuar edhe në rastin e një fëmije me aftësi të kufizuara, i cili ishte i detyruar të braktiste shkollimin e mesëm, për shkak të pamundësisë të udhëtimit deri në shkollën e mesme.²⁷¹ Me ndërmjetësimin e IAP-së, dhe me përkushtimin e autoriteteve komunale këtij nxënësi i është siguruar transporti dhe vazhdon shkollimin.

Mungesa e transportit nuk është e vetmja barrierë me të cilën përballen fëmijët, e në veçanti fëmijët me aftësi të kufizuara. Ata në shkollë përballen edhe me infrastrukturë joadekuate shkollore, mungesë të asistentëve personal, mësuesve mbështetës e shumë herë edhe të

²⁶⁸ IAP rastet: A. nr. 128/2014, A. nr. 116/2014, A. nr. 535/2014 dhe A. nr. 450/2014.

²⁶⁹ *Konventa për të Drejtat e Fëmijës*, është instrumenti më i rëndësishëm i së drejtës ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve, i cili zbatohet drejtpërdrejt nga institucionet e Kosovës, sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

²⁷⁰ IAP, rastet A. nr. 528/2014 dhe A. nr. 565/2014.

²⁷¹ IAP, rasti A. nr. 513/2013.

planeve individuale arsimore,²⁷² gjë që u mohon atyre gëzimin e plotë të së drejtës për arsim cilësor, gjithëpërfshirës, ashtu si është përcaktuar me ligj.

2.21.3. Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla

Dhuna mbetet dukuri shqetësuese në shkollat publike të Kosovës. Me gjithë përpjekjet e MASHT-it në këtë fushë, nuk është vërejtur ndonjë përparim.²⁷³ Në fillim të këtij viti në ambientet e shkollave dhe afër shkollave kanë ndodhur incidente të dhunshme. Dy nga këto incidente kanë përfunduar tragjikisht me humbjen e jetës së dy nxënësve.²⁷⁴

Në takimet e realizuara nga zyrtarët e IAP-së me nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta gjatë kësaj periudhe, del se shumë nga nxënësit janë të pakënaqur me situatën e sigurisë në shkollat e tyre. Shumë fëmijë mendojnë se shkollat nuk janë më aq vende të sigurta, pasi që disa nxënës bartin me vete armë të ftohta madje edhe armë zjarri, dhe se dhuna është e pranishme si brenda ashtu edhe jashtë hapësirës shkollore. Ata theksojnë se është shtuar përdorimi i alkoolit dhe substancave narkotike në disa shkolla të kryeqytetit. Aq më tepër ata janë të brengosur edhe me faktin se rrugës për në shkollë dhe anasjelltas rrezikohen nga qentë endacakë, si dhe nga makinat që lëvizin, sepse e kanë të pamundur të ecin trotuareve që tashmë janë shndërruar në vend-parkime.

Përveç mangësive të shumta në shkolla, për shkak të mungesës së kushteve elementare higjienike, mësimit në shumë ndërrime, mungesës së hapësirës përkatëse për ushtrime dhe lojë, problem më vete është edhe ajo se zëri i tyre nuk dëgjohej sa duhet dhe se mendimet e tyre nuk merren parasysh për çështjet që drejtpërdrejtë ndikojnë në të drejtat e tyre, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me dhunën dhe gjendjen e sigurisë.

²⁷² Informatat e siguruar nga përfaqësues të institucioneve shkollore dhe OJQ-ve që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar, në takimet e realizuara me ta gjatë muajit nëntor 2014.

²⁷³ Në kuadër të detyrimeve për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, MASHT-i ka vazhduar aktivitetet me qëllim të promovimit dhe përgatitjes së kushteve për zbatimin e Protokollit për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar, nr 21/2013. Në këtë drejtim MASHT-i ka realizuar takime me drejtoritë komunale të arsimit dhe inspektoratet e arsimit, ka mbajtur tryeza të rrumbullakëta, trajnime për përfaqësues të institucioneve përgjegjëse si dhe ka hartuar udhëzues për zbatimin e këtij protokollit.

Protokollit për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 6 shtator 2013. Me këtë protokoll janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve edukativo-arsimore dhe institucioneve të tjera në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve në institucionet parauniversitare. Gjithashtu, protokollit përcakton edhe procedurat për adresimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit parauniversitar.

²⁷⁴ Incidenti i parë ka ndodhur në oborrin e shkollës fillore “Emin Duraku” në Prishtinë me ç’rast me armë zjarri është vrarë një nxënës dhe është plagosur një tjetër, të dy fëmijë të moshës 14 vjeçe. Incidenti i dytë, po ashtu ka ndodhur brenda hapësirës shkollore në shkollën e mesme “Arkitekt Sinani” në Mitrovicë. Pas lëndimeve të marra nga therja me thikë, pas një zënke në mes të dy nxënësve, njëri prej nxënësve kishte ndërruar jetë në spitalin e qytetit. Informatat nga ueb faqja e Policisë së Kosovës, në: <http://www.kosovopolic.com/?page=1,26,3727&offseti=492> dhe e <http://www.kosovopolic.com/?page=1,26,3812&offseti=448> (19 janar 2015).

2.21.4. Trafikimi me qenie njerëzore - fëmijët viktime

Përkundër përparimeve të bëra, parandalimi i trafikimit të fëmijëve dhe mbrojtja përkatëse e të drejtave të fëmijëve - viktime të trafikimit me qenie njerëzore - mbetet sfidë për institucionet e Kosovës.

Edhe gjatë këtij viti, një numër i viktimize të trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë kanë qenë të mitura të trafikuar për qëllime të shfrytëzimit seksual. IAP gjatë këtij viti ka pranuar një ankesë nga një nënë e një vajze të mitur, kundër Policisë së Kosovës, për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve përkatëse që vajza e saj të largohet nga grupi që është duke e detyruar në kryerjen e veprave të ndryshme penale.²⁷⁵ Duke u nisur nga informatat e siguruar dhe rrethanat e rastit, IAP ka kërkuar nga institucionet që punojnë në identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve viktime të trafikimit me qenie njerëzore, që të ndërmerren veprimet e nevojshme në mënyrë që fëmijës t'i ofrohet mbrojtje dhe ndihmë adekuate. Obligimi për të ndihmuar përkatësisht për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në këtë rast është ritheksuar nga IAP edhe në takimet e *Grupit Punues*²⁷⁶ të Prishtinës dhe Ferizajt.

Institucionet e Kosovës në të gjitha rastet në të cilat fëmijët janë viktime do të duhej që me seriozitet dhe përgjegjësi më të madhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që fëmijëve viktime t'u ofrohet mbrojtja dhe ndihma adekuate.²⁷⁷ Në këtë drejtim Avokati i Popullit kërkon shtimin e dukshëm të përpjekjeve dhe angazhim më të madh të institucioneve në parandalimin e kësaj dukurie.

Duke marrë parasysh gjendjen e përshkruar në lidhje me të drejtat e fëmijëve, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme në këtë fushë, sidomos të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, Avokati i Popullit edhe këtë vit, për të gjitha institucionet përkatëse kompetente,

Rekomandon:

- *Të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme që rastet që kanë të bëjnë me fëmijë apo prekin të drejtat e tyre, të vendosen pa vonesa, brenda afateve të përcaktuara ligjore, në mënyrë që të mos dëmtohet apo rrezikohet shëndeti i fëmijëve, mirëqenia apo edhe jeta e tyre.*
- *Të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme që interesi më i mirë i fëmijëve të jetë parësor gjatë punës së tyre, përfshirë këtu edhe punën në çështjet që kanë të bëjnë me besimin e fëmijëve, apo me mos/realizimin e kontaktit të fëmijëve me prindin.*
- *Të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin dhe ngritjen e infrastrukturës fizike, si dhe për ndarjen e një buxheti të veçantë për sigurimin e transportit për fëmijë, në pajtim me legjislacionin që rregullon fushën e arsimit.*

²⁷⁵ LAP, rasti A. nr. 340/2014.

²⁷⁶ *Task Force* apo tryezat për menaxhim të rasteve përbëhen nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatave që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve që janë në rrezik të abuzimit, neglizhimit, trafikimit, shfrytëzimit ekonomik dhe seksual si dhe fëmijët në konflikt me ligjin. Tryezat për menaxhim të rasteve mund të shikohen si një mundësi e mirë për ofrimin e ndihmës përkatëse dhe mbrojtjen e fëmijëve të rrezikuar.

²⁷⁷ LAP, rastet A. nr. 340/2014, A. nr. 450/2014, A. nr. 385/2014, A. nr. 589/2014 dhe A. nr. 128/2014.

- *Të ndërmerren veprimet përkatëse në shtimin e numrit të mësuesve mbështetës si dhe në sigurimin e asistentëve personal për fëmijët me aftësi të kufizuara.*
- *Psikologët dhe pedagogët të jenë pjesë e personelit shkollor në të gjitha shkollat.*
- *Ora e kujdestarisë të përfshihet detyrimisht në programet shkollore.*
- *Të shtohet komunikimi në mes të mësimeve dhe prindërve, me qëllim të adresimit më të mirë të shqetësimeve dhe problemeve të nxënësve.*
- *Të ndërmerren veprimet përkatëse për rritjen e sigurisë në ambientet shkollore, rrugës për në shkollë dhe anasjelltas.*
- *Nxënësit të informohen për pasojat dhe rreziqet që sjell përdorimi i alkoolit dhe substancave narkotike.*
- *Të fuqizojnë kapacitetet e punonjësve të institucioneve përkatëse për identifikim efikas të viktimave të mitura, trajtimin dhe ofrimin e ndihmës adekuate atyre, duke u nisur nga nevojat dhe rrethanat e çdo rasti.*
- *Të ndërmarrin veprime përkatëse për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e punonjësve që punojnë me rastet e trafikimit me qenie njerëzore.*
- *Të vazhdojnë fushatat informuese, sidomos për fëmijët, në lidhje me trafikimin me qenie njerëzore, për rreziqet e mundshme dhe mënyrat e njohjes së tij, si dhe për të drejtat e fëmijëve për mbrojtje dhe ndihmë.*
- *Të krijojnë fonde të veçanta për të financuar nevojat urgjente të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe për ri-integrimin e plotë të tyre në shoqëri.*

2.22. E drejta shëndetësore dhe sociale

Gjendja në fushën e së drejtës shëndetësore dhe sociale për vitin raportues, nuk paraqet ndonjë ndryshim të madh, krahasuar me vitet paraprake. Gjendja e përgjithshme socio-ekonomike në Kosovë po vazhdon të jetë e rëndë si pasojë e papunësisë së madhe dhe zhvillimit të dobët ekonomik.

Ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2014 të cilat ndërlidhen me fushën e së drejtës shëndetësore dhe sociale, për nga numri, natyra ligjore dhe palët përgjegjëse përafërsisht mbesin të njëjta. IAP gjatë vitit 2014 ka hapur katër (4) raste për ankesa të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës nga ana e institucioneve shëndetësore, kurse pjesa tjetër e ankesave (59) i dedikohen institucioneve që ofrojnë shërbimet nga fusha e mirëqenies sociale. Këto ankesa kryesisht kanë të bëjnë me ndihmat sociale, pensionet dhe strehimin.

2.22.1. Shërbimet e mangëta shëndetësore dhe dyshimet për keqpërdorime

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore në Republikën e Kosovës edhe gjatë këtij viti ka vazhduar të mbetet i mangët në të gjitha nivelet (primare, sekondare dhe terciare). Furnizimi me barna nga lista esenciale, ka vazhduar të jetë i pamjaftueshëm dhe si pasojë pacientët janë detyruar t'i blejnë ato nëpër barnatoret private.²⁷⁸ Edhe këtë vit, numër i madh i pacientëve, për shkak të specifikave të sëmundjes, mosfrimit të shërbimeve shëndetësore, apo për arsye tjera, janë detyruar të kërkojnë trajtim shëndetësor jashtë vendit. Punëtorët shëndetësorë vazhdojnë të punojnë në kundërshtim me ligjin e punës, sidomos në kujdestari duke punuar njëzetekatër orë pandërprerë, e disa nga ata sidomos kirurgët edhe më shumë.

Një plagë tjetër e rëndë që e mundon tërë sistemin e shëndetësisë në Kosovës është keqmenaxhimi së bashku me dyshimet për keqpërdorime në këtë sektor. Hetimet e Prokurorisë Speciale lidhur me keqpërdorimet në fushën e shëndetësisë nga ana e profesionistëve shëndetësorë,²⁷⁹ kanë ndikuar shumë në zbehjen e besimit tek institucionet shëndetësore të Republikës së Kosovës. Siç dihet, këto hetime rezultuan me arrestime të disa zyrtarëve shëndetësorë, duke mos i shpëtuar pa implikime as krerët më të lartë të MSH-së.

2.22.2. Vlerësim i përgjithshëm i fushës së shëndetësisë

Sipas statistikave të fundit, numri i të sëmurëve me sëmundje kanceroze në Kosovë po vazhdon të rritet dita ditës.²⁸⁰ Këta të sëmurë po përballen me shpenzime të mëdha financiare duke kërkuar mjekim brenda dhe jashtë Kosovës për blerjen e terapisë apo përdorimit të metodave me rrezatim, ngase Reparti i Onkologjisë në QKUK nuk i posedon rregullisht citostatikët apo nuk ofron shërbimet e radioterapisë, sepse aparaturat nuk po funksionojnë dhe ato nuk mirëmbahen si duhet. Sipas Ligjit Nr. 04/L-125 për shëndetësi, neni 12 përcakton se Institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet dhe janë përgjegjëse për "parandalimin, zbulimin e hershëm dhe trajtimin e sëmundjeve malinje, veçanërisht i kancerit të gjirit, kancerit të qafës së mitrës, dhe kancerit kolorektal." (Paragrafi 1.4 i këtij neni).

Miratimi i Ligjit Nr. 04/L-249 për sigurimet shëndetësore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 prill 2014, mund të shihet si shpresë për zbutjen e kësaj gjendje të rëndë dhe të rritë shpresat e qytetarëve për një shëndetësi moderne në Kosovë. Por sipas të gjitha gjasave ky ligj do të ketë vonesa në zbatim.

2.22.3. Ankesat e njerëzve në sistemin shëndetësor

IAP ka pranuar ankesa të cilat kanë të bëjnë me cenimin e shëndetit të pacientëve nga ana e institucioneve shëndetësore, të cilat sipas legjislacionit në fuqi e kanë për obligim të ofrojnë

²⁷⁸ Lista e produkteve mjekësore dhe materialet shpenzuese sanitare që blihen për nevojat e të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor nga Buxheti i Kosovës.

²⁷⁹ Njoftim nga Prokurori i Shtetit, në <http://www.psh-ks.net/?page=1,8,631> (4.11.2014).

²⁸⁰ ASK, Seria 5, *Statistikat e Shëndetësisë 2013*, faqe 15, nëntor 2014.

ndihmën shëndetësore për të gjithë qytetarët, pa asnjë lloj diskriminimi. Norma e nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-125 për shëndetësi, përcakton se *“Zbatimi i këtij ligji do të bëhet duke respektuar dinjitetin, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut[...]”*. Kjo fatkeqësisht ende vazhdon të mbetet vetëm një shprehje gjuhësore e bukur por pa vlerë objektive, sepse, ky ligj nuk ka hyrë në fuqi dhe vazhdon të zvarritet zbatimi i tij praktik.

Nga ankesat e paraqitura në IAP, shihet se ato në shumë raste janë të drejtuara kundër personelit shëndetësor, sidomos mjekëve. Njëri nga ankuesit pretendon se nga neglizhenca e punëtorëve shëndetësor erdhi deri në vdekjen e foshnjës së tyre të posalindur.²⁸¹ Një ankues tjetër ankohet kundër personelit të institucionit dytësor shëndetësor, sepse anesteziologët kanë tentuar t'i detyrojnë familjarët që ta marrin të sëmurin në shtëpi ende pa u shëruar plotësisht, duke rrezikuar seriozisht jetën e pacientit, që edhe ashtu ishte i rrezikuar. IAP e ka hetuar këtë rast dhe pas takimeve të zhvilluara me autoritetet përgjegjëse, kjo gjendje është sanuar.²⁸²

Nga hetimet e rasteve tjera që ndërlidhen me të drejtën shëndetësore, IAP ka vërejtur se në disa raste kur të sëmurët janë të diagnostifikuar me sëmundje të cilat nuk kanë perspektivë të shërimit këta pacientë, ose qëndrojnë në institucione jo adekuate shëndetësore (institucione këto të papërgatitura me kuadër profesional dhe aparatura), apo lëshohen në shtëpi, sepse në Kosovë nuk është e themeluar disiplina shëndetësore e cila njihet me emrin *“Mjekësi Paliative”*.²⁸³ Këshilli i Ministrave të BE, orienton shtetet anëtare mbi organizimin e Kujdesit Paliativ, duke konstatuar se: *“Në shoqëritë evropiane me një popullsi drejt plakjes, pritet një rritje prej rreth 20% e nevojave për kujdes paliativ në 10-15 vitet e ardhshme, si për pacientët me kancer, ashtu edhe për ata që nuk vuajnë nga kanceri. Vlerësohet se nevoja për shtretër në kujdesin paliativ është afërsisht 50-100 për 1 milion banorë.”*²⁸⁴ Nisur nga ky fakt, MSH, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse ndoshta duhet të shqyrtojë me shumë seriozitet këtë rekomandim edhe pse nuk i është drejtuar Kosovës dhe të iniciojë çështjen e themelimit të kësaj disipline mjekësore, shumë të nevojshme edhe për qytetarët e Kosovës.

2.22.4. Mirëqenia sociale

Gjendja ekonomike dhe sociale e keqe, si pasojë e zhvillimit të ulët ekonomik, papunësisë së lartë, çështjeve të pazgjedhura të strehimit, po ndikon që shumë familje kosovare po migrojnë në shtetet e perëndimit, me shpresë se do të gjejnë një jetë më të mirë. Kjo gjendje e rëndë ka bërë po ashtu, që IAP gjatë vitit raportues të pranojë mjaft ankesa nga fusha e mirëqenies

²⁸¹ IAP, rasti A. nr. 320/2014, ankuesi pretendon se për shkak të neglizhencës totale nga ana e personelit mjekësor në maternitetin e QKUK-së, vdiq foshnja e tyre e posalindur.

²⁸² IAP, rasti A. nr. 87/2014, ankuesi pohon se i biri i tij ka pësuar goditje nga elektriciteti (tensioni i lartë) dhe ka pesë muaj që gjendet në komë në Kujdesin Intensiv dhe sipas tij anesteziologët po kërkojnë nga ai që ta marrë të sëmurin në shtëpi, por ai thekson se i sëmuri është komatoz dhe akoma ka nevojë për trajtim spitalor pasi çdo ditë aspirohet me kateter endobronchial, merr terapi parenterale dhe i bëhen ushtrime pasive nga reparti i terapisë fizikale, kurse në shtëpi nuk mund t'i ofrohen asnjë nga këto shërbime.

²⁸³ *Mjekësia paliative* është disiplinë relativisht e re mjekësore ku tretmani mjekësor ofrohet në pavijone të posaçme nga ekupe të trajnuara për kujdes ndaj të sëmurëve të cilët për shkak të sëmundjeve të pashërueshme, kryesisht tumoreve, AIDS-it apo sëmundjeve tjera janë në fundin e jetës së tyre (stadin terminal), ndërkohë që as barnat nuk mund të ndihmojnë më.

²⁸⁴ *Rekomandimi Rec (2003) i Këshillit të Ministrave të BE, drejtuar shteteve anëtare mbi organizimin e Kujdesit Paliativ* në: <http://www.eapcnet.eu/LinkClick.aspx?fileticket=YR9odrODI-s%3D&tabid=1709> (9.12.2014).

sociale të cilat kryesisht ndërlihen, por nuk kufizohen, me çështjet e strehimit dhe përfitimit të ndihmës sociale nga ana e shumë familjeve të cilat janë të përfshira në skemën e ndihmës sociale në Republikën e Kosovës.

MPMS është përpjekur të përfshijë shumë familje në skemën e ndihmës sociale, sipas ligjeve në fuqi, por bazuar në situatën ekonomike të vendit nevojat e familjeve për asistencë sociale janë shumë të mëdha, prandaj kërkohen më shumë mjete buxhetore për këtë kategori të popullatës, një pjesë e së cilës po jeton në varfëri ekstreme.

Shumë ankues kanë paraqitur ankesa në IAP, sepse QPS-të ua kanë ndërprerë ndihmën sociale pasi fëmija i tyre ka arritur moshën pesë vjeçare. IAP edhe në raportet e viteve paraprake ka kërkuar që të hiqet ky kufizim i moshës, sepse me arritjen e kësaj moshe fëmijët nuk mund t'i ndihmojnë familjes, por vetëm sa rriten nevojat për shtimin e ndihmave. Ky kriter është krejtësisht arbitrar dhe kuantitativ dhe nuk përkon me nevojat reale të familjeve të varfra. Fatkeqësisht deri më tash, këto rekomandime nuk janë marrë parasysh nga institucionet përgjegjëse.

2.22.5. Rastet konkrete në IAP për çështjet e ndihmave sociale

IAP, pas disa ankesave të kësaj natyre, ka hapur disa raste për hetime dhe ka lëshuar raporte me rekomandime.²⁸⁵ IAP ka pranuar ankesë lidhur me ndërprerjen e shfrytëzimit të pensionit në bazë të moshës, me pretendimin nga ankuesi se ndërprerja është bërë pa bazë ligjore. Sidomos të rënda mund të jenë rastet kur ndihma ndërpritet pikërisht për shkak të paaftësisë (qoftë ajo fizike apo mendore) së shfrytëzuesit të ndihmës për të respektuar kërkesat ligjore në lidhje me ndihmat apo vazhdimin e marrjes së tyre.²⁸⁶

Mirëpo, gjatë hetimit të rasteve kemi mësuar se kanë ndodhur raste keqpërdorimi nga disa shfrytëzues të kësaj kategorie, që kanë shfrytëzuar gabimet në letërnjoftimet e tyre lidhur me vitin e lindjes dhe kanë aplikuar për pension duke përfituar nga skema për përfitimin e pensionit bazë të moshës, para se ta arrijnë moshën 65 vjet. Mirëpo, gjatë riaplikimit, sidomos pas ndërrimit të letërnjoftimit nga ato të UNMIK-ut në ato të Republikës së Kosovës, zyrtarët e administratës pensionale kanë arritur t'i zbulojnë këto dukuri dhe kundër këtyre është marrë masa e ndërprerjes së pensionit deri në ri-imbursimin e plotë të mjeteve financiare të cilat i kanë shfrytëzuar në mënyrë jomeritore.²⁸⁷

Ligji Nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, përmes nenit 7 rregullon kushtet dhe kriteret për njohjen e së drejtës për pensionin bazik të moshës, sipas të cilit: “*Pensionin bazik i moshës do t’u paguhet të gjithë personave që janë shtetas të përbërshëm të Republikës së Kosovës, të cilët posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare*”, ndërsa dokumente valide të domosdoshme për njohjen e të drejtës në pension

²⁸⁵ IAP, rastet A. nr. 1/2014, A. nr. 4/2014, A. nr. 17/2014, A. nr. 70/2014 dhe A. nr. 85/2014.

²⁸⁶ IAP, rasti A. nr. 70/2014. IAP kishte hapur rast *ex officio* kur ka marrë informacionin përmes mediave se një familje kosovare jeton në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe nuk gëzon as ndihma sociale. Gjatë hetimit të këtij rasti, IAP ka vërejtur se kjo familje fillimisht ishte e përfshirë në skemën e ndihmës sociale, por asaj i është ndërprerë ndihma si pasojë e mosaplikimit për vazhdimin e ndihmës. Mosaplikimi për vazhdimin e ndihmës kishte ardhur si pasojë e mungesës së letërnjoftimit të shfrytëzuesit të ndihmës, i cili kishte ngecje në zhvillim mendor. Pas intervenimit të IAP dhe me rregullimin e letërnjoftimit, kjo familje e ka përfituar sërish ndihmën sociale në mënyrë retroaktive.

²⁸⁷ IAP, rasti A. nr. 121/2014.

bazik të moshës sipas këtij ligji janë ”Letërnjoftimi, i lëshuar nga organi përgjegjës i Republikës së Kosovës” dhe “Vërtetimi nga Zyra Civile se është banor i përbërshëm në adresën e caktuar”. Shihet qartë se ligjvënësi nuk e ka parashikuar mundësinë që dokumenti i identifikimit mund të jetë me gabime, prandaj që të evitohet kjo mangësi, deri në pajisjen e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës me letërnjoftime të reja dhe pa lëshime të tilla, MPMS përmes një udhëzimi administrativ mund të kërkojë që përveç letërnjoftimit të kërkohej edhe certifikata e lindjes apo ndonjë dokument tjetër.

2.22.6. Kërkesat për strehim social

IAP ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave të cilët kërkojnë që t’u sigurohet strehimi nga institucionet përgjegjëse komunale dhe këto familje kryesisht janë të përfshira në skemën e ndihmës sociale.

Në IAP, në fillim të vitit 2014, për çështjen e strehimit janë paraqitur 9 familje të komunitetit serb, të cilat ishin të vendosura në objektet e ish-ndërmarrjeve shoqërore, për shkak se nuk kanë mundur t’i rinovojnë shtëpitë e tyre. Ata nuk kishin probleme me strehimin deri në momentin kur AKPv e ka privatizuar (shitur) pronën e ish-ndërmarrjeve shoqërore. Pasi kjo pronë ka kaluar në pronësi private, pronari privat ka kërkuar që objekti të lirohet nga personat dhe sendet në afatin prej tre muajsh. Këto familje nuk kanë mundur të gjejnë zgjidhje, prandaj i janë drejtuar për ndihmë IAP-së. Pas hetimit të këtij rasti IAP ka lëshuar raport me rekomandim, përmes të cilit ka kërkuar nga komuna e Gjilanit ”*Marrjen e masave të menjëhershme për gjetjen e zgjidhjes së çështjes së banimit për këto 9 familje, të cilat janë duke banuar përkohësisht në objektin e privatizuar [...]*”.²⁸⁸

Ky problem është zgjidhur falë këtij rekomandimi dhe bashkëpunimit në mes të komunës së Gjilanit dhe MKK, të cilët kanë nënshkruar një marrëveshje, që fillimisht këto familje të vendosen në banesa dhe të bëhet pagesa e qirasë nga komuna, kurse MKK do t’i ndërtojë shtëpitë për këto familje, pasi që komuna të bëjë ndarjen e pronës, në të cilën do të ndërtohen shtëpitë e këtyre familjeve të zhvendosura.

IAP ka pranuar edhe ankesa tjera të kësaj natyre. Njëri nga ankuesit ankohet kundër komunës së Gjakovës, sepse ajo me aktvendimet e saj i ka shpallur uzurpatorë disa familje (të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas) dhe ka kërkuar nga ata lirimin e pronës komunale, duke i shndërruar ata si *familje në nevojë* për çështje strehimi. Këto familje deklarojnë se kanë ndërtuar shtëpitë e tyre në ato vendbanime për më shumë se dyzet vite. Ata pranojnë se kjo pronë është e regjistruar në emër të komunës, por theksojnë se nuk kanë mjete materiale për jetesë, marrin ndihma sociale dhe nuk kanë mundësi t’i ndërtojnë vet shtëpitë e tyre. IAP gjatë hetimit të këtyre rasteve ka vërejtur se organet përgjegjëse komunale Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit nuk kanë asnjë lloj strategjie për strehimin e këtyre banorëve, dhe nuk kanë bashkëpunuar me njëra tjetrën.²⁸⁹

²⁸⁸ IAP, rasti A. nr. 1/2014.

²⁸⁹ IAP, rasti A. nr. 318/2014.

2.22.7. Vendimet kundërligjore të ministrit të MPMS

IAP ka pranuar disa ankesa që kanë të bëjnë me vendimin e ministrit të MPMS, z. Nenad Rashiq, për vendimin nr.171, të lëshuar më 9 qershor 2011, përmes të cilit ka bërë pezullimin e pranimit të kërkesave për realizimin e të drejtave që burojnë nga *Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile*.²⁹⁰

Gjatë hetimit të këtyre rasteve, shihet se ministri i MPMS-së ka nxjerrë vendimin pas takimit me Fondin Monetar Ndërkombëtar, përmes të cilit kërkon nga Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimat Civile (DFDIL) që: “*Numri i paraqitësve të kërkesave për njohjen e statusit sipas Ligjit për Vlerat e Luftës të përmbyllet me gjendjen e datës 31 maj 2011 dhe deri në nxjerrjen e “një vendimi të ri politik” nga ministri i MPMS-së, prandaj të mos pranohet asnjë kërkesë e re për njohjen dhe realizimin e asnjë të drejte të përcaktuar me Ligjin për Vlerat e Luftës?*”.

Më 6 shkurt 2014, përfaqësuesit e IAP-së janë takuar me drejtorin e DFDIL-it të MPMS-së për të marrë informata shtesë lidhur me *vendimin*. Drejtori i DFDIL-it ka vërtetuar se *vendimi* është ende në fuqi dhe që nuk lejohet pranimi i kërkesave të reja. Ai më tutje pohoi se janë gjithsej 13.500 përfitues nga skema e paraparë me Ligjin për Vlerat e Luftës dhe, sipas disa vlerësimeve, janë edhe së paku 1000 paraqitës potencialë të kërkesave, të cilat si të tilla nuk mund të pranohen për shkak se *vendimi* është në fuqi.

Në kohën kur është nxjerrë *vendimi*, në fuqi ka qenë *Ligji Nr. 02/L-02 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës*, i datës 23 shkurt 2006. Ndërsa, më 8 dhjetor 2011, Kuvendi ka miratuar *Ligjin Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktima Civile dhe Familjet e Tyre*, i cili aktualisht është në fuqi dhe i cili shfuqizon rregulloret e UNMIK-ut dhe Ligjin Nr. 02/L-02. Megjithatë, *vendimi* ka vazhduar të mbetet në fuqi, duke pamundësuar kështu paraqitjen e kërkesave për realizimin e të drejtave të përcaktuara me ligj.

IAP është vënë në dijeni se ministri i MPMS-së, ka nxjerrë një vendim tjetër, vendimin Nr.10, të datës 21 janar 2013, për “*shfuqizimin e pjesshëm*” të *vendimit*. Shfuqizimi i *vendimit* vlen vetëm për familjet e të zhdukurve, të cilat kanë filluar të parashtrojnë kërkesat nga data 15 janar 2013 dhe për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës së UÇK-së dhe veteranëve të luftës, të cilët mund të aplikojnë për realizimin e të drejtave të tyre pas përfundimit të procesit të verifikimit të statusit të tyre. Mirëpo, *vendimi* vazhdon të vlejë për kategorinë e *viktimave civile*. Shfuqizimi i pjesshëm i *vendimit*, jo vetëm që e dëshmon, por e thëllon edhe më shumë diskriminimin që iu bëhet paraqitësve të kërkesave. Kjo, për shkak se fillimisht trajtimi i pabarabartë është bazuar me një datë të caktuar dhe i ka ndarë paraqitësit e kërkesave para dhe pas hyrjes në fuqi të *vendimit*, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për persona të zhdukur, viktimat civile, veteranë të luftës etj. Ndërsa, *vendimi* për shfuqizimin e pjesshëm të *vendimit* bëhet në mënyrë selektive, në bazë të kategorisë dhe vazhdon të mbetet në fuqi për kategorinë e viktimave civile të luftës.

IAP pas analizës ligjore të rasteve konstaton se ministrit të MPMS-së, sikurse edhe asnjë ministri tjetër në Republikën e Kosovës, nuk i delegohet ndonjë kompetencë për nxjerrjen e ndonjë vendimi, me të cilin do të pezullohej apo pengohej zbatimi i ligjit. Asnjë anëtar i Qeverisë, në këtë rast as ministrit të MPMS, nuk i delegohet e drejta e kufizimit të drejtave

²⁹⁰ IAP, rastet A. nr. 85/2014, A. nr. 4/2014 dhe A. nr. 542/2013.

dhe lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të parapara me ligj dhe me Kushtetutë. Çdo kufizim i tillë mund të bëhet vetëm me ligj duke u bazuar në nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. *Vendimi* apo çfarëdo akti tjetër normativ i një anëtarit të Qeverisë së Kosovës dhe i ndonjë autoriteti tjetër publik në Republikën e Kosovës, nuk është i vlefshëm nëse nuk është i bazuar në ligj dhe nuk është ligj.

IAP ka hartuar Raportin me rekomandime për MPMS në lidhje me rastin në fjalë. Përkundër obligimeve ligjore të Institucioneve të Republikës së Kosovës për respektimin dhe implementimin e rekomandimeve të IAP-së, ky rekomandim nuk është përfillur nga MPMS. Këto rekomandime vazhdojnë të mbeten të pazbatuara edhe nga Qeveria e re e Republikës së Kosovës dhe ministri përkatës i MPMS-së deri në përfundimin e këtij raporti.²⁹¹

Rekomandime:

- *Qeveria e Kosovës përmes mekanizmave përgjegjës për institucionet shëndetësore publike, të bëjë furnizimin me barna nga lista esenciale dhe material tjetër sanitar gjatë gjithë kohës.*
- *Të shtohet kontrolli në institucionet shëndetësore të të gjitha niveleve, në mënyrë që punëtorët shëndetësorë të ofrojnë shërbime kualitative shëndetësore dhe atyre t'u pamundësohet të keqpërdorin vendin e tyre të punës në dëm të pacientit.*
- *Qeveria e Kosovës, përmes amendamentimit të Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale, të kërkojë heqjen e kufizimit të ndihmës sociale për familjet me fëmijë që mbushin moshën 5 vjet, për arsye se ky kufizim nuk është kualitativ, nuk ka qëllim legjitim, nuk është proporcional dhe është kundërkushtetues.*
- *Komunat, me rastin e planifikimit të buxhetit, të parashohin vija buxhetore për ndërtimin e objekteve të banimit për familjet nevojtare.*
- *Qeveria e Kosovës të kërkojë nga institucionet përgjegjëse, duke përfshirë edhe organet e veta brenda qeverisë, respektimin dhe zbatimin e rekomandimeve të IAP-së.*

2.23. Të drejtat e komunitetit LGBT

IAP, si edhe viteve të tjera, i ka kushtuar vëmendje çështjeve dhe sfidave të jetës së komunitetit LGBT në Kosovë, i cili edhe më tutje ballafaqohet me problemin e moslajmërimit të shkeljeve individuale të të drejtave të personave LGBT. Siç kemi tërhequr vëmendjen edhe në raportet e mëhershme të IAP-së, paraqitja e shkeljeve të të drejtave të komunitetit LGBT është një nga faktorët kryesorë në monitorimin e punës së organeve shtetërore në parandalimin e këtyre shkeljeve.²⁹² Është e nevojshme që shkeljet e të drejtave të komunitetit LGBT të vihen në pah, rastet e shkeljeve ndaj personave të këtij komuniteti të lajmërohen tek organet kompetente, në mënyrë që të mund të zhvillohen hetimet dhe dënohen kryerësit e shkeljeve të këtyre të drejtave.

²⁹¹ IAP, Raporti me rekomandim, rastet: A. nr. 542/2013, A. nr. 4/2014 dhe A. nr. 85/2014.

²⁹² IAP, *Raporti vjetor për vitin 2013*, fq. 34.

Të drejtat e komunitetit LGBT në Kosovë janë relativisht mirë të mbrojtura me Kushtetutë dhe ligje,²⁹³ por në praktikë ekzistojnë probleme me të cilat pjesëtarët e komunitetit LGBT ballafaqohen çdo ditë. Megjithatë, gjatë vitit 2014, mund të thuhet se vërehet një përparim i dukshëm në promovimin e komunitetit LGBT në Kosovë.

Një përparim veçanërisht i dukshëm është shënimi i ditës kundër homofobisë dhe transfobisë.²⁹⁴ Nën përkrahjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (në tekstin e mëtutjeshëm USAID), Qendra për emancipimin e shoqërisë e njohur si QESH, mund të thuhet se me sukses ka zbatuar fushatën me shumë aktivitete. Përndryshe, kjo është pjesë e një projekti më të madh të cilin e zbaton organizata QESH në bashkëpunim me USAID i cili ka për qëllim ndihmën në ndërtimin e kapacitetit për përkrahje të komunitetit LGBT në Kosovë dhe forcimin e ndërgjegjësimit të shoqërisë për përfshirjen e komunitetit LGBT. Aktivitetet të cilat i kanë përcjellë këto ngjarje kanë kaluar pa kurrfarë incidentesh.

Gjatë një takimi koordinues të organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës (ZKM), pjesëtarët e komunitetit LGBT kanë shprehur falënderimin e tyre ndaj Policisë së Kosovës për organizim të mirë dhe përkrahje. Përparim i veçantë ekziston edhe në fushën e trajnimit të kuadrit policor në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT e që është financuar nga Ambasada Finlandeze në Kosovë.

Përkrahje të madhe, edhe këtë vit, komuniteti LGBT ka pasur edhe nga përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare dhe nga Qeveria/Zyra e Kryeministrit. Nën organizimin e kësaj zyre, këtë vit ka filluar mbajtja e takimeve të rregullta koordinuese të pjesëtarëve të organizatave të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT, përfaqësuesit e ministrive, policisë, ambasadave dhe organizatave tjera të cilat janë të rëndësishme në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit LGBT.

Po ashtu, është i rëndësishëm edhe inicimi i projektit të binjakëzimit “lufta kundër homofobisë dhe transfobisë” i cili është përkrahur nga instituti austriak dhe finlandez për shëndetin publik dhe kujdes social,²⁹⁵ me qëllim të ofrimit të ndihmës në dhënien e rekomandimeve për harmonizimin e ligjit dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme, të cilat do të kontribuonin në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT në Kosovë.

Problemet në të cilat më së shpeshti hasin pjesëtarët e komunitetit LGBT në Kosovë janë perceptimet e shoqërisë të cilat nuk janë mjaft të përgatitura për t’i pranuar dallimet, dhe me qëllim të tejkalimit të këtyre dallimeve, këtë vit, i është kushtuar vëmendje kërkimit të modaliteteve në zvogëlimin e dallimeve ekzistuese si dhe të ndikohet në ndërgjegjen e qytetarëve. Theks i veçantë është vënë në përfshirjen e komunitetit LGBT në sistemin arsimor, me fokus në parandalimin e diskriminimit të komunitetit LGBT në arsim.

Problemi i diskriminimit në bazë të përkatësisë seksuale posaçërisht vije në shprehje tek të rinjtë adoleshentë. Pjesëtarët e organizatave LGBT tregojnë shembuj kur vetë arsimtarët në shkolla i ngacmojnë dhe diskriminojnë të tjerët në bazë të orientimit seksual. Me qëllim të tejkalimit të këtij problemi në përgatitje e sipër janë publikimet e doracakëve për drejtorët e

²⁹³ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 24.

²⁹⁴ USAID, *Lajme* „Kosovo is Ready Project”, në: <http://www.usaid.gov/news-information/fact-sheets/kosovo-ready-project> (15.10.2014).

²⁹⁵ Ambasada Finlandeze në Kosovë, *Lajme*, “Finland supports sexual minorities in Kosovo”, 20 maj 2014, <http://www.finlandkosovo.org/public/default.aspx?contentid=306474&nodeid=42593&contentlan=2&culture=en-US> (20.11.2014).

shkollave lidhur me atë se si të ndikojnë në parandalimin e këtij lloji të diskriminimit dhe përgjithësisht në qasjen ndaj komunitetit LGBT.

Problem i veçantë është diskriminimi dhe dhuna nga ana e moshatarëve, dhe në këtë drejtim është e nevojshme të punohet në përmirësimin e komunikimit por edhe përgatitjen e kuadrit arsimor në mënyrë që t'i njoftojnë fëmijët me këtë temë. Përkrahje konkrete në këtë fushë është ofruar nga USAID përmes mësimit të programit për tolerancën, një lloj trajnimit për kuadrin arsimor për qasjen ndaj problematikës së LGBT-së dhe në përgjithësi ballafaqimin me paragjykimet ekzistuese, si t'i njohin fëmijët me këtë problematikë dhe si t'i japin gjithë kësaj një qasje tjetër përmes përmbajtjeve shkollore.²⁹⁶

Rekomandim:

- *Qeveria e Kosovës të përfshijë në programet e edukimit njohuritë në lidhje me të drejtat e komunitetit LGBT.*

2.24. Përdorimi i gjuhëve

Korniza juridike e Kosovës mbron të drejtat gjuhësore dhe përcakton mekanizmat mbrojtës me qëllim të respektimit të përdorimit të barabartë të gjuhëve dhe shkrimeve zyrtare të komuniteteve pakicë në Republikën e Kosovës.

Të drejtat gjuhësore në Kosovë janë pjesë e mbrojtjes juridiko-kushtetuese,²⁹⁷ qëllimi i së cilës është mbrojtja dhe ruajtja e identitetit të komuniteteve jo shumicë, që është e rregulluar më hollësisht me një sërë ligje dhe dispozita, në bazë të së cilave pjesëtarët e saj nuk mund të ndalohen të realizojnë cilëndo nga të drejtat e njohura. Në rregullimin juridik të Republikës së Kosovës, e drejta e përdorimit zyrtar të gjuhës është e rregulluar në pajtim me standardet ndërkombëtare.²⁹⁸

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për përdorimin e gjuhëve,²⁹⁹ Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre³⁰⁰, si dhe Ligji për vetëqeverisjen lokale,³⁰¹ i obligojnë të gjitha institucionet publike dhe ofruesit e shërbimeve të sigurojnë përdorimin e barabartë të dy gjuhëve zyrtare, shqipe dhe serbe, si dhe të gjuhëve zyrtare të cilat janë në përdorim në komuna. Gjuhët e komuniteteve tjera, siç janë gjuha turke, boshnjake dhe rome janë në përdorim zyrtar në nivelin komunal, në bazë të normave juridike të përcaktuara.

Duke i analizuar praktikat e deritashme në nivelin lokal dhe qendror, edhe pse nga miratimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve kanë kaluar më shumë se shtatë vjet, vërehet se zbatimi i tyre është një proces kompleks, i cili ka kërkuar dhe kërkon ende, që krahas bazës institucionale-

²⁹⁶ USAID, *Lajme* „Teaching Tolerance: A Lesson for Kosovo’s Educators in LGBT Awareness” 10.12.2014, <http://blog.usaid.gov/2014/12/teaching-tolerance-a-lesson-for-kosovos-educators-in-lgbt-awareness/> (14.12.2014).

²⁹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 5, 57, 58 dhe 59.

²⁹⁸ Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, Karta evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave, KEDNJ dhe Protokollin e saj, Rekomandimi për të drejtën e pakicave kombëtare për përdorimin e gjuhës së vet (Oslo, 1996) dhe Rekomandimet e Hagës në lidhje me të drejtat e pakicave kombëtare për shkollim.

²⁹⁹ Ligji Nr.02/L37 për përdorimin e gjuhëve.

³⁰⁰ Ligji Nr.03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

³⁰¹ Ligji Nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale.

juridike, të zhvillohen edhe kushtet tjera për realizimin e saj, siç janë: vetëdija shoqërore për të drejtat gjuhësore, zbatimi i politikës së mundësive të barabarta dhe zbatimi i politikës multikulturore e cila duhet të jetë e drejtë në shpërndarjen e drejtësisë.

2.24.1 Ankesat e parashtruara në lidhje me përdorimin e gjuhës

Avokati i Popullit gjatë vitit 2014 ka pranuar tri ankesa nga pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme të pakicave që kanë të bëjnë me zbatimin e të drejtës së përdorimit zyrtar të gjuhëve, e të cilat tregojnë për probleme të caktuara në realizimin e këtyre të drejtave në sistemin gjyqësor në Kosovë. Ankesat i referohen mospjesëmarrjes së Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të Gjykatës Themelore në Prizren që ankuesve t’iu dorëzojnë vendimet e gjykatës në gjuhën e palës në procedurë.

Përkritazi me ankesat e parashtruara, Avokati i Popullit ka iniciuar hetimet, për përcaktimin e drejtë të gjendjes faktike dhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Gjykata Themelore në Prizren, si palë përgjegjëse, ka kërkuar të deklarohen për pohimet e dhëna në ankesa. Gjatë procesit të hetimit Avokati i Popullit ka vërtetuar që ankuesit kanë pritur prej 6 deri në 22 muaj për dorëzimin e përkthimit të vendimit gjyqësor në lëndët e tyre. Në deklarimet e tyre dërguar Avokatit të Popullit, palët përgjegjëse i kanë arsyetuar këto vonesa të mëdha në përkthimin e vendimeve gjyqësore në gjuhët e palëve në procedurë, me numrin e pamjaftueshëm të përkthyesve në gjykata dhe me numrin e madh dhe vëllimin e shkresave të cilat përkthehen. Pas fillimit të hetimeve dhe veprimeve të Avokatit të Popullit për ankesat e lartpërmendura, palët përgjegjëse në këto raste, në afatin më të shkurtër, i kanë përkthyer aktgjykimet në gjuhët e palëve në procedurë dhe të njëjtat iu kanë dorëzuar atyre në mënyrë të rregullt.

Duke i vlerësuar faktet e vërtetuara dhe dispozitat juridike në këto raste, Avokati i Popullit konstaton që gjykatat, në të gjitha procedurat gjyqësore, duhet të sigurojnë barazinë e gjuhëve zyrtare dhe të punësojnë një numër përkates të përkthyesve, për të siguruar që të gjitha procedurat, dokumentet, njoftimet dhe shkresat në lidhje me procedurat, të lëshohen në afat të arsyeshëm në gjuhën(t) zyrtare, e cila është zgjedhur për atë proces,³⁰² me qëllim të parandalimit të zvarritjes së panevojshme të procedurave gjyqësore në kuptim të nenin 6 të KEDNJ-së.³⁰³

Shteti ka obligim të përgjithshëm që t’i zgjidhë problemet sistematike që përbëjnë thelbin e shkeljes së vërtetuar të afatit kohor.³⁰⁴ Në vlerësimin e asaj se a mundet që kohëzgjatja e afatit kohor të konsiderohet e arsyeshme, merren parasysh këta tregues: kompleksiteti i lëndës, sjellja e parashtruesit të ankesës, sjellja e organeve gjyqësore dhe administrative të shtetit, si dhe fakti se cila e drejtë e ankuesit është e rrezikuar në vetë lëndën.³⁰⁵ Prandaj, gjyqësorit

³⁰² *Ligji Nr.02/L37 për përdorimin e gjuhëve*, Përdorimi i gjuhëve në proceset gjyqësore, nenet 12-14.

³⁰³ *GJEDNJ*, rasti *Stögmüller v. Austria*, 10.11.1969, f. 5. Gjyqi ka theksuar se qëllimi i garantimit të afatit të kuptueshëm është “mbrojtja e të gjitha palëve pjesëmarrëse u procedurën gjyqësore nga vonesat e tepruara të procedurës”.

³⁰⁴ Po aty.

³⁰⁵ *GJEDNJ*, rasti *Buchholz v. the Federal Republic of Germany*, 6 maj 1981, f. 49.

vendor i mbetet përgjegjësi e veçantë që të siguroj se të gjithë ata që kanë ndonjë rol në procedurë të bëjnë gjithë çka mundën për të mënjeluar çfarëdo vonese të panevojshme.³⁰⁶

Për aq sa u theksua, del se parashtruesve të ankesave, për shkak të vonesave të tepërta në përkthimin e vendimeve gjyqësore, iu është pamundësuar jo vetëm të informohen me përmbajtjen e vendimit gjyqësor në gjuhën e vet, por edhe për të drejtën e shfrytëzimit të mjetit juridik, të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 13 të KEDNJ-së.³⁰⁷

2.24.2 Përdorimi i gjuhës në nivelin qendror dhe lokal

Përveç trajtimit të ankesave, IAP gjatë periudhës raportuese ka mbikëqyrë dhe përcjellë gjendjen, zbatimin dhe respektimin e të drejtave gjuhësore të komuniteteve në nivelin lokal dhe qendror, gjatë së cilës përfaqësuesit e IAP-së, me qëllim të shikimit të gjendjes së tërësishtme në zbatimin dhe realizimin e të drejtave gjuhësore, kanë biseduar me përfaqësuesit e organeve përgjegjëse shtetërore dhe lokale, të gjykatave, të komuniteteve minoritare etj.

Duke i analizuar të dhënat e mbledhura dhe praktikat në nivelin lokal e qendror lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare, përkundër mbrojtjes së zhvilluar kushtetuese dhe ligjore të të drejtave gjuhësore, është evidente që nuk ka përparim të madh në krahasim me periudhën raportuese paraprake, dhe se në Kosovë nuk është siguruar plotësisht përdorimi i barabartë zyrtar i gjuhëve të komuniteteve pakicë, gjë që ende shkakton pabarazinë juridike dhe shoqërore në realizimin e të drejtave gjuhësore.

Në tërë territorin e Republikës së Kosovës, gjuha shqipe dhe serbe janë gjuhë e kushtetutës dhe ligjeve, kuvendit, gjyqësisë, pushtetit ekzekutiv, administratës shtetërore, organeve dhe organizatave tjera shtetërore, sistemit arsimor dhe edukativ, ndërmarrjeve publike, institucioneve, vetëqeverisjes lokale, komunikimit të administratës shtetërore me qytetarët, si dhe e mjeteve të komunikimit masiv. Ato janë të obligueshme në emërtimet e organeve të pushtetit dhe administratës shtetërore, organeve të tjera shtetërore, ndërmarrjeve publike, institucioneve dhe organeve të vetëqeverisjes lokale; në hartimin dhe shpalljen e Kushtetutës, ligjeve dhe akteve tjera normative juridike; në tërësinë e procedurës zgjedhore në të gjitha nivelet; në marrëdhëniet e ndërsjella të organeve të pushtetit shtetëror, në marrëdhëniet me organet tjera shtetërore dhe organet e vetëqeverisjes lokale si dhe me qytetarët; në shkrimin e emërtimeve gjeografike, shenjave të komunikacionit, mbishkrimeve dhe njoftimeve; në lëshimin e të gjitha dokumenteve zyrtare qytetarëve të Republikës së Kosovës; në lëshimin e dokumenteve shkollore në institucionet me akreditim shtetëror; në të gjitha institucionet publike të arsimit dhe edukimit etj.

Të gjitha komunat në Kosovë deri më tani i kanë miratuar rregulloret komunale për përdorimin e gjuhëve. Gjuha turke momentalisht është zyrtare në komunat Prizren dhe Mamushë Më 2007 dhe 2008, komunat Gjilan, Mitrovicë, Prishtinë dhe Vushtrri gjithashtu e

³⁰⁶ GJEDNJ, rasti *Guincho v. Portugal*, 10 korrik 1984.

³⁰⁷ Neni 13 i KEDNJ-së siguron mjetin juridik efikas para organeve nacionale për shkak të çfarëdo shkeljeje të të drejtave të mbrojtura. Të drejtat e garantuara me nenin 13 janë të natyrës procedurale. Ai ka rëndësi të posaçme për sistemin juridik vendor, meqenëse në sistemin vendor kërkohet disponueshmëria e mjeteve juridike efektive ndaj shkeljes së të drejtave të njeriut dhe i drejtohet autoriteteve kompetente kombëtare, sepse ato kanë obligim t'i hetojnë pretendimet për shkeljet e të drejtave të njeriut.

kanë njohur turqishten si gjuhë në përdorim zyrtar. Boshnjakishtja është gjuhë zyrtare në komunat Prizren, Dragash dhe Pejë, e në përdorim zyrtar në komunën e Istogut. Komuna e Graçanicës, me vendimin e datës 10 tetor 2014, e ka njohur gjuhën rome si gjuhë në përdorim zyrtar, pasi që, sipas nenit 2.4 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, ajo gjuhë i plotëson kushtet të njihet si e tillë.

2.24.3 Problemet me përkthimet në gjuhët zyrtare

Ende nuk janë tejkaluar problemet rreth cilësisë së përkthimit në gjuhën serbe të ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat i nxjerrin institucionet e Kosovës në nivelin qendror dhe lokal, e as problemet me cilësinë e dokumenteve të përkthyer në gjuhën turke dhe boshnjake, të cilat janë në përdorim zyrtar në shumë komuna në Kosovë. Po ashtu, mungesa e përkthyesve për gjuhën boshnjake dhe turke, pjesëtarëve të këtyre komuniteteve iu pamundëson që në procedurat në organet shtetërore të përdorin gjuhën dhe shkrimin e tyre, kështu që ata përdorin gjuhën shqipe dhe serbe në komunikim me organet shtetërore, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror, dhe i marrin dokumentet në njërin nga këto dy gjuhë, për t'iu shmangur procedurave të gjata.³⁰⁸

Edhe më tutje, në komunat dhe gjykata e të gjitha niveleve, mungojnë burimet njerëzore dhe financiare, hapësira e përshtatshme për zyra, si dhe mjetet teknike themelore për përkthyesit me gojë dhe me shkrim, duke përfshirë fjalorët, programet kompjuterike që automatikisht e kontrollojnë drejtshkrimin ose aparatet për incizim. Shpeshherë përkthyesit nuk i kanë kualifikimet përkatëse dhe përvojën, prandaj domosdo iu duhet trajnimi profesional. E tërë kjo ua rëndon komuniteteve pakicë qasjen në shërbimet publike dhe pjesëmarrjen efektive në jetën publike.

Është vërtetuar se shumica e komunave ende nuk e kanë respektuar obligimin e vendosjes së mbishkrimeve brenda dhe jashtë komunës, si dhe të njoftimeve në tabelat e shpalljeve, në të gjitha gjuhët zyrtare. Ky obligim gjithashtu nuk po respektohet as në qendrat primare të mbrojtjes shëndetësore. Dokumentet e shkruara iu lëshohen palëve kryesisht në gjuhën e shumicës, ndërsa për përkthimin e tyre pritet gjatë dhe ato zakonisht përkthehen veç me kërkesë të palës. Shkaqet e kësaj janë të njëjta sikurse viteve të kaluara, numri i vogël i përkthyesve, mungesa e kualifikimeve për përkthim dhe e mjeteve financiare etj.

2.24.4 Problemet dhe shkaqet e mosrespektimit të gjuhëve zyrtare në administratën publike

Gjithashtu, disa nëpunës në zyrat komunale për komunitete, si dhe disa pjesëtarë të komunitetit serb vazhdimisht i theksojnë problemet në komunikim me organet komunale, ku në shërbimet të cilat për çdo ditë komunikojnë me pjesëtarët e komuniteteve pakicë, nëpunësit e ri të administratës publike shpeshherë nuk flasin gjuhën serbe (në zyrat për kadastër, për tatime, për regjistrim civil etj.).

³⁰⁸ KEDNJ, neni 13.

Shqiptarët, tash sa vjet, kanë probleme të ngjashme në komunat me shumicë të komunitetit serb në veri të Kosovës, ku fare nuk respektohet përdorimi i gjuhëve zyrtare. Kurse, në disa komuna me shumicë të komunitetit serb në pjesën qendrore të Kosovës, pa marrë parasysh punësimin e disa nëpunësve komunal shqiptarë, ka situata kur ata duhet t'iu drejtohen të punësuarve serbë në gjuhën serbe, sepse ata kryesisht e flasin dobët gjuhën shqipe.

Shkak i gjithë kësaj është mungesa e nëpunësve të administratës publike të cilët i njohin mirë gjuhët zyrtare dhe mungesa e trajnimit përkatës të gjuhës për nëpunës, e posaçërisht përkthyesit në komuna, mosinteresimi i tyre për mësimin dhe përsosjen e gjuhës, si dhe niveli i ulët i përfaqësimit të disa komuniteteve në administratën publike.

Avokati i Popullit vëren se Qeveria e Kosovës, as gjatë kësaj periudhe raportuese, nuk bëri përpjekje të dukshme sa i përket rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të dhëna në dy raportet vjetor paraprake, që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

2.24.5 Problemet e informimit elektronik në gjuhë të ndryshme nëpër komuna

Gjithashtu, Avokati i Popullit vëren se komunat ende nuk i kanë plotësuar rekomandimet e Avokatit të Popullit³⁰⁹ që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve zyrtare në ueb faqet zyrtare të komunave, pasi që në disa komuna dokumentet publike nuk janë publikuar në gjuhët zyrtare.

Gjatë përcjelljes dhe analizimit të ueb faqeve, është vërejtur se vetëm shtatë prej tyre janë plotësisht të harmonizuara me rregullat gjuhësore, edhe nëse përkthimi nganjëherë vonohet pak.³¹⁰ Komuna e Mamushës e ka versionin e faqes së internetit në gjuhën turke, mirëpo informatat nuk janë plotësisht të bartura në faqe në gjuhët zyrtare. Komuna e Prizrenit nuk e ka faqen në gjuhën boshnjake dhe nuk e përditëson rregullisht faqen në gjuhën serbe, kurse lidhja me versionin në gjuhën turke nuk hapet. Komuna e Dragashit nuk e ka faqen në gjuhën boshnjake, sikurse as komuna e Pejës, e cila nuk e ka as versionin në gjuhën serbe. Në komunat tjera, faqet e internetit kryesisht nuk janë në pajtim me kornizën ligjore, qoftë se janë njëgjuhëshe ose, edhe kur teknikisht janë në dispozicion në gjuhët zyrtare, shfaqin një varg mangësish, siç janë përditësimet e rralla, cilësia e dobët e përkthimit ose kategoritë e papërfunduara.³¹¹

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, komuna ka për obligim që në çdo ueb faqe zyrtare, në mënyrë të barabartë, të siguroj dhe publikoj informatat identike në të dy gjuhët zyrtare të komunës.

³⁰⁹ LAP, rasti *ex officio* A. nr. 275/2012.

³¹⁰ Ueb faqet e komunave Graçanicë, Kamenicë, Klllokot, Novobërdë, Ranillug, Shtërpcë dhe Vushtrri në bazë të rishikimit të realizuar nga këshilltarja ligjore e IAP-së, më 1.10.2014.

³¹¹ Raporti i OSBE-së, Respektimi i i të drejtave gjuhësore në komuna në Kosovë, qershor 2014. f.19-20.

2.24.6 Shembulli i mirë – përmirësimi në zbatimin e së drejtës së regjistrimit të emrit personal

Gjatë periudhës raportuese Avokati i Popullit vëren përmirësimin në zbatimin e së drejtës në regjistrimin e emrave të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, sipas gjuhës dhe shkrimit të tyre dhe është ndërruar praktika e librave amzë lidhur me regjistrimin e emrave në gjuhën dhe shkrimin e komuniteteve pakicë.

Në këtë drejtim në dhjetor të vitit 2013, MPB ka miratuar Udhëzimin e ri Administrativ nr. 25/2013 për dokumentimin e gjendjes civile, zbatimi i të cilit ka filluar më 2014. Udhëzimi Administrativ përkufizon llojet, format, komponentët përmbajtësor, mirëmbajtjen e regjimit, afatin e vlefshmërisë së dokumenteve të cilat ruhen dhe lëshohen sipas rregullave të shërbimit civil dhe lëshimin e atyre dokumenteve,³¹² si dhe atë se dokumentet personale lëshohen me kërkesë të palës, në gjuhën e komunitetit të cilit ai/ajo i takon, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.³¹³

2.24.7 Zyra e Komisionerit për Gjuhë

Avokati i Popullit, gjatë monitorimit të realizimit të të drejtave gjuhësore vëren se Zyra e Komisionerit për Gjuhë (ZKGJ), gjatë periudhës raportuese ka ndërmarrë një sërë aktivitete të suksesshme në nivel sistematik, të cilat koji tregojnë angazhimin dhe vendosmërinë e ZKGJ-së për realizimin e mandatit të besuar dhe vendosjen e praktikës së mirë, e cila, me përdorimin e plotë të gjuhëve zyrtare dhe shkrimeve të tyre, do të jetë e qëndrueshme në pajtim me Ligjin.

ZKGJ e ka vendosur ueb faqen e saj në pesë gjuhë (shqip, serbisht, boshnjakisht, turqisht dhe anglisht), e ka krijuar formularin *on line* për ankesa dhe i ka zgjidhur ankesat e parashtruara përmes ndërmjetësimit.

Me forcimin e zyrës dhe promovimit të saj, vërehet që nga viti në vit po rritet numri i ankesave të drejtuara ZKGJ-së.³¹⁴ Shenjë trimëruese është se edhe pse deri më tani ato janë vetëm zgjidhje individuale e jo edhe sistematike, të gjitha ankesat e qytetarëve, përveç disa të cilat janë në proces të zgjidhjes, veçse janë zgjidhur në dobi të vet parashtruesve.³¹⁵

Rekomandime:

- ***Që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të siguroj barazinë e gjuhëve zyrtare në të gjitha gjykatat ashtu që të gjitha procedurat, dokumentet, njoftimet dhe shkresat lidhur me procedurën, të lëshohen në afat të arsyeshëm në gjuhën(t) zyrtare të palëve.***

³¹² Udhëzimi Administrativ nr.25/2013 për dokumentacionin e gjendjes civile, neni 1.

³¹³ Po aty, neni 8, paragrafi 1-2.

³¹⁴ Në vitin 2014 në këtë zyrë janë parashtruar mbi 50 ankesa për shkeljen e të drejtës për përdorimin e gjuhëve.

³¹⁵ Informatat e dhëna nga Komisioneri për Gjuhë gjatë takimit me përfaqësuesit e IAP-së, të mbajtur më 10.11.2014, në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës.

- *Që Qeveria e Kosovës të siguroj që të gjitha institucionet në nivel qendror dhe lokal t'i punësojnë përkthyesit profesional për gjuhët zyrtare në Kosovë, për t'u përmirësuar cilësia e përkthimit në këto gjuhë.*
- *Që Ministria e Administratës Publike, në bashkëpunim me komunat, të siguroj dhe të monitoroj që ueb faqet e komunave të përmbajnë informacione në të gjitha gjuhët zyrtare, në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve.*
- *Që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal t'iu ofroj këshilla dhe udhëzime komunave në aspektin e detyrimeve të veta për të mbështetur statusin e njëjtë dhe përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare në punën e tyre.*
- *Që Zyra e Komisionerit për Gjuhë të forcoj monitorimin e respektimit të obligimeve gjuhësore të institucioneve të Kosovës që parashihen me ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe të vazhdoj me ndërmartjen e masave me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve të Kosovës për të drejtat e tyre gjuhësore.*

2.25 Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre

Në bazë të mandatit të vet IAP edhe në këtë raport vjetor, një vëmendje të veçantë ua kushton të drejtave të komuniteteve pakicë në Kosovë dhe realizimit efektiv të të drejtave të njeriut dhe të pakicave, si dhe sfidave dhe problemeve, me të cilat janë përballur komunitetet pakicë gjatë periudhës raportuese.

Për shkak të legjislacionit për të drejtat e veçanta dhe numrit të komuniteteve, një raport nuk mund të punohet vetëm përmes analizës së parashtresave individuale të trajtuara në IAP, por para së gjithash nëpërmjet të dhënave të grumbulluara, informacioneve të marra dhe përmes monitorimit të punës së institucioneve të ndryshme, sidomos atyre që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me pjesëtarë të komuniteteve pakicë, si dhe ndikim në aspektin e respektimit ose shkeljes së të drejtave të komuniteteve pakicë.

Gjithashtu, për punimin e kësaj teme një rëndësi të madhe kanë edhe kontaktet e drejtpërdrejta, të menjëhershme me qytetarë, me të cilët kanë biseduar zyrtarët e IAP, me qëllim të mbledhjes së informacioneve në terren në lidhje me situata të ndryshme dhe në lidhje me pengesat me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve joshumicë me rastin e realizimit të të drejtave të tyre.

Duke analizuar në përgjithësi, mund të përfundohet, si në raportet e mëparshme vjetore, që komunitetet pakicë në Kosovë, përkundër kornizës ligjore jashtëzakonisht të mirë që i mbron të drejtat e tyre dhe veprimeve pozitive afirmative në nivelin qendror dhe lokal, megjithatë, kanë qenë të margjinalizuara, kur është në pyetje respektimi i obligimeve të caktuara ligjore dhe kushtetuese të të gjitha niveleve të qeverisë ndaj tyre. Në fakt, të gjithë shembujt pozitivë reduktohen vetëm në disa raste individuale dhe jo në komunitete pakicë në tërësi, gjë që është e domosdoshme të ndryshohet në të ardhmen.

Në lidhje me problemet e disa komuniteteve do të diskutohet në vazhdim përmes pjesëve të veçanta, në të cilat janë paraqitur të gjeturat, vëzhgimet dhe problemet me të cilat përballen komunitetet pakicë në Kosovë në jetën e përditshme. Me këtë rast vlen të kujtohet korniza e përgjithshme ligjore që mbron të drejtat e komuniteteve pakicë, e këto janë: Kushtetuta e

Republikës së Kosovës,³¹⁶ Konventa kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare,³¹⁷ dhe Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.³¹⁸

Avokati i Popullit konsideron se edhe në këtë periudhë raportuese, nuk ka pasur përparim të dukshëm dhe përmirësim të situatës, në të cilën janë komunitetet pakicë.

2.25.1 Kthimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur në Kosovë

Raporti i cili ka të bëjë me kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur në Kosovë bazohet në të dhënat të cilat IAP i ka grumbulluar gjatë vitit 2014, e të cilat janë të mbështetura në të dhënat statistikore të UNHCR-së për personat e zhvendosur, si dhe të dhënat e siguruara nga përfaqësuesit e institucioneve lokale dhe qendrore.³¹⁹

Duke analizuar të dhënat statistikore të UNHCR-së³²⁰ vijmë në përfundim se prej vitit në vit vazhdon trendi i rënies së kthimit të personave të zhvendosur, pjesëtarë të komuniteteve pakicë. Gjatë vitit 2014 janë kthyer gjithsej 407 pjesëtarë të komuniteteve pakicë, që për fat të keq është pothuajse gjysma e numrit të personave të kthyer, krahasuar me vitin 2013. Për sa i përket kthimit, në procesin e gjertanishëm ka munguar efikasiteti dhe qëndrueshmëria e saj për arsye se në thelb mungojnë projektet dhe programet konkrete të cilat do t'u ofroheshin të kthyerve, që pas asistencës periodike në ushqim të mund të vazhdojnë të krijojnë dhe ekzistojnë në mënyrë vetanake, pa mbështetje të organizatave humanitare. Problemi qëndron në faktin se popullata e vjetër në moshë vendos për t'u kthyer, derisa gjenerata e re jo me dëshirë vendos për këtë hap, për shkak të perceptimit individual të sigurisë, por edhe për shkak të pamundësisë për t'u punësuar dhe gjendjes së përgjithshme ekonomike. Kthimi i popullatës së re të komunitetit serb vërehet vetëm në ato mjedise ku popullata serbe përbën shumicën, ku qasja në shkollim, punësim dhe shërbime shëndetësore në masë të madhe është më e mirë se në mjedise të tjera. Lidhur me këtë, nuk është befasues fakti se në vendet urbane kthehen vetëm individët, posaçërisht personat e moshuar. P.sh. në Prizren janë kthyer vetëm disa persona të komunitetit serb, prej të cilëve gjithsej 5 fëmijë në tërë komunën e Prizrenit³²¹ derisa në Pejë janë kthyer gjithsej 9 serbë të cilët edhe jetojnë aty. Duhet të cekim se në fshatin Bellopojë në komunën e Pejës jetojnë vetëm 10 familje, prej 100 shtëpive sa janë ndërtuar për të kthyerit (të tjerët vijnë në mënyrë periodike gjatë verës ose vetëm për t'i vizituar pronat e tyre).³²²

³¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 59, 60, 61 dhe 62.

³¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22(4), i cili synon të përmirësoj barazinë e gjithmbarshme dhe efikase të komuniteteve pakicë në të gjitha fushat e jetës, si ato ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore.

³¹⁸ Ligji Nr. 03/L-47 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, 13 mars 2008.

³¹⁹ Mbledhjet në mes të përfaqësuesve të IAP-së dhe kryesuesve të zyreve për komunitete dhe kthim në Pejë, Graçanicë, Prizren, Rahovec e Klinë gjatë tetorit dhe nëntorit 2014 si dhe deklaratat publike të MKK, të marra nga ueb faqja zyrtare e MKK-së.

³²⁰ Zyra e shefit të misionit të UNHCR-së në Prishtinë, vështrim i të dhënave statistikore të përditësuara në fund të tetorit 2014. Në bazë të të dhënave të marra nga UNHCR në periudhën janar - tetor 2014 në Kosovë janë kthyer: 238 serb, 22 rom, 121 ashkali dhe egjiptas, 9 boshnjakë, 16 goranë dhe 1 malazias.

³²¹ Informata të marra në mbledhjen me shefin e Zyrës komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKK) në Prizren më 20 nëntor 2014; 1 fëmijë jeton dhe vijon shkollimin si nxënës i vetëm në gjuhën serbe në ndërtesën e Bogoslllovisë së Prizrenit, derisa 4 fëmijë me prindërit e tyre jetojnë në fshatin Novakë.

³²² Informata të marra në mbledhjen me shefin e ZKK-së në Pejë më 21 nëntor 2014.

Zyrrat për komunitete të cilat në punën e tyre përfshijnë komunitetin boshnjak në Kosovë, theksojnë problemin e shpërnguljes së popullatës së re të kësaj bashkësie, për shkak të pozitës shumë të vështirë dhe pamundësisë për punësim, si dhe për shkak të kushteve më të favorshme për studime në qendrat e arsimit të lartë në Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi.³²³

2.25.2 Situata e sigurisë dhe incidentet sporadike

Çështja e sigurisë në lidhje me mbrojtjen dhe përmirësimin e të drejtave të pronës, si dhe të drejtës së banimit të personave të zhvendosur edhe të kthyer, vazhdojnë të ndikojë negativisht në procesin e kthimit. Kur është fjala për sigurinë, vazhdojnë të regjistrohen incidente sporadike kundër pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, e që kryesisht prek anëtarët e komunitetit serb në zonat e kthyer. Përveç incidenteve të vogla shënohet edhe një numër i konsideruar i incidenteve të rënda si zjarr-vënie, shkaktim dëmsh, shkrimi i porositve kërcënuese në muret e shtëpive dhe pronat e pjesëtarëve kryesisht serbë. Po ashtu janë regjistruar edhe një numër i vjedhjeve të makinave bujqësore e bagëtisë, si dhe një sulm fizik i armatosur. Në disa komuna nuk janë zbuluar sulmuesit nga Policia, andaj ka raste kur ato edhe janë përsëritur.

Në këtë kontekst, duhet theksuar se numri më i madh i incidenteve ka ndodhur në komunën e Klinës (në fshatrat Dërsnik, Grapç, Klinac dhe Drenoc, por edhe në Klinë), pastaj në Fushë Kosovë, Rahovec, fshatin Levoshë (komuna e Pejës), në fshatrat Zhaq, Gurrakoc dhe Shalë (komuna e Istogut), Viti dhe Gjilan.³²⁴ Deri më sot nga Policia e Kosovës janë zgjidhur vetëm dy raste të vjedhjes së bagëtisë në komunën e Klinës, ndërsa incidentet e tjera, si sulmet fizike dhe të armatosura kanë mbetur të pazbuluara apo janë ende në procedurë hetimore.³²⁵

Të gjitha këto dhe raste të ngjashme në masë të madhe dekurajojnë kthimin e qëndrueshëm dhe dekurajojnë edhe ata që mendojnë të kthehen, veçanërisht, pasi Policia e Kosovës nuk merret me incidente në mënyrë të duhur dhe nuk arrin të gjejë autorët e këtyre incidenteve.

Pos personave të zhvendosur jashtë Kosovës, në territorin e Kosovës ende janë funksionale qendrat kolektive për personat e zhvendosur, për të cilat IAP ka tërhequr vërejtjen edhe në periudhat e mëparshme raportuese. Për fat të keq personat e zhvendosur brenda vendit mbeten të akomoduar në 36 qendra kolektive, kryesisht në veri të Kosovës dhe komunat e Graçanicës dhe Shtërpçës,³²⁶ ku këta persona jetojnë në kushte shumë të vështira. Në raportet dhe komunikatat e veta MKK ka planifikuar që këto qendra kolektive të mbetura t'i mbyllë sa më parë, por që aktiviteti lidhur me këtë ende është në fazën e planifikimit. Me këtë rast duhet përmendur Strategjinë e re për komunitete dhe kthim (2014-2018) dhe Plani i Veprimit³²⁷ të cilën e ka hartuar MKK, e cila pasqyron objektivat strategjike për kthim të qëndrueshëm të personave të zhvendosur në Kosovë, për të cilët IAP beson se do të përmirësojë jo vetëm kthimin e të zhvendosurve, por dhe qëndrueshmërinë e saj.

³²³ Bisedë me shefat e ZKK-ve në Prizren, Dragash dhe Pejë më 14 tetor dhe 20 e 21 nëntor 2014.

³²⁴ Shih, në: <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12> (8.12.2014).

³²⁵ *Po aty*, si dhe biseda telefonike me shefin e ZKK në Klinë më 11 dhjetor 2014, i cili i ka konfirmuar informatat për sulmet ndaj të kthyerve në komunën e Klinës.

³²⁶ Shih në: <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12> (8.12.2014).

³²⁷ MKK, Strategjia për komunitete dhe kthim dhe Plani i Veprimit (2014-2018), janar 2014.

Çështja e mbrojtjes së pasurisë dhe të drejtave pronësore të personave të zhvendosur edhe më tej paraqet problem të madh, e që përbën një prej faktorëve kyç për një kthim të qëndrueshëm. Edhe përkundër faktit se AKPr ka zgjidhur më shumë se 96 % të rasteve të dorëzuara.³²⁸ Megjithatë në disa raste edhe pas dëbimit të banorëve të paligjshëm dhe uzurpatorëve të pasurisë së paluajtshme të personave të zhvendosur, ka ndodhur që ato përsëri të uzurpohen.

Pritja shumëvjeçare që AKPr t'i zgjidhte rastet e parashtruara nga ana e pronarëve të patundshmërive, si dhe vonesat në zbatimin e vendimeve nga AKPr kundruall banorëve të paligjshëm, pamundësojnë popullatën e shpërngulur të kthejnë pronën në pronësinë e vet dhe që të njëjtën ta përdorin dhe shfrytëzojnë lirshëm dhe të papenguar, gjë që paraqet shkeljen e së drejtës në pronë.³²⁹ Pos kësaj, të shpeshta janë rastet e zvarritjes ose refuzimit të autoriteteve të caktuara lokale të regjistrojnë pronën në zyrat e kadastrës dhe të lëshojnë certifikatat e pronësisë në emër të pronarëve legjitimë, pas dorëzimit të dokumentacionit dhe vendimeve përfundimtare të AKPr-së. Për këtë shkak qytetarët janë të detyruar që t'i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë, njësisë për konteste administrative dhe kështu detyrohen sërish që me vite të presin në zgjidhjen e kontestit, tani me autoritetet lokale.³³⁰ Informatat e cekura dokumentohen nga zyrtarët ligjorë të IAP-së të cilët pranojnë, regjistrojnë dhe punojnë në ankesat që lidhen me çështjet e të drejtës pronësore.³³¹

Vëmendje e posaçme duhet kushtuar edhe faktit se pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, para luftës së vitit 1999, kryesisht kanë jetuar nëpër lagjet e joformalizuara dhe mu për këtë fakt, tani përballen me probleme për të dokumentuar të drejtën pronësore dhe banesore. Në seriozitetin e problemit të zhvendosjes brenda Kosovës ka raportuar edhe Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara në raportin e tij të 5 qershorit 2014, gjatë vizitës në Kosovë.³³²

Rekomandime:

- *Agjencia Kosovare e Pronës të shtojë dhe përmirësojë bashkëpunimin me pushtetin ekzekutiv në kuadër të kompetencave ligjore, në mënyrë që t'i jepet përgjigje më efektive uzurpimit të sërishëm të pronës në mënyrë të jashtëligjshme, për çka duhet një koordinim më i mirë me policinë e Kosovës dhe gjyqësorin.*

³²⁸ AKPr në: <http://www.kpaonline.org/sr/default.asp> (1.12.2014).

³²⁹ KEDNJ, neni 1, Protokoli 1 është instrument ligjor i aplikueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë.

³³⁰ LAP, rastet A. nr. 552/2014, A. nr. 262/2014, A. nr. 414/2014, A. nr. 546/2014 dhe A. nr. 339/2013.

³³¹ LAP, rastet A. nr. 56/2014, A. nr. 234/2014, A. nr. 226/2012, A. nr. 181/2013 si dhe rasti A. nr. 435/13. Në këtë rast konkret ankuesja ka kaluar nëpër të gjitha instancat gjyqësore në Kosovë, madje edhe GJKK ka sjellë vendim në dobi të saj në mesin e vitit 2014, ashtu që ankueses t'i kthehet prona në pronësi, por ajo deri në përfundim të këtij raporti nuk ka arritur të realizojë të drejtën e saj në përdorimin e pronës në mënyrë të papenguar.

³³² Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, "Raporti i Raportuesit Special mbi të drejtat njerëzore të personave të zhvendosur brenda vendit", 5 qershor 2014: "Edhe pse shumica e romëve, ashkalive dhe egjiptasve të zhvendosur kishin shtëpi, e drejta e tyre e banimit dhe e tokës kurrë nuk ka qenë e regjistruar dhe ata nuk kanë dokumentacion mbi pronësinë e shtëpive të tyre. Shumica dërrmuese e të kthyerve të cilët nuk kanë pronë janë romë, ashkali dhe egjiptas të cilët besojnë se nuk mund të kyçen në projekte të rindërtimit të shtëpive dhe kështu përfundojnë në zhvendosje të sërishme."

- *Policia e Kosovës të garantojë siguri dhe të veprojë në mënyrë efektive për të mbrojtur dhe zbuluar autorët e sulmeve të drejtuara kundër komuniteteve pakicë dhe të mbrojë pronën e tyre.*
- *MKK në kuadër të strategjisë së kthimit të përfshijë edhe projekte të cilat kanë të bëjnë me kthimin e qëndrueshëm, në kuptim të nxitjes së ekonomisë së vogël dhe stimulimit të bujqësisë në mjediset rurale të të kthyerve, me qëllim që personat e kthyer të kenë mundësi të punojnë dhe si rezultat të kësaj edhe kthimi i tyre të jetë më i qëndrueshëm.*
- *Qeverisja lokale, në koordinim dhe bashkëpunim me MKK, të përfshijë në planet e veta edhe nevojat banesore të të kthyerve dhe personave të riatdhesuar, të cilët para luftës së vitit 1999 kanë jetuar në lagjet e joformalizuara, në mënyrë që pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas, të mos vijnë në situatë të zhvendosjen sërish.*

2.25.3 Arsimimi i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë

Në fushën e arsimit, gjithashtu nuk ka ndonjë përparim domethënës në raport me periudhën e mëparshme raportuese të IAP-së. Ende ekzistojnë dy sisteme paralele të arsimit, njëri sipas planit dhe programit të MASHT-it të Republikës së Kosovës dhe tjetri, i cili është në përputhje me programin e Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë, të financuar nga Republika e Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, të pavarur njëri nga tjetri.

Gjatë periudhës raportuese, është për t'u lavdëruar fakti që nga janari i vitit 2014, për herë të parë u arrit një bashkëpunim i hapur ndërmjet institucioneve arsimore, të cilat punojnë sipas planit dhe programit të Serbisë (kjo e dhënë nuk vlen për institucionet arsimore në veri të Kosovës) dhe qeverive lokale, drejtorive komunale për arsim të Kosovës, gjë që parqet një hap përpara drejt integritimit të plotë me institucionet legjitime të Kosovës. Bashkëpunimi i deritashëm është shënuar në ndihmën e institucioneve arsimore të qeverisjes vendore, në kuptimin e ngrohjes për dimër, pajisjeve shkollore, materialeve të zyrës për administrimin e shkollës, organizimin e transportit për nxënësit e të ngjashme.

Një problem tjetër paraqet mosnjohja e diplomave të arsimit të lartë, të fituara në fakultete, shkolla të larta dhe në Universitetin e Mitrovicës në Veri, i cili punon sipas sistemit arsimor të Serbisë. Përkundër marrëveshjeve të arritura në Bruksel në mes Kosovës dhe Serbisë për njohjen reciproke të diplomave, kjo çështje ka mbetur ende e pazgjidhur për shkak të moszbatimit të marrëveshjeve.

Si edhe më parë, anëtarët e komunitetit të turqve, boshnjakëve, shumicës së komunitetit të ashkalive, egjiptianëve dhe një pjesë me e vogël e komunitetit rom, i ndjekin mësimet sipas planit dhe programit të MASHT-it. Pjesëtarët e komunitetit serb, kroat,³³³ malazias, goran (komuna e Dragashit) dhe shumica e pjesëtarëve të komunitetit rom, e ndjekin mësimin në gjuhën serbe, sipas planit dhe programit të Serbisë.

Ende është prezent problemi i përfshirjes së vogël të fëmijëve të pjesëtarëve të komuniteteve të romëve, ashkalive dhe egjiptasve në përcjelljen e mësimave në shkolla. Në rastet më të

³³³ Shkolla fillore “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Janjevë, komuna e Lipjanit.

shpeshta, fëmijët e këtyre komuniteteve, pas përfundimit të arsimit fillor, nuk e vazhdojnë shkollimin e mëtejshëm. Ky fakt e inkurajoi Ambasadën e Mbretërisë së Norvegjisë që t'u ndihmojë këtyre komuniteteve dhe t'i inkurajojë fëmijët e romëve, ashkalive dhe egiptianëve, që pavarësisht nga situata e vështirë, ta vazhdojnë arsimimin e mesëm shkollor, duke i stimuluar me dhënie të 500 bursave, që u janë ndarë në fund të tetorit 2014. IAP e përshëndet një ndihmë të tillë të Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë dhe inkurajon edhe përfaqësitë e tjera diplomatike të vendosura në Republikën e Kosovës, por edhe organizatat e tjera ndërkombëtare, që të përkrahin projekte të tilla në gjithë territorin e Kosovës.

Mësimdhënia sipas planit dhe programit të Serbisë zhvillohet, sikurse më parë edhe në disa fshatra të komunës së Dragashit, të populluara me pjesëtarë të komunitetit goran, ndërsa pjesëtarët e komunitetit boshnjak në këtë komunë arsimohen në shkollat fillore dhe të mesme, që punojnë sipas planit dhe programit të MASHT-it.³³⁴

Problemi ende ekziston në kuptimin që nxënësit e komunitetit goran ende vazhdojnë të jenë të privuar nga e drejta për të përdorur objektet e dy shkollave fillore në Krushevë dhe Dragash, si dhe ndërtesën e një shkolle të mesme në Dragash, për shkak të vendimit të prindërve që fëmijët të vijojnë mësimin sipas planit dhe programit të Serbisë, prandaj këta nxënës janë të detyruar që nga Krusheva dhe Dragashi ta vijojnë mësimin në shkollë në fshatra të tjera dhe të udhëtojnë.³³⁵ Në tri vitet e fundit, siç raportoi IAP, me ndërmjetësimin e OSBE-së është bërë një përpjekje për ta zgjidhur problemin, me qëllim që pjesëtarët e komunitetit goran të integrohet në sistemin arsimor të Kosovës dhe të kthehen në shkollën e tyre lokale, mirëpo deri në fund të periudhës raportuese, kjo çështje nuk është zgjidhur.

Pjesëtarët e komunitetit boshnjak që jetojnë në rajonet e Pejës, Prizrenit dhe Dragashit i ndjekin mësimet në gjuhën e tyre amtare, sipas programit të MASHT-it. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve theksojnë se ende nuk po zgjidhet problemi i mungesës së teksteve shkollore për shkollat e mesme dhe fakultetet në gjuhën boshnjake dhe pohojnë gjithashtu se edhe përkthimi i teksteve për nxënësit e shkollave fillore është shumë i keq, njëkohësisht mungojnë tekstet për lëndët qytetare kombëtare si: gjuha amtare, historia, gjeografia dhe teksti i edukatës muzikore për klasën e 10 dhe të 11-të.³³⁶

Për këtë problem ka raportuar edhe IAP në raportet e tij të mëparshme, por problemi ende nuk është zgjidhur. Mungesa e teksteve shkollore për shkollat e mesme, siç e theksojnë në zyrat për komunitete në komunat ku jetojnë boshnjakët, kompensohet me marrjen e librave nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia. Gjithashtu, si pozitiv duhet të theksuar faktin që nga viti shkollor 2014/15 është hapur shkolla e mesme e mjekësisë në gjuhën boshnjake në Dragash, me iniciativën e zyrës komunale për komunitete dhe kthim dhe me miratimin e DKA në Dragash.³³⁷

Nxënësit e komunitetit boshnjak, pas përfundimit të shkollimit të mesëm kanë mundësi të vijojnë studimet në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" (Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti i Teknologjisë Kompjuterike dhe Telekomunikacionit) dhe në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka" (Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Biznes, i cili nga ky vit filloi të regjistrojë edhe studentët në nivelin master).

³³⁴ Në komunën e Dragashit janë 6 shkolla fillore dhe 2 shkolla të mesme, të cilat punojnë edhe sipas sistemit të arsimit të Republikës së Kosovës edhe sipas sistemit të arsimit të Republikës së Serbisë.

³³⁵ Raporti „*Kthimi në shkollat në rajonin e Dragashit*“, European Centre for Minority Issues Kosovo (ECMI) në lidhje me arsimin në komunën e Dragashit, datë 8 nëntor 2014.

³³⁶ Informacionet e marra në një takim me shefin e ZKK në Prizren, më 20 nëntor 2014.

³³⁷ Informacionet e marra në një takim me shefin e ZKK në Dragash, më 14 tetor 2014.

Boshnjakët në komunën e Prizrenit nga fshatrat Mushnikovë, Lubizhdë dhe Gërncar gjithnjë e më shpesh po vendosin t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në klasat, ku mësimi mbahet në gjuhën shqipe, për shkak të mundësisë së integritit më të lehtë dhe për arsye të mësimi të gjuhës shqipe, si dhe për shkak të kushteve më të mira dhe mundësisë së zgjedhjeve kur është fjala për edukim të mëtejshëm.³³⁸

Sa i përket komunitetit turk, në bazë të informatave të mbledhura, vetëm mund të konstatohet se janë integruar më së miri në shoqërinë kosovare, qoftë në fushën e arsimit, qoftë në fushat e tjera dhe jetën e përditshme. Pjesëtarët e komunitetit turk janë të pakënaqur me cilësinë dhe numrin e teksteve shkollore në gjuhën turke, të cilat kur mungojnë i marrin nga Turqia.

Rekomandimet:

- *Qeveria e Kosovës të bëjë përpjekje maksimale për njohjen reciproke të diplomave, dhe të ndihmojë edhe në këtë mënyrë avancimin e të drejtave të komuniteteve.*
- *MASHT-i t'i kushtojë kujdes të veçantë përmirësimit të cilësisë së teksteve në gjuhën turke dhe boshnjake për vitin e ardhshëm shkollor 2015/16 dhe gjithashtu të sigurojë tekstet që mungojnë në këto gjuhë, me qëllim që pjesëtarët e komunitetit turk dhe boshnjak të mos detyrohen të kërkojnë zgjidhje nga Turqia dhe Bosnjë e Hercegovina.*
- *Qeveria e Republikës së Kosovës si dhe qeverisjet lokale, t'i kushtojnë vëmendje të veçantë arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptias për t'i motivuar të rinjtë që të mos e braktisin shkollimin.*
- *Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me qeverisjet lokale, të hartojnë plan konkret të veprimit për ngritjen e vetëdijes së prindërve dhe fëmijëve të komuniteteve të përmendura, në mënyrë që fëmijët e tyre të mos e braktisin shkollimin.*

2.25.4 Situata e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptias

Pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptias po përballen me një situatë të vështirë në aspektin socio-ekonomik, arsimor, të kushteve të banimit në të cilat jetojnë dhe në aspektin e integritit të tyre më të mirë në shoqëri.

Kur flitet për realizimin e "Strategjisë për Integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë në shoqërinë e Kosovës", të miratuar në vitin 2008, me Planin e Veprimit për zbatimin e saj (që nga viti 2009), nuk është bërë shumë për përmirësimin e gjendjes së romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në aspektin ekonomik, politik dhe arsimor. Konstatimi është se shumë prej veprimeve të parapara në planin e veprimit janë zbatuar pak, ose nuk janë zbatuar fare, kështu që nuk mund të flitet për një përmirësim të dukshëm të gjendjes së komuniteteve të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve.³³⁹

³³⁸ Informacionet e marra në një takim me shefin e ZKK në Prizren më 20 tetor 2014.

³³⁹ Informacionet e marra nga përfaqësuesi i organizatës së shoqërisë civile, veçanërisht nga OJQ "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians" (Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve) nga Graçanica.

Shembuj pozitivë të zbatimit të Strategjisë mund të vërehen vetëm në disa komuna të caktuara ku është bërë diçka vetëm në fushat e kulturës dhe arsimit (libra shkollore dhe pajisje për nxënës) dhe atë vetëm mbi bazën e donacioneve të huaja, ndërsa mjete të drejtpërdrejta materiale nga qeverisja lokale pothuajse nuk ka pasur.

Gjendja e vështirë socio-ekonomike, në të cilën jetojnë romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, ka krijuar si rezultat situatën e shpërnguljes masive të këtyre komuniteteve nga Kosova gjatë disa muajve të fundit, gjë që dëshmohet nga raportet e organizatave të shoqërisë civile që merren me komunitetet pakicë.³⁴⁰

Sipas informatave të mbledhura nga IAP, numri i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptias, të cilët e braktisën Kosovën (qoftë individualisht, qoftë familje të tëra) silltet diku rreth 1700-2000 persona deri në fillim të dhjetorit të vitit 2014, ndërsa numri më i madh i tyre janë nga Ferizaj, Prizreni, Fushë Kosova dhe Obiliqi.³⁴¹

Personat, të cilët u larguan nga Kosova, në ndërkohë flitet për dhjetëra-mijëra qytetarë të Kosovës, në mesin e të cilëve janë edhe 3000-4000 pjesëtarë të këtyre komuniteteve, migrojnë kryesisht në vendet e Evropës perëndimore përmes kanaleve ilegale, kurse si arsye më të shpeshtë për largim nga Kosova e citojnë gjendjen e tyre socio-ekonomike.

Konkludimi logjik dhe i pashmangshëm është se situata me shpërnguljen masive të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve është shqetësuese dhe se është koha e fundit që qeveria t'i kushtojë vëmendje të veçantë zgjidhjes së problemeve të pjesëtarëve të komuniteteve në fjalë, siç është kërkuar ndër të tjera Qeverisë së Kosovës në letrën e hapur të datës 6 nëntor 2014, e cila i është drejtuar Kryeministrit nga organizatat kryesore të shoqërisë civile të angazhuara për përmirësimin e gjendjes së komuniteteve të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, si dhe për të drejtat e minoriteteve në përgjithësi.³⁴²

Kur është fjala për personat e riatdhesuar nga radhët e komuniteteve të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, situata e tyre nuk ka ndryshuar në kuptimin pozitiv, në krahasim me raportin e IAP të vitit 2013. Nuk është përmirësuar, e as nuk ka ndonjë program për trajnimin profesional të personave të riatdhesuar, mundësitë për punësim janë të vogla, ndërsa nuk ekziston ndonjë program adekuat kalimtar edukativ për fëmijët e personave të riatdhesuar, para vazhdimit të shkollimit të rregullt. Të gjitha ato që u thanë edhe më tej e vështirësojnë edhe qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve publike dhe zyrave për personat e riatdhesuar.

Rekomandimet:

- *Institucionet qendrore dhe lokale duhet të bëjnë më shumë përpjekje për zbatimin e Strategjisë për ri-integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, për përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike dhe sidomos për nxitjen e arsimit të fëmijëve të këtyre komuniteteve.*

³⁴⁰ Raporti i ECMI „Sfidat në përpjekjet e Kosovës kaq integrimi: Shpërngulja në rritje e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve“, 3 dhjetor 2014.

³⁴¹ Informacionet e marra nga përfaqësuesi i organizatës së shoqërisë civile, veçanërisht nga OJQ “Voice of Roma, Ashkali and Egyptians” (Zëri i romëve, ashkalive dhe egjiptianëve) nga Graçanica.

³⁴² <http://www.ecmikosovo.org/?p=5808>, letër e hapur e udhëheqësit të Platformës së OJQ-ve që punojnë me komunitetet e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve (8.12.2014).

2.25.5 Përfaqësimi në punësim në organet qendrore dhe lokale të pushtetit

Në periudhën e mëparshme raportuese IAP i ka kushtuar vëmendje të veçantë kësaj çështjeje, dhe për këtë arsye ka monitoruar situatën në lidhje me punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në organet qendrore dhe lokale të pushtetit gjatë vitit 2014. Pjesëtarët e pakicave janë ende të përfaqësuara në përqindje të pamjaftueshme në administratën publike.

Duke analizuar pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë nëpër institucione, është e qartë se ata janë të pranishëm vetëm në disa ministri të caktuara, të cilat merren me çështjen e komuniteteve, si dhe në ato ministri në krye të të cilave gjenden përfaqësues të komuniteteve pakicë, siç është rasti me MKK, MAPL dhe MPMS (deri në fillim të dhjetorit të vitit 2014).

Avokati i Popullit kërkon që dispozitat ligjore në këtë fushë të interpretohen në mënyrën siç janë parashikuar, d.m.th. përfaqësimi duhet të jetë adekuat në çdo ministri veç e veç, në mënyrë që të mund të flitet për përfaqësimin proporcional të komuniteteve në nivelin qendror. Përveç kësaj, Avokati i Popullit thekson edhe faktin e përfaqësimit të pamjaftueshëm institucional të pjesëtarëve të komuniteteve të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, të cilët janë të përfaqësuar në numër më të vogël në të gjitha institucionet qendrore, edhe lokale të pushtetit.

Gjithashtu, duhet theksuar që ende është e vogël përqindja e pjesëtarëve të komuniteteve të pakicave në ndërmarrjet publike (rreth 2,5%), gjë që tregon se në këtë aspekt nuk ka ndryshuar asgjë që nga periudha e raportimit paraprak të IAP-së.

Rekomandim:

- *Të sigurohet përfaqësim i barabartë i të gjitha komuniteteve në nivelin lokal dhe qendror në punësim, sipas kërkesës së ligjit. Ndërsa të kërkohet medoemos që ndërmarrjet publike të respektojnë kërkesën ligjore për punësim të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, sidomos nga komunitetet ashkali, egjiptas dhe rom.*

Pjesa e tretë

2.26 Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

2.26.1 Vështrime të përgjithshme

Për Avokatin e Popullit mbetet shqetësim i jashtëzakonshëm dhe plagë e hapur për Republikën e Kosovës, mungesa e zbatimit të ligjit dhe të respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut në fushën e drejtësisë.

Edhe gjatë këtij viti raportues, gjyqësorin e Kosovës, gjykatat dhe prokuroritë së bashku, e kanë përcjellë vështirësi të natyrave të ndryshme, të cilat kanë pasur për pasojë humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë për sundimin e ligjit. Mosfunksionimi i pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit; zvarritja në vendosjen e lëndëve civile dhe penale; numri i lëndëve të pazgjidhura nga vitet paraprake; shkalla e ulët e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore; parashkrimi i lëndëve gjyqësore; vendime dhe procese gjyqësore ndaj gjyqtarëve për

korupsion; moszbatimi në praktikë i normave të KEDNJ-së, mosinterpretimi i vendimeve të gjyqësorit kosovar sipas vendimeve të GJEDNJ-së.

Kompetencat e Avokatit të Popullit për trajtimin e ankesave të parashtruara në raport me punën e gjykatave, janë të kufizuara, përkundër numrit të madh të ankesave të paraqitura. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit mund të hetojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me “zvarritje të paarsyeshme të procedurave gjyqësore apo keqpërdorim të dukshëm të pushtetit.”³⁴³

Edhe gjatë këtij viti nuk është arritur shtrirja e pushtetit gjyqësor në pjesën veriore të vendit nga Institucionet e Republikës së Kosovës dhe Misioni i Unionit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), edhe pse Kushtetuta garanton pushtetin gjyqësor në tërë territorin e vendit.³⁴⁴ Që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës, prej fillimit të vitit 2008, gjykatat nuk funksionojnë në pjesën veriore të Mitrovicës, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq.

Sistemi gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës vazhdon të mbështetet nga EULEX-i, në fushën e sundimit të ligjit, mbi bazën e Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Kosovës dhe BE-së.³⁴⁵ Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, do të vazhdojnë të ndihmojnë autoritetet gjyqësore vendore drejt zhvillimit dhe forcimit të një sistemi të pavarur të drejtësisë.

Gjyqtarët veprojnë në panele të përziera gjyqësore me gjyqtarë vendorë, për fusha të rezervuara të hetimit dhe gjykimit, si: krimet e luftës, gjenocidin, terrorizmin, krimin e organizuar, korupsionin, krimet ndëretnike, vrasjet e rënda, krimet ekonomike dhe krimet e tjera të rënda, por edhe për gjykimin e lëndëve civile të të gjitha natyrave, sipas ligjit mbi kompetencat.³⁴⁶ Ndërsa KGJK nuk ka kurrfarë kompetence mbi gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, sepse ata i përgjigjen vetëm organeve të Komponentit të Drejtësisë të EULEX-it

2.26.2 Ankesat e qytetarëve ndaj gjykatave

Në të vërtetë, numri më i madh i ankesave të qytetarëve të paraqitura në IAP në vitin 2014, i përkasin gjyqësorit. Kundër gjykatave si palë përgjegjëse, qytetarët kanë parashtruar gjithsej 665 ankesa, ndërsa në vitin paraprak 2013 janë regjistruar 577 ankesa. Realisht, ka një rritje prej 88 ankesave ose mbi 15% ndaj gjyqësorit, në raport me vitin 2013.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar, 470 prej tyre janë shpallur të papranueshme, sipas nenit 19.1.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit.³⁴⁷ Ndërsa për 195 ankesa janë hapur hetime.

³⁴³ Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 15, paragrafi 6.

³⁴⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 102, paragrafi 2. “Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.”

³⁴⁵ Ligji, Nr. 04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë.

³⁴⁶ Ligji Nr. 03L 053 për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, neni 5. paragrafi 1.

³⁴⁷ Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 19, p. 1.3.: “Ankesa nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit, ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj; ankesa është anonime; ankesa

Numri më i madh i ankesave është paraqitur kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjithsej 172 ankesa; kundër Gjykatës së Apelit 125; kundër DHPGJSK-së 66 ankesa. Numër më i vogël i ankesave janë paraqitur kundër gjykatave të tjera themelore në Kosovë dhe kundër GJSK-së. Natyrisht, Gjykata Themelore e Prishtinës ballafaqohet edhe me numrin më të madh të lëndëve në tërë Kosovën.

Në të gjitha rastet, kur kërkesat apo ankesat e qytetarëve në lidhje me gjyqësorin nuk kanë qenë në përputhje me kompetencat e Avokatit të Popullit, palët janë udhëzuar dhe drejtuar tek institucionet kompetente profesionale për ofrimin e shërbimeve juridike, si në Agjencionin për Ndihmë Juridike Falas dhe OJQ-të, të cilat kryejnë shërbime ligjore falas për qytetarët.

Nga analiza e natyrës së ankesave të hetuara të qytetarëve, konstatohet se shumica e ankesave ka të bëjë me: zvarritje, herë-herë disavjeçare, të procedurave gjyqësore; parashkrimin e lëndëve gjyqësore; pastaj me moskzekutimin e vendimeve gjyqësore të plotfuqishme; dyshime në objektivitetin e gjyqtarit në vendosjen e lëndës; përfaqësimin jo të mirë nga avokatët mbrojtës.

Ky është një tregues i gjendjes së rëndë të sistemit gjyqësor, i cili ende nuk ka arritur të përmbushë detyrimet ligjore në raport me kërkesat dhe të drejtat e garantuara të qytetarëve, për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre.

2.26.3 Zvarritjet e procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve

Prej të gjitha ankesave të paraqitura kundër gjyqësorit, numri më i madh ka të bëjë me zvarritje të procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve nëpër gjykata, të cilat para së gjithash janë të natyrës civile, të fushave të ndryshme, por edhe penale. Zvarritja e procedurave gjyqësore, para së gjithash është pasojë e numrit të madh të lëndëve të trashëguara nga vitet paraprake, si dhe mbërritja e vazhdueshme e numrit të madh të lëndëve të reja gjyqësore nga sfera të ndryshme.

Përkundër faktit të shtimit të numrit të gjyqtarëve, e që aktualisht janë 335, dhe stafit mbështetës civil 1437 të punësuar,³⁴⁸ sa i përket zvarritjeve të lëndëve gjyqësore nuk është vërejtur ndonjë përparim i konsiderueshëm në gjyqësor. Sipas raportit të gjashtëmujorit të parë të vitit 2014 të KGJK, numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura ishte 463.301 lëndë gjyqësore.³⁴⁹

Sipas shënimeve statistikore të raportit vërehet se në gjashtëmujorin e parë gjykatat kanë zgjidhur 230.674 lëndë gjyqësore, ndërsa qytetarët i kanë parashtruar 238.276 parashtrësia në gjykata. Nga kjo mund të konstatohet se gjyqësori me shumë pranon lëndë se sa është në gjendje t'i zgjidhë. Duke u nisur nga ky fakt, Avokati i Popullit kërkon nga KGJK-ja, por edhe institucionet tjera përgjegjëse, që të angazhohet për gjetjen e një zgjidhjeje ligjore.

Në të gjitha rastet e ankesave të cilat janë në kompetencë të IAP-së, lidhur me zvarritjet e procedurave gjyqësore nga gjykatat, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime dhe ka kontaktuar, qoftë përmes letrave apo takimeve të drejtpërdrejta me zyrtarë të gjykatave themelore. Në të

paraqet keqpërdorim të së drejtës për paraqitjen e ankesës; ankuesi ka dështuar të sigurojë informatat e kërkuara nga Avokati i Popullit”.

³⁴⁸ KGJK, *Raporti i 6-mujorit të parë 2014*, *Statistikat e gjykatave të rregullta*, www.kgjk-ks.org (11.12.2014), f. 3.

³⁴⁹ *Po aty*, f. 3.

shumtën e rasteve, për dallim nga zyrtarët e lartë të ekzekutivit të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit ka hasur në bashkëpunimin e personave përgjegjës në gjykata për zgjidhjen e ankesave të palëve ankuese, shpeshherë madje edhe duke caktuar seancat gjyqësore.

Me gjithë bashkëpunimin e mirë me shumicën e personave përgjegjës, Avokati i Popullit nuk gjen arsytim për zvarritjen e procedurave që kanë të bëjnë me konteste pronësore, kur qytetarët janë të detyruar që vendimet t'i presin me vite të tëra.

2.26.4 Parashkrimi i lëndëve gjyqësore nga gjykatat

Përkundër faktit që në raportin 6-mujorit të parë të vitit 2014, KGJK nuk paraqet të dhënat lidhur me parashkrimin e lëndëve gjyqësore, gjatë këtij viti raportues në IAP kanë arritur ankesa për shkak të parashkrimit të lëndëve gjyqësore nga ana e gjykatave.

Parashkrimi i lëndëve nga ana e gjykatave mund të jetë rezultat i ngarkimit me lëndë gjyqësore dhe pamundësisë së vendosjes brenda afateve kohore. Po ashtu mund të jetë edhe si rezultat i reformave të vazhdueshme të gjyqësorit. Mirëpo, ka raste kur parashkrimi është edhe si pasojë e neglizhencës apo të keqpërdorimit të detyrës së gjykatësit. Për Avokatin e Popullit parashkrimi i lëndëve gjyqësore paraqet një nga shkeljet më të rënda të të drejtave dhe lirive të qytetarëve të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.³⁵⁰

Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) e KGJK-së, në të gjitha rastet e parashkrimit të lëndëve gjyqësore, duhet të hetojë në hollësi shkaqet e parashkrimit të lëndëve dhe, në çdo rast, pa asnjë përjashtim, të iniciojë ndërmarrjen e masave ligjore ndaj përgjegjësve të pandërgjegjshëm për ndarjen e drejtësisë dhe të iniciojë nxjerrjen e tyre para drejtësisë.

Avokati i Popullit, bazuar në ankesat qytetarëve lidhur me parashkrimin e lëndëve gjyqësore, rekomandon KGJK-në, të ndërmarrë të gjitha masat për zbatimin strikt të legjislacionit në fuqinë Republikën e Kosovës, në mënyrë që gjykatat të mos zvarrisin lëndët deri në parashkrimin e tyre.

2.26.5 Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të plotfuqishme

Avokati i Popullit, gjatë këtij viti po ashtu ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave të qytetarëve për shkak të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga gjykatat themelore. Në të gjitha këto raste, nga qytetarët e zhgënjyer është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në nivel të vendit është mjaft i ulët. Sipas Raportit të gjashtë mujorit të parë të vitit 2014 të KGJK-së,³⁵¹ përmbarimi i vendimit sipas dokumentit përmbarues është 64,16 % ndërsa i ekzekutimit të kontesteve ekonomike 50,20 %. Shkaqet të cilat ndikojnë në shkallën e ulët të ekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme, sipas KGJK-së,

³⁵⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 54: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

³⁵¹ KGJK, Raporti i 6-mujorit të parë 2014, Statistikat e gjykatave të rregullta, www.kgjk-ks.org (11.12.2014).

qëndrojnë në numrin e vogël të bashkëpunëtorëve për ekzekutim dhe mungesa e adresave të sakta në Kosovë.

Në të gjitha rastet e ankesave të cilat janë në kompetencë të IAP-së, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime dhe ka kontaktuar përmes letrave dhe takimeve të drejtpërdrejta me zyrtarë të gjykatave përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, duke kërkuar arsytet për zvarritje të ekzekutimit të vendimeve. Avokati i Popullit në të gjitha kërkesat ka marrë shpjegimet zyrtare dhe gjykatat kanë ndërmarrë veprime procedurale në drejtim të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

2.26.6 Rastet e tjera të ndryshme të ankesave të qytetarëve

Një numër i ankesave të qytetarëve nga komuniteti jo shumicë, është drejtuar në IAP edhe për shkak se gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore nuk kanë pasur të siguruar përkthimin në gjuhën e tyre amtare, apo përkthimi ka qenë i dobët, dhe nuk kanë mundur ta përcjellin dhe ta kuptojnë në mënyrë të qartë zhvillimin e procedurave gjyqësore për rastet e tyre. Po ashtu, një numër i ankesave janë paraqitur për shkak se gjykatat nuk i kanë përkthyer me kohë vendimet gjyqësore dhe palët nuk kanë mundur të ushtrojnë mjete efektive juridike ndaj vendimeve, brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj. Avokati i Popullit në të gjitha rastet e ankesave ka kërkuar respektimin e së drejtës së palës për njoftim në gjuhën e tyre në përputhje me ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Po ashtu një pjesë e ankesave i referohen përmbajtjes së vendimeve gjyqësore të shkallës së parë, por edhe të vendimeve të formës së prerë të gjykatave, për të cilat janë shterë të gjitha mjetet e ankimit. Në këto raste Avokati i Popullit i ka këshilluar ankuesit që nëse ende konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre nga procesi dhe vendimi gjyqësor, brenda afatit ligjor mund të drejtën e ankimit me mjetet të rregullta dhe të jashtëzakonshme ligjore, në instancat më të larta gjyqësore.

Ankesa në IAP janë paraqitur edhe për zvarritje të padrejta nga administrata e gjykatave, për shkak të mosdërgimit të vendimeve gjyqësore brenda afateve ligjore, si dhe për shkak të pamundësisë së palëve për qasje në lëndën e tyre në gjykatë. Avokati i Popullit, në të gjitha rastet e ankesave të kësaj natyre, ka kontaktuar zyrtarët e gjykatave dhe në bashkëpunim me gjykatat, i ka zgjidhur ankesat e palëve. Palëve u janë dorëzuar vendimet gjyqësore apo ata janë informuar lidhur me gjendjen e lëndëve në gjykata.

Një numër shqetësues i ankesave janë paraqitur edhe për shkak të mospërfaqësimit të mirë të ankuesve nga avokatët e tyre mbrojtës, të caktuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata. Në të gjitha këto raste, palët janë njoftuar me të drejtën e tyre që të kërkojnë ndërrimin e avokatëve dhe për rastin e tyre ankesën ta paraqesin në OAK.

Shumë herë, qytetarët në ankesat e tyre drejtuar Avokatit të Popullit, kërkojnë monitorimin e rastit të tyre në gjykatë, por në disa raste kërkojnë edhe hartimin e parashtresave të ndryshme dhe përfaqësimin e tyre në instancat e ndryshme gjyqësore. Por ka raste që është kërkuar nga IAP referimin e çështjes së tyre në GJKK, për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut edhe në rastet kur Avokati i Popullit nuk është kompetent për të referuar një rast në GJKK. Po ashtu, në disa raste ka pasur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave, për të cilat janë shterë të gjitha mjetet e ankimit, duke përfshirë edhe ankimin

kushtetues. Nga Avokati i Popullit kërkohet që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në GJEDNJ në Strasburg.

Në radhë të parë, kjo është rezultat i mos informimit të qytetarëve me misionin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit, për natyrën e rasteve që mund të referohen në GJKK nga Avokati i Popullit, si dhe për pamundësi momentale të referimit të çështjeve në GJEDNJ në Strasburg. Njëkohësisht kjo dëshmon edhe për humbjen e besimit në drejtësinë e gjyqësorit në përgjithësi. Në shumë nga këto raste ata shprehen se kanë besim vetëm në IAP, prandaj kërkojnë medoemos ndihmën e IAP, megjithëse Avokati i Popullit nuk mund të zëvendësojë avokatin mbrojtës para asnjë gjykate.

2.26.7 Ankesat ndaj Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Avokati i Popullit gjatë këtij viti raportues ka pranuar edhe ankesa ndaj KGJK-së. Pas hetimit të ankesave të qytetarëve, në disa raste ka konstatuar se ka pasur shkelje të drejtave të njeriut, andaj ka rekomanduar KGJK-në për eliminimin e këtyre shkeljeve dhe të përmirësimit të legjislacionit në fushën e të drejtave të njeriut. Në të gjitha këto raste, kërkesat e Avokatit të Popullit janë marrë parasysh dhe janë zbatuar brenda afateve të arsyeshme kohore.

2.26.8 Ankesa e Sindikatës së punëtorëve lidhur me taksat gjyqësore

Më 5 qershor 2014, Avokati i Popullit ka pranuar ankesën nga kryetari i Sindikatës të ish-ndërmarrjes shoqërore “Ingeniering”, në emër të 24 punëtorëve dhe nga kryetari i Sindikatës të ish-ndërmarrjes shoqërore në likuidim “Mirusha” nga Malisheva, në emër të 120 punëtorëve kundër vendimit nr. 25, të datës 5 mars 2014, të KGJK për miratimin e planit për taksat gjyqësore të DHPGJSK-së. Sipas këtij vendimi të KGJK, nga punëtorët është kërkuar pagesa fikse për taksa gjyqësore prej 100 eurosh, për çfarëdo padie kundër AKPv-së për çështje të të drejtave të punëtorëve, që rrjedhin nga procesi i privatizimit.³⁵²

Avokati i Popullit, më 18 qershor 2014, ia drejtoi shkresën KGJK-së, me të cilin përkujtoi se me Udhëzimin Administrativ nr. 2008/02 janë të përcaktuara taksat gjyqësore, për procedurat në gjykatat e Republikës e Kosovës dhe se taksat e reja pengojnë realizimin e të drejtave të punëtorëve nga procesi i privatizimit. KGJK, me shkresën e datës 13 gusht 2014 e njofton Avokatin e Popullit, se vendimi për taksa gjyqësore, i kontestuar është ndryshuar dhe se punëtorët janë të liruar nga pagesa e taksave shtesë, gjatë realizimit të drejtave të tyre në procesin e privatizimit.

2.26.9 Mungesa e gjykatësit në Gjykatën Themelore - dega në Graçanicë

Avokati i Popullit, më 25 qershor 2014, në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka bërë hetime sipas detyrës zyrtare (*ex officio*), prej të cilave rezulton që në Gjykatën

³⁵² LAP, rastet A. nr. 265/2014 dhe 266/2014.

Themelore në Prishtinë, dega në Graçanicë,³⁵³ nga data 1 shkurt 2014 nuk është asnjë gjyqtar, duke shkaktuar zvarritje të paligjshme dhe shkelje të të drejtave të qytetarëve për gjykim të drejtë dhe brenda periudhës së arsyeshme kohore.

Pas përfundimit të hetimeve *ex officio*, Avokati i Popullit, më 11 korrik 2014 i dërgoi letër rekomandimi KGJK për marrjen e masave të nevojshme dhe të domosdoshme që pa vonesë të mëtutjeshme të dërgohet një gjyqtar në degën e Gjykatës Themelore të Prishtinës, në Graçanicë, për të vazhduar me procedimin e më se 1000 lëndëve, të cilat gjenden në këtë degë të gjykatës në Graçanicë.

Më 17 korrik 2014, KGJK dërgoi përgjigje, në të cilën e informoi Avokatin e Popullit se i njëjti pajtohet me rekomandimin e mësipërm, dhe se kryesuesi i KGJK-së mori vendim që nga data 1 gusht 2014 të emërohet një gjyqtar i fushës së të drejtës civile në Gjykatën Themelore të Prishtinës, dega në Graçanicë, i cili të njëjtën ditë filloi të punojë.

2.26.10 Konstatimet e Avokatit të Popullit lidhur me mbrojtjen gjyqësore të të drejtave

Vështirësitë në realizimin e të drejtave gjyqësore të qytetarëve para organeve të drejtësisë, tek qytetarët kanë krijuar perceptime dhe opinione publike të dyshimit në punën e gjyqësorit, përkundër kryerjes së lëndëve të shumta gjyqësore. Zvarritjet e procedurave për vite të tëra, derisa lëndët të vendosen me aktgjykim të formës së prerë, ndikon drejtpërdrejtë në humbjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë, sidomos në gjykata.

Për shkak të mosfunksionimit të sistemit gjyqësor në pjesën veriore të vendit, qytetarëve u janë shkëlur rëndë të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me Kushtetutë, posaçërisht e drejta për mbrojtje gjyqësore. Për këtë arsye një numër relativisht i madh i lëndëve gjyqësore të mbetura atje, nuk kanë arritur të shqyrtohen dhe mund të parashkruhen.

Një problem shqetësues për qytetarët e vendit përbën fakti se nuk ekziston një mekanizëm ligjor për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm kohor, kur kjo e drejtë e tyre cenohet nga gjyqësori vendor. Ky mekanizëm ligjor do të mundësonte kompensimin e palëve për shkak të dëmit të shkaktuar material, për zvarritje të procedurave gjyqësore, ashtu siç është e zakonshme në vendet demokratike.

Kohëzgjatja me vite të tëra e procedurave civile dhe procedurave tjera nëpër Gjykata, për vendosjen e lëndëve gjyqësore edhe më tutje rezulton me qasje të vështirësuar, në mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të njeriut nga gjykatat. Këtë vit ka pasur parashkrim të lëndëve gjyqësore dhe zvarritje në ekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme gjyqësore. Për Avokatin e Popullit kjo paraqet një nga shkeljet më të rënda të të drejtave dhe lirive të qytetarëve të garantuara me Kushtetutë.

Këtë vit vërehet një rritje e numrit të parashtrësive në të cilat shprehin pakënaqësi me vendimet gjyqësore, për shkak të dyshimit në objektivitetin e ndarjes së drejtësisë dhe kërkojnë ndërmarrjen e masave nga Avokati i Popullit, ndërsa dukshëm është rritur numri i rasteve kur palët kërkojnë monitorimin e seancave gjyqësore si në proceset penale dhe civile. Këto për Avokatin e Popullit janë shenja të qarta dalluese për rritjen e shkallës së mosbesimit në drejtësinë e ndarë nga gjykatat dhe mosbesim total në sistemin e kontrollit gjyqësor.

³⁵³ LAP, rasti *ex officio* A. nr. 284/2014.

Rrjedhimisht, kjo po përcillet edhe me numër të shtuar të kërkesave për referim të rasteve në GJKK apo edhe në instanca gjyqësore ndërkombëtare.

Gjykatat veprojnë me numër të pamjaftueshëm të burimeve njerëzore, gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe personave të tjerë ndihmës, si dhe ballafaqohen me kushte jashtëzakonisht të rënda infrastrukturore. Kjo është e shprehur sidomos në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në Mitrovicë, në Gjykatën e Apelit dhe në DHPGJSK. Këto mangësi dhe pengesa reflektohen drejtpërdrejtë në efikasitetin e kësaj gjykate si dhe në kualitetin e punës së saj, e cila shprehet në humbjen e besimit të qytetarëve. Natyrisht, këto nuk përbëjnë as faktorët e vetëm dhe as faktorët kryesorë për gjendjen në të cilën gjendet gjyqësori kosovar në përgjithësi.

Rekomandime:

Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës

- *Shtirirjen e pushtetit gjyqësor në tërë territorin e vendit, përfshirë pjesën veriore të Mitrovicës dhe komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, ashtu si parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*

Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë

- *Të iniciojë përpilimin e një instrumenti ligjor që do të përbënte një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit përmes kompensimit lidhur me ankesat për parashkrimin e lëndëve gjyqësore dhe për zvarritje të paarsyeshme të procedurës gjyqësore.*
- *Të iniciohet nxjerrja e një vendimi të përkohshëm për ndalimin e parashkrimit të lëndëve gjyqësore në Republikën e Kosovës, si pasojës e mohimit të së drejtës së qytetarëve për t'u drejtuar tek gjyqësori për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme.*

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

- *Të rrisë numrin e gjyqtarëve dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Gjykatën e Apelit dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ashtu që të gjitha lëndët gjyqësore të trajtohen brenda afateve të arsyeshme kohore dhe pa zvarritje të paarsyeshme.*
- *Zyra e Prokurorit Disiplinor të hetojë të gjitha rastet e ankesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me parashkrimin e lëndëve të tyre gjyqësore dhe, në rastet e keqpërdorimit të detyrës, të propozojë shqiptimin e masave ligjore ndaj gjykatësve dhe prokuroreve të cilët kanë rënë ndesh me ligjin.*

Gjykatave dhe KGJK-së

- *Të mundësojë sigurimin e përkthyesve profesionalë për të gjitha kontestet gjyqësore penale, civile dhe administrative, për të gjitha palët nga komunitetet jo shumicë, në gjuhën e tyre.*

- *Vendimet gjyqësore të nxirren në afate ligjore dhe me kohë t'u dorëzohen palëve në gjuhën e tyre, pa vonesa administrative të përkthimit.*
- *Përmbartimin dhe zbatimin konsekuent të vendimeve të plotfuqishme gjyqësore në afatin e paraparë me ligj.*
- *Rritjen e transparencës dhe njoftimin e të gjitha palëve, në rastin e kërkesës së tyre për t'u njoftuar për lëndët e tyre, pas reformimit të gjykatave sipas Ligjit dhe transferimit të lëndëve gjyqësore në kompetencë ligjore.*

2.27 E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

Në fushën e të drejtave të njeriut, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është një parakusht i nevojshëm për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tjera, por kjo e drejtë është shumë diskutabile në shoqërinë kosovare, për shkak të numrit të rasteve të pazgjidhura në gjykata, i cili vazhdimisht është në rritje. E drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm ka një bazë të fortë normative e cila i referohet mbrojtjes së të drejtës për trajtim të barabartë para organeve gjyqësore dhe shtetërore, e drejta për një seancë publike e cila mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj, e drejta për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, drejta e prezumimit të pafajësisë, e drejta për një përfaqësues ligjor dhe ndihmë juridike falas etj. Si në raportet e mëparshme, Avokati i Popullit rikujton se edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, situata nuk është aspak e kënaqshme.

Gjatë periudhës së raportimit, IAP ka pranuar 547 ankesa nga qytetarët dhe ka hapur 180 raste për hetime, të cilët përfshijnë pohimet për shkeljen e të drejtave të procesit të rregullt gjyqësor, veçanërisht të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme.

Në të gjitha rastet e hapura, IAP ka nisur hetimet dhe ka kërkuar informata nga gjykatat e instancave të ndryshme, në lidhje me veprimet të cilat janë ndërmarrë, për të mbrojtur të drejtat e njeriut. Nga përgjigjet e pranuar nga gjykatat të ndryshme të Kosovës, Avokati i Popullit ka vërejtur se gjyqësori i Kosovës ballafaqohet me një numër shumë të madh të rasteve të pazgjidhura. Numri i rasteve të pazgjidhura, sipas raportit vjetor të KGJK-së për punën e gjykatave të vitit 2014, është i lartë dhe ka tendencë të rritjes së mëtejme.

Prej ankesave të pranuar, që kanë të bëjnë me të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, mund të vërehet se një numër i tyre, lidhet me kohëzgjatjen dhe mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, veçanërisht në rastet që lidhen me kontestet pronësore, të cilët janë grumbulluar gjatë shumë viteve dhe prej të cilëve një numër i madh i tyre ende mbetet pezull dhe i pazgjidhur, për një periudhë të gjatë kohore.

Rastet të shqyrtuara për shkeljen të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm theksuan problemin e zbatimit të ligjit, në kuptimin e trajtimit urgjent dhe mosrespektimin e afateve ligjore gjatë marrjes së vendimeve të këtyre rasteve. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet problemi i cili lidhet me kontestet e punës, që kërkojnë veprimin e lartpërmendur. E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe me ligjet themelore që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Në IAP janë regjistruar raste të

zvarritjes procedurale para gjykate në fushën e marrëdhënieve të punës, të cilat edhe pas disa viteve ende nuk janë shqyrtuar.

Një nga ankesat e regjistruara në IAP, ka qenë për një kontest pune kur ankuesi ishte drejtuar Gjykatës Themelore në Pejë në vitin 2011, për shkak të shkëputjes së paligjshme të marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit. Rasti nuk i është ndarë asnjë gjykatësit të Gjykatës Themelore dhe pas riorganizimit të gjyqësorit në Kosovë, rasti është transferuar në Gjykatën e Apelit, por deri më sot ky rast nuk është i procesuar. Avokati i Popullit ka nisur hetimet lidhur me rastin e ankuesit, duke dërguar një shkresë gjykatës me të cilën ka kërkuar informata lidhur me veprimet e ndërmarrja, me qëllim të zgjidhjes së problemit. Nga përgjigja e pranuar Avokati i Popullit konstatoi se problemi në këtë rast ka qenë grumbullimi i lëndëve në gjykatën e lartpërmendur. Ky rast thekson se zvarritja e procedurës gjyqësore rezulton me shkeljet të rënda të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, një numër i ankesave të pranuar nga qytetarët ndërlidhen me të drejtat e procesit të rregullt gjyqësor, të cilat i referohen kohëzgjatjes së procedurës, për shkak të mosfunksionimit të gjykatave në pjesën veriore të Mitrovicës. Ky fakt mbetet një sfidë e madhe në sigurimin e sundimit të ligjit.

Në bazë të Ligjit të ri për Gjykatat, juridiksioni i Gjykatës Supreme të Kosovës (GJSK) është reduktuar dhe për shkak të asaj kjo gjykatë është më pak e ngarkuar me lëndë, përkatësisht në vitin 2014, kjo gjykatë ka pranuar 83,3 % më pak raste se sa në vitin 2013 dhe statistikat tregojnë se efikasiteti i punës së kësaj gjykate është 100 %.

Në bazë të analizave të raporteve statistikore për punën e gjykatave, Avokati i Popullit thekson faktin shqetësues i cili referohet tendencës së rritjes së numrit të rasteve të pazgjidhura gjatë vitit 2014 kundër DHPGJSK-së, e cila vendos në bazë të ligjit lidhur me ankesat e paraqitura kundër AKPv-së, si dhe kërkesave të ndërmarrjeve shoqërore. Në bazë të informatave zyrtare të KGJK, statistikat për punën e gjykatave tregojnë se DHPGJSK ka 17.077 raste të pazgjidhura, ndërsa në fund të vitit 2013 ky numër ka qenë 16.424. Efikasiteti i kësaj gjykate është vlerësuar me 29,9 %.

Në këtë kontekst, në periudhën raportuese, IAP ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm të ankesave në lidhje me zvarritjen e procedurës në DHPGJSK. Duhet të theksohen rastet e vitit 2011, kur ankuesit kanë drejtuar çështjen në këtë gjykatë, por ajo deri më sot nuk ka vendosur për çështjen e ankuesve, asnjë seancë gjyqësore nuk është caktuar, dhe gjithashtu ankuesit nuk kanë pasur asnjë informatë lidhur me punën për rastet e lartpërmendura. Pas kryerjes së hetimeve nga Avokati i Popullit, gjatë periudhës raportuese ka pranuar nga gjykata një përgjigje konstante, që rastet janë në procedurë, që në shumicën e këtyre rasteve ka ardhur deri te ndërrimi i gjykatësit dhe në fund të përgjigjes shënohet emri i gjyqtarit i cili është caktuar për rastet në fjalë. Gjithashtu, në përgjigjen e gjykatës theksohet që për shkak të numrit të madh të rasteve të pranuar në gjykatë, rasti në fjalë do të procedohet për një periudhë shumë të shkurtër kohore. Avokati i Popullit vazhdon procedurën në këto raste, për shkak se në bazë të hetimeve të kryera nga IAP shihet qartë mosgatishmëria e gjyqësorit në Kosovë, posaçërisht e DHPGJSK-së, që t'u garantojë qytetarëve të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit edhe në vitin 2014 ka pranuar ankesat e qytetarëve lidhur me zvarritjen e procedurës për pranimin e vendimit gjyqësor në gjuhën amtare të tyre edhe pse Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton përdorimin e saj. Në këtë kontest, institucionet gjyqësore kanë bërë një përparim të konsiderueshëm, edhe pse ende është e nevojshme që ato të sigurojnë një numër më të madh të interpretove dhe përkthyesve gjyqësorë. Kjo çështje ende

nuk është zgjidhur në mënyrë të duhur, pavarësisht iniciativave të mëparshme, të cilat janë vërtetuar si të pasuksesshme.

Por duhet të theksohet bashkëpunimi korrekt i DHPGJSK-së me Avokatin e Popullit, në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve procedurale, pas intervenimit të Avokatit të Popullit, në mënyrë që ankesat e parashtruara të ankuesve të procedohen në periudhë të shkurtë kohore.³⁵⁴

Avokati i Popullit është i mendimit se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet nga aspekti i rrethanave të veçanta që lidhen me lëndët e parashtruara në gjykatë. Megjithatë, numri i vogël i rasteve të punuara, në krahasim me lëndët të pranuar në gjykatë, për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve dhe numrit të madh të padive që pranohen nëpër gjykatat e Kosovës, nuk do të kontribuojnë në zgjidhjen e këtij problemi. Ky problem duhet të trajtohet, jo vetëm në kuadër të ligjit por edhe në mënyrë të përpilimit të politikave më të mira për zbatimin e tyre. Nëse në kohën më të shkurtër nuk merren masa konkrete, si rritja e numrit të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtoreve, dhe rritja e efikasitetit në punën e gjykatave, konstatohet në këtë mënyrë do të rritet edhe numri i rasteve të pazgjidhura.

Duke marrë parasysh këtë gjendje dhe se numri i ankesave është në rritje për shkak të zvarritjes së procedurës pas parashtrimin të padisë, Avokati i Popullit konkludon se institucionet përkatëse nuk kanë ndërmarrë masat e nevojshme, edhe pse kanë ekzistuar shumë projekte, strategji, plane, si dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit në periudhën e mëparshme të raportimit, për të siguruar një proces gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme, siç parashikohet në Kushtetutë dhe në instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Rekomandime:

Këshillit Gjyqësor i Kosovës:

- *Me qëllim të rritjes së efikasitetit të gjykatës, të ndërmerren veprime ligjore /iniciativa që janë të përshtatshme dhe efektive, që e drejta për gjykim të drejtë edhe të paanshëm të mos jetë veç e karakterit formal, por të jetë e zbatueshme në praktikë.*
- *Të ndërmerren masat e nevojshme për zbatimin e rregullave në fuqi, në mënyrë që gjykatat të shmangin zvarritjen procedurale të lëndëve, të cilat pastaj sjellin deri te parashkrimi i tyre.*
- *Dorëzimi i vendimeve gjyqësore të palëve në kohën e duhur, brenda afatit ligjor dhe në gjuhën e tyre, në bazë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare, dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*

³⁵⁴ LAP, rasti A.nr. 570/2013. Ankesa ka të bëjë me padinë për kthimin e tokës, të cilën ankuesi ka parashtruar në gjykatë, në vitin 2008. Përveç seancës paraprake gjyqësore, të cila është mbajtur në vitin 2011, gjykata nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër lidhur me padinë e ankuesit. Avokati i Popullit, pas hetimeve të kryera kontaktoi gjykatën, duke kërkuar informata për çështjen e lartpërmendur, dhe në periudhën të shkurtë kohore mori përgjigjen kur lënda do të procesohet, dhe për këtë çështjen e informoi ankuesin në kohë të duhur. Lidhur me rastin e ankuesit, gjykatësi ka marrë një urdhër me të cilin ka kërkuar prej ankuesit korigjimin e padisë në seancën e parë të caktuar, duke pasur parasysh faktin që të dy paditësit kanë ndërruar jetë gjatë zvarritjes së procedurës të paarsyeshme nga ana e gjykatës. Ankuesi ka vepruar sipas urdhrin të gjykatësit dhe në seancën e radhës është marrë vendimi lidhur me rastin.

2.28 Të drejtat e të akuzuarit

Secili që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat e përcaktuara me Kushtetutë,³⁵⁵ Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK),³⁵⁶ si dhe instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.³⁵⁷

Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka pranuar 151 ankesa, me pretendimin se është shkelur e drejta e të akuzuarit, duke mos përfshirë këtu shkeljen për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, që shpesh ndërliidhen në mes vete. Për 34 prej tyre janë hapur për hetime, ndërsa të tjerat, 117 ankesa, janë cilësuar të papranueshme.

Avokati i Popullit edhe në raportet tjera ka ngritur shqetësimin për raste të shkeljes të së drejtës së akuzuarit. Në raportet e mëhershme vjetore dhe raporte të veçanta, Avokati i Popullit vazhdimisht ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me cenimin e kësaj të drejte. Rastet e shkeljes së kësaj të drejte, të cilat madje edhe përsëriten, paraqesin jo vetëm shqetësim për Avokatin e Popullit, por para së gjithash cenim të rëndë të të drejtave të njeriut.

Paraburgimi i zgjatur dhe i pajustificuar vazhdon të jetë një sfidë për sistemin e drejtësisë penale. EULEX-i mori përsipër tri raste, pasi gjyqësori vendor nuk i kishte finalizuar procedurat brenda afatit ligjor të paraburgimit.³⁵⁸

Në njërin nga rastet e paraqitura në IAP gjatë periudhës raportuese, pala ankohet për cenimin e kësaj të drejte sipas nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së. Pala ankohet për vazhdimin e paraburgimit. Ai konsideron se në procesin gjyqësor që po zhvillohet kundër tij, cenohen të drejtat e tij si i akuzuar. Ai ka 4 vite që është në paraburgim, prej 25 gusht 2010.³⁵⁹ Të drejtat e ankuesit lidhur me kohëzgjatjen e paraburgimit janë të përcaktuara me nenin 190, paragrafin 4 të KPPRK-së, në kohë maksimale prej 18 muajve, deri në vendosjen e çështjes penale dhe kjo e drejtë e tij nuk është respektuar nga ana e gjykatës, pasi ankuesi gjendet në paraburgim për më shumë se katër vite pa vendim përfundimtar gjyqësor. Avokati i Popullit konstaton se në këtë rast kemi shkelje të kësaj të drejte të garantuar me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare.

KPPRK, në nenin 5 paragrafi 1, përcakton se: “Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme”, ndërsa në paragrafin 2 të po këtij neni përcakton detyrimin e gjykatës që “[...] të kujdeset që procedura të zbatohet pa zvarritje dhe të pengohet çdo keqpërdorim i të drejtave që u përkasin pjesëmarrësve në procedurë”, me të vetmin qëllim që “Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme” (paragrafi 3 i të njëjtit nen).

Të drejtat e të akuzuarit garantohen edhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, si Pakti Ndërkombëtar për Drejtat Civile dhe Politike dhe KEDNJ, të cilat, në rast konflikti, kanë prioritet ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike.

³⁵⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 30.

³⁵⁶ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-123.

³⁵⁷ Po aty, neni 22.

³⁵⁸ Kosovo Progress Report 2014, pg.2, “Unjustified prolonged detention continues to be a challenge for the criminal justice system. EULEX took over three cases as the local judiciary did not finalise proceeding within the legal time frame for detention”.

³⁵⁹ IAP, rasti A. nr. 442/2014.

IAP, ka vërejtur se në shumë raste, vendimi për paraburgim nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm. Në shumicën e rasteve gjykatat kanë dështuar të bëjnë lidhjen kauzale në mes të akuzës dhe privimit të lirisë në çështje konkrete. Kjo përbën një element të rëndësishëm për vlerësimin e ligjshmërisë sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së. Këto raste janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 5 paragrafi 1 të KEDNJ-së. Gjithashtu, sipas të njëjtit nen, edhe rastet në të cilat vendimi për paraburgim nuk përmban bazë juridike, dështon për të ofruar mbrojtje të mjaftueshme kundër arbitraritetit.

IAP vëren se për të konsideruar ose jo në një çështje konkrete zvarritje të procedurës, gjykatat nuk mund të trajtojnë këtë si çështje abstrakte, por duhet vlerësuar në çdo rast konkret rrethanat e rastit dhe nuk ka asnjëherë një periudhë fikse të zbatueshme për secilin rast pa përjashtim. Një vlerësim i tillë duhet të përmbajë referencë për secilin fakt dhe t'i marrë parasysh rrethanat personale të individit për të arsyetuar paraburgimin e tij.

Një tjetër çështje me rëndësi në sistemin tonë penal është edhe zbatimi i masave alternative, të cilat deri më tani nuk kanë gjetur zbatim të gjerë. Jurisprudenca e GJEDNJ-së thekson se kur gjykatat vendosin për lirimin ose paraburgimin e individit, autoritetet janë të obliguara të konsiderojnë masat alternative për të siguruar prezencën e individit në gjykim.³⁶⁰

Në rastet e paraburgimeve të paligjshme, kur personi i paraburgosur lirohet dhe shpallet i pafajshëm, sipas ligjit ka të drejtë të kompensohet, për shkak të privimit të lirisë. Shkalla e kompensimit sipas vendimit të Sekretariatit të KGJK-së, për “kriteret e përgjithshme për kompensimin e dëmit të personave të dënuar ose të arrestuar pa arsye”, të datës 25 gusht 2008, përfshin vlerën fikse për muaj. Avokati i Popullit vëren se neni 5, paragrafi 5 i KEDNJ-së nuk ka përcaktuar një vlerë fikse për kompensim. Jurisprudenca e GJEDNJ ka përcaktuar se kompensimi i cili është i papërfillshëm dhe jo proporcional me seriozitetin e shkeljes, nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 5, paragrafi 5 i KEDNJ-së.³⁶¹

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen e autoriteteve se kjo bazë juridike për kompensim është në fuqi që nga 25 gusht 2008 dhe që nga atëherë deri në ditën e sotme nuk ka ndryshuar dhe nuk është rishqyrtuar asnjëherë mbi bazat e lartpërmendura, prandaj është e domosdoshme që të rishqyrtohet dhe të përshtatet me standardet e kërkuara të nenit 5 paragrafi 5 të KEDNJ-së.

Çështje që është ngritur edhe në raportet e kaluara dhe vazhdon të mbetet shqetësuese, është pranimi i ankesave të shumta sa i përket pakënaqësisë me mbrojtjen e ofruar, sidomos nga avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare, por edhe nga ata që i kanë zgjedhur vet.³⁶² Avokati i Popullit konsideron se duhet siguruar mekanizëm efektiv në OAK, në mënyrë që përfaqësuesit juridikë (avokatët) të papërgjegjshëm, seriozisht të hetohen dhe të nxirren para drejtësisë dhe të ballafaqohen me pasojat e shkeljes së ligjit. Funksionimi efektiv i këtij mekanizmi do të ndihmonte në disiplinën e avokatëve dhe ngritjen e përgjegjshmërisë profesionale të tyre.

Sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka parashtruar nevojën e menjëhershme për zbatimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, siç e ka përcaktuar edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 52). Fakti se gjykatat penale në Kosovë në vendimet e tyre kanë

³⁶⁰ *Khudoyorov v. Russia*, § 183; *Lelièvre v. Belgium*, § 97; *Shabani v. Switzerland*, § 62. [lirimi mund të kushhtëzohet nga garancia për të siguruar prezencën para gjykatës].

³⁶¹ *Cumber v. the United Kingdom*, Commission decision; *Attard v. Malta*.

³⁶² IAP është njoftuar nga OAK se gjatë vitit 2014, Komisioni Disiplinor i Hetimeve ka pranuar 72 ankesa, prej tyre 3 janë hedhë poshtë për shkak të parashkrimit, 2 janë refuzuar për shkak të tërheqjes së palëve, 10 janë në procedurë për vendosje, 15 janë në hetime, 42 janë refuzuar.

injuar dhe nuk i janë përmbajtur këtij detyrimi kushtetues, është shqetësues për tërë sistemin gjyqësor. Kjo gjendje shtron nevojën e reformës radikale në qasjen e gjykatave ndaj standardeve ndërkombëtare dhe detyrimeve kushtetuese. Avokati i Popullit konsideron se autoritetet përgjegjëse, duke përfshirë KGJK-në dhe IGJK-në, duhet urgjentisht të sigurojnë trajnime adekuatë dhe reforma të përshtatshme për avancimin e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Rekomandime:

- *Gjykatat të shqiptojnë masa tjera alternative, ndërsa vetëm në raste të domosdoshme dhe ligjrisht të bazuara të shqiptojnë paraburgimin, si mjet për sigurimin e të akuzuarit.*
- *Gjykatat të bëjnë arsyetimin e duhur të vendimeve për vazhdimin e paraburgimit.*
- *KGJK të bëjë rishqyrtimin e shumës së kompensimit për rastet e paraburgimit të paligjshëm.*
- *Oda e Avokatëve të Kosovës, të sigurojë kualitet më të madh të ndihmës ligjore dhe të marrë masa disiplinore ndaj avokatëve që shkelin Ligjin për Avokatinë dhe Kodin e Etikës Profesionale të Avokatit.*

2.29 E drejta për mjete juridike

E drejta për mjete juridike ndaj vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat cenojnë të drejtat dhe interesat e qytetarëve, është një nga të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë,³⁶³ si dhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, në nenin 2 paragrafi 3 obligon shtetet palë, që *“të sigurojnë që çdo person, kur t’i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv, edhe atëherë kur shkeljen e kryejnë personat me rastin e ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare”*.

Në procedurë gjyqësore penale, mjetet juridike dhe afatet kohore për shfrytëzimin e ankesave, si ato kundër ndalimit, caktimit ose vazhdimin të paraburgimit, ankimit të vendimeve gjyqësore si dhe ushtrimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, janë të rregulluara dhe të përcaktuara me Ligj.³⁶⁴ Mjetet juridike për kundërshtimin e paraburgimit janë të përcaktuara edhe me

³⁶³ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, neni 32 “Secili person ka të drejtë të përdor mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

³⁶⁴ *Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L-123*, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 13 dhjetor 2012.

instrumente ndërkombëtare.³⁶⁵ Po ashtu, edhe e drejta për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme, është e garantuar me legjislacionin përkatës vendor³⁶⁶ dhe me KEDNJ.³⁶⁷

Afati kohor për zhvillimin e procedurës dhe për nxjerrjen e vendimeve në rastet administrative, është e përcaktuar me Ligjin për Procedurën Administrative.³⁶⁸

2.29.1 Raste individuale të paraqitura në IAP

Gjatë vitit 2014, IAP ka pranuar 263 ankesa, me pretendimin se është shkelur e drejta për mjete juridike. Prej tyre në 52 raste janë hapur hetime, ndërsa të tjerat janë cilësuar si të papranueshme. Shkaqet më të shpeshta të ankesave të paraqitura në IAP, janë për shkak të cenimit të të drejtave të tyre dhe janë parashtruar kundër gjykatave, ministrive, komunave, Policisë së Kosovës dhe kompanive publike. Ankesat paraqiten për shkak të mos shqyrtimit të ankesave brenda afateve ligjore dhe moszbatimit të vendimeve gjyqësore dhe administrative.

Në njërin nga rastet e paraqitura në IAP gjatë periudhës raportuese, pala ankohet kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak të diskualifikimit të tij nga gara konkurruese për pozitën e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM), duke ia mohuar të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike efektive, pa i dhënë ndonjë sqarim të qartë ligjor se pse eliminohet nga konkurrenca.³⁶⁹

Avokati i Popullit, më 22 prill 2014, përmes një letre zyrtare, kërkoi nga sekretari i Kuvendit dhe kryetarja e Komisionit *ad hoc*, që të informohet për veprimet që janë ndërmarrë apo planifikohen të ndërmerren në të ardhmen, ashtu që ankuesit t'i kthehet përgjigja brenda afatit ligjor. Në këtë letër Avokati i Popullit theksoi se “Nisur nga përmbajtja e mendimit ligjor të

³⁶⁵ KEDNJ, neni 5, paragrafi 4 “Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendos, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm”.

³⁶⁶ Ligji Nr. 03/L006 për Procedurën Kontestimore, neni 10.1” Gjykata ka për detyrë të përipiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe më sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji”.

³⁶⁷ KEDNJ, neni 6, paragrafi 1.”Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e pa anshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendoset si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për besueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.

³⁶⁸ Ligji Nr. 02/L-28 i Procedurës Administrative, neni 130, paragrafi 1 përcakton se ”ankimimi administrativ bëhet brenda 30 dite nga dita e marrjes së njoftimit”. Neni 130, paragrafi 2 përcakton ”në rastin e mosveprimit administrativ (mos nxjerrjes së aktit dhe heshtjes së plotë), ankimi administrativ bëhet brenda 60 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedurës administrative”.

³⁶⁹ LAP, rasti A. nr. 155/2014. Ankuesi pohon se më 28 shkurt 2014, përmes postes elektronike zyrtare, është njoftuar nga Komisionit parlamentar *ad hoc* se më datën 4 mars 2014, në zyrat e Kuvendit të Republikës së Kosovës është caktuar intervista për pozitën e anëtarit të KPM, për të cilën pozitë ankuesi kishte konkurruar. Më 4 mars 2014, pak orë para se të fillon intervista, ankuesi njoftohet përmes telefonit se nuk mund t'i nënshtrohet intervistës, për shkak të një mendimi ligjor të AkK-së, e cila vlerëson se: “Nëse aplikuesi arrin të zgjidhet dhe vazhdon të ushtrojë këto dy pozita, konsiderohet se është në papajtueshmëri dhe kundërshtim me nenin 16, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike. Më 5 mars 2014, ankuesi iu drejtua Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kryesueses së Komisionit *ad hoc*, me një kërkesë me shkrim për dhënien e sqarimit me shkrim lidhur me shkaqet e diskualifikimit të tij nga gara e mëtejme për pozitën e anëtarit të KPM, mirëpo asnjëherë nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

Agjencisë kundër Korrupsionit (AkK), diskualifikimi i ankuesit nga konkurrenca, pa i dhënë mundësinë që të deklarohet se për cilën pozitë do të përcaktohej, është në kundërshtim me kërkesën e mendimit ligjor të AkK”. Më 21 maj 2014, sekretari i Kuvendit përmes letrës zyrtare e njoftoi Avokatit e Popullit për zhvillimin e procedurave nga Komisioni *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë KPM, mirëpo, nuk u dhanë sqarime shtesë për kërkesën kryesore të Avokatit të Popullit, që të informohet për arsyet e eliminimit nga gara.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në analizën ligjore, pas konstatimit për shkelje të të drejtave të njeriut në dëm të ankuesit, hartoi Raport me rekomandime duke rekomanduar që: (a) Kuvendi të ketë parasysh dhe të respektojë mendimet ligjore dhe opinionet e dhëna nga agjencia kompetente, në këtë rast AkK, sidomos kur vetë kërkon mendime të tilla; (b) Qytetarëve të cilët bëjnë parashtresa pranë këtij organi t’u kthehet një përgjigje brenda afatit ligjor,³⁷⁰ në mënyrë të mos u mohohet e drejta për shfrytëzim të mjeteve juridike efektive kundër vendimeve të veta, pasi një gjë e tillë qytetarëve u garantohet me Kushtetutë; (c) Sekretaria e Kuvendit të këshillojë komisionet përkatëse që të kenë parasysh të drejtat e njeriut dhe që kërkesave/ankesave të qytetarëve t’u përgjigjen me kohë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ankesat e paraqitura lidhur me të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave janë të paraqitura kundër KGJK-së, gjykatave të të gjitha niveleve, si dhe DHPGJSK-së.

Ankesat e qytetarëve drejtuar ministrive, administratës dhe komunave, kryesisht kanë të bëjnë me mos përgjigje në kërkesat e tyre – heshtje administrative, të cilat përfshijnë çështje të fushave të ndryshme: marrëdhënia e punës, çështjet pronësore, strehimi, qasja në dokumente publike.

Avokati i Popullit, në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore, ka zhvilluar hetime në lidhje me pohimet për cenimin e të drejtës për mjete juridike, ka kontaktuar përmes letrave dhe takimeve të drejtpërdrejta me autoritetet përgjegjëse dhe pas konstatimit të shkeljes të së drejtës për mjete juridike, ka kërkuar që të zbatohen rekomandimet e dhëna me qëllim të eliminimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe ligji.

Rekomandime:

- *Institucionet e Republikës së Kosovës në të gjitha nivelet, organet administrative dhe gjykatat, të respektojnë të drejtën për mjete juridike ashtu që qytetarët ta ushtrojnë këtë të drejtë sipas ligjit.*

2.30 Raportet e Avokatit të Popullit me Gjykatën Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën dhe vendimet e saj janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

³⁷⁰ *Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative*, neni 109, pika a), përcakton se:” Detyrimi për të njoftuar palët e interesuara, duhet të njoftohen për të gjitha aktet administrative me anë të të cilave merren vendime për pretendimet e tyre , ose krijohen, marrin fund, zgjerohen ose kufizohen interesat legjitime ose të drejta të palëve, ose pengohen kushtet për gëzimin e tyre në ndonjë mënyrë tjetër”. Neni 112 i po këtij ligji ka përcaktuar se: “Aktet administrative duhet të njoftohen brenda 8 ditëve nga dita kur është nxjerr akti, me përjashtim të rasteve kur me ligj është paraparë afat tjetër”.

Avokati i Popullit legjitimohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës si palë e autorizuar që t'i drejtohet GJKK-së kur ai vlerëson se të drejtat dhe liritë e njeriut janë pakësuar apo shkelur me rastin e nxjerrjes së një norme ligjore me karakter të përgjithshëm. Avokati i Popullit në vazhdimësi e përcjell punën e Gjykatës, si dhe praktikën e GJEDNJ-së dhe në shumë raste iu referohet vendimeve të këtyre dy gjykatave në rekomandimet, mendimet dhe sugjerimet e tij.

Është me rëndësi të ritheksohet se Avokati i Popullit është palë e autorizuar për të ngritur çështje para GJKK-së mbi bazën e nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës, për çështje që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, si dhe përputhshmërinë e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

2.30.1 Ndryshimi i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese – heqja e kufizimit

Avokati i Popullit edhe në raportimin e vitit të shkuar ka theksuar se do të duhej hapur diskutimi në lidhje me nevojën e ndryshimit të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese në mënyrë që të ndryshohet afati 6-mujor i përcaktuar si afat brenda të cilit Avokati i Popullit mund të parashtojë çështjet para GJKK-së. Avokati i Popullit konsideron se ky kufizim “[...] (6) muaj nga hyrja në fuqi e aktit të kontestuar” është joproporcional. Ky kufizim i afatit nuk mund të mbështetet nga përvoja e deritanishme në Republikën e Kosovës dhe në përvojat e vendeve të rajonit me ngjashmëri politiko-juridike, por as në përvojën e vendeve të tjera evropiane, që shquhen për stabilitet politiko-juridik. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit propozon dhe kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ndryshimin e kësaj norme ligjore, përkatësisht të nenit 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, duke hequr tërësisht kufizimin për Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës është personi i vetëm institucional jopolitik dhe i pavarur që e gëzon të drejtën e iniciativës për kontroll të kushtetutshmërisë së akteve përkatëse. Kur bëhet fjalë për ngritjen e rasteve të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera normative, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk e kufizon Avokatin e Popullit në aspektin material. Mirëpo, Ligji për Gjykatën Kushtetuese, duke e përcaktuar një afat të tillë kohor për ngritjen e rasteve të kushtetutshmërisë së ligjeve, paraqet një kufizim procedural të panevojshëm dhe rigid. Në lidhje me këtë Avokati i Popullit nëpërmjet një raporti me rekomandim i ka kërkuar Kuvendit të Kosovës që të ndërmerr veprime në drejtim të ndryshimit të Ligjit në fjalë.³⁷¹

Konsiderojmë se e drejta për të ngritur raste të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera normative, në veçanti kur këto mund të kenë ndikim në të drejtat dhe liritë themelore, nuk mund të kufizohet në aspektin kohor.

2.30.2 Referimi i Dekretit të Presidentes në Gjykatën Kushtetuese

Më 9 tetor 2014, Avokati i Popullit vlerësoi se Presidentja e Kosovës me nxjerrjen e Dekretit nr. DKGJK-001–2014 të datës 31 gusht 2014, kishte shkelur Kushtetutën, duke konfirmuar vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në GJKK pa marrë propozim nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga Gjykata që të njëjtin ta shfuqizojë, duke e

³⁷¹ LAP, Raport me rekomandime *ex officio* A. nr. 171/2014.

shpallë si kundër kushtetues. Nëpërmjet një analize të gjerë dhe të thellë, Avokati i Popullit në mënyrë të hollësishme shprehu qëndrimin e tij se nuk mund të interpretohet delegimi i kompetencës së *emërimit* të gjyqtarëve të GJKK-së në mënyrë që të nënkuptohet edhe delegimi i kompetencës së *propozimit* të tyre.³⁷² Këto janë dy kompetenca të ndara, dhe në mungesë të delegimit eksplicit të kompetencës së propozimit me Marrëveshjen ndërkombëtare në mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, ajo kompetencë mbetet e Kuvendit. Përderisa tre gjyqtarët ndërkombëtarë nuk janë propozuar nga Kuvendi, vazhdimi i mandatit të tyre nga Presidentja Jahjaga duhej shfuqizuar si akt kundërkushtetues. Avokati i Popullit konsideroi se nuk mund të anashkalohet Kuvendi me një veprim kaq të thjeshtë të Presidentes.

Sidoqoftë, më 13 nëntor 2014, Avokati i Popullit pranoi nga GJKK Aktvendimin për papranueshmëri të kërkesës lidhur me Dekretin e Presidentes së Republikës së Kosovës nr. DKGJK – 001 – 2014, të datës 31 gusht 2014, për konfirmimin e vazhimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në GJKK. Ky Aktvendim i GJKK-së do të konsiderohej si fjala e fundit në aspektin e hierarkisë ligjore, po të mos kishte dalë më vonë dëshmi që krijonin dëshmi të arsyeshme se Aktvendimi ishte i falsifikuar, duke fshehur mungesën e kuorumit.

Një analizë e hollësishme e Aktvendimit të GJKK-së për këtë rast, vë në pah mangësitë profesionale juridike dhe një mungesë pothuajse të plotë të arsytimit në këtë Aktvendim. Në aspektin substancial, shembulli më i dukshëm i mungesës së arsytimit shfaqet në pretendimin e Gjykatës se Dekreti i Presidentes është në linjë me atë që kërkohet në përmbajtjen e marrëveshjes ndërkombëtare. Ky pretendim i Gjykatës nuk shoqërohet me asnjë argument, me asnjë citim të dispozitave specifike të marrëveshjes, në të cilën pretendon të bazohet, si dhe nuk i përgjigjet asnjërit prej argumenteve të parashtruara nga Avokati i Popullit mbi këtë pikë.

Çështja drejtuar GJKK-së, përmes kërkesës së parashtruar nga Avokati i Popullit, konsistonte pikërisht në pyetjen nëse devijimi i Dekretit të Presidentes nga dispozitat relevante kushtetuese, është në të vërtetë në linjë me atë që kërkohet në përmbajtjen e marrëveshjes ndërkombëtare. Këtë pikë, Avokati i Popullit e ka kontestuar me një arsyetim të gjatë dhe të hollësishëm juridik në kërkesën e tij. Fakti që Gjykata ka vendosur të trajtojë pyetjen kryesore të një rasti me vetëm një paragraf të shkurtër, pa arsyetim, pa citim, dhe pa iu përgjigjur asnjë argumenti të parashtruesit mbi këtë pyetje, tregon një varfëri shqetësuese të shtjellimit juridik, si dhe një shpërfillje të standardeve të gjykimit të drejtë dhe të paanshëm.

Pak kohë pas dërgimit të kërkesës nga Avokati i Popullit tek GJKK, në emisionin *Jeta në Kosovë* u bë publik një memorandum i brendshëm i Misionit EULEX, i shkruar nga një Këshilltar Ligjor i EULEX-it, i cili i është drejtuar Kryetarit të Misionit. Sipas këtij memorandum, Kryetari i GJKK-së ishte konsultuar nga EULEX-i mbi pyetjen e parashtruar në këtë rast, duke shprehur mendimin e tij se anashkalimi i Kuvendit në procesin e emërimit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë nuk do të përbënte shkelje kushtetuese. Ndërsa, më 10 tetor 2014, në revistën *Prishtina Insight*, u botua një kopje të plotë e memorandumit, në të cilin shprehimisht qëndron se: “Kryetari i Gjykatës Kushtetuese në mënyrë joformale u pajtua me këtë procedurë [për emërimin e tre gjyqtarëve ndërkombëtarë], dhe tha që nuk ka nevojë për angazhimin e Kuvendit[.]”³⁷³

Duhet theksuar se, megjithëse memorandum i EULEX-it tregon se Kryetari i GJKK-së z. Enver Hasani u pajtua vetëm “në mënyrë joformale” me anashkalimin e Kuvendit, ai

³⁷² Parashtruesin e Avokatit të Popullit drejtuar GJKK-së mund ta gjeni në www.ombudspersonkosovo.org

³⁷³ *Prishtina Insight*. Issue No. 143, October 10 - 23.

memorandum tregon gjithashtu se, z. Hasani është konsultuar pikërisht në cilësinë e tij si Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, jo thjesht vetëm për mendimin e tij profesional. Mënyra e vetme se si identifikohet ai në memorandum është në bazë të funksionit të tij zyrtar: “*Kryetar i Gjykatës Kushtetuese*”. Pra vetëm në atë cilësi është konsultuar nga EULEX-i. dhe ka dhënë mendimin e tij shprehimisht si Kryetar i GJKK-së. Rrjedhimisht del se, Z. Hasani ka luajtur rol aktiv në miratimin e procedurës së ndjekur për emërimin e këtyre gjyqtarëve dhe është e dukshme që mund të vihet në pikëpyetje anshmëria e tij në vlerësimin e kushtetutshmërisë së vetë asaj procedure që po kontestohej nga Avokati i Popullit. Megjithëkëtë, në vend që të rezervohet nga pjesëmarrja në procedurën e rastit KO155/14, ai e kishte caktuar vetën si pjesë të kolegjit shqyrtues të këtij rasti.³⁷⁴

Në kuadër të obligimit juridik, intelektual dhe institucional për arsyetimin e vendimeve, edhe GJKK është e lidhur me standarde të verifikueshme. Ky obligim i Gjykatës korrespondon me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për t’u shprehur në lidhje me çështjen. Avokati i Popullit, si parashtrues në këtë proces, ka të drejtën subjektive që t’i kërkojë Gjykatës, jo vetëm të marrë vendim të arsyetuar, por dhe që në arsyetimin e vendimit t’i përmbahet tekstit normativ të legjitimuar në mënyrë demokratike. Përballë një Aktvendimi të tillë, Avokati i Popullit jo vetëm ka të drejtë, por e ka edhe për detyrë, të tërheqë vëmendjen e publikut dhe të hapë debat publik për performancën e dobët juridike dhe profesionale të gjykatës më të lartë të vendit në lidhje me çështjen e Dekretit të Presidentes.

2.30.3 Gjetja e punëve përgatitore për Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Për Avokatin e Popullit shqetësuese ka qenë edhe mos gjetja e dokumenteve përgatitore (*travaux préparatoires*) të Kushtetutës së Kosovës, dokumente këto të pazëvendësueshme, të cilat do të mund të përdroreshin për të ndihmuar në zgjidhjen e dykuptimësisë në tekstin e Kushtetutës dhe për të kuptuar qëllimin e hartuesve të saj. Kërkesat e vazhdueshme nga GJKK, gjatë një periudhe prej më shumë se katër vite, për gjetjen dhe për futjen e tyre në përdorim, kanë dështuar. Institucionet përgjegjëse, të cilat kanë pasur në pronësi këto dokumente, për arsye krejt të panjohura, i kanë mbajtur të fshehura këto dokumente nga publiku dhe institucionet relevante. Mospërgjigja, apo ta quajmë edhe fshehjen e tyre, është rasti më eklatant i refuzimit të qasjes në dokumente publike në Republikën e Kosovës. Megjithëse, në media është raportuar se këto dokumente gjenden të arkivuara dhe “pa pronar” në një objekt të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ato nuk i janë ofruar madje as për konsultim, madje as GJKK-së të Republikës së Kosovës, nga “pronari” i tyre.³⁷⁵

Zbardhja në media e këtij informacioni shqetësues, por edhe kërkesat e pasuksesshme të Gjykatës Kushtetuese për të konsultuar këto dokumente për rastet në shqyrtim, e ka detyruar Avokatin e Popullit të hapë rast *ex officio* me pesë qëllime kryesore: (1) për të konstatuar nëse është me bazë raportimi për ekzistencën dhe vendndodhjen, respektivisht arkivimin e këtyre dokumenteve, në objektin e Qeverisë; (2) për të hetuar nëse ndonjë institucion ose organ i pushtetit shtetëror ka vepruar në kundërshtim me nenin 41, par. 2 të Kushtetutës, e cila përcakton se “[d]okumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë

³⁷⁴ Shih në: http://www.gjk-ks.org/repository/docs/KO155-14_SHQ.pdf (29.12.2014).

³⁷⁵ “Arkiva e draftimit të Kushtetutës në objekt të Qeverisë dhe ‘pa pronar,’” *Kosova Press*, 1 tetor 2014 (<http://www.kosovapress.com/sq/nacionale/arkiva-e-draftimit-te-kushtetutes-ne-objekt-te-qeverise-dhe-pa-pronar-26024/>).

publike[.]”; (3) për t’u siguruar që këto dokumente të dërgohen pa vonesë tek GJKK, në përputhje me kërkesat e vazhdueshme të kësaj Gjykate; (4) për të mundësuar qasje në *travaux preparatoires* nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë punës së vet, dhe (5) për të publikuar dhe për të ruajtur këto dëshmi institucionale dhe historike të themelimit të Republikës së Kosovës, si për qytetarët e sotëm, ashtu edhe për brezat e ardhshëm.

Pas një hulumtimi këmbëngulës dhe komunikimeve të suksesshme me zyrat përgjegjëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Presidencën, Qeverinë e Kosovës dhe Arkivin Shtetëror të Kosovës, Avokati i Popullit, më 5 dhjetor 2014 ka marrë konfirmimin zyrtar që Zyra e Kryeministrit, e cila posedonte të gjitha dokumentet, i dërgoi ato në ASHAK më 24 nëntor 2014, dhjetë ditë pas kërkesës së parë nga ana e Avokatit të Popullit.

Natyrisht, askush deri më tani nuk është marrë në përgjegjësi ligjore për “humbjen”, “pronësinë” e paligjshme, apo mosdhënien e këtyre dokumenteve institucioneve relevante, në radhë të parë GJKK, kur ato janë kërkuar edhe publikisht në raste të ndryshme. Kjo dëshmon katërcipërisht, edhe njëherë më shumë, për papërgjegjësinë ligjore të rangut më të lartë të hierarkisë shtetërore të Republikës së Kosovës.

2.30.4 Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Rekomandimi i Avokatit të Popullit i vitit 2013 drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe AKPv-së që të zbatojnë vendimin e GJKK-së, të datës 7 dhjetor 2010, Nr. REF.: AGJ 75/10 për kompensimin e ish-punonjësve të Fabrikës së Çelikut - IMK Ferizaj vazhdon të mbetet i pazbatuar e rrjedhimisht edhe vendimi i GJKK-së. Të dy institucionet, si Qeveria e Republikës së Kosovës, po ashtu edhe AKPv, kanë qëndruar dhe vazhdojnë të qëndrojnë të heshtura në lidhje me këtë.

Në lidhje me këtë rast, Avokati i Popullit nuk pranoi asnjëherë përgjigje as nga Qeveria dhe as nga agjencia e përmendur, megjithëse Kushtetuta e Republikës së Kosovës obligon të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që t’u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe të zbatojnë rekomandimet e tij. Moszbatimi i vendimeve gjyqësore nga institucionet dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas për zbatimin e vendimeve gjyqësore pa vonesa të panevojshme, përbën shkelje të të drejtave të njeriut, zbehë besimin e qytetarëve në zbatimin e drejtësisë dhe shtetin ligjor.

Rekomandime:

- *Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121, përkatësisht neni 30, duke e hequr tërësisht kufizimin kohor për kontestimin e akteve juridike/paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese nga Avokati i Popullit.*
- *Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit të ndërmarrin masa të menjëhershme për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Ref. nr. AGJ 75/10, sipas rastit nr. KI 08/09, pa ndonjë zvarritje të mëtutjeshme.*

2.31 Hetimi kundërligjor i IAP nga Prokuroria Themelore

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka afërsisht 30 muaj që ka hapur hetime mbi bazën e një denoncimi anonim ndaj IAP-së, ndonëse nuk dihet data e saktë e hapjes së hetimeve, pasi IAP nuk ka pranuar asnjë shkresë zyrtare për hapjen e hetimeve nga prokuroria. Me këtë fakt IAP është vënë në dijeni për herë të parë kur policia hetimore ka ardhur në selinë e IAP dhe nga zyrtari përgjegjës kërkoi dokumente zyrtare, sipas një shkrese të lëshuar nga Prokuroria Komonale (tani Prokuroria Themelore në Prishtinë, nr. 2302/2-2012 të datës 04.07.2012, me të cilën autorizohet Njësia e Hetimeve Financiare - Departamenti Hetimeve për Krime Ekonomike në Policinë e Kosovës, për ndërmarrjen e veprimeve hetimore.

IAP, bazuar në mandatin e tij kushtetues, për zbatimin e ligjit nga të gjitha autoritetet publike, ka bashkëpunuar me hetuesit policorë, duke iu ofruar të gjitha dokumentet e kërkuara nga ana e tyre, duke respektuar kompetencat e tyre, gjithnjë me qëllim të hetimeve të dyshimit të supozuar për keqpërdorime financiare dhe të përfundimit sa më të shpejtë të hetimeve.

Me gjithë gatishmërinë dhe bashkëpunimin e IAP-së, për të ndihmuar organet e hetuesisë në hetimin mbi bazën e denoncimit anonim për keqpërdorime financiare hetimet e filluara asnjëherë nuk kanë përfunduar zyrtarisht.

Stërzgjatja e hetimeve nga Prokuroria mbi 30 muaj, kalimi nga hetimet fillimisht financiare në hetime nga marrëdhënia e punës, mos informimi i IAP lidhur me fillimin e hetimeve, veprat dhe personat e dyshuar, mungesa e aktvendimit të Prokurorisë për fillimin e hetimeve, vënë në dyshim qëllimin e këtyre hetimeve dhe të nismëtarit/ëve dhe trajtimin ligjor të këtyre hetimeve, të cilat qartazi po përcillen me shkelje ligjore të KPPRK-së, në dëm të IAP-së. Këto hetime e kanë vënë nën presion të drejtpërdrejtë punën dhe ushtrimin e mandatit ligjor të IAP-së si institucion i pavarur kushtetues, në mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të njeriut.

2.31.1 Përshkrimi i fillimit të hetimeve - Dëshmitë dhe faktet e rastit

IAP për herë të parë ka kuptuar se janë hapur hetime nga ana e Prokurorisë Komonale (tani Prokuroria Themelore) në Prishtinë kundër IAP-së, sipas autorizimit PN.nr.2302/2012 të datës 4.7.2012. Hetimet e iniciuara **mbi bazën e denoncimit anonim** kanë të bëjnë me shkeljet e mundshme dhe **keqpërdorimet financiare** në IAP, pa përmendur emra konkretë të personave të dyshuar.³⁷⁶

IAP sipas kërkesës së zyrtarëve hetues, ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara; raportet e auditimit, listat e pagave, vendimet e pozitive, faturat e shpenzimeve të ndryshme etj.

Pas kërkesës së parë, me një shkresë të dytë, të datës 11.02.2013, hetuesi i NjHF-DHKEK, kërkon nga IAP edhe dokumente shtesë: Raportet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për vitin 2011; tenderi për furnizim me naftë për vitin 2010; kontratat për furnizim me telefona mobil për vitin 2010; kontrata për shërbime të teknologjisë informative për vitin 2010; kontrata për shërbime hoteliere për vitin 2010; kopjen e tenderit për furnizim me pije për konferencën

³⁷⁶ Kërkesa e Policisë së Kosovës - Njësia për Hetime të Krimeve Financiare, e datës 30.10.2012, DHKEK/P/122/12, Referenca NDH-06/1-02/1-2/391-2012.

ndërkombëtare, të 10-të jubilarë të IAP-së, si dhe të gjitha kontratat e shpenzimeve, lidhur me këtë konferencë.³⁷⁷ Të gjitha këto dokumente janë dorëzuar me kohë..

Policia e Kosovës, Njësia për Hetime të Krimeve Financiare, në vitin 2013, nëpërmjet telefonit i ka ftuar 3 zyrtarë për intervistim, ndërsa në vitin 2014 ka ftuar 8 zyrtarë të IAP-së, madje disa edhe nga dy e tri herë në stacionin e policisë në Prishtinë, lidhur me këto hetime.

IAP nuk është informuar asnjëherë se në çfarë cilësie janë ftuar këta zyrtarë për të dhënë deklaratat, sepse nuk ka pasur asnjë ftesë zyrtare me shkrim. Po ashtu, IAP nuk e ka të qartë se a janë këta persona të dyshuar për keqpërdorime financiare apo janë të ftuar si dëshmitarë apo sqarues të dokumenteve.

Me shkresën e datës 15.11.2013, Prokurorja e Shtetit znj. Merrushe Llugini, lëshon Urdhëresë, me të cilën zgjerohen hetimet dhe kërkohet nga IAP që zyrtarit policor hetues të ngarkuar me rastin, t'i jepet një kopje e dosjeve të 12 zyrtarëve të punësuar në IAP, për të hetuar dyshimet lidhur me themelimin e marrëdhënies së punës dhe avancimet e tyre në IAP.³⁷⁸

Prokuroria, nga **hetime për keqpërdorime financiare**, të cilat po i zhvillonte mbi 17 muaj, tani kalon në hetime të **punësimit dhe avancimit** dhe, për këtë zgjerim të hetimeve në një fushë tjetër, IAP deri më sot nuk ka marrë kurrfarë njoftimi dhe aktvendimi për zgjerim të hetimeve.³⁷⁹

Në mesin e dosjeve të kërkuara ka zyrtarë të cilët janë punësuar në IAP që nga viti 2000, përkatësisht që nga themelimi i IAP-së nga OSBE, kur ky institucion ka qenë i udhëhequr nga OSBE. Këta zyrtarë kanë përvojë 13-vjeçare në IAP, ndërsa tani, në vitin 2013, prokuroria po heton mënyrën e punësimit të tyre. Në këtë mënyrë lind dilema se, kush është përgjegjës dhe a mund të kërkohet përgjegjësi penale për mënyrën e punësimit të bërë nga OSBE?

Po ashtu, në mesin e të punësuarve për të cilët kërkohen dosjet, ka persona të cilët janë të emëruar publik nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pa u sqaruar çështja e imunitetit të tyre a mund të hetohen këta persona pa u njoftuar Kuvendi i Kosovës?³⁸⁰

Pasi IAP nuk ka marrë aktvendim për zgjerimin e hetimeve nga Prokuroria Themelore e Prishtinës, nuk e ka të qartë nëse zyrtarët, dosjet e të cilëve kërkohen, janë persona të dyshuar për krime të rënda penale?

Në takimin e mbajtur më 9 dhjetor 2013, Avokati i Popullit njoftoi Kryeprokurorin e Shtetit për hetimet e nisura dhe kërkoi të informohet në lidhje me hetimet që janë duke u zhvilluar kundër IAP-së, si dhe e njoftoi për lëshimet ligjore nga Prokuroria në dëm të IAP-së dhe kërkoi evitimin e tyre.³⁸¹

³⁷⁷ Kërkesa e Policisë së Kosovës Njësia për Hetime Financiare, e datës 11.2.2013, DHKEK/P/122/12, Referenca NDH-06/1-02/1-2/42-2012.

³⁷⁸ Urdhëresë nr. PPN.I.nr.2302/2012 e datës 1.11.2013, Departamenti i Krimeve të Rënda i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, hetime për punësimet e OSBE-së.

³⁷⁹ Po aty.

³⁸⁰ Po aty.

³⁸¹ Takim i Avokatit të Popullit me z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit, dhe z. Imer Beka, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, më 9 dhjetor 2013. Kryeprokurori Kabashi njoftoi se nuk është shumë i informuar në lidhje me atë se për çka po bëhet fjalë, por në bazë të numrit të lëndës shihet se nuk është fjala për rast të hapur, por është fjala për procedurë paraprake të mbledhjes së të dhënave në bazë të njoftimeve të pranuar për keqpërdorim të mundshëm. Më tej ai theksoi se këto raste (anonime) edhe vetë prokuroria i merr me shumë rezervë megjithatë në bazë të ligjit janë të obliguar që të veprojnë. Avokati i Popullit i bëri me dije Kryeprokurorit se, është i interesuar për rezultatet

Më 4 korrik 2014, nëpërmjet telefonit është ftuar në bisedë-intervistë nga NJHF – DHKEK në Policinë e Kosovës Drejtori Ekzekutiv i IAP-së. Në bisedë e sipër, vetëm gojarisht, pa ofruar asnjë dokument zyrtar, Drejtori Ekzekutiv i IAP-së është informuar se ai është personi i dyshuar në hetimet e zhvilluara kundër IAP, për veprën penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. Në këtë bisedë nuk është përmendur ndonjë emër tjetër i ndonjë zyrtari të IAP-së.

Pas këtij njoftimi gojor të Policisë së Kosovës – NJHF-DHKEK, IAP duke konsideruar se angazhimi i këshilltarëve ligjor të institucionit do të paraqiste konflikt të interesit ka vendosur të angazhojë avokat mbrojtës për të përcjellë procedurat dhe për të mbrojtur interesat e IAP në çështje penale.

Më 25 korrik 2014, avokati mbrojtës i angazhuar nga IAP, nëpërmjet një shkrese, kërkoi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamentit të Krimeve të Rënda, respektivisht Kryeprokurorit të kësaj Prokurorie z. Imer Beka dhe prokurorja e rastit znj. Merrushe Llugiqi, që të *“njoftohemi se në cilën fazë gjenden hetimet eventuale, dhe nëse ka kaluar afati nga neni 157 i këtij kodi, kërkojmë që të merret vendimi për pushimin e hetimeve,”*. As Avokati mbrojtës dhe as IAP, respektivisht Drejtori Ekzekutiv i IAP-së, nuk kanë pranuar kurrë asnjë përgjigje.

Avokati i Popullit më 26 dhjetor 2014, në konferencën për media të organizuar të fund të vitit, publikisht ka kërkuar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, z. Imer Beka, të zbardhë procesin dhe fatin e rastit të hetimeve të hapura kundër IAP 30 muaj më parë.³⁸² Të njëjtën ditë, Kryeprokurori, z. Imer Beka, i pyetur nga portali online KALLXO.COM për deklaratën publike të Avokatit të Popullit rreth hetimeve të fshehta të Prokurorisë Themelore në Prishtinë kundër IAP-së, deklaroi se *“Lënda është në fazën e hetimeve dhe ajo ka të bëjë për individët përbrenda Institucionit duke mos anashkaluar edhe vet Avokatin e Popullit.”*³⁸³ Që nga ajo ditë, IAP nuk ka marrë asnjë informatë, dokument apo njoftim zyrtar nga Prokuroria në lidhje me rastin.

Megjithëse tani më kanë kaluar mbi 30 muaj nga fillimi i hetimeve, IAP ende nuk ka asnjë informacion zyrtar nga Prokuroria për gjetjet nga hetimet, nëse ka kryerje të veprës penale apo të ndonjë veprimi tjetër të kundërligjshëm nga zyrtarët e IAP-së.

2.31.2 Baza ligjore

Hetimet zhvilluara nga ana e Prokurorisë së Shtetit ndaj IAP nuk janë zhvilluar në përputhje me nenin 103 dhe 104 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), nr. 04/L-123.

përfundimtare të hetimit dhe përfundimin e tyre sipas kërkesës së ligjit, në të kundërtën hetimet e hapura jashtë afateve ligjore janë një presion i vazhdueshëm në bashkëpunëtorët e IAP dhe në punën e institucionit dhe përpjekje për frikësim dhe shantazh me qëllime politike. Po ashtu nga Kryeprokurori u kërkua që çështja e hetimit zbardhet deri në fund.

³⁸² Shih në: <http://www.telegrafi.com/lajme/sami-kurteshi-thote-se-kosova-ka-deshtuar-me-2014-qeni-i-keq-ta-bjen-ujkun-ne-torishte-2-56010.html>; në: <http://kosovaonline.info/?page=1,3,56355> (30.12.2014).

³⁸³ Shih në: <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Avokati-i-Popullit-Kerkon-Ta-Dije-Pse-Po-Hetohet-3877> (30.12.2014).

Neni 103, paragrafi 3 dhe 4 përcakton:

*“3. Çdo person për të cilin prokurori i shtetit ka dyshim të arsyeshëm se ka kryer veprë penale duhet të ceket **si i pandehur në aktvendimin për fillimin e hetimit**. Çdo i pandehur i cekur në vendim gëzon të gjitha të drejtat që i takojnë të pandehurit me këtë Kod.*

*4. Nëse prokurori i shtetit mëson për kryerjen e një veprë tjetër penale ose për një të dyshuar tjetër gjatë hetimit, prokurori i shtetit mund të fillojë një hetim të ri për veprën e re penale apo të dyshuarit, ose mund të zgjerojë hetimin ekzistues. Prokurori i shtetit njofton gjyqtarin e procedurës paraprake **për aktvendimet e reja apo të ndryshuara.**”*

Neni 104, paragrafi 1 dhe 5 përcakton:

*“1. Hetimi fillobet me **aktvendim të prokurorit të shtetit**. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit do të kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përbërësit e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale, nëse masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit apo hetimit janë autorizuar dhe provat me të dhënat e mbledhura deri në atë moment. Një kopje e aktvendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprake.*

5. Hetimi kryhet vetëm lidhur me veprën penale dhe me të pandehurin e përcaktuar në aktvendimin mbi fillimin e hetimit apo në aktvendimin e ndryshuar.”

2.31.3 Hetimi i avancimeve në punë

Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK), në nenet 221, 222 dhe 223, veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës, në asnjë dispozitë ligjore nuk parasheh se avancimet në punë janë veprë penale.

Po ashtu, punësimet në Institucionin e Avokatit të Popullit bëhen në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civil dhe në të gjitha rastet e punësimit për pozita menaxhuese të pranishëm kanë qenë përfaqësuesit e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK). Në të gjitha rastet e punësimeve, bazuar në ligjet dhe rregullat e shërbimit civil, KPMK ka mandatin mbikëqyrës në bazë të Ligjit Nr. 03/L-192, neni 10, i cili përcakton funksionet e Këshillit:

“1.2. vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës;

1.3. mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.”

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, si institucioni më i lartë kushtetues i kontrollimit ekonomik e financiar, çdo vit auditon IAP dhe, të gjeturat lidhur me çështjet financiare publikohen në raportet e tij.³⁸⁴ Auditori i Përgjithshëm asnjëherë nuk ka gjetur keqpërdorime të mjeteve financiare në IAP, që do të shërbente si bazë për hetime penale. Përveç auditimit financiar, Auditori i Përgjithshëm për çdo vit auditon edhe punësimet e reja për vitin kalendarik të auditimit. Sipas raporteve të tij, ai asnjëherë nuk ka evidentuar shkelje të procedurave ligjore të punësimit në IAP.

³⁸⁴ Shih në: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_IAP_2010_Shqip_636893.pdf;
në: http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_IAP_2011_Shqip_872837.pdf; në:
http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_IAP_2012_Shqip_306104.pdf; në:
http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_IAP_2013_Shqip_512034.pdf (25.12.2014).

2.31.4 Konstatimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

Siç vërehet edhe nga përshkrimi më lartë, IAP ka bashkëpunuar me zyrtarët hetues dhe prokurorinë në të gjitha fazat e hetimit, duke iu ofruar atyre të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe ka mundësuar që të gjithë zyrtarët e tij t'u përgjigjen ftesave nëpërmjet thirrjeve telefonike për intervistim.

Avokati i Popullit konstaton se, hetimet e filluara para më se 30 muajve, janë zvarritur pa arsye dhe nuk kanë përfunduar ndonjëherë, përkundër interesimit të IAP-së për zbardhjen e dyshimeve për keqpërdorim në IAP. Mungesa e transparencës, rezultateve dhe informatave në lidhje me hetimet, janë një keqpërdorim klasik i kompetencave ligjore nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, respektivisht Kryeprokurori i saj, z. Imer Beka.

IAP, konstaton se në mungesë të aktvendimit të prokurorisë për zhvillim të hetimeve, si dhe të njoftimit se nga kush është iniciuar kallëzimi penal, duke deklaruar se iniciimi penal është anonim, sipas shkresës së parë të policisë, ka fshehje të qëllimit të zhvillimit të hetimeve nga ana e zyrtarëve policor dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë. Po ashtu, mungesa e informatave se ndaj cilëve zyrtarë të IAP-së janë duke u zhvilluar hetimet; cilët janë personat e pandehur, nëse ata janë të zgjedhur publikë apo shërbyes civilë; mungesa e informatave se për cilën veprë penale të krimeve respektivisht keqpërdorimeve po zhvillohen hetimet; mungesa e emërimit ligjor të veprës penale; mungesa e një dokumenti zyrtar që dëshmon kohën e fillimit të hetimit, të gjitha këto janë elemente që shtojnë dyshimin për keqpërdorim të pozitës zyrtare nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, me dijeninë e ish-Kryeprokurorit të Shtetit z. Ismet Kabashi.

Mungesa e një aktvendimi për zgjerim të hetimeve për veprë të re penale punësim/avancim, pas 17 muajve të hetimit për dyshime të keqpërdorimit financiar, kjo lë dhe nuk mund të kuptohet ndryshe përveç se, pasi që nga hetimet për krime financiare nuk janë gjetur fakte dhe dëshmi të shkeljeve, tani kërkohet doemos ndonjë shkelje bërë në IAP, qoftë edhe në lëmin e punësimit dhe avancimit, që nuk është fare në kompetencë të prokurorisë sipas KPRK-së.

Punësimi dhe avancimi i nënshtrohen mbikëqyrjes nga institucionet e pavarura, KPMK-së dhe Auditori i Përgjithshëm dhe duke ditur se avancimi nuk është veprë penale, për Avokatin e Popullit ka hapësirë për dyshim të bazuar në qëllimet objektive dhe ligjore të këtij hetimi të përgjithshëm. Avokati i Popullit konstaton se për hetimet e hapura nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, IAP nuk është njoftuar zyrtarisht, nuk ka pranuar aktvendim për hapjen e hetimeve dhe nuk ka aktvendim për zgjerimin e hetimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 103 dhe 104 të KPRK-së, Nr. 04/L-123.

Avokati i Popullit konstaton se këto hetime të nisura në mënyrë anonime, të përcjella me kërkesa të hetuesve policorë dhe prokurorisë për dokumente të shumta, të llojllojshme dhe të periudhave të ndryshme kohore, me numër të madh të të intervistuarve (vetëm për 12 intervistime të kryera nga zyrtarët policor për të cilat është i informuar IAP vetëm nga bashkëpunëtorët por jo edhe zyrtarisht), numrit të madh të dosjeve të kërkuara të të punësuarve (trembëdhjetë), në mesin e të cilëve janë edhe këshilltarë ligjorë, sforcon dyshimin se kemi të bëjmë me hetime të porositura, me qëllim të paracaktuar, për të penguar punën e Avokatit të Popullit duke bërë përpjekje për ta frikësuar dhe shantazhuar atë me hapje të hetimeve për gjithçka, për çdo kohë dhe në çdo kohë, pa asnjë bazë dhe vetëm për të shantazhuar IAP duke e mbajtur atë nën presionin e hetimeve me dyshimin për fajësi.

Për më tepër, vetë deklarimi i Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, z. Imer Beka, se *“Lënda është në fazën e hetimeve dhe ajo ka të bëjë për individët përbrenda Institucionit duke mos anashkaluar edhe vet Avokatin e Popullit”*,³⁸⁵ duke i *“zgjerruar betimet”* edhe kundër vet Avokatit të Popullit si person, dëshmon për qëllimin politik me premisa të veprës penale të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të Prokurorisë së Shtetit të Kosovës kundër Avokatit të Popullit, me qëllim të shantazhit dhe të presionit politik. Kjo është vepër e dënueshme me KPRK.

Rekomandon:

Prokurorinë Themelore në Prishtinë

- *Të njoftojë IAP për identitetin e iniciuesit/ve, person fizik apo juridik, dhe ndjekjen e tij penale për shkak të paraqitjes së kallëzimit të rrejshëm penal. Përfundimin e hetimeve edhe dërgimin e aktvendimit për mbylljen e rastit lidhur me dyshimet e ngritura për veprën penale me shifrën PPN.nr.2302/2012, pas kalimit të afatit kohor sipas nenin 159 paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale.*

Prokurorin e Shtetit

- *Të hetojnë zyrtarët/prokuroret e çështjes të involvuar në këtë çështje, dhe të ndërmerr masa ligjore ndaj të gjithë atyre, varësisht nga shkalla e përgjegjësisë së tyre personale dhe funksionale, deri në shkarkim, për zhvillimin e hetimeve me shkelje të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nenet 103,104, 9. paragrafi 1,2,3 dhe, në dëm të Institucionit të Avokatit të Popullit.*

³⁸⁵ Shih në: <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Avokati-i-Popullit-Kerkon-Ta-Dije-Pse-Po-Hetohet-3877> (30.12.2014).

Kapitulli III

Bashkëpunimi dhe aktivitetet e IAP-së

3.1. Bashkëpunimi me institucionet vendore

Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm për të mbrojtur dhe për të përmirësuar gjendjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kosovë, IAP angazhohet për të bashkëpunuar me institucionet vendore, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, që angazhohen për promovimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

IAP, edhe gjatë vitit 2014, ka bashkëpunuar me institucionet vendore siç janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, ministritë e ndryshme, komunat, institucionet dhe agjencitë e pavarura, si dhe gjykatat.

Në pjesën e parë të vitit, gjegjësisht deri në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në qershor 2014, bashkëpunimi me institucionet vendore ka qenë i vazhdueshëm. Por, për shkak të bllokadës politike të krijuar pas vendimeve të GJKK-së dhe pengesave në konstituimin e Kuvendit dhe mos formimin e qeverisë mbi gjashtë muaj, janë vërejtur pengesa të ndryshme në bashkëpunimin e IAP-së me institucionet vendore. IAP, me gjithë pengesat, ka vazhduar bashkëpunimin edhe me Qeverinë e Republikës së Kosovës, mirëpo bllokimi i funksionimit të institucioneve gjatë vitit 2014 është shprehur qartë edhe në sjelljen e qytetarëve, sepse është vërejtur një rënie e dukshme e ankesave të qytetarëve në IAP kundër institucioneve publike.

Në periudhën funksionale të institucioneve, me Kuvendin e Republikës së Kosovës janë realizuar shumë takime, gjithashtu janë dërguar raporte me rekomandime. Me theks të veçantë duhet përmendur bashkëpunimin shumë të mirë që IAP ka pasur me Komisionin parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Komisioni parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, gjatë shqyrtimit të Raportit vjetor 2013 të IAP-së, punën e IAP, si dhe punimin në mënyrë sistematike të raportit vjetor dhe dërgimit në parlament në afatin e paraparë me ligj, e ka vlerësuar shumë lartë.

Këshilli Konsultativ për Komunitete që vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet dhe përbëhet përveç të tjerësh, nga përfaqësues të asociacioneve të komuniteteve, ku edhe IAP ka dhënë një kontribut të çmueshëm në trajtimin e çështjeve dhe grumbullimin e informatave lidhur me situatën e komuniteteve në shoqërinë tonë.

IAP në cilësinë e vëzhguesit është pjesë e Komitetit Drejtues Ndërinstitucional për integrimin e Komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, themeluar nga Qeveria e Kosovës, lidhur me realizimin e strategjisë afatmesme për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian 2009-2015.

Grupi për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) i IAP në drejtim të promovimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe të ngritjes së kapaciteteve profesionale ka bashkëpunuar edhe me

Këshillin për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë (KMDF),³⁸⁶ i cili përveç tjerash punon në përcaktimin e prioriteteve dhe masave të nevojshme që duhet të ndërmerren me qëllim të përmirësimit të situatës në lidhje me mbrojtjen dhe drejtësinë për fëmijë.

Më 5 maj 2014 GDF, mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga ZQM e ZKM-së, në bashkëpunim me UNICEF-in dhe BE-në në Kosovë, në kuadër projektit “Reformat e drejtësisë për fëmijë”. Në këtë tryezë u prezantuan “Treguesit e Drejtësisë për Fëmijë” të cilët ishin zhvilluar dhe hartuar me qëllim që institucionet qeveritare të ndihmohen në marrjen e vendimeve për sistemin e drejtësisë për fëmijë duke paraqitur dëshmitë në qendër të procesit të politik-bërjes dhe ofrimin e informatave lidhur me përmbushjen dhe respektimin e standardeve përkatëse.

IAP po ashtu bashkëpunon me Komisionarin për gjuhët pranë ZKM-së, nën juridiksionin e të cilit është monitorimi i respektimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Përfaqësuesit e IAP-së të grupit për të drejtat e komunitetit LGBT po ashtu janë pjesë e Grupit Koordinues dhe Këshillëdhënës në nivelin nacional të Republikës së Kosovës pranë ZQM-së për të drejtat e LGBT dhe me pjesëmarrje aktive në takimet e grupit kontribuojnë në gjetjen e formave më të mira në mbrojtjen e pjesëtarëve të orientimit LGBT nga diskriminimi në shoqëri.

IAP ka vazhduar bashkëpunimin me të gjitha nivelet duke dhënë kontributin e tij në ofrimin e opinioneve në nismat legislative, projektligjeve dhe drafteve të akteve nënligjore në fushën e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit, me hapjen edhe të dy zyrave rajonale në fund të vitit 2013, në Ferizaj dhe në Gjakovë, është ofruar edhe më afër qytetarëve në drejtim të mbrojtjes të të drejtave të tyre.

Sipas statistikave të IAP-së, edhe gjatë vitit 2014 numri më i madh i ankesave nga qytetarët janë adresuar ndaj gjyqësorit mirëpo edhe bashkëpunimi në raport me vitin paraprak lidhur me trajtimin e ankesave të qytetarëve ka qenë dukshëm më i mirë. Përfaqësuesit e IAP-së, në përputhje me mandatin, sipas nevojës dhe kërkesës së ankueseve, kanë monitoruar seancat gjyqësore lidhur me rastet e paraqitura nga palët.

Bashkëpunim të mirë IAP ka pasur edhe me Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), Policinë e Kosovës, SHKK-në dhe Inspektoratin e tij, Prokurorinë Speciale, lidhur me hetimin e ankesave të personave të privuar nga liria.

IAP ka interesim për të forcuar edhe më tutje bashkëpunimin me institucione, me qëllim të përmirësimit të mirëqeverisjes si dhe parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe zbatimit të ligjit.

3.1.1. Komentet dhe rekomandimet në projektligje dhe akte nënligjore

Në kuadër të përgjegjësisë të Avokatit të Popullit, të përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, është edhe: “*të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e*

³⁸⁶ Këshilli në fjalë është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 25 gusht 2011. Mandati i Këshillit ka të bëjë përveç tjerash edhe me definimin e prioriteteve dhe përcaktimin e masave të nevojshme që duhet të ndërmerren me qëllim të përmirësimit të situatës në lidhje me mbrojtjen dhe drejtësinë për fëmijë. IAP është pjesë e Këshillit në cilësinë e anëtarit vëzhgues.

ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës”.³⁸⁷

Gjatë vitit 2014, IAP ka pranuar një sërë projektligjesh dhe draftesh të udhëzimeve administrative nga Qeveria dhe ministritë dhe IAP ka dhënë komentet ligjore në të gjitha aktet e pranuar. Sipas Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 09/2011, organi propozues ka obligim që për projektligjet dhe aktet nënligjore, pos me ministritë përkatëse, të konsultohet edhe me IAP-në, për përputhshmërinë e tyre me “... *standardet e pranueshme ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut*...”.³⁸⁸ Afati për dërgimin e komenteve është 15 ditë pune.³⁸⁹

Po ashtu IAP ka dhënë komente ligjore edhe në pakon e ligjeve bazike për të drejtat e njeriut (Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit; Projektligji për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Projektligji për barazinë gjinore në shoqëri), Avokati i Popullit ka dhënë komente edhe për disa projektligje tjera dhe drafte të akteve nënligjore, të cilat po i paraqesim në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Projektligji ose Drafti i aktit nënligjor	Sponsorizuesi i Projektligjit / Draftit
1	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit	Ministria e Drejtësisë
2	Projektligji për mbrojtjen nga diskriminimi	Qeveria e Kosovës
3	Projektligji për barazinë gjinore në shoqëri	Qeveria e Kosovës
4	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës	Kuvendi i Republikës së Kosovës
5	Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale	Qeveria e Kosovës
6	Projekt Rregullorë për kushtet e punës dhe kompensimi në rast të paaftësisë së shkaktuar në punë për të burgosurit	Ministria e Drejtësisë
7	Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën e liritimit me kusht	Ministria e Drejtësisë
8	Projekt Udhëzimi Administrativ për funksionimin e shërbimit shëndetësor të burgjeve	Qeveria e Kosovës
9	Projekt Rregullorë për rendin shtëpiak në Shërbimin Korrektues	Ministria e Drejtësisë
10	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë	Qeveria e Kosovës
11	Projektligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative	Ministria e Administratës Publike

Tabela 1: Lista e dokumenteve për të cilat IAP ka dërguar komente dhe rekomandime

³⁸⁷ Ligji nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 1, pika 1.6.

³⁸⁸ Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, neni 7, paragrafi 2.

³⁸⁹ Po aty, neni 7, paragrafi 3.

Gjithashtu, Avokati i Popullit i ka dërguar Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, **Rekomandimin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 30.**

Avokati i Popullit e vlerëson pozitivisht praktikën e dërgimit të projektligjeve si dhe të drafteve të udhëzimeve administrative dhe të akteve tjera nënligjore nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës për konsultim me IAP.

Megjithëse kjo paraqet ngarkesë të konsiderueshme profesionale dhe kohore për IAP-në, Avokati i Popullit ri-konfirmon gatishmërinë për të ofruar ndihmën dhe përkrahjen profesionale të IAP-së në këtë drejtim dhe u rekomandon të gjitha institucioneve të vendit që t'i dërgojnë në IAP aktet normative për konsultim dhe komentim, sidomos ato që kanë të bëjnë në çfarëdo mënyre me të drejtat e njeriut.

3.1.2. Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Bashkëpunimi me shoqërinë civile është pjesë e mandatit të IAP-së me qëllim të avancimit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Duke u nisur nga kjo edhe gjatë vitit 2014, IAP ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me OJQ-të.

Në periudhën raportuese, IAP në bashkëpunim me KMDLNJ-në dhe QKRMT-në, si një *Grup Punues* për krijimin e MKPT-së, ka monitoruar QK në Dubravë dhe QK e QP në Lipjan. Në lidhje me këtë monitorim, në shtator 2014 është mbajtur tryeza e rumbullakët me temën “Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës - sfidat, mundësitë dhe hapat e bërë përpara”, në fokus të së cilës ishin raportet e publikuara të grupit punues për MKPT-në, nga monitorimi i këtyre qendrave, si dhe aktivitetet e zbatuara në periudhën janar-dhjetor 2014.

Përfaqësuesit e IAP me pjesëmarrjen e tyre kanë dhënë kontribut edhe në realizimin e projekteve të përbashkëta të OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare. Përfaqësuesit e IAP, në bashkëpunim me UNICEF-in, kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nëpër shkolla të komunave të ndryshme, lidhur me realizimin e platformës “Know Your Rights” (Njihni të Drejtat Tuaja), e cila kishte për qëllim që të rinjtë e moshës 16-29-vjeçare të mësojnë më shumë lidhur me të drejtat e tyre, t'i qasen informatave lidhur me sistemin e ankesave, të kërkojnë ndihmë ligjore dhe të raportojnë shkeljet e të drejtave të tyre *online*, të cilat do t'i shkojnë IAP-së.

Gjatë muajit tetor përfaqësuesit e zyrave rajonale të IAP-së në Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë dhe Prizren morën pjesë në takimet e organizuara nëpër shkolla, në kuadër të projektit të OJQ-së “Innovations Lab Kosovo”, në bashkëpunim me UNICEF-in në realizimin e platformës “Know Your Rights”. Në këto takime nxënësve iu është shpërndarë fletëpalosja e IAP-së ***për të drejtat e fëmijëve.***

Përfaqësuesit e IAP, morën pjesë aktive në takimet e organizuara me nxënësit e shkollave - “Tefik Çanga” dhe “Jeronim de Rada” në Ferizaj, pastaj shkollave “Andon Zako Çajupi” e “Bedri Gjinaj” në Mitrovicë, në kuadër të programit “Together 4 children rights - Child Protection” (Së bashku për të drejtat e fëmijëve – Mbrojtja e fëmijëve), të implementuar nga

OJQ “Syri i Vizionit” nga Peja, i mbështetur nga OJQ “Save the Children”, lidhur me rritjen e sigurisë së fëmijëve në shkolla.

Bashkëpunim IAP ka pasur edhe me OJQ-të tjera, si: “Smile”, me të cilën janë realizuar dokumentar në fusha të ndryshme të të drejtave të njeriut. Është realizuar gjithashtu bashkëpunimi i zyrës rajonale të IAP-së në Graçanicë me OJQ “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve” dhe me OJQ “Komunikimi për Zhvillim Social dhe të Drejtat Civile”.

Pas themelimit të rrjetit të OJQ-ve të komunitetit serb të Anamoravës (me përkrahjen e ECMI), me qëllim të krijimit të bashkëpunimit me Sekretariatit e rrjetit, më 19 maj 2014, me z. Aleksandar Stojkoviç, Sekretar i Përgjithshëm i rrjetit të komunitetit serb të Anamoravës në Partesh, në rajonin e Gjilanit, është organizuar një takim në të cilin është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit të IAP-së, me OJQ-të lokale të Anamoravës, për ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Më 26 maj 2014, në Dragash po ashtu është organizuar një takim me përfaqësuesit e rrjetit të OJQ-ve të komunitetit goran – z. Veis Sherifi, Sekretar i Përgjithshëm i rrjetit dhe z. Fergap Zaimi, anëtar i Sekretariatit dhe anëtar i Këshillit Konsultativ të Komuniteteve pranë Presidencës.

Përfaqësuesit e rrjetit të OJQ-ve të komunitetit goran, e vlerësuan lartë gatishmërinë dhe interesimin e IAP-së për zhvillimin e bashkëpunimit dhe e konsideruan si një mundësi të mirë për vetëdijesimin e qytetarëve për të drejtat e njeriut dhe për misionin e IAP-së.

IAP ka ndërtuar një bashkëpunim të mirë edhe me komunitetin LGBT. Lidhur me këtë IAP bashkëpunon me OJQ që i mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBT, siç janë OJQ “Qesh”, OJQ “ISDY”- Institute for Sustainability and Development of Youth (Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Rinisë).

Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e komunitetit LGBT, më 26 qershor 2014, ka mbajtur takimin e radhës në të cilin të pranishëm ishin Institucionet vendore, OJQ të cilët i mbrojnë interesat e komunitetit LGBT në Kosovë, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë.

3.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Një ndër fushat me rëndësi të veçantë në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të IAP-së, është bashkëpunimi ndërkombëtar. Prandaj, IAP edhe gjatë këtij viti vëmendje të veçantë i ka kushtuar këtij bashkëpunimi, si në rrafshin botëror, po ashtu edhe në rrafshin evropian e regional. Në këtë kuadër duhet theksuar edhe bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare të vendeve të tjera që veprojnë në Kosovë.

3.2.1. Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare

Më qëllim të shkëmbimit të informacionit dhe praktikave më të mira në fushën e të drejtave të njeriut në botë, IAP ka marrë pjesë në shumë takime ndërkombëtare, shumëpalëshe dhe dypalëshe, të cilat njëkohësisht kanë shërbyer edhe për forcimin e bashkëpunimit.

Më 12-14 mars 2014, IAP mori pjesë në Takimin e 27-të të Komitetit Koordinues Ndërkombëtar të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ICC- eng. International Coordinating Committee for National Human Rights Institutions),³⁹⁰ të mbajtur në Gjenevë. Temat e trajtuara në këtë takim ishin: çështje të ndryshme të mbarëvajtjes së punëve të kësaj organizate, zbatimi i planit strategjik të ICC; aktivitetet e ndërmarra gjatë vitit; aspektet financiare dhe pagesat e anëtarësive të institucioneve anëtare; çështja e kërkesave për akreditim dhe raporti i takimit të Nën-komitetit për Akreditim dhe trajtimi i kërkesave për akreditim nga institucionet e shteteve joanëtare të Kombëve të Bashkura, sipas nenit 38 të Statutit të ICC-së,³⁹¹ duke përfshirë edhe kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.³⁹² Byroja e ICC, duke miratuar raportin e nënkomitetit për akreditim, kishte refuzuar kërkesën e IAP për njohjen e statusit A dhe të qenit anëtar i barabartë i ICC për shkaqe formale dhe politike, ngase Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe nuk është e njohur nga OKB, por jo edhe për shkaqe profesionale dhe kualitative apo ligjore.

Pas prezantimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të këtij nën-komiteti, në sesionin e diskutimeve z. Kurteshi, Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës, kundër-argumentoi rekomandimet e Nën-Komitetit për Akreditim dhe mbrojti kërkesën e IAP-së për akreditim në ICC, fjalim i cili më pas iu dërgua me postë elektronike të gjithë personave përgjegjës në këtë proces. Aty u kërkuar shprehimisht që ICC të ketë prioritet të drejtat e njeriut, para barrierave politike, meqë ky është edhe misioni primar i kësaj organizate. Po ashtu Avokati i Popullit bëri edhe propozime konkrete për ICC se si të tejkalohet kjo situatë në lidhje me anëtarësimin e IAP në ICC.

Përveç kësaj në ditën e dytë të takimit ai pati disa takime me personat kyçë në Nën-komitetin për akreditim, me qëllim të diskutimit lidhur me çështjen e akreditimit të IAP-së në ICC, z. David Langtry, nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Kanadasë dhe me z. Michel Frost, nga Komisioni Francez për të Drejtat e Njeriut, i cili përfaqëson grupin evropian në Nën-komitetin për Akreditim. Me të dy u bisedua për vendimin e Nën-komitetit për Akreditim të IAP-së në ICC dhe mospajtimin e IAP me këtë vendim, duke shprehur kundër-argumentet e IAP-së.

Në ditët e tjera të këtij takimi pati edhe disa panele të rëndësishme ku u trajtuan tematikat në vijim: Rishikimi periodik universal, Bashkëpunimi në mes të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ) me parlamentet, Të Drejtat e Grave dhe Planet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, nga të cilat rrodhën diskutime shumë përmbytjesore dhe praktika të mira që mund të ndiqen nga shumë institucione për të drejtat e njeriut.

³⁹⁰ Komiteti Koordinues Ndërkombëtar i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ICC) është organizatë ndërkombëtare e institucioneve që merren më të drejtat e njeriut. Ajo promovon dhe fuqizon këto institucione, në mënyrë që të jenë në pajtueshmëri me Parimet e Parisit dhe vepron si lider i promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në: <http://nhri.ohchr.org/EN/Pages/default.aspx> (17.12.2014).

³⁹¹ Statuti i Komitetit Ndërkombëtar të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ICC), përkatësisht neni 38 i tij, thotë se: “*Kryetari i ICC-së, pas konsultimeve me anëtarët e tjerë, mund të ftojë ndonjë institucion tjetër që të marrë pjesë në punën e ICC-së si vëzhgues*”, në: <http://nhri.ohchr.org/EN/AboutUs/Governance/Statute/ICC%20Statute%20as%20amended%20at%20ICC%2025.pdf> (17.12.2014).

³⁹² Raporti i Nën-komitetit për Akreditim i ICC-së, mbajtur në Gana, nëntor 2013, aneksi 2, në: http://nhri.ohchr.org/EN/ICC/BureauMeeting/112013/_layouts/WordViewer.aspx?id=/EN/ICC/BureauMeeting/112013/Adoption%20of%20the%20draft%20agenda%20for%20the%20ICC%20Bureau%20me/SCA%20Chairperson%20report%20to%20ICC%20Bureau%20%20Ghana%20Nov%202013.docx&Source=http%3A%2F%2Fnhri.ohchr.org%2FEN%2FICC%2FBureauMeeting%2F112013%2FPages%2Fdefault.aspx&DefaultItemOpen=1&DefaultItemOpen=1 (17.12.2014).

Më 17-19 shtator 2014, IAP u përfaqësua edhe në Asamblenë e Përgjithshme Vjetore të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI),³⁹³ i cili u mbajt në Talin të Estonisë, me temën “Roli i Ombudsmanit në Demokraci”. Në pjesën e dytë të konferencës punimet u fokusuan në katër grupe punuese, me këto tema specifike:

- *A duhet Ombudsmani të promovoj reforma legjislative?*
- *Ndikimi i normave ndërkombëtare dhe evropiane, udhëzimeve dhe standardeve në punën e Ombudsmanit,*
- *A është Ombudsmani konkurrues me degën gjyqësorë, të pushtetit shtetëror?*
- *Roli i Ombudsmanit në kontrollin e agjencive shtetërore të inteligjencës.*

Në grupin e parë punues u theksua se ombudsmanët duhet të jenë sytë dhe veshët e parlamentit dhe kontrollimit demokratik të administratës së shtetit. Raporti vjetor është mënyra më e mirë për të paraqitur gjetjet për të drejtat e njeriut në parlament. Mirëpo, në mënyrë që të funksionojë mirë ky proces, bashkëpunimi në mes ombudsmanit dhe parlamentit është i rëndësishë thelbësore.

Në grupin e dytë punues u ofruan përvojat e disa institucioneve në implementimin e normave dhe standardeve të ndryshme për të drejtat e njeriut. U theksua tendenca dhe nevoja e ndryshimit të konceptit të institucioneve të ombudsmanëve klasikë edhe në drejtim të IKDNJ-ve dhe ky ishte konstatim i pothuajse të gjithë pjesëmarrësve.

Në grupin e tretë punues u theksua se gjykatat dhe Ombudsmanët kanë detyra dhe kompetenca të ndryshme ligjore. Ombudsmani nuk siguron mbrojtje gjyqësore, pasi që nuk ka mekanizma ligjore për zbatimin e vendimeve të tij, këtë fuqi e ka vetëm gjyqësori. Megjithatë gjykata në njërin anë dhe Ombudsmani në anën tjetër mund të bashkëpunojnë në shumë çështje sa i përket mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në grupin e katërt punues u sollën përvojat e veçanta të disa shteteve dhe roli i ombudsmanit në Kontrollin e Agjencisë së Inteligjencës. Një praktikë të mirë në këtë drejtim e ndau me të gjithë pjesëmarrësit Ombudsmani i Finlandës, ku kjo çështje është e rregulluar në mënyrë ligjore.

Një delegacion i IAP mori pjesë edhe në *Forumit Botëror për të Drejtat e Njeriut*, i cili u mbajt prej 27-30 nëntor 2014, në Marakesh të Marokut. Në forum morën pjesë më shumë se 6000 pjesëmarrës nga rreth 100 vende të botës. Forumi kishte për qëllim të ofronte një platformë universale për dialog në mes qeverive, institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe organizatave të shoqërisë civile për respekt, dinjitet, barazi dhe drejtësi.

Gjatë forumit janë zhvilluar një numër i madh i punëtorive, konferencave, trajnimeve dhe ngjarjeve të tjera të veçanta me tema të ndryshme për të drejtat e njeriut: si barazia gjinore, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, qasja në drejtësi, ndërveprimi i institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut me mekanizma të Kombeve të Bashkuara, procesi legjislativ dhe të drejtat e njeriut etj.

Për të avancuar edhe më tutje bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rrjetëzimin e institucionit me homologë të tjerë, IAP këtë vit ka aplikuar për t'u anëtarësuar edhe në dy asociacione të tjera shumë të rëndësishme. *Së pari*, në Asociacionin e Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM) dhe, *së dyti*, në Asociacionin e Ombudsmanëve të Frankofonisë.

³⁹³ IAP është anëtar institucional në Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI). Për më tepër shih: www.theioi.org

IAP mori pjesë edhe në takimin e tetë të AOM-së , i cili u mbajt në Tiranë, më 26-27 qershor 2014, me temën “Forcimi i demokracisë - cilët janë partnerët e Ombudsmanit”.

3.2.2. Bashkëpunimi evropian

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, një bashkëpunim shumë të mirë IAP ka me Rrjetin Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI), me seli në Bruksel, në të cilin është anëtar që prej nëntorit të vitit 2013. ENNHRI është organizatë që ka mision mbështetjen dhe fuqizimin e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut, në pajtueshmëri me Parimet e Parisit.³⁹⁴

Në kuadër të aktiviteteve të këtij rrjeti, në qershor të vitit 2014, për herë të parë u mbajt Akademia e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut,³⁹⁵ ku morën pjesë përfaqësues nga 34 institucione për të drejtat e njeriut nga e tërë Evropa, ndër të cilët edhe një përfaqësuese nga IAP. Kjo Akademi u fokusua në trajnime praktike se si të adresohen sfida specifike me të cilat ballafaqohen institucionet për të drejtat e njeriut si dhe në punën e zbatimit të mandatit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në mënyrë efektive. Ajo ishte gjithashtu një mundësi e mirë për shkëmbimin e praktikave të mira ndërmjet pjesëmarrësve dhe platformë e mirë diskutimi se si këto institucione mund ta ndihmojnë njëra-tjetrën në punën e tyre me interes të përbashkët.

Qëllim kryesor i kësaj akademie ishte forcimi i kapaciteteve të pjesëmarrësve në 4 fusha kryesore: 1) Sjellja e institucioneve një hap më afër pajtueshmërisë me Parimet e Parisit, sa i përket pavarësisë së punës së këtyre institucioneve; 2) Integrimi i perspektivës gjinore; 3) Monitorimi i të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat ekonomike dhe sociale dhe 4) Ndërveprimi në mënyrë më efektive me mekanizma të Kombeve të Bashkuara, me qëllim të fuqizimit të zbatimit të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në nivel vendor.

IAP po ashtu është anëtar institucional edhe në Institutin Evropian të Ombudsmanëve (EOI),³⁹⁶ prej të cilit pranon informatorë të ndryshëm në lidhje me aktivitetet që zhvillohen në mekanizma të ndryshëm evropianë, por gjithashtu edhe zhvillon aktivitete, takime e konferenca, ku marrin pjesë të gjithë anëtarët.

IAP, edhe pse me status të vëzhguesit në Rrjetin Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijë (ENOC), për shkak se për anëtarësim kusht është anëtarësimi i vendit në Këshillin të Evropës, ai ka bashkëpunim shumë të mirë dhe merr pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara nga ky rrjet. Këtë vit, prej 22 - 24 tetor u mbajt konferenca e tetëmbëdhjetë e këtij rrjeti në Edinburg të Skocisë, me temën “Ndikimi i varfërisë dhe masave kufizuese shtetërore në realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve”. Konferenca trajtoi temat si: fëmijët e cenueshëm, promovimi i të drejtave të fëmijëve, pjesëmarrja e fëmijëve, mirëqenia, shëndetësia, familja dhe përkujdesja alternative, si dhe dhuna.

³⁹⁴ Parimet e Parisit për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, shih në: <http://www2.ohchr.org/english/law/parisprinciples.htm> (17.12.2014).

³⁹⁵ Rreth Akademisë së Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut shihni në: <http://www.spp.ceu.hu/sites/spp.ceu.hu/files/attachment/article/718/nhriacademy-program-june2014-onlineversion.pdf> (17.12.2014).

³⁹⁶ Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI), në: www.eoi.at

3.2.3. Bashkëpunimi rajonal

Bashkëpunimi në nivel rajonal është konsideruar i domosdoshëm dhe shumë i dobishëm në punën e të gjitha institucioneve të ombudsmanëve, sidomos sa i përket shkëmbimit të praktikave më të mira përmes zhvillimit të një bashkëpunimi të ndërsjellë.

Prandaj, më 18 maj 2010, në një takim të përbashkët, vendet e rajonit bënë një hap më tutje për formalizimin e bashkëpunimit dhe aktiviteteve të Institucioneve të Ombudsmanëve, ku u nënshkrua *Deklarata e Sarajevës për bashkëpunim*, nga disa vende pjesëmarrëse të rajonit siç janë: Maqedonia, Bosnjë e Hercegovina, Kroacia, Sllovenia, Serbia dhe Vojvodina. Në dritën e kësaj nisme, më 10 dhe 11 shkurt 2014, një tjetër takim u organizua në Slloveni, ku morën pjesë edhe përfaqësues nga IAP, i cili kishte për qëllim hapjen e diskutimit në lidhje me definimin e prioriteteve dhe modeleve të bashkëpunimit, sfidat e mundshme dhe çështje të tjera që do të mund të konsideroheshin të rëndësishme. Pas këtij takimi, më 4 prill 2014, edhe Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, nënshkruajti Deklaratën e Sarajevës për Bashkëpunim. Pritet që në të ardhmen të ketë aktivitete të përbashkëta rajonale të shpeshtuara në këtë drejtim.

IAP merr pjesë edhe në të gjitha aktivitetet e Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës Juglindore (CRONSEE), në të cilin është anëtar prej vitit 2009. Ky rrjet ndërmerr aktivitete të përbashkëta për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Një takim i organizuar nga ky rrjet u mbajt më 5 dhjetor 2014 në Beograd me temë "Reputacioni *On line* - Mbrojtja e integritetit të fëmijëve në internet". Nga ky takim në fund doli një deklaratë e përbashkët e të gjithë pjesëmarrësve, e cila theksoi shqetësimin e thellë për dhunën dhe abuzimin në rritje të fëmijëve në hapësirën e internetit.

Ndërkohë, një rol të dobishëm në ngritjen e bashkëpunimit në mes të institucioneve për të drejtat e njeriut në rajon ka luajtur edhe TAIEX, i cili organizoi disa konferenca gjatë vitit për të cilin po raportohet. Njëra u mbajt në Shqipëri, më 25-26 shtator me temë "Roli i institucioneve të Ombudsmanëve në procesin e integritetit evropian", kurse e dyta u mbajt në Maqedoni, më 20-21 tetor, me temën "Mbikëqyrja e institucioneve psikiatrike me qëllim të mbrojtjes nga tortura dhe keqtrajtimi".

3.2.4. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë

Ekziston një numër i madh i organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës, me të cilat IAP ka një bashkëpunim të shkëlqyeshëm. Disa nga to edhe e kanë mbështetur IAP-në me projekte të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve, promovim dhe në forma të tjera.

Këtë vit, OSBE e ka mbështetur IAP-në me organizimin e një trajnimi lidhur me hetimin e rasteve kundër diskriminimit për të gjithë stafin, si dhe promovimin e mandatit të IAP-së kundër diskriminimit përmes një TV reklame, e cila u transmetua në televizionin publik dy herë nga dy javë në hapësira të ndryshme kohore.

Edhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) mbështeti IAP-në me një fushatë tjetër në televizionin publik, e cila në mënyrë të detajuar sqaroi për publikun rolin dhe mandatin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Këshilli i Evropës vazhdon të jetë një partner me rëndësi të jashtëzakonshme për IAP. Gjatë këtij viti, në bashkëpunim me Këshillin, IAP realizoi disa veprime të përbashkëta. Këtë vit

përfaqësues të IAP ishin pjesë e Këshillit Drejtues të Programit të Përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Evropës me temë "Mbështetja e qasjes në arsimim dhe mirëkuptimin ndërkulturor". Pritet që në vitin e ardhshëm të bashkëpunojmë edhe në një projekt shumë të dobishëm, që do të realizohet si mbështetje për institucionet gjyqësore dhe gjysmë-gjyqësore.

Këtë vit është realizuar edhe një fushatë shumë e suksesshme me temën "Njih të drejtat tua", ku partnerë të përbashkët ishin IAP, UNICEF, Laboratori i Inovacionit dhe Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë. Fushata u fokusua në ngritjen e vetëdijes së fëmijëve për të drejtat e tyre, prandaj në kuadër të aktiviteteve pati shumë vizita të drejtpërdrejta në shkolla, tryeza, dhe aktivitete të tjera promovuese.³⁹⁷

Një bashkëpunim tjetër shumë të frytshëm, IAP pati edhe gjatë këtij viti me Ambasadën e Francës në Kosovë. Ata mbështetën IAP-në përmes organizimit të një kursi të gjuhës frënge dhe një trajnimi tjetër lidhur me promovimin e rasteve kundër diskriminimit.

IAP është shumë falënderues edhe ndaj Ambasadës së Belgjikës, Norvegjisë dhe Turqisë, të cilat e kanë mbështetur atë me donacione, përmes të cilave u realizuan disa aktivitete të rëndësishme përgjatë disa viteve të kaluara.

3.2.5. Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë

IAP çdo vit pranon pyetësorë të tematikave të ndryshme nga organizata ndërkombëtare, për të raportuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe këtë vit janë dërguar disa pyetësorë të cilët janë të listuar në tabelën e mëposhtme.

Data	Tema e raportit	Organizata/institucionit të cilit i është dërguar raporti
30 qershor 2014	Pyetësor lidhur me praktikat e mira që lidhen me të drejtat e njeriut dhe ambientin	Eksperti i Pavarur i Seksionit për të Drejtat e Njeriut dhe të Ambientit, Sektori për Zhvillim të Qëndrueshëm Njerëzor-Divizioni për Procedura Speciale në OKB
28 gusht 2014	Puna dhe të gjeturat e grupit punues të Mekanizmit për Parandalim të Torturës në Kosovë	Departamenti i Shtetit të SHBA/Ambasada Amerikane për Raportin për të drejtat e njeriut në botë
8 shtator 2014	Pyetësori Ndërkombëtar për Komisionarët e Informimit	Qendra për Liri të Informimit
9 dhjetor 2014	Hetimi i ankesave sipas detyrës zyrtare	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve
9 dhjetor 2014	Alokimi i resurseve të mjaftueshme për funksionimin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut	Rrjeti Evropian për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut

Tabela 2: Lista e raporteve të dërguara në organizata të ndryshme ndërkombëtare

³⁹⁷ Për më tepër shih pjesën *Aktivitetet e Njësisë për të Drejtat e Fëmijëve*, në po këtë raport.

3.3. Komunikimi me media

Mosfunksionimi dhe jo stabiliteti i përgjithshëm institucional në vend, e kanë diktuar debatin publik dhe vëmendjen shoqërore në përgjithësi në Kosovë, gjatë vitit 2014. Gjatë këtij viti paraqitjet në media nga IAP për çështjet e ngritura janë përmbledhur kryesisht në deklarata dhe raporte të publikuara dhe të shpërndara mediave bashkë me materialet përcjellëse. Fakti se materialet e shpërndara kanë trajtuar tema shumëdimensionale, përfshirë përgjegjësitë, kompetencat dhe funksionimin e institucioneve të ndryshme, kanë mundësuar që ato të trajtohen nga mediat nga këndvështrime të ndryshme dhe jo vetëm në momentin e plasimit.

Gjithashtu, përmes komunikimit me publikun dhe institucionet, përmes mediave, IAP ka vënë në plan të parë: mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si bërthama e misionit të IAP-së; fuqizimin në publik të rolit dhe imazhit të IAP-së, si mbrojtës dhe avokues të të drejtave të njeriut; ofrimin e informacionit të nevojshëm për kompetencat, përgjegjësitë dhe punën e IAP-së, si dhe hapjen mediale të çështjeve që janë konsideruar të rëndësishme për debat publik.

Gjatë 2014-tës, në ueb faqen e IAP-së dhe për media janë plasuar 30 komunikata, njoftime, raporte etj. (shih tabelën e mëposhtme). Gjithashtu, gjatë këtij viti IAP ka publikuar Raportin vjetor, 2 buletinë: njëri si përmbledhje ekzekutive e punës, statistikave dhe strukturës funksionale të institucionit nga Raporti vjetor 2013 dhe tjetri me përmbledhjen e rekomandimeve të përgjithshme të IAP-së gjatë vitit 2013. Gjithashtu, IAP ka publikuar edhe një buletin në alfabetin e Brajlit, si përmbledhje të përgjithshme informative për punën dhe misionin e IAP-së.

Po ashtu, në bashkëpunim me OSBE-në, është zhvilluar një fushatë kundër diskriminimit, brenda së cilës janë zhvilluar një varg aktivitete. Ndërsa në kuadër të bashkëpunimit me UNDP është realizuar një dokumentar, si pjesë e një fushate sensibilizuese për të drejtat e njeriut dhe për punën dhe misionin e IAP-së.

Gjatë vitit 2014 janë realizuar 90 paraqitje publike përmes masmediave dhe shtypit të shkruar (intervista, prononcime, emisione të hapura për pyetje të qytetarëve, debate etj. Ky numër i paraqitjeve mediale nuk përfshin shpërndarjen apo riprodhimin e të njëjtave nga portalet elektronike apo mediat tjera elektronike a të shkruara, që kanë huazuar materialet. Po ashtu, këtu nuk janë të përfshira temat e iniciuara nga vetë mediat, qoftë të bazuara në deklaratat, reagimet apo informatat nga IAP, qoftë të iniciuara nga vetë mediat, për të cilat s'është kërkuar opinioni apo qëndrimi i IAP-së.

Të hapura për mediat kanë qenë edhe tri tryeza të rrumbullakëta: lidhur me të drejtat e konsumatorit, lidhur me domosdoshmërinë e një procesi të rregullt zgjedhor, si dhe tryeza lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

ALSAT	1
BIRN / Jeta në Kosovë	7
Epoka e Re	1
Bota sot	1
Drejtësia në Kosovë	1
Radio Evropa e Lirë	5
Gazeta Lajm	1
Infodirekt	1
inLajm	1
KLAN Kosova	6
Koha Ditore	3
Kosova Sot	4
Kosova Press	4
KTV	8
Lajm.info	1
Lajmi.net	1
Ora News (Balkan Magazine)	1
Radio Dukagjini	3
Radio Kosova (programi shqip)	8
Radio Kosova (programi serbisht)	1
Radio Romano Avazo Prizren	1
RTK 1	12
RTK 2	6
RTV 21	3
Media Nazionale Suedeze	1
TV BESA (Prizren)	1
TV Rrokum	3
ZËRI	3

Tabela 3: Paraqitjet mediale të IAP-së, sipas medimeve gjatë vitit 2014

3.4. Aktivitetet e Njësisë për të Drejtat e Fëmijëve

Grupi për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) në kuadër të IAP-së është themeluar me qëllim që me kujdes të veçantë t'i mbikëqyrë, mbrojë dhe hetojë shkeljet e të drejtave të fëmijëve nga autoritetet publike në Kosovë.

GDF gjatë vitit 2014 përveç se ka shqyrtuar ankesat e paraqitura në IAP, ka ndërmarrë edhe aktivitete të tjera në drejtim të promovimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe të ngritjes së kapaciteteve profesionale.

Më 11 mars 2014, GDF mori pjesë në takim të radhës të Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë (KMDF),³⁹⁸ në të cilin u diskutuan çështjet që kishin të bënin me veprimet e ndërmarrura në drejtim të jetësimit të Protokollit për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar. Këtu u diskutua edhe për dokumentin e hartuar për treguesit e drejtësisë për fëmijë si dhe për nevojën e vlerësimit të punës së KMDF, me qëllim të identifikimit të nevojave dhe ofrimit të mbështetjes përkatëse për monitorim dhe raportim lidhur me reformat e sistemit të Drejtësisë për Fëmijë.

Më 5 maj 2014 GDF, mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga ZKM / ZQM, në bashkëpunim me UNICEF dhe BE në Kosovë, në kuadër të projektit “Reformat e drejtësisë për fëmijë”. Në këtë tryezë u prezantuan “Treguesit e Drejtësisë për Fëmijë” të cilët ishin zhvilluar dhe hartuar me qëllim që institucionet qeveritare të ndihmohen në marrjen e vendimeve për sistemin e drejtësisë për fëmijë në bazë të informatave më të mira, duke paraqitur dëshmitë më të mira në qendër të procesit të politik-bërjes dhe ofrimit të informatave lidhur me përmbushjen dhe respektimin e standardeve përkatëse.

Më 21 maj 2014, në Prishtinë u mbajt konferenca për prezantimin e raportit “Hulumtim me pjesëmarrje aktive”, pjesë e projektit “Liderët e rinj romë në veprim - LYRA”,³⁹⁹ e organizuar nga Save the Children, në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të IAP-së. Në këtë konferencë nga përfaqësues të liderëve të rinj romë, të cilët kishin qenë pjesë të hulumtimit për komunën e Prizrenit dhe Gjakovës, u prezantuan edhe të gjeturat e hulumtimit në fjalë, i cili i referohej braktisjes së shkollës, martesave të hershme, diskriminimit të fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas nga mësimdhënësit, si dhe të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin shkollor në këto komuna. Përveç rekomandimeve të veçanta për secilën prej temave të lartpërmendura liderët e rinj theksuan edhe çështjet që sipas rezultateve të hulumtimit duhen vendosur në rend të ditës, të institucioneve qeverisëse.

Më rastin e shënimit të Ditës së Fëmijëve, më 1 qershor 2014, përfaqësues të IAP-së në Prishtinë, Graçanicë, Mitrovicë, Prizren, Gjiilan dhe Gjakovë nën tendat e vendosura në sheshet e këtyre vendeve kanë biseduar me fëmijë për të drejtat e fëmijëve dhe rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, gjegjësisht të fëmijëve.

Po në të njëjtën ditë, në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta me Save the Children, në kuadër të projektit “Prishtina lexon”, në sheshin kryesor të Prishtinës, përfaqësuesja e IAP-së ka diskutuar dhe u ka lexuar fëmijëve nene të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, ndërsa Avokati i Popullit, ka pranuar nga disa fëmijë shkresat e fëmijëve, të cilat ishin grumbulluar gjatë ditës

³⁹⁸ KMDF është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 25 gusht 2011. Mandati i KMDF ka të bëjë përveç tjerash edhe me definimin e prioritetëve dhe përcaktimin e masave të nevojshme që duhet të ndërmerren me qëllim të përmirësimit të situatës në lidhje me mbrojtjen dhe drejtësinë për fëmijë. Ai përbëhet nga përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. IAP është pjesë e KMDF në cilësinë e anëtarit vëzhgues.

³⁹⁹ Projekti LYRA (Leaders - young Roma in Action) është projekt rajonal i financuar nga Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe zbatohet në tri shtete: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Projekti përfshin 60 liderë të rinj romë dhe jo romë. Qëllimi i projektit ka të bëjë me fuqizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe kompetencave të liderëve të rinj (18- 26 vjeç) romë dhe jo romë dhe aktivistëve në Ballkanin Perëndimor, për të ndërmarrë hapa efektiv në nivel lokal, nacional dhe rajonal për të përmirësuar përfshirjen sociale, mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e romëve.

në kutinë e ankesave. Kutia e ankesave ishte vendosur nga Save the Children, me qëllim që fëmijëve t'u ofrohet mundësia që mendimet, dëshirat apo brengat e tyre t'i shfaqin edhe në formë të shkruar.

Më 2 qershor 2014, përfaqësuesja e IAP-së mori pjesë në programin e mëngjesit në TV 21, në të cilin është diskutuar edhe për punën e GDF në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Në takimin e datës 2 qershor 2014, të organizuar nga OJQ "Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim" u shpalosën të gjeturat e studimit, i cili po realizohej nga kjo organizatë lidhur me dhunën dhe sigurinë e nxënësve në ambientet shkollore. Në këtë takim, nga pjesëmarrësit, përfaqësues të institucioneve arsimore, organizatave joqeveritare, përfshirë këtu edhe IAP, u paraqitën qëndrime dhe rekomandime për adresimin përkatës si dhe parandalimin e dukurisë së dhunës në shkollat e Kosovës.

Më 20 qershor 2014, IAP dhe UNICEF nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit përkitazi me projektin "Njih të Drejtat Tua", i cili do të realizohej nëpërmjet platformës *on line*,⁴⁰⁰ e cila do t'u mundësojë të rinjve (16- 29 vjet) të mësojnë më shumë për të drejtat e tyre, qasje në informata lidhur me funksionimin e sistemit ligjor në Kosovë, si dhe në adresimin dhe kërkimin e ndihmës juridike për paraqitjen e ankesave për shkelje të të drejtave të njeriut.

Më 26 qershor 2014, në Podujevë u mbajt tryeza e rrumbullakët lidhur me "Rolin e gjykatave në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve" në kuadër të Programit për sundim efektiv të ligjit, të organizuar nga USAID, në bashkëpunim me KGJK, në të cilin mori pjesë edhe GDF. Në këtë tryezë nga të pranishmit u diskutua edhe për nevojën e respektimit dhe të mbrojtjes më të mirë të të drejtave të fëmijëve nga gjykatat.

Përfaqësuesja e IAP-së mori pjesë në tryezën e rrumbullakët, për të komentuar "Analizën e situatës së fëmijëve të braktisur 0-3 në Kosovë", të organizuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), e cila u mbajt në Prishtinë më 1 korrik 2014.

Më 14 korrik 2014, GDF i IAP-së mori pjesë në konferencën e përirimit të Raportit të katërt, lidhur me vlerësimin e zbatimit të Strategjisë dhe planit nacional të veprimit për të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës, për vitin 2013, i publikuar nga ZKM e Republikës së Kosovës. Si pjesë e panelit të konferencës përfaqësuesja e IAP-së prezantoi temën "Përpyekjet e Institucionit të Avokatit të Popullit në promovimin dhe garantimin e interesit më të lartë të fëmijëve".

Më 27 gusht 2014, në Prishtinë u mbajt tryeza e diskutimeve, ku mori pjesë edhe GDF, me temën "Sfidat në zbatimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur në Kosovë, shikuar nga praktika gjyqësore dhe të gjeturat e raportit vlerësues të legjislacionit për të drejtat e fëmijëve, krahasuar me Konventën për të Drejtat e Fëmijës", të përgatitur nga UNICEF. Pjesëmarrësit e tryezës diskutuan dhe informuan të pranishmit për veprimet, vështirësitë dhe sfidat e hasura gjatë zbatimit praktik të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Përfaqësuesja e IAP-së, në bashkëpunim me OJQ "Syri i Vizionit" nga Peja, në kuadër të projektit "Child Protection and Child Rights Governance", gjatë muajit shtator 2014 është takuar me nxënës të shkollave fillore të mesme të ulëta "Naim Frashëri" dhe "Ismail Qemali" në Prishtinë. Në këto takime është diskutuar edhe për të drejtat e fëmijëve, procedurat e ankimit në rast të shkeljes së të drejtave të fëmijëve si dhe për rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

⁴⁰⁰ Shih në: <http://www.knowyourrightsks.org>

Në kuadër të projektit “Liderët e rinj romë në veprim - LYRA”, liderët e rinj në takimin e mbajtur më 18 nëntor 2014, të organizuar nga Save the Children, nga përfaqësues të IAP- së janë informuar për misionin e IAP-së, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, procedurat e ankesës si dhe për punën e GDF.

Në kuadër të “Javës kundër dhunës ndaj fëmijëve”, të organizuar nga OJQ Syri i Vizionit dhe Save the Children, më 19 tetor 2014, një grup i fëmijëve nga komuna të ndryshme të Kosovës janë takuar me Avokatën e Popullit. Fëmijët gjatë diskutimeve shprehën shqetësimet e tyre për situatën e sigurisë/pasigurisë në shkollat e tyre dhe rrugës për në shkollë.

“Krizë ekonomike, shërbimet për fëmijë nuk/kanë mbijetuar. Çfarë të bëjmë?” ishte temë diskutimi e CRONSEE,⁴⁰¹ në konferencën e nëntë vjetore, e cila u mbajt nga 18-19 shtator 2014 në Beograd (Serbi). Në këtë konferencë morën pjesë edhe përfaqësues të IAP-së. Përfaqësues të ombudsmanëve, anëtarë të CRONSEE në konferencë theksuan rëndësinë e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve edhe gjatë krizave ekonomike sidomos në fushën e arsimit, mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjes sociale si dhe mbrojtjes nga dhuna.

Më 30 shtator - 1 tetor 2014, përfaqësues të IAP-së morën pjesë në seminarin dhe realizuan vizitën studimore në Varshavë (Poloni), të organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Polonisë dhe Ombudsmeni i këtij shteti. Temë e seminarit ishte “Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve” në kuadër të këmbimit të përvojave me shtetet e Grupit të Vishegradit (Poloni, Çeki, Slloveni dhe Hungari), vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, me theks të posaçëm mbi ndikimin e ombudsmanit për fëmijë në avancimin e të drejtave të fëmijës.

Nga 22 - 24 tetor 2014 në Edinburg të Skocisë u mbajt konferenca e tetëmbëdhjetë e Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës (ENOC)⁴⁰² në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të IAP-së. Tema e konferencës ishte “Ndikimi i varfërisë dhe masave kufizuese shtetërore në realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve” e cila përfshiu punëtori me temat si: fëmijët e cenueshëm, promovimi i të drejtave të fëmijëve, pjesëmarrja e fëmijëve, mirëqenia, shëndetësia, familja dhe përkujdesja alternative si dhe dhuna.

Në fund të punimeve, anëtarët e ENOC dolën me deklaratë, me të cilën shprehën shqetësimin e thellë përkitazi me ndikimin e masave kufizuese shtetërore dhe varfërisë në realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve. Ata deklaruan se krizat financiare dhe ekonomike dhe reagimi i shteteve ndaj tyre kanë rezultuar me rritjen e nivelit të varfërisë së fëmijëve dhe përjashtimit social në një numër të shteteve evropiane. Deklarata do t’u përcillet parlamenteve të shteteve përkatëse me rekomandimet që:

- Të gjitha shtetet evropiane të përgatisin dhe miratojnë plane strategjike gjithëpërfshirëse për të parandaluar varfërinë e fëmijëve dhe përjashtimin social, të cilat do të jenë pjesë e planeve nacionale të veprimit për të drejtat e fëmijës.
- Të gjitha shtetet evropiane duhet të krijojnë buxhete për fëmijë, të cilët kërkojnë identifikimin dhe analizimin e burimeve për fëmijë në buxhetet nacionale.

⁴⁰¹ CRONSEE është themeluar në vitin 2006, me qëllim të bashkëpunimit, promovimit dhe këmbimit të përvojave më të mira në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në vendet e Evropës Juglindore. IAP është anëtarë i këtij rrjeti prej vitit 2009.

⁴⁰² ENOC është themeluar më 1997 nga 42 institucione të pavarura që merren me të drejtat e fëmijëve nga 34 shtete të Evropës. ENOC është themeluar me qëllim të inkurajimit të zbatimit të plotë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, këmbimit të informatave, qasjeve dhe strategjive si dhe për të promovuar zhvillimin e institucioneve të të drejtave të fëmijëve.

- Të gjitha shtetet evropiane të sigurojnë që të gjitha politikat e tyre, ligjet dhe praktikat të jenë në pajtim me instrumentet relevante për mbrojtjen e fëmijëve, në veçanti me Konventën për të Drejtat e Fëmijës.
- Të gjitha shpenzimet publike kombëtare si dhe ata që vendosin për burimet duhet t'i u japin prioritet nevojave, të drejtave, dhe interesave më të mirë të fëmijëve, me theks të veçantë të fëmijëve që përjetojnë apo janë të rrezikuar nga përjashtimi social.

Më 2 nëntor 2014, IAP përkatësisht GDF mori pjesë në konferencën e përirimit të raportit “Korniza Ligjore për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë, Pajtueshmëria me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve”, në të cilën u prezantuan të gjeturat nga analiza e kryer e legjislacionit në fuqi që prek të drejtat e fëmijëve, nga perspektiva e Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe normave relevante regionale dhe ndërkombëtare.

Më 5 nëntor 2014, në takim të organizuar nga Save the Children, në të cilën mori pjesë edhe GDF, nga përfaqësues të institucioneve që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve u diskutua për statusin ligjor të ndëshkimit fizik të fëmijëve në Kosovë, si dhe për nevojën e parandalimit dhe eliminimit të të gjitha formave të ndëshkimit fizik në të gjitha ambientet përfshirë këtu shtëpinë, shkollën, institucionet e kujdesit alternativ, kujdesit ditor dhe në institucione penale.

Në kuadër të aktiviteteve promovuese nga 3-30 nëntor 2014, IAP ka realizuar fushatën informuese për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, lidhur me rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Me këtë aktivitet është shënuar edhe 25 vjetori i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, e cila paraqet një nga dokumentet më gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në botë.

Qëllimi kryesor i organizimit të fushatës ka qenë informimi i nxënësve për rolin e IAP-së, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe për mundësitë e tyre, që përkitazi me shkeljet e të drejtave të njeriut, t'i drejtohen IAP-së.

Qëllim tjetër i fushatës ka qenë edhe ofrimi i mundësive për fëmijët që të dëgjoen nga përfaqësuesit e IAP-së, përkatësisht që të shprehin mendimet, qëndrimet apo shqetësimet e tyre, për probleme të ndryshme me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë, jo vetëm në shkollë, por edhe në rrugë e gjetiu.

Gjatë kësaj fushate janë vizituar shumë shkolla të fshatrave dhe qyteteve të komunave të Kosovës si të Prishtinës, Pejës, Gjilanit, Vitisë, Kamenicës, Junikut, Deçanit, Klinës, Gjakovës, Malishevës, Rahovecit, Vushtrrisë, Skenderajt, Prizrenit, Suharekës, Drenasit, Lipjanit, Obiliqit dhe Graçanicës.

Në bashkëpunim me përfaqësues të Laboratorit të Inovacioneve të Kosovës - UNICEF, në kuadër të projektit “Njih të Drejtat Tua” përfaqësues të IAP-së në muajin tetor dhe nëntor 2014, janë takuar me të rinj të Prishtinës, Mitrovicës, Pejës, Gjakovës, Gjilanit, Prizrenit, Ferizajt dhe Graçanicës. Në këto takime të rinjtë, përveç të tjerash në punë grupore nëpërmes të rasteve studimore janë njoftuar dhe kanë diskutuar për të drejtat e njeriut, identifikimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut si dhe rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Më 17 nëntor 2014, përfaqësuesja e IAP-së mori pjesë në programin e mëngjesit në TV 21, në të cilin është diskutuar lidhur me të drejtën për arsimim, për fëmijët e fshatit Semajë të komunës së Kaçanikut.

Me rastin e shënimit të Ditës Universale të Fëmijëve, më 20 nëntor 2014, fëmijë të shkollave fillore të mesme të ulta të komunës së Prishtinës kanë vizituar Zyrën Qendrore të IAP-së. Gjatë diskutimeve të bëra me Avokatin e Popullit, fëmijët kanë shprehur shqetësimet dhe pikëpamjet e tyre për gjendjen e fëmijëve dhe të drejtat e tyre në familje, shkollë dhe shoqëri.

“Në rend të parë fëmijët: Shpenzime më të mira publike për arritjen e rezultateve më të mira për fëmijë dhe familje”, ishte tema e konferencës së mbajtur nga rrjeti “Eurochild”,⁴⁰³ nga 26-28 nëntor 2014, në Bukuresht (Rumani), në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të GDF. Metodologjitë e përdorura në eksplorimin e asaj se çfarë po ndodhë në Evropë në lidhje me evidenca të bazuara dhe me praktika sa i përket fëmijës dhe familjes, kthimi social i investimeve dhe partneriteti publiko-privat, ishin në fokus të prezantimeve dhe diskutimeve të bëra gjatë zhvillimeve të konferencës.

“Reputacioni *on line* - mbrojtja e integritetit të fëmijës në internet”, ishte temë diskutimi e CRONSEE në takimin tematik, i cili u mbajt më 5 dhjetor 2014 në Beograd, ku ishin edhe përfaqësuesit e IAP. Pjesëmarrësit me këtë rast shprehën shqetësimin e thellë lidhur me shtimin e rasteve të keqpërdorimit dhe keqtrajtimit të fëmijëve në internet. Ata, gjithashtu, theksuan se fëmijët gjatë përdorimit të internetit i ekspozohen llojeve të ndryshme të dhunës, keqtrajtimeve, shfrytëzimit, shkeljes së dinjitetit njerëzor dhe të privatësisë si dhe rrezikimit të rritjes dhe zhvillimit përkatës e ndonjëherë edhe të jetës dhe shëndetit.

Lidhur me këtë ata konkluduan se në kuadër të planeve rajonale, kombëtare dhe lokale duhet miratuar, zbatuar dhe përkrahur edhe masat dhe rekomandimet në vazhdim:

- Autoritetet publike në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve të internetit të definojnë strategjitë dhe planet për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi në internet si dhe të mbrojnë ata nga përmbajtja e dëmshme. Këto dokumente do të duhej të shfaqnin “zero tolerancë” ndaj dhunës elektronike dhe në mënyrë precize të definojnë aktivitetet të cilat në mënyrë efektive dhe me kohë do të parandalojnë/ndalojnë çdo formë të dhunës dhe abuzimit të fëmijës në ambientin virtual, identifikojnë dhe sjellin kryesin para drejtësisë, si dhe sigurojnë masa rehabilituese për viktimën. Strategjitë dhe planet duhet të sigurojnë edhe masa gjithëpërfshirëse për të mbrojtur fëmijët nga përmbajtjet e dëmshme në internet, të cilat negativisht ndikojnë në rritjen, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.
- Autoritetet publike të miratojnë dispozita të veçanta lidhur me çasjen e fëmijëve në internet kafe, vende të lojës dhe ambiente të tjera që ofrojnë shërbime interneti, me qëllim të mbrojtjes së tyre nga rreziqet dhe përdorimi joadekuat i internetit. Në këtë drejtim do të duhej që të viheshin kritere për të garantuar ambiente miqësore për fëmijë, që do të plotësonin kërkesat e përshkruara si mbikqyrja përkatëse, filtra të veçant, kufizime kohore, ndalimi i hyrjes së moshave të reja pas mesnatës.
- Duhet të themelohen mekanizma efektiv që do të jenë në dispozicion të fëmijëve dhe të rriturve për të raportuar dhe për t’u ankuar për shkeljet e bëra në internet. Fëmijët duhet të kenë qasje në shërbime këshilluese për të përkrahur dhe

⁴⁰³ Eurochild është rrjet i organizatave dhe individëve që punojnë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në Evropë. Puna e tyre mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

këshilluar ata se si duhet të veprojnë për rastet e dhunës në internet apo të shkeljeve të të drejtave të tyre.

- Autoritetet publike me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjëve të dizajnojnë dhe zbatojnë fushata publike për të ngritur vetëdijen e publikut në veçanti të fëmijëve dhe të rinjve, prindërve dhe profesionistëve që punojnë me fëmijë, për rreziqet nga dhuna në internet dhe për masat e mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes.
- Autoritetet publike duhet që me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe të rinjëve, profesionistëve dhe ofruesve të shërbimeve të internetit dhe të komunikimit të zhvillojnë programe trajnimi për fëmijët lidhur me sjelljen në hapsirën e internetit, në veçanti në rrjetet sociale, rëndësinë e *on line* reputacionit si dhe mënyrën e ruajtjes dhe mbrojtjes, si dhe të mekanizmave të mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes.
- Autoritetet publike duhet të inkurajojnë dhe të marrin pjesë në zhvillimin e mjeteve të reja për trajtimin dhe ruajtjen e privatësisë së të dhënave personale të fëmijëve dhe filtrimin dhe ndalimin e informatave me përmbajtje të dëmshme.

Këto aktivitete do të duhej të ndërmerreshin me pjesëmarrjen e plotë të fëmijëve dhe të rinjve, duke marrë parasysh parimin e sigurimit të informatave fëmijës si dhe parimin e rrjedhjes së lirë të informatave.

Më 21 nëntor 2014, 26 nëntor 2014, dhe më 9 dhjetor 2014, në kuadër të programit "Së bashku për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve", në Gjakovë, Mitrovicë dhe Prishtinë janë mbajtur tryeza të përbashkëta, të organizuara nga OJQ "Syri i Vizionit" në bashkëpunim me Save the Children, në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve qeveritare, shoqërisë civile, mediave dhe të IAP-së. Qëllimi i mbajtjes së këtyre tryezave ishte analizimi i situatës së të drejtave të fëmijëve në aspektin legjislativ dhe vlerësimi i nevojave për ndryshimin apo hartimin e ligjeve të reja, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe përmirësimin e situatës së të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Më 9 dhjetor 2014, në vazhden e aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të projektit "Njih të Drejtat Tua", përfaqësues të IAP-së morën pjesë në tryezën e rrumbullakët në të cilën, përveç të tjerash u prezantuan dhe u diskutua edhe për 3 punimet fituese të garës së zhvilluar lidhur me të drejtat e fëmijëve. Gara ishte zhvilluar përmes platformës *online* "Njih të Drejtat Tua".

3.5. Aktivitetet kundër diskriminimit

Departamenti kundër Diskriminimit (DKD) edhe gjatë këtij viti raportues ka realizuar vizita të rregullta me OJQ-të, të cilat i përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara, nga të cilët IAP ka pranuar ankesa lidhur me kushtet për qasje të lirë nëpër institucione publike, si dhe legjislacionin për persona me aftësi të kufizuara.

Si në vitet paraprake përfaqësuesit e IAP kanë realizuar vizitat nëpër spitale, OJQ, vendbanime të banuara me komunitetet, nëpër shtëpitë për të moshuar dhe në institucionet për përkujdesje. Gjithashtu, janë zhvilluar takime me komisararin për gjuhët në ZKM, përfaqësues të IAP-së kanë marrë pjesë në debate publike, konferenca dhe trajnime të ndryshme dhe gjithashtu në kuadër të fushatës "Njihuni me të Drejtat Tuaja", janë vizituar

shkolla nëpër Komuna të Kosovës dhe janë mbajtur ligjërata lidhur me IAP dhe mos-diskriminimin.

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar takime me ZQM, koordinatorë për të drejta të njeriut në nivel lokal dhe qendror, si dhe ka marrë pjesë në debatin publik për plotësim ndryshimin e Projektligjit kundër diskriminimit.

Në monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut të personave të vendosur në shtëpitë për të moshuar dhe në institucionet për përkujdesje, gjatë këtij viti është vizituar disa herë shtëpia për të moshuar në Prishtinë, Institucioni Special në Shtëme, Klinika e Psikiatrisë në QKUK. Gjatë vizitave, në fokus kanë qenë monitorimi i kushteve të jetesës së banorëve, hapësirat nëpër rezidenca, kushtet e punës së të punësuarve nëpër këto institucione.

Gjatë vitit raportues përfaqësues të IAP-së kanë marrë pjesë në debate publike në mediat audio-vizuale vendore, ku janë trajtuar tema lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Më 19 shkurt 2014, përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë në tryezën e realizuar nga Shoqata e Juristëve NORMA lidhur me skemën pensionale në Kosovë.

Më 5 shkurt 2014, përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë, si dhe ka dhënë kontribut në tryezën e organizuar nga Grupi i Grave Deputete, në bashkëpunim me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), me temën Ligji i Punës dhe niveli i zbatueshmërisë së ligjit në fjalë.

Nga 10-12 shkurt 2014, në Prishtinë, në bazë të Projektit të përbashkët midis Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë në trajnimin mbi monitorimin e vendeve ku mbahen personat e privuar nga liria.

Më 17 mars 2014, përfaqësuesi i IAP ka qenë pjesëmarrës si dhe ka dhënë kontribut në takimin e Grupit Teknik Punues, të organizuar nga ZKM / ZQM, në lidhje me aprovimin e Prioriteteve për Qeverinë e Kosovës nga Komiteti Drejtues Ndërinstitucional, mbi zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 2009 – 2015.

Më 5 maj dhe 26 qershor 2014, përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë si dhe ka dhënë kontribut në takimin e Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues në nivel Nacional në Republikën e Kosovës për të drejtat e komunitetit LGBT.

Më 14 maj 2014, përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë, si dhe ka dhënë kontribut në diskutimin publik për projekt-udhëzimin administrativ nr. 13/2013 për subvencionimin e linjave ekonomike të paqëndrueshme të organizuar nga Ministria e Infrastrukturës.

Më 30 maj 2014, përfaqësuesi i IAP ka dhënë kontribut në tryezën e organizuar me temën “Monitorimi i të kthyerve - Vlerësimi të kthimit vullnetar” të organizuar nga Agjencia e Kosovës për Zhvillim dhe Avokim në Graçanicë.

Më 25 korrik 2014, përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë si dhe ka dhënë kontribut në tryezën e rumbullakët mbi zgjidhjen e kërkesave për regjistrimin e tokës bujqësore që u është kthyer pronarëve në periudhën 1992-1998, dhe që tani i përkasin komunës së Graçanicës. Kjo tryezë ishte organizuar nga OSBE dhe Komuna e Graçanicës, Departamenti i Planifikimit Urbanizmit, Topografisë dhe Planifikimit Hapësinor.

Më 8 gusht 2014, përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë si dhe ka dhënë kontribut në tryezën me titull “Njohja e sistemit gjyqësor në Kosovë nga ana e komuniteteve pakicë”, të organizuar nga Qendra për Zhvillim Social në Graçanicë.

Më 18 dhe 19 shtator 2014, përfaqësuesi i IAP ka marrë pjesë si dhe ka dhënë kontribut në Konferencën vjetore të takimeve të rrjetit të Ombudsmanëve për fëmijë me temën “Krizë ekonomike, shërbimet për fëmijët - kanë (apo nuk kanë) mbijetesë. Çfarë bëjmë ne?”, të mbajtur në Beograd (Serbi).

Më 13 nëntor 2014, përfaqësues të IAP-së janë takuar me drejtorin e “Hendikosit” për t’u informuar për situatën e PAK në Kosovë.

Më 17 dhe 26 nëntor 2014, përfaqësues të IAP-së kanë vizituar qendrën burimore “Përparimi” në Prishtinë, ku kanë biseduar me nxënës, si dhe personelin e shkollës lidhur me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti.

Gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të 2014, janë vizituar një numër i konsiderueshëm i shkollave fillore dhe të mesme në Prishtinë dhe komuna tjera, duke përfshirë edhe komuna të banuara me minoritete, lidhur me kushtet për vijimin e mësimin të fëmijëve me aftësi të kufizuara nëpër shkolla publike.

3.6. Personeli i IAP-së

Burimet njerëzore paraqesin një faktor të rëndësishëm në funksion të realizimit të mandatit kushtetues të IAP-së. Numri i të punësuarve për vitin raportues 2014 është 54 të punësuar, dhe ky numër është përcaktuar mbi bazën e ndarjeve buxhetore vjetore. Numri i pozitave të miratuara prej 63 punonjës, sipas kategorisë së zyrtarëve, ndahet si në vijim: gjashtë (6) zyrtarë publikë, të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe pesëdhjetë e shtatë (57) zyrtarë - nëpunës civilë.

Gjatë vitit 2014 janë punësuar katër (4) punëtorë të rinj, me ç’rast njëri nga punonjësit e rinj është nga komuniteti jo shumicë, respektivisht nga komuniteti ashkali. Mirëpo, duhet theksuar fakti se me gjithë përpjekjet, IAP nuk ka arritur ende të plotësojë kërkesën ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në IAP sipas parimit 50+1, për shkak të mungesës së hapësirës – zyrave – për punë në objektin e tanishëm privat me qera.

Një fakt që vlen të theksohet është se tendenca e largimit të kuadrit profesional në vitin 2014 nuk është paraqitur sikurse në vitet paraprake. Mirëpo, edhe gjatë vitit 2014 ka pasur lëvizje të personelit dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës në mënyrë vullnetare, përkatësisht dy (2) punonjës e kanë ndërprerë marrëdhënien e punës. Shkaqet kryesore për shkëputjen vullnetare të marrëdhënies së punës, pas përgatitjes profesionale afatgjate në IAP, janë: akomodimi në vende tjera të punës, për shkak të ardhurave më të larta dhe me kushte më të favorshme të punës se në IAP, apo edhe riorientimi profesional.

Buxheti i IAP-së për vitin 2014 ka qenë i mjaftueshëm për pozitat e miratuara. IAP ende nuk i ka plotësuar të gjitha vendet e punës, në pamundësi të akomodimit të këtyre zyrtarëve për shkak të hapësirës së kufizuara në objektin aktual në pronësi private dhe pa kushte optimale për punë.

IAP është në pritje të amendamentimit të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe ligjeve të tjera, në kuadër të pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, prej të cilave burojnë edhe kompetenca ligjore shtesë për IAP. Prandaj, me qëllim të ushtrimit të kompetencave të reja, përveç sigurimit të hapësirës së re respektivisht objektit të ri në pronësi publike, do të jetë e nevojshme edhe plotësimi i pozitave të tanishme si dhe të mundësohet shtimi i personelit varësisht nga kompetencat të reja.

3.7. Buxheti i IAP-së

IAP është institucion i pavarur i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit “*LAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës*”.⁴⁰⁴ Po sipas kësaj dispozite ligjore, IAP-së i sigurohet buxhet i nevojshëm “*pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera*”.⁴⁰⁵

3.7.1. Financimi i IAP-së nga Buxheti i Kosovës

Duke u bazuar në procesin ligjor për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, Avokati i Popullit i ka parashtruar kërkesën e vet buxhetore për vitin 2014, Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kërkesa buxhetore e Avokatit të Popullit për vitin 2014, është bazuar në planin e punës dhe të aktiviteteve të planifikuara të IAP-së, kurse buxheti i aprovuar për vitin 2014, nga organet vendimmarrëse, është ndarë sipas kërkesës buxhetore.

Pasqyrimi i gjendjes dhe rrjedhës së buxhetit të IAP-së për vitin 2014 është paraqitur në tabelën në vijim. Ndërsa raporti dhe pasqyrimi i detajuar i të gjitha rrjedhave në kuadër të buxhetit të IAP-së, për të gjitha kategoritë e veçanta ekonomike, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas përmbajtjes së formularit të unifikuar për raportim financiar të hartuar nga Komisioni parlamentar për Buxhet dhe Financa.⁴⁰⁶

⁴⁰⁴ Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, neni 34, paragrafi 2.

⁴⁰⁵ Po aty.

⁴⁰⁶ Raporti financiar i detajuar për buxhetin e IAP-së do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas formularit unik për raportime financiare.

Nr.	Kategoritë ekonomike	Kërkesa buxhetore për vitin 2014	Buxheti i ndarë për vitin 2014	Buxheti final për vitin 2014	Buxheti final 2013
1.	Paga dhe mëditje	596.371.00	596.371.00	596.371.00	513.050.00
2.	Mallra dhe shërbime	459.239.00	459.239.00	390.353.15	302.239.00
3.	Shpenzime komunale	30.000.00	30.000.00	25.500.00	23.000.00
4.	Shpenzime kapitale	10.000.00	10.000.00	10.000.00	52.000.00
Gjithsej		1.095.610.00	1.095.610.00	1.022.224.15	890.289.00

Tabela 4: Kërkesa buxhetore dhe buxheti i aprovuar për vitin 2014

Planifikimi dhe shpenzimet buxhetore janë realizuar sipas nevojave dhe destinacionit të përcaktuar për punë dhe funksionim të IAP-së, kurse nuk ka munguar monitorimi dhe kontrolli i brendshëm në shfrytëzimin e buxhetit.

Me vendimin Nr. 01/176, datë 10 mars 2014, Qeveria e Republikës së Kosovës, me destinim të këtij vendimi për rritjen e pagave prej 25% të nëpunësve civilë, IAP-së i janë bërë shkurtime buxhetore në shumë prej 73,385.85 €, sipas këtyre kategorive buxhetore: nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në shumë 68.885.85 € dhe nga kategoria e shërbimeve komunale në shumë prej 4.500.00 €.

Me rastin e përmbylljes së vitit fiskal 2014, IAP pas analizës financiare të gjendjes së buxhetit në raport me mjetet e planifikuara për shpenzim deri më 31 dhjetor 2014, ka identifikuar dhe vlerësuar edhe kursimet buxhetore.

Më 5 dhjetor 2014, IAP ka dërguar njoftimin me shkrim Ministrisë së Financave për kthimin e mjeteve financiare buxhetore në shumë prej 128,000.00 Euro në Buxhetin e Kosovës, mirëpo kjo ministri nuk ka bërë tërheqjen e këtyre mjeteve buxhetore të deklaruara për kthim nga ana e buxhetit të IAP-së.

3.7.2. Buxheti final i IAP-së dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2014

Në tabelën vijuese e paraqesim gjendjen e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2014. Kjo është një tabelë me paraqitje përmbljedhëse e të dhënave mbi kategoritë ekonomike, sipas shpenzimeve të shprehura në përqindje.

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti final 2014	Buxheti i shpenzuar	Të pashlyera	Mjete të lira	Realizimi në %
1.	Paga dhe mëditje	596.371.00	542.558.37	0.00	53.812.63	90.98 %
2.	Mallra dhe shërbime	390.353.15	252.779.03	61.983.60	75.590.52	64.76 %
3.	Shpenzime komunale	25.500.00	14.724.05	1.891.03	8.884.92	57.74 %
4.	Shpenzime kapitale	10.000.00	9.145.00	855.00	0.00	91.45 %
Gjithsej		1.022.224.15	819.206.45	64.729.63	138.288.07	80.14 %

Tabela 5: Buxheti i shpenzuar për vitin 2014

3.7.3. Financimi i IAP-së nga donatorët

Gjatë vitit 2014, IAP-në e kanë përkrahur në aktivitete të ndryshme për ngritjen profesionale të personelit dhe në vizita studimore jashtë vendit, disa nga institucionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë si: Këshilli i Evropës, OSBE, UNDP, Ambasada e Francës etj. Kjo përkrahje e donatorëve është financuar dhe menaxhuar nga vetë donatorët.

3.7.4. Përfundim

Buxheti i kërkuar dhe miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për IAP për vitin 2014 ka qenë i mjaftueshëm. Nuk ka pasur asnjë pengesë apo kufizim të çfarëdo natyre nga ana e Kuvendit në këtë drejtim.

Për vitin 2015, varësisht nga pakoja legislative e ligjeve për të drejtat e njeriut në Kosovë, e cila pritet të miratohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mesin e të cilave do të jenë Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji kundër Diskriminimit dhe Ligji për Barazi Gjinore, IAP do të ngarkohet edhe me tri kompetenca të reja.

Sipas Ligjit kundër Diskriminimit, IAP tani e tutje do të ketë edhe rolin e Institucionit Kombëtar për Barazi dhe kundër Diskriminimit. Sipas Ligjit për Barazi Gjinore, IAP do të ngarkohet edhe me kompetencën e Institucionit Kombëtar për zbatimin e Barazisë Gjinore. Ndërsa një kompetencë e re për IAP do të jetë edhe roli i ri si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT).

Të gjitha këto kompetenca do të përcillen edhe me angazhime shtesë, të cilat do të kërkojnë edhe personel shtesë e rrjedhimisht edhe mjete të reja financiare, personel që duhet të rekrutohet deri në fund të vitit 2015. Natyrisht, menaxhmenti i IAP-së me kohë do të

përgatitë edhe projektbuxhetin për vitin 2015 dhe 2016 duke pasur parasysh këto kërkesa shtesë ligjore dhe do t'i dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës me kohë propozimin për kërkesën buxhetore lidhur me ndarjen e mjeteve të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve dhe misionit të vet Kushtetues dhe ligjor.

Kapitulli IV

Përmbledhja statistikore e rasteve të paraqitura në IAP

Nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2014, në selinë e IAP-së në Prishtinë dhe në zyrat rajonale janë parashtruar 2224 ankesa dhe kërkesa për këshillë apo ndihmë juridike, nga qytetarët e Kosovës. Me Avokatin e Popullit apo zëvendësit e Avokatit të Popullit janë takuar personalisht, 207 ankues, gjatë “*Ditëve të Hapur*” të mbajtura dy herë në muaj në Prishtinë dhe së paku një herë në muaj nëpër komuna të tjera.

Numri më i madh i rasteve të hetuara nga IAP, gjatë periudhës raportuese, kanë qenë kryesisht përkritazi me: të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen e pronës, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtën për mjete juridike etj.

4.1. Ankesat e shpallura të papranueshme nga IAP

Gjatë vitit 2014, IAP ka pranuar 2224 ankesa dhe kërkesa për këshillë juridike nga qytetarët e Kosovës. Pas shqyrtimit të tyre, për 587 ankesa janë hapur hetimet, ndërsa 1637 janë shpallur ankesa të papranueshme⁴⁰⁷, bazuar në kompetencat ligjore të IAP-së. Në krahasim me vitin 2013, këtë vit numri i ankesave të papranueshme është rritur për 177 ankesa apo për afro 9 %.

Arsyet e refuzimit të ankesave të shpallura të papranueshme nga IAP, bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit, shprehur në numra dhe përqindje, janë si në vijim:

- *Neni 20, paragrafi 1.1*⁴⁰⁸ – *S’ka shkelje, keq-administrim* – 487 ankesa ose 30 %
- *Neni 20, paragrafi 1.4*⁴⁰⁹ – *Mos shfrytëzim i mjeteve juridike* – 468 ankesa ose 28 %
- *Neni 20, paragrafi 1.3*⁴¹⁰ – *Në shfrytëzim të mjeteve juridike* – 338 ankesa ose 21 %
- *Neni 19, paragrafi 1.3.1*⁴¹¹ – *Jashtë jurisdiksionit të IAP-së* – 270 ankesa ose 16 %
- *Neni 20, paragrafi 1.2*⁴¹² – *Dështim, mos-interesim i palës* – 43 ankesa ose 3 %
- *Neni 19, paragrafi 1.3.2*⁴¹³ – *Pas afatit ligjor* – 31 ankesa ose 2 %

⁴⁰⁷ Ankesat e papranueshme janë ankesa në për të cilat IAP nuk mund të hapë hetime bazuar në kompetencat e tij të përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit, neni 19 dhe neni 20.

⁴⁰⁸ *Ligji Nr. 03/L-195 për Avokatit të Popullit*, neni 20, paragrafi 1.1 “Kur nga shënimet e paraqitura dhe nga rrethanat e rastit del se të drejtat dhe liritë e njeriut nuk janë shkelur apo nuk është kryer kurrfarë keqadministrimi.”

⁴⁰⁹ *Po aty*, neni 20, paragrafi 1.4 “Kur të gjitha mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme nuk janë shterur, përpos nëse ai vlerëson se do të jetë e padobishme për paraqitësin e ankesës për të filluar apo vazhduar procedurën, apo nëse vlerëson se individët kanë pësuar dëm të madh apo mund të pësojnë dëm të madh dhe të pakompenzueshëm në ndërkohë.”

⁴¹⁰ *Po aty*, neni 20, paragrafi 1.3: “Kur procedurat për një lëndë janë duke u zhvilluar në organet gjyqësore ose në organet e tjera kompetente, përveç në rastet e specifikuar me këtë ligj.”

⁴¹¹ *Po aty*, neni 19, paragrafi 1.3.1 “Nuk është në kompetencën e Avokatit të Popullit sipas këtij ligji.”

⁴¹² *Po aty*, neni 20, paragrafi 1.2: “Kur kërkesa është jo e plotë dhe nuk është kompletuar edhe pas kërkesave të Avokatit të Popullit.”

⁴¹³ *Po aty*, neni 20, paragrafi 19, paragrafi 1.3.2: “Ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë me këtë ligj.”

Të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës, të cilat bazuar në pohimet e ankuesve janë cenuar nga autoritetet e ndryshme publike, marrë parasysh vetëm ankesat e shpallura të papranueshme nga IAP, të shprehura në numra dhe përqindje, (një ankesë mund të ketë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara), janë si në vijim:

- Mbrojtja shëndetësore dhe sociale – 374 ankesa ose 20 %
- E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm – 367 ankesa ose 19 %
- E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit – 297 ankesa ose 15 %
- Mbrojtja e pronës – 274 ankesa ose 14 %
- E drejta për mjete juridike – 211 ankesa ose 11 %
- Të drejtat e të akuzuarit – 117 ankesa ose 6 %
- Barazja para ligjit – 39 ankesa ose 2 %
- E drejta e martesës dhe familjes – 35 ankesa ose 2 %
- E drejta për arsimin – 30 ankesa ose 2 %
- Të drejtat e fëmijës – 29 ankesa ose 2 %
- Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar – 20 ankesa ose 1 %
- Liria e lëvizjes – 17 ankesa ose 1 %
- Të tjera – 96 ankesa ose 5 %

Autoritetet publike përgjegjëse, për të cilat ankuesit pohojnë se kanë bërë shkelje të të drejtave të tyre, të shprehura në numra dhe përqindje, duke pasur parasysh vetëm ankesat e shpallura të papranueshme nga IAP, (një ankesë mund të ketë më shumë se një institucion përgjegjës), janë si në vijim:

- Gjykatat – 470 ankesa ose 28 %
- Ministrinë – 336 ankesa ose 20 %
- Komunitet – 254 ankesa ose 15 %
- Personat privat – 90 ankesa ose 6 %
- Policia – 85 ankesa ose 5 %
- Autoritetet e huaja – 84 ankesa ose 5 %
- Kompanitë private – 64 ankesa ose 4 %
- AKP (ish AKM) – 64 ankesa ose 4 %
- Ndërmarrjet Publike - 43 ankesa ose 3 %
- Prokuroritë Publike – 31 ankesa ose 2 %
- Të tjera – 128 ankesa ose 8 %

Nga analiza e rasteve të refuzuara nga IAP, të ndara sipas autoriteteve publike përgjegjëse kundër të cilave më së shpeshti janë paraqitur ankesa si dhe problemeve të theksuara nga ankuesit, mund të nxirren përfundime të rëndësishme, të cilat në mënyrë plotësuese e kompletojnë pasqyrën e gjendjes së të drejtave të njeriut nga këndvështrimi i rasteve objektivisht ekzistuese, por të cilat janë të papranueshme për IAP, bazuar në kompetencat e tij ligjore.

4.1.1. Ankesat e papranueshme kundër gjykatave

IAP gjatë vitit 2014, ka shpallur të papranueshme 470 ankesa të qytetarëve kundër gjykatave. Nga përmbajtja e ankesave të papranueshme, vërehet se pjesa dërmuese e tyre kanë të bëjnë me pohimet e ankuesve për zvarritje të procedurave gjyqësore. Pjesa tjetër e ankesave kanë të bëjnë me: pakënaqësi lidhur me vendimet e organeve gjyqësore, pamundësinë financiare të angazhimit të avokatit, përpilimin e ankesave, mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, kërkesa për këshilla ligjore etj.

Numri më i madh i këtyre ankesave janë shpallur të papranueshme, pasi bazuar në pohimet e ankuesve dhe dëshmitë e prezantuara, është konstatuar se palët nuk i kanë shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion, apo janë në shfrytëzim të tyre. Pjesa tjetër e ankesave janë refuzuar pas konstatimit se nuk ka shkelje apo keqadministrim në ankesat përkatëse, për shkak se kanë qenë jashtë jurisdiksionit të IAP-së apo edhe për mosinteresim të ankuesve.

Në të gjitha këto raste, ankuesit janë njoftuar dhe këshilluar lidhur me pretendimet e tyre kryesisht për zgjatje të procedurave (nëse ka apo nuk ka zvarritje), janë njoftuar për mjetet juridike që i kanë në dispozicion, mundësinë për përpilimin e ankesave pa pagesë në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas etj. Po ashtu, palët janë informuar edhe për kompetencat ligjore të IAP-së dhe për mundësinë që ata të paraqiten sërish nëse gjendja nuk ndryshon edhe pas shfrytëzimit të mjeteve juridike apo pas kalimit të afateve të caktuara pa veprim të instancave përgjegjëse.

4.1.2. Ankesat e papranueshme kundër ministrive

Gjatë periudhës raportuese, IAP ka shpallur të papranueshme 336 ankesa kundër ministrive. Pjesa më e madhe e këtyre ankesave janë kundër MPMS-së, respektivisht Departamentit për Administratë Pensionale të Kosovës (DAPK) dhe QPS-ve. Si shqetësim kryesor paraqitet refuzimi i kërkesave të ankuesve për pensione të kategorive të ndryshme, ndihma sociale apo edhe ndërprerja e tyre.

Gjatë vitit 2014 ka një dyfishim të ankesave të shpallura të papranueshme kundër DAPK, në krahasim me vitin e kaluar. Numër i konsiderueshëm i ankesave janë edhe lidhur me vendimet e ndryshme të ministrive (posaçërisht lidhur me konteste të punës), heshtjen e autoriteteve qeveritare ndaj parashtrësive të qytetarëve, trajtime joadekuate mjekësore etj.

Gati gjysma e ankesave të lartpërmendura janë shpallur të papranueshme, pasi palët nuk i kanë shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion. Pjesa tjetër e ankesave janë refuzuar pasi nga pohimet e ankuesve dhe dëshmitë e prezantuara, nuk është konstatuar ndonjë shkelje e të drejtave të njeriut apo keq-administrim, palët kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike, ankesat kanë qenë jashtë jurisdiksionit të IAP-së etj.

4.1.3. Ankesat e papranueshme kundër komunave

Gjatë vitit raportues, IAP ka shpallur të papranueshme 254 ankesa të qytetarëve kundër komunave. Këto ankesa kryesisht kanë të bëjnë me çështjen e strehimit, kontestet e punës, të

drejtat pronësore, dështimin e kompensimit për punën e bërë, mospërkrahjes financiare nga komunat për qytetarët me kushte të vështira materiale etj.

Afro 40% të këtyre ankesave, IAP i ka refuzuar pasi nuk ka gjetur shkelje apo keqadministrim, ndërsa për pjesën tjetër të ankesave palët janë udhëzuar dhe këshilluar lidhur me mjetet juridike që i kanë në dispozicion për adresimin e çështjeve të tyre para organeve përgjegjëse komunale etj.

4.1.4. Ankesat kundër autoriteteve të huaja dhe personave privat

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të shpallura të papranueshme, vërehet një numër i konsiderueshëm i ankesave (174 ankesa) kundër personave privat dhe autoriteteve të huaja.

Ankesat kundër personave privat, kanë të bëjnë kryesisht me: mbrojtjen e pronës, mosmarrëveshje të ndryshme, të drejtat martesore etj. Ndërsa në ankesat kundër autoriteteve të huaja, si shqetësim kryesor ngrihet mospagesa e pensioneve nga Serbia, por edhe vështirësitë që hasin ankuesit me rastin e realizimit të kërkesave për pensione apo çështje tjera nga shtetet e huaja.

Në këto raste vërehet mungesë e njohurive të ankuesve për kompetencat kushtetuese dhe ligjore të IAP-së. Megjithatë, në të shumtën e këtyre rasteve përveç se palët njoftohen për kompetencat ligjore të IAP-së, ata këshillohen për hapat që duhet ndjekur dhe institucionet e instancat përgjegjëse për realizimin e të drejtave të tyre.

4.1.5. Përfundim

Të dhënat e prezantuara dëshmojnë se nga numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP, se 74 % e totalit të ankesave të paraqitura gjatë vitit 2014, shpallen të papranueshme menjëherë pas shqyrtimit të tyre, duke u bazuar në kompetencat ligjore të IAP-së. Gati gjysma e këtyre ankesave të shpallura të papranueshme, janë refuzuar ose për arsye se ankuesit nuk i kanë shfrytëzuar mjetet juridike ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike.

Në rastet e mos shfrytëzimit të mjeteve juridike, ankuesit e kanë vizituar IAP-në, për t'u këshilluar lidhur me mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe mjetet juridike efektive që i kanë në dispozicion. Në rastet kur palët janë në shfrytëzim të mjeteve juridike, duket qartë një mosbesim në instancat përgjegjëse për zgjidhjen e rasteve të tyre. Në shumicën e këtyre rasteve, palët vizitojnë IAP-në me shpresën se do t'u ndihmojë që rastet e tyre të zgjidhen në afatin sa më optimal dhe në mënyrë sa më të drejtë, apo se IAP do të marrë përsipër rolin e avokatit mbrojtës. Kjo është një shenjë e qartë e rritjes së besimit në IAP, megjithëse nuk është e ligjshme që Avokati i Popullit të marrë këtë rol dhe nuk e bën atë në asnjë rast.

Nga sa u tha më lartë, përveç humbjes së besimit në autoritetet publike dhe kërkesës për azhuret më të madh të institucioneve përgjegjëse në trajtimin e lëndëve dhe kërkesave të qytetarëve, vërehet një mungesë e informimit të qytetarëve lidhur me mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre në institucionet përgjegjëse në njërën anë, por edhe për mosnjohjen e mandatit të IAP-së, në anën tjetër, të kompetencave të tij ligjore.

Rekomandim

- *Është i domosdoshëm një sensibilizim dhe fushatë informuese për të drejtat dhe obligimet ligjore të qytetarëve, si dhe për misionin dhe kompetencat kushtetuese e ligjore të IAP-së, që do të ndikonte në edukimin e qytetarëve për mjetet efektive ligjore në dispozicion dhe rrjedhimisht uljen e numrit të ankesave të papranueshme në IAP.*

4.2. Paraqitja statistikore e rasteve për vitin 2014

Në tabelat e mëposhtme, në mënyrë të hollësishme, paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2014. Në këto tabela janë të pasqyruara të gjitha llojet e veprimeve dhe të rasteve me shifra absolute. Po ashtu, këtu janë të pasqyruara edhe rastet e zgjidhura nga IAP, raportet për rastet e hetuara dhe rekomandimet e nxjerra në raporte, dështrimet e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së etj.

	Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP	2224
	<i>Numri i personave të përfshirë në ankesat e paraqitura⁴¹⁴</i>	2956
<i>Përkatësia etnike e ankuesve</i>		
	Shqiptarë	1938
	Serb	145
	Boshnjak	34
	Rom	33
	Ashkali	22
	Turq	21
	Egjiptas	18
	Të tjerë	13
<i>Gjinia e ankuesve të paraqitur në IAP</i>		
	Meshkuj	1717
	Femra	507
<i>Autoritetet përgjegjëse ndaj të cilave janë drejtuar ankesat</i> <i>(një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)</i>		
	Gjykatat	665
	Ministritë	474

⁴¹⁴ Një ankesë mund të ketë disa ankues, të cilët pohojnë se u janë shkelur të drejtat nga autoritetet publike.

	Komunat	400
	Policia	125
	Person privatë	91
	Autoritetet e huaja	87
	Agjencia Kosovare për Privatizim	76
	Kompanitë private	70
	Ndërmarrjet publike	53
	Prokuroritë Shtetërore	42
	Të tjera	183

Tabela 6: Ankesat e paraqitura nga qytetarët në IAP gjatë vitit 2014

	Numri i ankesave të shpallura të papranueshme	1637
<i>Baza ligjore e papranueshmërisë së ankesave bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit</i>		
	S'ka shkelje, keqadministrim - Neni 20, pika 1.1	487
	Mos shfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 20, pika 1.4	468
	Në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 20, pika 1.3	338
	Jashtë juridiksionit - Neni 19, pika 1.3.1	270
	Mosinteresim, dështim i palës - Neni 20, pika 1.2	43
	E parashtruar pas afatit ligjor - Neni 19, pika 1.3.2	31

Tabela 7: Ankesat e shpallura të papranueshme gjatë vitit 2014

	Rastet e hapura për hetim nga ankesat e paraqitura nga qytetarët	587
	Rastet e hapura sipas detyrës zyrtare (<i>ex officio</i>)	15
<i>Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara</i>		
	Shqiptarë	470
	Serb	73
	Rom	12
	Boshnjak	10
	Turq	8

	Të tjerë	14
<i>Gjinia e ankuesve bazuar në rastet e hetuara nga IAP</i>		
	Meshkuj	450
	Femra	137
<i>Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP (një rast mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)</i>		
	Gjykatat	195
	Komunat	147
	Ministritë	139
	Policia	40
	Prokuroritë Shtetërore	12
	Agjencia Kosovare për Privatizim	11
	Ndërmarrjet publike	10
	Kompanitë private	6
	Të tjera	59

Tabela 8: Rastet e hapura për hetim në IAP gjatë vitit 2014

	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	180
	Mbrojtja e pronës	95
	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	82
	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	63
	E drejta për mjete juridike	52
	Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	39
	Të drejtat e të akuzuarit	34
	E drejta e qasjes në dokumente publike	28
	Të drejtat e fëmijës	26
	E drejta për arsimin	26
	Barazia para ligjit	26
	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	18
	Përgjegjësia për mjedisin jetësor	10

	E drejta e privatësisë	8
	E drejta për jetën	8
	Liria e lëvizjes	7
	E drejta e martesës dhe familjes	7
	Dinjiteti i njeriut	7
	Raste për ndërmjetësim	6
	E drejta e lirisë dhe sigurisë	4
	Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	4
	E drejta e integritetit personal	2
	Konfesionet fetare	1
	Liria e asociimit	1

Tabela 9: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë
(një rast mund të përfshijë më shumë se një shkëlqje të të drejtave të garantuara)

	Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura	534
Baza ligjore e mbylljes së rasteve bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit		
	I zgjedhur pozitivisht, në pajtim me kërkesën e ankuesit - neni 19, p.1.5.	296
	I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 20, pika 1.3	81
	I papranueshëm, s'ka shkëlqje, keqadministrim - neni 20, pika 1.1	81
	I papranueshëm, mos shfrytëzim i mjeteve juridike - neni 20, pika 1.4	40
	I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - neni 20, p.1.2	22
	I mbyllur me raport	12
	I papranueshëm, jashtë juridiksionit - neni 19, pika 1.3.1	1
	I papranueshëm, ankesë anonime - neni 19, pika 1.3.3	1

Tabela 10: Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura nga IAP gjatë vitit 2014
(jo vetëm rastet e vitit 2014, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)

SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL		
	Gjykata Themelore në Prishtinë	52
	Gjykata e Apelit në Prishtinë	32
	Gjykata Themelore në Gjiilan	18
	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës	17
	Gjykata Themelore në Prizren	17
	Gjykata Themelore në Pejë	14
	Gjykata Themelore në Gjakovë	13
	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	9
	Gjykata Themelore në Mitrovicë	9
	Gjykata Themelore në Ferizaj	8
	Gjykata Supreme e Kosovës	4
	Prokuroria Themelore në Prishtinë	3
	Prokuroria Themelore në Gjakovë	3
	Institucione të tjera (me vetëm nga një rast)	8
AUTORITETET QEVERITARE		
	Shërbimi Korrektues i Kosovës	51
	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	35
	Ministria e Punëve të Brendshme	15
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	7
	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	4
	Ministria e Shëndetësisë	3
	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	3
	Qeveria e Kosovës	3
	Ministria për Kthim dhe Komunitete	3
	Ministria për Punë të Jashtme	3
	Ministria e Infrastrukturës	2
	Institucione të tjera (me vetëm nga një rast)	10

PUSHTETI LOKAL		
	Komuna e Ferizajt	22
	Komuna e Prizrenit	18
	Komuna e Gjakovës	16
	Komuna e Prishtinës	14
	Komuna e Lipjanit	9
	Komuna e Gjilanit	8
	Komuna e Mitrovicës	7
	Komuna e Parteshit	6
	Komuna e Pejës	4
	Komuna e Malishevës	4
	Komuna e Vushtrrisë	4
	Komuna e Leposaviqit	4
	Komuna e Obiliqit	4
	Komuna e Kamenicës	2
	Komuna e Klinës	2
	Komuna e Graçanicës	2
	Komuna e Drenasit	2
	Komuna e Shtërpcës	2
	Komuna e Fushë Kosovës	2
	Komuna e Deçanit	2
	Komuna e Vitisë	2
	Komuna e Istogut	2
	Institucione të tjera (me vetëm nga një rast)	9
PALË TË TJERA PËRGJEGJËSE		
	Policia e Kosovës	40
	Universiteti i Prishtinës	14
	KEDS	12
	Agjencia Kosovare për Privatizim	11

	Agjencia Kosovare e Pronës	3
	Autoritetet e huaja	3
	Presidenca e Kosovës	3
	Komisioni Qendror Zgjedhor	3
	Kuvendi i Kosovës	3
	Korporata Energjetike e Kosovës	3
	Qendra Klinike Universitare e Kosovës	2
	Kompania e Ujësjetës Prishtina	2
	Dogana e Kosovës	2
	Radio Televizioni i Kosovës	2
	Biblioteka Kombëtare Universitare	2
	Institucione të tjera (me vetëm nga një rast)	14
Palë Private		7

Tabela 11: Autoritetet përgjegjëse individuale të rasteve të hetuara nga IAP

(një rast mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)

Autoriteti përgjegjës	<i>Numri i letrave të dërguara nga IAP</i>	Numri i letrave të mbetura pa përgjigje
SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL		
Gjykata Themelore në Prishtinë	52	11
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	24	4
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	9	2
Gjykata Themelore në Pejë	4	1
Prokuroria Themelore në Mitrovicë	1	1
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	1	1
Misioni i EULEX-it	1	1
AUTORITETET QEVERTARE		
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	7	5
Ministria e Punëve të Jashtme	3	3

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	3	3
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	3	3
Ministria për Komunitete dhe Kthim	3	2
Departamenti për Mjekësi Ligjore	2	2
Ministria e Administratës Publike	1	1
PUSHTETI LOKAL		
Komuna e Prizrenit	7	4
Komuna e Prishtinës	9	5
Komuna e Graçanicës	3	2
Komuna e Pejës	3	2
Komuna e Mitrovicës	3	2
Komuna e Kllokotit	2	2
Komuna e Drenasit	2	2
Komuna e Leposaviqit	2	2
INSTITUCIONE TË TJERA PUBLIKE		
Universiteti i Prishtinës	8	3
Presidenca e Kosovës	6	2
Policia e Kosovës	6	2

Tabela 12: Dëshitimet e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së

	Raporte për rastet e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	10
	Raporte për rastet e hetuara <i>ex officio</i>	3
	<i>Rekomandime në Raportet e rasteve të hetuara</i>	28
	Kërkesa për masë të përkohshme	2

Tabela 13: Raportet me rekomandimet dhe kërkesat për masë të përkohshme nga IAP

Autoriteti përgjegjës	<i>Rekomandime të implementuara</i>	<i>Rekomandime të paimplementuara</i>	<i>Në pritje për implementim</i>
Kuvendi i Kosovës		1	7
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural			3
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	1	3	
Ministria e Infrastrukturës	2	1	
Ministria e Punëve të Brendshme		2	
Qeveria e Kosovës		2	
Ministria e Punëve të Jashtme		1	
Agjencia Kosovare e Privatizimit		1	
Komuna e Gjilanit	1		
Agjencia Kosovare e Pronës		1	
Ministria për Komunitete dhe Kthim		1	
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1		
Gjithsej	5	13	10

Tabela 14: Implementimi i rekomandimeve në raportet për rastet e hetuara nga IAP

4.3. Paraqitja grafike e statistikave




Figura 1: Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2014




Figura 2: Përkatësia etnike e qytetarëve të paraqitur në IAP gjatë vitit 2014




Figura 3: Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2014




Figura 4: Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2014




Figura 5: Përkatësia etnike e qytetarëve sipas rasteve të hapura për hetim gjatë vitit 2014




Figura 6: Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP




Figura 7: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë




Figura 8: Rastet e mbyllura nga IAP gjatë vitit 2014

(jo vetëm rastet e vitit 2014, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)




Figura 9: Implementimi i rekomandimeve në raportet për rastet e hetuara nga IAP

Shkurtesat

AKPv	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKPr	Agjencia Kosovare e Pronës
AkK	Agjencia kundër Korrupsionit
AMM	Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit
AOM	Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AShAK	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
ASHMDHP	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
BE	Bashkimi Evropian
BIK	Bashkësia Islame e Kosovës
BSL	Burgu i Sigurisë së Lartë
BSPK	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
CRONSEE	Rrjetin e Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës Juglindore
DAPK	Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës
DÇPB	Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore
DFDIL	Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimat Civile
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DKD	Departamenti kundër Diskriminimit
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
DHPGJSK	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve
ENOC	Rrjeti Evropian i Ombudsmanëve për Fëmijë
EOI	Instituti Evropian i Ombudsmanëve
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
GDF	Grupi për të Drejtat e Fëmijëve
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJKK	Gjykata Kushtetuese e Kosovës
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
ICC	Komiteti Koordinues Ndërkombëtar i Institucioneve Kombëtare
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IOI	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve
IPFK	Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
IKDNJ	Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut
ISHM	Instituti i Shëndetit Mendor
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike
KES	Këshilli Ekonomiko Social
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
KKSB	Këshilli Komunale për Siguri në Bashkësi
KKZ	Komisionit Komunal i Zgjedhjeve
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
KMDF	Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për të Drejtat e Fëmijëve
KOS	Kisha Ortodokse Serbe
KPMK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial të Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Këshilli i Vendvotimit
LPV	Lista Përfundimtare e Votuesve
LQDP	Ligji për Qasje në Dokumente Publike
LGBT	Lesbian, Gay, Bisexual and Transgender
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKPT	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
OHCHR	Zyra e Komisarariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OVL	Organizata e Veteranëve të Luftës
PAK	Personat me aftësi të kufizuar

PLK	Paneli për Lirim me Kusht
QK	Qendra Korrektuese
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QP	Qendra e Paraburgimit
QPS	Qendra për Punë Sociale
QV	Qendra e Votimit
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNHCR	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VV	Vendvotime
ZKGJ	Zyra e Komisionerit për Gjuhë
ZKK	Zyra për Komunitete dhe Kthim
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPD	Zyra e Prokurorit Disiplinor
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë